

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave të edukimit

Viti LXX (70)

2020

Shkodër, 2020

REDAKSIA

Kryeredaktor - Prof. dr. Gëzim DIBRA

Sekretar shkencor - Prof. dr. Fatmir VADOHEJ

*Anëtarë –Prof. dr. Mimoza PRIKU, prof. as. dr. Fatbardha Osmanaga,
prof.as.dr. Arjana Striniqi, prof. as.dr. Dhurata Hoxha, dr. Eranda
HALLUNI, dr. Visar DIZDARI, dr. Besara KADIU*

DREJTOR I REVISTËS

Prof. dr. Suzana GOLEMI

Korrektori dhe punoi në kompjuter: *Arta Bajrami*

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
Seria e Shkencave të Edukimit
Tel/fax: 0035522243747

PASQYRA E LËNDËS

Fatmir VADOHEJ, Fatbardha OSMANAGA

Mësimdhënia në kohën e pandemisë Covid 19 dhe motivimi i studentëve
Teaching during the Covid 19 Pandemic and students' motivation7

Eranda HALLUNI, Edit LEZHA

Rrjetet profesionale në funksion të zhvillimit profesional të mësuesve në
arsimin fillor
*Professional Learning Networks Serving Primary School Teachers Professional
Development*.....21

Dritan DHORA, Lulzime DHORA, Dhimitër DHORA

Specie interesante të faunës së Shqipërisë, të mundshme për t'u njohur
nga shkollarët
*Interesting species of the fauna of Albania,
possible to be recognized by scholars*.....39

Arbana BEKTESHI

Evidentim i gjendjes dhe perspektivës së sportit shqiptar
Evidence of the state and perspective of Albanian sports47

Sokol AXHEMI

Dinamika e mësimdhënies online të disiplinave gjeografike në shkollat e
larta gjatë pandemisë Covid 19
*Dynamics of online teaching of geographical disciplines in high schools during
the Covid pandemic 19*.....63

Valbona KRAJA

Muzeu dhe shkolla si burime reciproke bashkëpunimi
*Museum and school as mutual sources of
cooperation*.....75

Lindita LUTAJ, Helena MUKLI

Të nxënësit në kushtet e mësimdhënies në distancë

Teaching challenges and distance learning.....97

Sidita ZAGANJORI (Karini), Neira MEDJA

Metodikë e zhvillimit të laboratorëve të fiziologjisë së përgjithshme gjatë pandemisë Covid -19

The methodology of general physiology laboratories development during pandemic Covid 19.....107

Galsvinda BIBA, Aurilda MALI

Trendet e përdorimit të medias sociale në procesin e rekrutimit

Trends of using social media in the recruitment process.....121

Lediana XHAKOLLARI, Eralda ZHILLA, Entela XHAKOLLARI

Personaliteti i oficerit të policisë

Police officer personality.....133

Elona HASMUJAJ

Strategjitë e përballimit të bullizmit kibernetik dhe simptomat depresive tek adoleshentët e qytetit të Shkodrës.

Cyberbullying coping strategies and symptoms of depression among adolescents of Shkoder City.....141

Edvin LAME

Impakti i ndryshimit organizacional në përjetimin e nivelit të stresit tek punonjësit

The impact of organizational change on employee experiencing stress levels.....157

Alfred NELA

Vetëvrasjet e pacientëve të hospitalizuar me infeksionin SARS-CoV-2, në Shqipëri

Suicides of patients hospitalized with SARS-CoV-2 infection in Albania.....173

Loreta TOMAJ

Projekti edukativ “Takoj emocionet”

Ndërrhyrje parësore ndaj varësive dhe promovuese e shëndetit mendor të njeriut

Educational project “Meet the emotions”

Primary intervention against addictions

and promoter of human mental health.....187

Megi SHLLAKU (Vjerdha)

Modelet themelore për shpjegimin e çrregullimit të spektrit autik: nga teoria tek përvoja

Basic models for explaining Autistic Spectrum Disorder: from theory to

experience.....205

Arlinda Ymeri

Rëndësia e psikologut shkollor në shmangien e braktisjes së shkollës.

The importance of the school psychologist in avoiding.....213

Brilanda LUMANAJ

Kuptimi dhe implikime praktike të punës sociale ligjore

Understanding and practical implications of forensic social work223

Ledina PREZA, Bujanë TOPALLI

Puna sociale në zonat rurale.

(Rasti i bashkisë Shkodër)

Rural Social Work

(The case of the municipality of Shkodra.....233

Gjulia BEBANI

Sfidat që ndeshin punonjësit socialë në ushtrimin e profesionit të tyre në qendrat komunitare të qytetit të Shkodrës.

The challenges that social workers face in exercising their profession at the

communities centers at the Shkodra.....247

Arena LLAPAJ

Përmbledhje përshkruese e elementeve të punës sociale.

Descriptive summary of elements of social work.....261

Sherif DERVISHI

Veçori të komunikimit në zyrën e pritjes së qytetarëve në rrethanat e pandemisë Covid 19

Peculiarities of communication in the office of citizen services under the circumstances of covid – 19 pandemic.....273

Arjan REXHEPI

Fejesa si institucion paramartesor, rëndësia, dhe roli i tij dje dhe sot.

Engagement as a premarital institution, its importance, and role yesterday and today.....289

MËSIMDHËNIA NË KOHËN E PANDEMISË COVID 19 DHE MOTIVIMI I STUDENTËVE

Fatmir Vadohej, Fatbardha Osmanaga

*Universiteti "Luigj Gurakuqi", departamenti i Mësuesisë, departamenti
Psikologji-Punë Sociale,*

ABSTRAKT

Motivimi konsiderohet si katalizator i sjelljes njerëzore. Ai është një konstrukt shumëdimensional dhe formohet nga faktorët kontekstualë dhe nga karakteristikat individuale. Motivimi është i rëndësishëm për secilin prej nesh, aq më shumë në ditët e sotme. Punimi është përqendruar tek motivimi i studentëve dhe synon të japë informacion lidhur me ndikimin e mësimit online në kohë pandemie në motivimin e tyre. Motivimi akademik ka lidhje me aftësi dhe rezultate pozitive akademike dhe shëndetësore. Ekzistojnë shumë teori lidhur me arritjen e motivimit, si p.sh., teoria e vetëpërcaktimit, teoria social-konjitive, teoritë e vetvetes, teoria e vlerës së pritshmërisë. Janë kryer disa studime lidhur me motivimin e studentëve gjatë kësaj periudhe të pandemisë Covid-19 që po jetojmë. Në pjesën më të madhe të këtyre studimeve rezultoi se ka rënie të motivimit të studentëve, si dhe ekzistojnë vështirësi të natyrave të ndryshme me të cilat studentët po përballen. Janë dhënë konkluzionet dhe sugjerimet përkatëse, duke u ndalur kryesisht në nevojën e kryerjes së studimeve lidhur me motivimin e studentëve tanë, si dhe në drejtim të rritjes së motivimit të studentëve.

Fjalët kyç: motivim, studentë, mësimit.

Teaching during the Covid 19 Pandemic and students' motivation

ABSTRACT

Motivation is considered the catalyst for human behavior. It is a multidimensional construct and is formed by contextual factors and

individual characteristics. Motivation is important to each of us, especially nowadays. The paper focuses on student motivation and aims to provide information about the impact of online teaching in pandemic times on their motivation. Academic motivation is related to positive academic and health skills and outcomes. There are many theories regarding the achievement of motivation, such as the theory of self-determination, the theory of social-cognition, self-theories, expectancy-value theory. Several studies have been conducted regarding student motivation during this period of the Covid-19 pandemic we are experiencing. In most of these studies it turns out that there is a decrease in student motivation, as well as there are difficulties of various natures that students are facing. Relevant conclusions and suggestions are given, focusing mainly on the need to conduct studies related to the motivation of our students, as well as in terms of increasing student motivation.

Keywords: motivation, students, teaching.

Hyrje

Pandemia COVID-19 ka ndryshuar jetën e përditshme, duke imponuar sfida të pashembullta sanitare, politike, ekonomike, sociale dhe arsimore. Mbyllja në shtëpi dhe mbylljet e përkohshme të shkollës kanë prekur, gjithashtu, sistemet arsimore në të gjithë botën (Reimers and Schleicher, 2020; World Bank Group, 2020). Kalimi në mësimin në distancë vendosi një ngarkesë të rëndë për mësuesit, studentët dhe prindërit e tyre (Cachón-Zagalaz et al., 2020; Hiraoka and Tomoda, 2020) (cituar nga Zaccoletti S. et al, 2020).

Sipas UNESCO-s, deri në fund të prillit 2020, 186 vende kanë zbatuar mbyllje në të gjithë vendin, duke prekur rreth 73.8% të totalit të nxënësve të regjistruar (UNESCO, 2020). Edhe pse izolimi dhe distancimi social janë mënyrat e vetme për të ngadalësuar përhapjen e COVID-19 duke thyer zinxhirin e transmetimit, mbyllja e institucioneve arsimore ka prekur një numër të madh studentësh (cituar nga Muthuprasad T. et al., 2021).

Kolegjet dhe universitetet iu përgjigjën pandemisë COVID-19 duke i kaluar online kurset e tyre. Një numër i madh i fakulteteve të cilët kurrë nuk kishin dhënë mësim (biles, nuk kishin mësuar online), ishin papritmas përgjegjës për t'u dhënë mësim studentëve në këtë mënyrë, shumë prej të cilëve nuk kishin mësuar më parë online dhe që nuk e kishin menduar një gjë të tillë kur u regjistruan në kursin e tyre. Për më tepër, studentët me të ardhura të ulëta, kanë më shumë të ngjarë të kenë pajisje kompjuterike të

vjetëruara ose të kufizuara dhe akses më të dobët në internet në shtëpi, duke i vendosur ata në një disavantazh të mundshëm në krahasim me moshatarët e tyre me prejardhje më të pasur. Për më tepër, hulumtimet paraprake mbi të mësuarit online, sugjerojnë që studentët me prejardhje akademike më të dobët mësojnë më mirë në klasat në auditore sesa në kurset plotësisht online (Means B., et al., 2020, f.3).

Rekomandimet e OECD-së (2020) theksojnë se “Zhvillimi i qëndrimeve pozitive ndaj të mësuarit mund t’i ndihmojë studentët të kapërcejnë disa nga sfidat e mundshme të paraqitura nga mësimi online, të tilla si, për shembull, përqendrimi gjatë mësimit online, apo të pasurit e motivimit të mjaftueshëm. Ato janë, gjithashtu, thelbësore në mbështetjen e studentëve në përdorimin në mënyrë efektive të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe në përvetësimin sa më shumë nga teknologjitë e reja për të mësuar. Qëndrimet pozitive ndaj të mësuarit, vetërregullimi dhe motivimi i brendshëm për të mësuar luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e performancës në shkollë në përgjithësi, por mund të jenë veçanërisht të rëndësishme nëse vazhdon mësimi online. Qëndrimet dhe prirjet e studentëve ndikohen në një shkallë të madhe nga mbështetja që marrin nga familjet dhe mësuesit dhe nga modelet që u ekspozohen. Forma të ndryshme të mbështetjes nga familjet dhe mësuesit, duke përfshirë mbështetjen emocionale të prindërve dhe entuziazmin e mësuesve, kanë rezultuar të rëndësishme për zhvillimin e qëndrimeve pozitive ndaj të mësuarit dhe mund të bëjnë që studentët të fitojnë qëndrime dhe prirje të cilat mund të maksimizojnë aftësinë e tyre për të shfrytëzuar sa më shumë mundësitë e mësimit online”.

Punimi synon të japë informacion lidhur me ndikimin e mësimdhënies online në kohë pandemie në motivimin e studentëve. Arsyeja e përzgjedhjes së temës lidhet me faktin se, gjatë kësaj periudhe të punës sonë, kemi pasur dhe momente në të cilat studentët e shprehnin, me fjalë dhe me veprime, lodhjen dhe demotivimin e tyre. Një shqetësim i yni lidhej me faktin se një dukuri e tillë ishte tipike për studentët tanë apo përbënte një dukuri globale? Për këtë arsye vendosëm që të hedhim pak dritë lidhur me motivimin e studentëve në kohë pandemie.

Metodologjia e punimit

Punimi është cilësor dhe bazohet në shfrytëzimin e literaturës. Punimi synon të japë informacion lidhur me ndikimin e mësimdhënies online në kohë pandemie në motivimin e studentëve.

Punimi synon t’i japë përgjigje pyetjes kërkimore: “A ndikon mësimdhënia online në kohë pandemie në motivimin e studentëve?”

Janë përdorur këto kritere për përzgjedhjen e literaturës:

- a) përfshirja e konceptit të motivimit;
- b) përfshirja e konceptit të mësimdhënies online në periudhën e pandemisë së Covid-19;
- c) përfshirja e studimeve të lidhura me motivimin e studentëve.

Trajtimi teorik

Në situatën aktuale pandemike, ku mësuesit duhet të përshtaten me metodat e mësimdhënies pandemike, motivimi i studentit është i një rëndësie të madhe (Nagpal Sh., 2020).

Motivimi është katalizator i sjelljes njerëzore. Schunk dhe Pintrich (2002, f. 5) e përkufizuan motivimin si "procesi përmes të cilit nxitet dhe mbështetet aktiviteti i drejtuar nga qëllimi". Ky përkufizim thekson se motivimi formohet dhe kufizohet si nga faktorët kontekstualë, ashtu dhe nga karakteristikat individuale (Anderman & Dawson, 2011). Motivimi nuk është një koncept njëdimensional; në të vërtetë, ai është një konstrukt kompleks, shumëdimensional që përfshin komponentë të ndryshëm, siç janë besimet, qëllimet, vlerat, dëshirat, nevojat dhe emocionet (Murphy & Alexander, 2000; Wentzel&Wigfield, 2009; Anderman & Dawson, 2011) (cituar nga Zaccoletti S. et al., 2020).

Psikologjia e edukimit ka identifikuar dy klasifikime themelore të motivimit, i brendshëm dhe i jashtëm. Motivimi i brendshëm lind nga dëshira për të mësuar një temë për shkak të interesave të saj të qenësishme, për vetëpërmbushje, kënaqësi dhe për të arritur zotërimin e lëndës. Nga ana tjetër, motivimi i jashtëm është motivimi për të performuar dhe për të pasur sukses për hir të arritjes së një rezultati ose përfundimi specifik. Studentët që janë shumë të orientuar nga notat janë të motivuar nga jashtë, ndërsa studentët që duket se përqafojnë vërtet punën e tyre dhe kanë një interes të vërtetë për të janë të motivuar së brendshmi (cituar nga Teach the Earth, 2021).

Duke pasur parasysh natyrën shumëdimensionale të motivimit studiuesit kanë propozuar teori të ndryshme lidhur me arritjen e motivimit (p.sh., teoria e vetëpërcaktimit, teoria socialkonjitive, teoritë e vetvetes, teoria e vlerës së pritshmërisë). Pavarësisht nga këto teori të lidhura me motivimin, ekziston një konsensus midis studiuesve që motivimi akademik ka lidhje me aftësi dhe rezultate pozitive akademike dhe shëndetësore, të tilla si: vetërregullimi, këmbëngulja, mendimi kritik, arritjet akademike, përfundimi i shkollës, sukcesi në karrierë, mirëqenia psikologjike dhe shëndeti fizik (p.sh., Guay et al., 2008; Archambault et al., 2009; Lai, 2011; De Naeghel et al., 2012; Cerasoli et al., 2014; Kriegbaum et al., 2015; Lazowski e Hulleman, 2016; Yilmaz Soylu et al., 2017; Camacho et al.,

2020) (cituar nga Zaccoletti S. et al., 2020).

Teoria e vetëpërcaktimit (SDT)

Teoria e vetëpërcaktimit (SDT) përfaqëson një kornizë të gjerë për studimin e motivimit dhe personalitetit njerëzor. SDT artikulon një metateori për formulimin e studimeve motivuese, një teori e qartë, e cila përcakton burimet e ndryshme, të brendshme dhe të jashtme të motivimit, si dhe një përshkrim të roleve përkatëse të motivimit të brendshëm dhe llojeve të motivimit të jashtëm në zhvillimin njohës dhe shoqëror dhe në ndryshimet individuale. Ndoshta më e rëndësishmja, pohimet e SDT-së, gjithashtu, përqendrohen në atë se si faktorët socialë dhe kulturorë lehtësojnë ose minojnë ndjenjën e vullnetit dhe iniciativës së njerëzve, përveç mirëqenies së tyre dhe cilësisë së performancës së tyre. Pohohet se rrethanat që mbështesin përvojën e autonomisë, kompetencës dhe përkatësisë së individit nxisin format më të vullnetshme dhe me cilësi të lartë të motivimit dhe angazhimit për aktivitete, duke përfshirë performancën e shtuar, këmbënguljen dhe kreativitetin. Për më tepër, SDT propozon që shkalla në të cilën ndonjë nga këto tri nevoja psikologjike nuk përkrahet ose pengohet brenda një konteksti shoqëror do të ketë një ndikim të fuqishëm dëmtes në mirëqenien në atë mjedis.

Teoria e vetëpërcaktimit sugjeron që njerëzit janë të motivuar për t'u rritur dhe për të ndryshuar nga tri nevoja të lindura dhe universale psikologjike. Kjo teori sugjeron që njerëzit janë në gjendje të vetëpërcaktohen kur plotësohen nevojat e tyre për kompetencë, lidhje dhe autonomi. Koncepti i motivimit të brendshëm, apo përfshirja në aktivitete për shpërblimet e qenësishme të vetësjelljes, luajnë një rol të rëndësishëm në teorinë e vetëpërcaktimit. Teoria e vetëpërcaktimit lindi nga puna e psikologëve Edward Deci dhe Richard Ryan, të cilët fillimisht prezantuan idetë e tyre në librin e tyre të vitit 1985 "Vetëpërcaktimi dhe motivimi i brendshëm në sjelljen njerëzore" (Cherry K., 2019).

Teoria Social Kognitive Sociale (SCT)

Teoria Social Kognitive (SCT) filloi si Teoria e Mësimin Social (SLT) në vitet 1960 nga Albert Bandura. Ajo u zhvillua brenda SCT-së në 1986 dhe pohon që të mësuarit ndodh në një kontekst shoqëror me një ndërveprim dinamik dhe reciprok të personit, mjedisit dhe sjelljes. Karakteristika unike e SCT-së është theksimi i ndikimit shoqëror dhe theksimi i tij në përforcimin shoqëror të jashtëm dhe të brendshëm. SCT e konsideron unike mënyrën se si individët e përvetësojnë dhe e ruajnë sjelljen, duke marrë parasysh edhe mjedisin shoqëror në të cilin individët

kryejnë sjelljen. Teoria merr parasysh përvojat e kaluara të inividit, të cilat faktorizojnë (përfshijnë një sërë faktorësh) nëse veprimi i sjelljes do të ndodhë. Këto përvoja të së kaluarës ndikojnë në përforcimet, pritjet dhe pritshmëritë, të gjitha këto modelojnë nëse një person do të përfshihet në një sjellje specifike, si dhe arsyet pse një person angazhohet në atë sjellje (Wayne W., LaMorte, MD. (2019).

Komponentët kryesorë të SCT-së në lidhje me ndryshimin e sjelljes individuale përfshijnë:

- Vetefikasiteti: Besimi se një individ ka kontroll mbi një sjellje dhe është në gjendje ta kryejë sjelljen.
- Aftësia sjellore: Të kuptuarit dhe aftësia për të kryer një sjellje.
- Pritjet (besimi se diçka do të ndodhë): Përcaktimi i rezultateve të ndryshimit të sjelljes.
- Pritshmëritë (gjendja e të menduarit ose e të shpresuarit se diçka, veçanërisht diçka e mirë, do të ndodhë): Caktimi i një vlere në rezultatet e ndryshimit të sjelljes.
- Vetëkontrolli: Rregullimi dhe monitorimi i sjelljes individuale.
- Të mësuarit vëzhgues: Shikimi dhe vëzhgimi i rezultateve të të tjerëve që kryejnë ose modelojnë sjelljen e dëshiruar.
- Përforcimet: Promovimi i stimujve dhe shpërblimeve që inkurajojnë ndryshimin e sjelljes (Boston University School of Public Health, 2021).

Teoritë lidhur me veten

Carol Dweck përshkruan një seri studimesh të bazuara në mënyrë empirike që shqyrtojnë se si njerëzit zhvillojnë besimet për veten e tyre (d.m.th., teoritë për veten) dhe se si këto teori lidhur me vetveten krijojnë botën e tyre psikologjike, duke formësuar mendime, ndjenja dhe sjellje (Dweck, C. S., 2000). Këto teori tregojnë pse disa studentë janë të motivuar të punojnë më shumë dhe pse të tjerët përvetësojnë modele të të qenit i pafuqishëm dhe janë të vetëmposhtur. Konkluzionet e Dweck eksplorojnë implikimet për konceptin e vetëvlerësimit, duke sugjeruar një rimendim të rolit të tij në motivim dhe të rrethanave që e promovojnë atë. Ajo demonstroi empirikisht se studentët që zotërojnë pikëpamjen e entitetit për inteligjencën kanë më pak të ngjarë të provojnë detyra sfiduese dhe janë në rrezik për mosarritje akademike (Dweck, C. S., 2000; 2006).

Studentët zotërojnë dy lloje pikëpamjesh mbi aftësinë/inteligjencën:

1. **Pikëpamja e entitetit** – Kjo pikëpamje (ata që quhen "Teoricienë të entitetit") e trajtonin iteligjencën si fikse dhe të qëndrueshme. Këta studentë kanë një dëshirë të lartë për të provuar veten e tyre para të tjerëve; të shihen

si të zgjuar dhe të shmangin dukjen jointeligjente.

2. Pikëpamja në rritje (rritëse) – Kjo pikëpamje e trajton inteligjencën si të lakueshme, fluide dhe të ndryshueshme. Këta studentë shohin kënaqësinë që vjen nga procesi i të mësuarit dhe shpesh shohin mundësi për t'u përmirësuar. Ata nuk përqendrohen në atë që rezultati do të thotë për ta, por në atë që ata mund të arrijnë nga marrja pjesë në këtë projekt.

Teoricienët e entitetit janë të ndjeshëm ndaj të qenit i pafuqishëm të mësuar, sepse ata mund të mendojnë se rrethanat janë jashtë kontrollit të tyre (d.m.th. nuk ka asgjë që mund të ishte bërë për t'i bërë gjërat më mirë), kështu që ata mund të heqin dorë lehtë. Si rezultat, ata thjesht mund të shmangin situatat ose aktivitetet që ata i perceptojnë si sfiduese (ndoshta përmes zvarritjes, mungesave në punë etj.). Nga ana tjetër, ata mund të zgjedhin qëllimisht detyra jashtëzakonisht të vështira në mënyrë që të kenë një justifikim për dështim. Së fundi, ata mund të ndalojnë së provuari krejtësisht. Për shkak se sukcesi (ose dështimi) shpesh është i lidhur me atë që perceptohet si një sasi fikse e inteligjencës sesa përpjekje (p.sh., besimi se "Unë u ndava keq, sepse nuk jam një person i zgjuar"), studentët mund të mendojnë se dështimi nënkupton një mungesë natyrore të inteligjencës. Dweck zbuloi se studentët me një histori të gjatë sukcesi mund të jenë më vulnerabël për zhvillimin e të mësuarit të të qenit i pafuqishëm, sepse ata mund të besojnë në pikëpamjen e entitetit të inteligjencës më lehtë sesa ata me më pak sukses (Dweck, C. S., 2000).

Ata me pikëpamjen rritëse ("Teoricienë në rritje") kur përballen me dështim, reagojnë ndryshe: këta studentë dëshirojnë të kapërcejnë sfidat dhe, për këtë arsye, përshtasin një model të orientuar drejt zotërimit. Ata menjëherë fillojnë të marrin në konsideratë mënyra të ndryshme se si ata mund ta trajtojnë detyrën në mënyra të ndryshme dhe ata i shtojnë përpjekjet e tyre. Ndryshe nga teoricienët e entitetit, teoricienët në rritje besojnë se përpjekja, përmes rritjes së të mësuarit dhe zhvillimit të strategjisë, do të rrisë inteligjencën e tyre (Learning Theories, 2020).

Teoria e vlerës së pritshmërisë

Sipas Nicole Arduini-Van Hoose, "Motivimi ndikohet nga disa faktorë, përfshirë përforsimin për sjelljen, por, gjithashtu, edhe qëllimet, interesat dhe sensin e vetefikasitetit dhe vetëpërcaktimit të studentëve. Faktorët kombinohen për të krijuar dy burime të përgjithshme të motivimit: pritshmëritë e studentëve për suksesin dhe vlerën që studentët i japin një qëllimi. Shikimi i motivimit në këtë mënyrë shpesh quhet modeli i vlerës së pritshmërisë për motivimin (Wigfield & Eccles, 2002; Wigfield, Tonk, & Eccles, 2004) dhe shpesh jepet me një formulë shumëzimi: pritshmëri x

vlerë = motivim. Marrëdhënia midis pritshmërisë dhe vlerës është më shumë me natyrë "shumëzimi" sesa me natyrë shtesë, sepse, për t'u motivuar, është e nevojshme që një person të ketë të paktën një pritshmëri modeste për sukses dhe t'i japë një detyrë të paktën një vlerë pozitive. Nëse keni pritshmëri të mëdha për sukses, por nuk e vlerësoni aspak një detyrë (i jepni asaj mendërisht një vlerë "0"), atëherë nuk do të ndiheni aspak të motivuar. Po kështu, nëse e vlerësoni shumë një detyrë, por nuk keni pritshmëri për sukses për ta kryer atë (i jepni asaj një pritshmëri "0"), atëherë edhe ju nuk do të ndiheni aspak të motivuar".

Pritshmëria është gjykimi i një individi për aftësitë e tij. Ai i përgjigjet pyetjes: "A mund ta bëj këtë detyrë?" Vlera është besimi i një individi në lidhje me rëndësinë e diçkaje ose arsytet pse ai mund të angazhohet në detyra të caktuara. Ai i përgjigjet pyetjes: "A dua ta bëj këtë detyrë dhe pse?" Në teorinë e vlerës së pritshmërisë, si pritshmëritë, ashtu edhe vlerat, luajnë një rol të rëndësishëm në parashikimin e vendimeve të ardhshme të një individi, angazhimin, këmbënguljen dhe arritjet e tij. Sipas teorisë së vlerës së pritshmërisë, motivimi varet nga të pasurit e pritshmërive dhe vlerave pozitive të individit (University of Tennessee Knoxville).

Gjetje nga studime të ndryshme

Një studim i Arënliu dhe Bërxulli (2020) mati shqetësimin psikologjik të studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në ditët e para të pandemisë së COVID-19 në Kosovë. Studimi gjeti se 11.4% e studentëve pjesëmarrës kishin raportuar distres të theksuar psikologjik, 13.3% distres psikologjik të moderuar psikologjik, 24.7% distres të lehtë psikologjik, ndërsa 50.6 % e studentëve nuk raportuan aspak distres psikologjik (Arënliu dhe Bërxulli, 2020). Studentët të cilët raportuan se nuk ishin aspak të motivuar për t'u përfshirë në mësimin online, gjithashtu, raportuan nivele të larta (të moderuara apo të theksuara) të distresit psikologjik, në krahasim me studentët që raportuan se ishin shumë të motivuar për të ndjekur mësimet online (cituar nga Duraku Z.H., Hoxha L., 2020, f.3).

Shqipëria është një vend evropian me rreth 2.8 milionë banorë, 15 institucione publike dhe 25 institucione jopublike të arsimit të lartë (IAL) dhe gjithsej 139,043 studentë (viti 2018-2019), shumica e të cilëve janë të regjistruar në IAL publike (113.277, ose 81%) (EACEA, 2020).

Në nivelin kombëtar, niveli i pjesëmarrjes së studentëve ndryshonte në fillim të mbylljes, por ishte në rritje gjatë javëve të fundit. Që nga 20 prilli 2020, numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt gjatë semestrit

aktual online, siç raportohet nga të gjitha IAL-të, është rreth 65.000. IAL-të kanë identifikuar raste kur studentët janë përballur me vështirësi (kryesisht aksesit dhe performanca në internet, kushtet e shtëpisë etj.) dhe stafi po punon për të garantuar mbështetjen e duhur. Sidoqoftë, zbatimi i mësimdhënies dixhitale në Shqipëri pas situatës Covid-19 tregon se stafi akademik është përshtatur shpejt me këtë mënyrë të re të mësimdhënies, megjithëse disa mangësi duhet të adresohen. Kjo përvojë e re për IAL-të ka bërë që stafi akademik të përballlet jo vetëm me pengesa, por edhe të identifikojë nevojën për aftësi dhe kompetenca më të mira dixhitale, duke prezantuar metodologji dhe teknologji të reja në mësimdhënie dhe të nxënies. Kjo përvojë pritet të ndikojë në një numër të madh të IAL, veçanërisht ato publike dhe të inkurajojë rritjen në të ardhmen, jo vetëm të investimeve në fushën e TIK në mësimdhënie dhe mësimnxënie, por edhe për të forcuar zhvillimin profesional të stafit përmes trajnimeve në lidhje me teknologjinë dixhitale dhe metodat e mësimdhënies (EACEA, 2020).

Në studimin e bërë nga Paola Xhelili, Eliana Ibrahim, Erinda Rruci dhe Kristina Sheme (2021, f.105-107) u përfutuan, ndër të jera, këto rezultate: “Vetëm 52.5% e të anketuarve u përshtatën me lehtësi me mësimin online gjatë mbylljes së pranverës 2020 për arsye të COVID-19. Për më tepër, vetëm 14.2% pohuan që procesi i të mësuarit ishte më i lehtë për t’u ndjekur dhe kuptuar online, ndërsa 85.9% e tyre nuk kishin të njëjtin mendim. Më shumë se gjysma e studentëve pohuan se u duhej të ndryshonin metodën e tyre të studimit gjatë studimeve të mësimin online. 47.4% e studentëve pajtohen ose pajtohen plotësisht se kishin vështirësi në marrjen dhe përpunimin e materialeve të kursit për shkak të mungesës së familjaritetit me teknologjinë. Rreth 66.1% e të anketuarve pajtohen ose pajtohen plotësisht që provimet online shkaktojnë më shumë ankth krahasuar me provimet në klasë dhe vetëm 27.6% e tyre pranojnë se mësimi në distancë kishte një ndikim pozitiv në performancën e tyre akademike. Për më tepër, vetëm 32.7% e studentëve, mendojnë se do të ishin në gjendje të arrijnë qëllimet e tyre akademike përmes mënyrës së të mësuarit online. Studentët me performancë të mesme dhe të lartë akademike kishin perceptim më pozitiv në lidhje me ndikimin e teknologjisë sesa ata me performancë të ulët akademike. Rreth 62.9% e studentëve pranuan që aftësitë e tyre teknologjike ishin përmirësuar që nga fillimi i mësimin online dhe 53.5% deklaruan se kishin reduktuar përdorimin e teknologjisë për qëllime argëtimi. Rreth 68.1% e studentëve treguan se ishin më të motivuar në klasë, 5.9% në klasë në mësimin online dhe 26% ishin të motivuar në mënyrë të barabartë në të dy mjediset e të mësuarit. Për më tepër, procesi i të mësuarit për 75.4% të studentëve, ishte

më tërheqës në klasë dhe për 11.2% të mësuarit ishte më interesant gjatë mësimit në distancë. Rreth 64.9% e studentëve pohuan se ata ishin më produktivë dhe të përkushtuar në studimin e tyre gjatë mësimit në klasë, 9.9% gjatë mësimit online dhe 26.1% janë njësoj produktivë në të dy mënyrat. Vetëm 9.8% pohuan se ishin më të përqendruar në mësimin online dhe 13.1% ishin më komunikues gjatë orës online, ndërsa 63.7% ishin më aktivë në klasë dhe 23.2% shfaqin të njëjtën sjellje në të dy mjediset. Gjysma e studentëve (52%) deklaruan se niveli i tyre i frekuentimit ishte i njëjtë, si në leksione online, ashtu edhe në leksione në kampus’’.

Në studimin e bërë nga Meeter dhe kolegët me studentë të programit të studimit Bachelor në psikologji në Universitetin Vrije në Amsterdam, studentëve iu kërkua të vlerësonin motivimin e tyre, përpjekjet dhe rezultatet akademike gjatë qëndrimit në shtëpi dhe t’i krahasonin ato me periudhën përpara COVID-19. Autorët konkluduan se “Në përputhje me pritjet tona, ne zbuluam se studentët raportuan se ishin më pak të motivuar sesa para pandemisë COVID-19. Kjo rënie e motivimit ishte e lidhur me një rënie të përpjekjeve; studentët raportuan se kishin kaluar më pak kohë në studimet e tyre se më parë dhe kishin marrë pjesë në më pak leksione dhe takime të grupeve të vogla’’.

Ulja e motivimit mund të lidhet me më pak lehtësira optimale për mësimin online, ndërsa mungesa e ndërveprimit shoqëror ishte një faktor në pakënaqësinë me mësimin online.

Studentët shprehën një vlerësim më të ulët për leksionet online dhe takimet e grupeve të vogla krahasuar me periudhën jo online. Në komentet e tyre me shkrim ata e përshkruan mësimin online si mungesë të aspektit shoqëror, duke shkaktuar shqetësime për shkak të dështimeve teknike, ose thjesht, “jo arsimim i vërtetë’’.

Mungesa e ndërveprimit shoqëror përbënte kategorinë më të madhe në komentet e studentëve lidhur me faktorët që ndikuan negativisht në motivimin e tyre. Një kategori tjetër e faktorëve demotivues të renditur nga studentët ishin shqetësimet dixhitale - parregullsitë teknike të cilat dëmtojnë mësimin online. Në të vërtetë, rënia e motivimit u shoqërua me mungesën e burimeve të përshtatshme për mësimin online, siç është një vend i qetë për të studiuar dhe lidhja e duhur e internetit.

Studentët, gjithashtu, shpesh bënë komente lidhur me formatet teknike, duke sugjeruar për shembull se leksionet e pararegjistruara mund të paraqiten më mirë sinkronisht (d.m.th., transmetohen në një kohë të caktuar dhe mund të shikohen vetëm atëherë) (Meeter et al., 2020).

Sri Gustiani (2020, f.24) thekson se në universitetet indoneziane “Të mësuarit përmes internetit ka shkaktuar mungesë motivimi për disa

studentë për të mësuar, ndërsa të tjerët ishin shumë të motivuar. Cahyani, Listiana, & Larasati (2020), Rachmat (2020) dhe Simamora (2020) në studimin e tyre raportuan se studentët me mungesë motivimi u ndikuan shumë nga faktorë të jashtëm, si: mjedisi i të mësuarit, koha e të mësuarit dhe mbështetjet instrumentale (ndihma e marrë nga të tjerët), të cilët, nga ana tjetër, ndikuan në rezultatet. Meqenëse mësimi online u krye nga shtëpia, shumë prindër menduan se ende mund të kërkonin ndihmë për të bërë punë shtëpie nga fëmijët e tyre në kohën e tyre të mësimin online. Lidhja e papërshtashme e internetit dhe pajisjet për të pasur akses në mësimin online, gjithashtu, shkaktuan frustrim. Nga ana tjetër, Fitriyani, Fauzi, & Sari (2020) dhe Simamora (2020) argumentuan se faktorët e brendshëm i motivuan shumë studentët e universitetit në mësimin online. Entuziazmi dhe ambicia për të kuptuar dhe për të marrë njohuri të reja i kanë shtyrë ata të studiojnë shumë edhe online. Përveç kësaj, rezilienca dhe gjendja psikologjike, gjithashtu, i ndihmuan ata në mënyrë të favorshme për të patur sukses në të mësuarit online.

Në studimin e bërë nga Vanda Sieber, Anna-Katharina Praetorius dhe Roya Hüppi (2020, f.22), autorët arritën këto konkluzione: “Të gjithë pjesëmarrësit në studim perceptuan më pak kënaqësi me jetën dhe punën/universitetin gjatë pandemisë, si dhe më shumë stres në jetën e tyre të përditshme. Të dhënat përshkruese për qëndrimet ndaj mësimdhënies tregojnë se pedagogët dhe studentët kanë qëndrime relativisht neutrale ndaj e-learning. Analizat statistikore në lidhje me ndërveprimin e kanaleve të komunikimit të përdorura për të dhënë mësim në distancë tregojnë se kanalet e komunikimit sinkron (të cilat ishin përdorur nga një pjesë e madhe e kampionimit) mund të mundësojnë më shumë bashkëveprim student-student, si dhe bashkëveprim student-pedagog krahasuar me kanal komunikues mjaft asinkron të postës elektronike. Edhe nëse mësimdhënia plotësisht online nuk përbënte standard më përpara, studentët raportuan se ndiheshin të mbështetur nga pedagogët e tyre në lidhje me autonominë, kompetencën dhe aftësinë e tyre gjatë asaj kohe. Motivimi gjatë orëve të mësimin ishte mjaft i lartë si për studentët, ashtu dhe për pedagogët. Përgjithësisht, stafi i universitetit që mori pjesë në studim ndihej i mbështetur nga organizata, kolegët dhe eprorët e tyre.

Konkluzione dhe sugjerime

Gjithë njerëzimi po kalon një periudhë të vështirë, si rrjedhojë e pandemisë Covid-19. Ashtu si të gjitha sferat, edhe arsimit po përballë me vështirësi të natyrave të ndryshme. Në këtë kontekst, edhe arsimit universitar nuk bën përjashtim. Mësimi në shumë universitete në botë u kalua online, për periudha të caktuara kohore, në varësi të shkallës së

prekjes nga pandemia, në periudha të ndryshme dhe në vende të ndryshme. Një gjë e tillë përbënte një sfidë si për pedagogët, ashtu edhe për studentët dhe familjet e tyre. Në këto kushte, ndër të tjera, edhe motivimi i studentëve merr një rëndësi të veçantë.

Ekzistojnë shumë teori lidhur me motivimin. Teoria e vetëpërcaktimit sugjeron që njerëzit janë në gjendje të vetëpërcaktohen kur plotësohen nevojat e tyre për kompetencë, lidhje dhe autonomi. Sipas kësaj teorie, rrethanat që mbështesin përvojën e autonomisë, kompetencës dhe përkatësisë së individit nxisin format më të vullnetshme dhe me cilësi të lartë të motivimit dhe angazhimit për aktivitete, duke përfshirë performancën e shtuar, këmbënguljen dhe kreativitetin. Teoria Social Kognitive e vë theksin tek mënyra se si individët e përvetësojnë dhe e ruajnë sjelljen, duke marrë parasysh edhe mjedisin shoqëror në të cilin individët kryejnë sjelljen. Sipas saj, komponentët kryesorë në lidhje me ndryshimin e sjelljes individuale përfshijnë: vetefikasitetin, aftësinë sjellore, pritjet, pritshmëritë, vetëkontrollin, të mësuarit vëzhgues, përforcimet. Teoria e vlerës së pritshmërisë liston dy burime të motivimit: pritshmëritë e studentëve për suksesin dhe vlerën që studentët i japin një qëllimi. Sipas saj, pritshmëri \times vlerë = motivim. Sipas Carol Dweck, studentët zotërojnë dy lloje pikëpamjesh mbi aftësinë/inteligjencën: a) pikëpamjen e entitetit, b) pikëpamjen në rritje (rritëse). Teoricienët e entitetit janë të ndjeshëm ndaj të qenit i pafuqishëm të mësuar, ndërsa ata me pikëpamjen rritëse, kur përballen me dështim, dëshirojnë të kapërcejnë sfidat.

Studimet e bëra lidhur me mësimdhënien online në këtë kohë pandemie zbuluan gjetje të rëndësishme, të cilat janë të lidhura me distresin psikologjik të studentëve, sidomos në ditët e para, rënie të motivimit të tyre, vështirësi të hasura nga ata, të tilla si: aksesit në internet, cilësia e tij, kushtet e shtëpisë, vështirësi në ndjekjen dhe të kuptuarit e leksioneve online, vështirësi në përshtatjen me metodat e reja të mësimdhënies online, vështirësi në përdorimin e teknologjisë, mungesa e ndërveprimit shoqëror, pajisjet jo të duhura teknologjike etj.

Duke pasur parasysh gjetjet teorike dhe gjetjet e studimeve të kryera gjatë periudhës së pandemisë, lind si domosdoshmëri kryerja e një studimi për të analizuar motivimin e studentëve tanë. Gjithsesi, duke u bazuar edhe në praktikën e punës sonë të përditshme, mendojmë se është e nevojshme të punohet për rritjen e motivimit të studentëve. Një gjë e tillë mund të realizohet me sukses përmes përfshirjes së shumë aktorëve, si: pedagogë, studentë, prindër, familjarët e tjerë. Studentët kanë nevojë për kompetencë, lidhje dhe autonomi, për mbështetje nga ana e mjedisit shoqëror. Po kështu,

vëmendje duhet t'u kushtojmë edhe pritshmërive të studentëve dhe qëllimeve të tyre. Nëse ata zhvillojnë pritshmëri të larta dhe vlera të larta në qëllimet e tyre për sukses, motivimi i tyre do të rritet, duke sjellë rezultate më të larta akademike. Stafi akademik luan rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim. Kontributi i tij konsiston në disa aspekte, si p.sh., në drejtim të cilësisë së lartë të mësimdhënies online, në drejtim të mënyrës së komunikimit dhe të mbështetjes së studentëve, në mënyrë që studentët tanë ta përballojnë sa më mirë këtë situatë pandemie.

Referenca

- Boston University School of Public Health (2021). Rural Health Information Hub (aksesuar nga: <https://www.ruralhealthinfo.org/toolkits/health-promotion/2/theories-and-models/social-cognitive>).
- Cherry K. (2019). Self-Determination Theory and Motivation (aksesuar nga: <https://www.verywellmind.com/what-is-self-determination-theory-2795387>).
- Duraku Z.H., Hoxha L. (2020). *Ndikimi i COVID-19 në arsimin e lartë: Studim i bashkëveprimit në mes të shëndetit mendor të studentëve, qëndrimet ndaj të mësuarit online, aftësitë e të mësuarit dhe ndryshimet në jetën e studentëve* (aksesuar nga: https://www.researchgate.net/publication/341654819_Ndikimi_i_COVID-19_ne_arsimin_e_larte_Studim_i_bashkeveprimit_ne_mes_te_shendetit_mendor_te_studenteve_qendrimet_ndaj_te_mesuarit_online_aftesite_e_te_mesuarit_dhe_ndryshimet_ne_jeten_e_studenteve).
- EACEA (2020). Influence of Covid-19 on teaching in Albanian Higher Education (aksesuar nga: <https://supporthere.org/news/influence-covid-19-teaching-albanian>)
- Gustiani S. (2020). Students' motivation in online learning during Covid-19 pandemic era: a case study. *HOLISTICS JOURNAL*, Volume 12, Number 2, p.23-40.
- Learning Theories (2020). Self-Theories (Dweck) (aksesuar nga: <https://www.learning-theories.com/self-theories-dweck.html>).
- Means, B., and Neisler, J., with Langer Research Associates. (2020). Suddenly Online: A National Survey of Undergraduates During the COVID-19 Pandemic. San Mateo, CA: Digital Promise (aksesuar nga: https://digitalpromise.org/wp-content/uploads/2020/07/ELE_CoBrand_DP_FINAL_3.pdf).
- Meeter, M., Bele, T., Den Hartogh, C.F., Bakker, T., De Vries, R.E. & Plak, S. (2020). College students' motivation and study results after COVID-19 stay-at home orders. Vrije Universiteit Amsterdam.
- Muthuprasad T., Aiswarya S., Aditya K.S., Jha G.K. (2021). Students' perception and preference for online education in India during COVID -19 pandemic. *Social Sciences & Humanities Open*. Volume 3, Issue 1 (aksesuar nga: <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S2590291120300905>).
- Nagpal Sh. (2020). Raising Student Motivation During the Pandemic. *Magna Publications* (aksesuar nga: <https://www.facultyfocus.com/articles/effective-teaching-strategies/raising-student-motivation-during-the-pandemic/>).
- Nicole Arduini-Van Hoose. Expectancy-Value Theory. **Provided by:** Hudson Valley Community College (aksesuar nga: <https://courses.lumenlearning.com/edpsy/chapter/expectancy-value-theory/>).

- OECD (2020). Strengthening online learning when schools are closed: The role of families and teachers in supporting students during the COVID-19 crisis (aksesuar nga: <http://www.oecd.org/coronavirus/policy-responses/strengthening-online-learning-when-schools-are-closed-the-role-of-families-and-teachers-in-supporting-students-during-the-covid-19-crisis-c4ecba6c/>).
- Sieber V., Praetorius A., Hüppi R. (2020). Initial report Teaching, motivation, and well-being during Covid-19 from the perspective of university students and lecturers. Technical report. DOI: 10.5281/zenodo.4020377.
- Teach the Earth (2021). Student Motivations and Attitudes: The Role of the Affective Domain in Geoscience Learning (aksesuar nga: <https://serc.carleton.edu/NAGTWorkshops/affective/motivation.html>).
- University of Tennessee Knoxville. Motivational theories (aksesuar nga: <https://mighty Mustangs.utk.weebly.com/expectancy-value-theory.html>).
- Xhelili, P., Ibrahim, E., Rruci, E., & Sheme, K. (2021). Adaptation and perception of online learning during COVID-19 pandemic by Albanian university students. *International Journal on Studies in Education (IJonSE)*, 3(2), 103-111.
- Zaccoletti S., Camacho A., Correia N., Aguiar C., Mason L., Alves R.A., Daniel J.R. (2020). Parents' Perceptions of Student Academic Motivation During the COVID-19 Lockdown: A Cross-Country Comparison. *Front. Psychol.*, <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2020.592670> (aksesuar nga <https://www.frontiersin.org/articles/10.3389/fpsyg.2020.592670/full>).
- Wayne W., LaMorte, MD. (2019). *The Social Cognitive Theory*. Boston University School of Public Health (aksesuar nga: <https://sphweb.bumc.bu.edu/otlt/MPH-Modules/SB/BehavioralChangeTheories/BehavioralChangeTheories5.html>).

RRJETET PROFESIONALE NË FUNSION TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSUESVE NË ARSIMIN FILLOR

Eranda Halluni (Bilali), Edit Lezha

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti i Mësuesisë

ABSTRAKT

Rrjetet profesionale janë një nga format më efektive të zhvillimit profesional në nivelin lokal. Mësuesit, pjesë e rrjetit, kanë përfitime në drejtim të rritjes dhe zhvillimit profesional. Në katër vitet e fundit, Shqipëria ka krijuar struktura për të mbështetur këtë lloj rrjeti profesional. Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë rolin e rrjeteve profesionale në lidhje me zhvillimin profesional të mësuesve të arsimit fillor. Dizajni i kërkimit cilësor u përpoq të identifikonte perceptimet e 9 drejtuesve të rrjeteve profesionale në arsimin fillor. Të dhënat u mbledhën me anë të vlerësimit të raporteve, intervistave gjysmë të strukturuar dhe një fokus grupi. Rezultatet treguan se ekziston një perceptim i përgjithshëm pozitiv midis të gjithë drejtuesve që rrjeti profesional është një strategji e mirë për të lehtësuar të mësuarit bashkëpunues midis mësuesve dhe për të ndihmuar ata në zbatimin e praktikave inovative të nxëniet në klasa. Sipas tyre, burimet e trajnimeve duhet të azhurnohen në mënyrë që të sigurojnë një sasi trajnimesh të përshtashme dhe cilësore për mësuesit bazuar në përparësitë e zhvillimit profesional të tyre.

Fjalë kyçe: rrjete profesionale, zhvillim profesional, përfitime, vështirësi.

Professional Learning Networks Serving Primary School Teachers Professional Development.

ABSTRACT

Professional learning networks are one of the most effective forms of professional development in local level. Teachers, part of a network, have benefits in terms of growth and professional development. In the last four years, Albania has established structures to support this type of professional network. The purpose of this study is to evaluate the role of

professional learning networks related to the professional development of primary education teachers. The qualitative research design attempted to identify the perceptions of 9 network learning leaders in primary education. Data were collected by means of reports assessment, semi-structured interviews and a focus group. The results showed that there is a positive general perception among the all network learning leaders that Professional Learning Network is a good strategy to facilitate collaborative learning among teachers and help to implement learning innovations practices in the classrooms. According to them PLN training resources should be updated in order to provide an adequate qualitative amount of trainings to teachers based on their professional development priorities.

Key words: Professional learning networks, professional development, benefits, challenges.

Hyrje

Sistemi arsimor në Shqipëri pas viteve '90 ka hyrë në një fazë të thellë reformimi që synon përmirësimin e cilësisë së arsimit. Vendosija e demokracisë në Shqipëri, si dhe tranzicioni i tejzgjatur i kalimit nga një sistem në një tjetër, bëri të nevojshëm reformimin e herëpashershëm të sistemit arsimor, i cili edhe sot synon përmirësimin e cilësisë së arsimit. Në arsimin parauniversitar po zbatohet kurrikula e re mësimore bazuar në kompetenca. Kjo kërkon ndryshimin e rolit të mësuesit dhe të shkollës si dhe pritshmëritë ndaj tyre. Mësimdhënia dhe të nxënësve me kompetenca kërkon mësues cilësorë dhe të aftë për të lehtësuar të nxënësve të tyre, të përkushtuar ndaj tyre dhe nevojave të tyre, si dhe t'u sigurojë atyre strategji, mjete dhe burime të përshtatshme për ta bërë të nxënësve më efektiv. Rritja e cilësisë së mësimdhënësve është një faktor kyç në atë që e bën shkollën të suksesshme dhe është rruga më e rëndësishme për të përmirësuar rezultatet e nxënësve (OECD 2009). Sondazhet nga Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA), treguan se vendet që patën përmirësimin e arritjeve dhe barazisë në arsim kishin aplikuar kërkesa më të forta për kualifikimet e mësuesve dhe stimuj për të tërhequr në mësimdhënie profesionistë me arritje të larta, kishin motivuar mësuesit për t'u përfshirë në zhvillimin profesional dhe rritur atraktivitetin ndaj profesionit. Studimi "Sondazhet Ndërkombëtare për Mësimdhënien dhe të Nxënësve" (TALIS), vuri në dukje nevojat urgjente për zhvillim profesional në një sërë temash (të identifikuar nga mësimdhënësit) dhe nivele relativisht të ulëta të bashkëpunimit mes mësuesve. (IZHA, Tetor, 2016, Formimi fillestar i mësuesve në institucionet e arsimit të lartë shqiptar,

fq.14). Përfitimet e një qasjeje vazhdimësie që lidh formimin fillestar të mësuesve me praktikën profesionale, licencimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional janë tashmë të konfirmuara. (Eurydice 2011c, Vaillant dhe Manso 2013).

Në këtë kontekst me rëndësi është zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve dhe drejtuesve për të pasur një arsim cilësor dhe një mësimdhënie efikase. Ai përfshin një seri veprimtarish dhe procedurash që përcaktojnë shkallën e zgjidhjes së problemeve profesionale me kompetencën e duhur dhe sidomos aftësitë e tyre mësimdhënëse. Sipas Kremer (1988), qëllimi i përgjithshëm i zhvillimit profesional të mësuesve është që të mbrohet dhe të përmirësohet cilësia e mësimdhënies, me synimin që mësuesit të bashkëpunojnë për të përmirësuar praktikën mësimore në klasë. Studiues të ndryshëm, si: Rebore (1991), Stanley & Popham (1988), Kremer (1988), Bridges, (1996), kanë nënvizuar se ky qëllim arrihet nëpërmjet:

- Përmirësimi të mësimi duke nxitur vetëzhvillimin dhe ndihmën e kolegëve.
- Dallimit dhe vlerësimi të veprimtarive për zhvillimin e stafit.
- Sigurimi të një lidhjeje komunikimi ndërmjet sistemit shkollor dhe mësuesit.
- Vendimmarrjes në lidhje me pozicionin e mësuesit.

Një nga format e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë sipas udhëzimit nr.1, datë 20.01.2017. “*Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë*” janë rrjetet profesionale.

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Qëllimi i studimit është të vlerësojë rolin e rrjeteve profesionale në zhvillimin profesional të mësuesve të arsimit fillor. Pyetjet kërkimore të parashtruara për studim përfshijnë:

- a) Si realizohet dhe perceptohet funksionimi i rrjeteve profesionale në arsimin fillor?
- b) Cilat janë benefitet e rrjeteve profesionale në lidhje me zhvillimin profesional të mësuesve të arsimit fillor?
- c) Cilat janë vëshirësitë që drejtuesit e rrjeteve përballen në organizimin e takimeve?

Qasja hulumtuese e përzgjedhur për t’i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të studimit është ajo cilësore. Në këtë studim u përfshinë 9 drejtues të rrjeteve profesionale të arsimit fillor që ushtrojnë veprimtarinë e tyre si pjesë e ZA-së Shkodër.

FAZAT E STUDIMIT

Fazat nëpër të cilat është hartuar, zhvilluar dhe konkluduar ky studim janë të paraqitura si më poshtë:

Faza e parë: Njohja e situatës

Faza e parë e studimit ka pasur në fokus të saj hulumtimin me kuadrin teorik që ekzistonte në lidhje me formimin e rrjeteve profesionale në arsimin parauniversitar (specifikisht arsimin fillor) në Shqipëri. Gjatë kësaj faze u shqyrtuan dhe u analizuan paralelisht udhëzimet e MASR-së; akte ligjore dhe nënligjore të politikës arsimore dhe raportet. Kjo fazë siguroi një bazë të rëndësishme për pjesën e hartimit të dizajnit të kërkimit.

Faza e dytë: Hartimi i projektit të kërkimit

Kjo fazë e dytë e studimit u orientua drejt hartimit të dizajnit të kërkimit, qëllimit, objektivave, pyetjeve kërkimore, përcaktimit të kampionit, kohëzgjatjen e studimit, përcaktimin e teknikave të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave. Qasja hulumtuese e përzgjedhur për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të studimit është ajo cilësore. Sipas Willig, C.(2013) kërkimi cilësor lidhet me mënyrën se si njerëzit i japin kuptim botës si dhe përvojave të tyre në jetë dhe kjo është shumë e rëndësishme për t'u referuar edhe në këtë studim, pasi teorizimi i subjekteve do të realizohet brenda kontekstit ku ato ndërveprojnë.

Faza e tretë: Përzgjedhja e kampionit

Gjatë fazës së tretë të studimit, kampioni është përzgjedhur duke përdorur strategjinë e kampionimit jo me probabilitet, kampioni i qëllimshëm (mbi bazën e gjykimit). Në këtë studim u përfshinë 9 drejtues të rrjeteve profesionale të arsimit fillor që ushtrojnë veprimtarinë e tyre si pjesë e ZA-së Shkodër. Arsyeja e përzgjedhjes së drejtuesve të rrjeteve profesionale u bazua si një përpjekje e vetëdijshme nga ana e studiuseve për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore të studimit. Rikujtojmë që roli i drejtuesve ka disa funksione sipas Udhëzimit nr.1, datë 20.01.2017, të MASR, *“Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë të cilat janë si më poshtë:*

Drejtuesi i rrjetit: a) harton në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të rrjetit planin vjetor të veprimtarisë së rrjetit; b) ka përgjegjësi për zhvillimin cilësor të takimeve të rrjetit, nëpërmjet organizimit të përgatitjes paraprake të anëtarëve të rrjetit; c) organizon dhe drejton takimet e rrjetit me një tematikë të caktuar; d) realizon takime të rrjetit dhe përcjell informacionet që merr nga institucione të tjera, si: DAR/ ZA-te, IZHA, ISHA, AKP-ja etj.; e) plotëson listën e pjesëmarrësve me nënshkrimin e çdo pjesëmarrësi dhe e dorëzon te specialisti përkatës i DAR/ ZA-së; f) përgatit raport të shkurtër për çdo takim të rrjetit, si dhe raport vjetor për veprimtaritë e rrjetit

përkatës. Drejtuesi i rrjetit luan edhe rolin e trajnerit për tematika të ndryshme në rrjetin që ai drejton.

Kampionimi i qëllimshëm është një prej llojeve të kampionimit pa probabilitet i cili bëhet në momentin kur vendimi për përfshirjen e pjesëmarrësve merret nga kërkuesi, bazuar në një ose disa karakteristika të caktuara, të tilla si: njohuria e specializuar për çështjen e marrë në studim ose kapaciteti e gatishmëria për të marrë pjesë në studim (Jupp, 2006). Pjesëmarrësit përzgjidhen mbi bazën e karakteristikave apo përvojave që lidhen drejtpërsëdrejti me fushën e interesit dhe pyetjet e studimit, të cilat i lejojnë studiuesit ta studiojë temën në thellësi. Rastet e zgjedhura janë ato që mund të zbulojnë dhe të hedhin sa më shumë dritë mbi fushën e studimit (Matthews & Ross, 2010). Duke analizuar udhëzimin përkatës drejtuesit e rrjeteve kanë peshën më të madhe dhe kryesore të përgjegjësive të realizimit të takimeve në rrjet, por edhe të raportimit të tyre si një zë përfaqësues i nevojave të mësuesve për zhvillimin e tyre profesional.

Faza e katërt: Mbledhja e të dhënave

Faza e katërt ishte faza aplikative e studimit. Studimi u realizua përgjatë vitit shkollor 2020-2021. Në fillim të vitit shkollor me lejen e ZVA Shkodër u mundësua kontakti me drejtuesit e rrjeteve profesionale të arsimit fillor. Drejtuesve iu shpjegua qëllimi i studimit, dizajni i kërkimit, mënyra se si do mbledheshin të dhënat, çështjet etike gjatë studimit dhe se si do përdoren të dhënat gjatë përfundimit të studimit. Kjo fazë pati disa etapa:

Etapa I: Intervista gjysmë e strukturuar

Në këtë etapë u realizuan intervista gjysmë të strukturuar me secilin drejtues të rrjetit. Bazë për strukturimin e pyetjeve të intervistës ishte analiza e udhëzimit të MASR-së; akte ligjore dhe nënligjore të politikës arsimore dhe raportet. Kjo lloj interviste mundëson fleksibilitet dhe lirshmëri në mbledhjen e të dhënave në kontekstin dhe realitetin që kanë dhe ndërveprojnë pjesëmarrësit. Pikërisht për këtë arsye u përzgjedh ky instrument në mënyrë që t'u lejojë pjesëmarrësve t'u përgjigjen pyetjeve dhe të diskutojnë për çështjet në mënyrën se si ata dinë të shprehen, të lejojë studiuesin që të eksplorojë çështjet me pjesëmarrësit, të nxisë pjesëmarrësit të shprehin opinionet dhe ndjenjat e tyre, të jetë fleksibël dhe e përshtatshme për pjesëmarrës të ndryshëm, të garantojë që me secilin pjesëmarrës të diskutohen të njëjtat aspekte të temës së hulumtimit (Matthews & Ross, 2010).

Intervista gjysmë e strukturuar përmbush qëllimin e kërkimit, pasi nxit dhe inkurajon pjesëmarrësin të flasë në thellësi për përvojat dhe opinionet e tij, si dhe eksploron arsyet e sjelljeve apo qëndrimeve të tyre ndaj çështjeve të

caktuara. Struktura e intervistës përfshinte pyetje për të dhënat demografike, pyetje rreth njohurive që ka respondentit për temën që po hulumtohet, pyetje nga eksperiencia, pyetje për opinionet që ka respondentit rreth çështjes, pyetje se si ai ndjehet ndaj çështjes, pyetje për ndjesinë që krijon fenomeni i përjetuar.

Etapa II: Analiza tematike e relacioneve

Pasi u zhvilluan intervistat individuale me drejtuesit e rrjeteve u analizuan transkriptet. Pastaj u analizuan raportet përmbledhëse dhe planet vjetore për takimet që kanë zhvilluar. Analiza u fokusua te temat e takimeve, rezultatet dhe sugjerimet që mësuesit jepnin për çdo takim në lidhje me tematikën në raport me zhvillimin e tyre profesional. Kjo analizë na ndihmoi që të strukturonim guidën për fokus grupin që do të zhvillohej me nëntë drejtuesit nëpërmjet aplikacionit Zoom.

Etapa III: Fokus grupi

Në këtë etapë drejtuesit diskutuan rreth përfitimeve dhe vështirësive të cilat ato ishin ndeshur përgjatë viteve në lidhje me takimet e rrjeteve profesionale. Realizimi i fokus grupit u realizua online nëpërmjet aplikacionit Zoom. Intervista e fokus grupit lejon që pjesëmarrësit të pyeten për perceptimet, mendimet, besimet dhe qëndrimet e tyre për një temë dhe situata të caktuara. Gjatë fokus grupit u diskutuan sfidat për të hartuar dhe realizuar takimet, benefitet që mendonin se mësuesit përfitonin, si e vlerësoni dobishmërinë e takimeve të këtij viti në krahasim me vitet e tjera për shkak të pandemisë etj.

Faza e pestë: Analizimi terësor i të dhënave

Temat dhe nëntema relevante për pyetjet kërkimore u caktuan dhe u përfaqësuan sipas citateve që janë zgjedhur për t'i paraqitur në seksionin e gjetjeve. Ky proces u përsërit për çdo intervistë në mënyrë për të kapur gjerësinë e plotë dhe diversitetin e pikëpamjeve dhe përvojave të drejtuesve (Ritchie & Leëis, 2003). Faza përmbyllet me dhënien e rezultateve dhe rekomandimet përkatëse.

Ku bazohet veprimtaria e rrjetit profesional? Cila është baza ligjore? Cili është dokumentacioni mbi të cilin ngrihet veprimtaria e funksionimi i tij?

Në udhëzimin nr. 1, datë 20.01.2017, "*Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë*", në Nenin 3 "*Format e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë*", thuhet: "Format e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë janë: a) zhvillimi i brendshëm profesional; b) trajnime c) rrjetet profesionale; d) këshillime e) kurset afatshkurtra dhe kurset afatgata."

Po në këtë udhëzim në Kreun XII "*Rrjetet profesionale*", Neni 37

Siç edhe shihet nga tabela, database na jep një informacion të detajuar mbi pjesëmarrësit e rrjeteve profesionale.

Tabela 2. Të dhëna për rrjetet profesionale, Arsim fillor.

Drejtues Rrjeti	Total	Meshkuj	Femra	Kategoria I	Kategoria II	Kategoria III	Kategoria IV	Shkolla që mbulon
E.R	43	5	38	17	20	6	-	"Isa Jakupi", "Ismet Sali Brucaj", "Dedë Gjo Luli", "Haxhi Hajdari", Shtoj i vjetër, "Tringë Smajli", Shtoj i Ri
V.SH	32	-	32	28	4	-	-	"Salo Halili", "Ndre Mjeda".
F.M	28	4	24	8	14	2	4	"Tonc Gjon Toma", Sheldi, "Dëshmorët e Rrencit", "At Gjon Karma", "Zef Jubani"
L.L	31	2	29	22	9	-	-	"Skënderbej", "Azem Hajdari", "Prenkë Jakova"
M.D	22	6	16	11	9	2	-	"Edit Durham", "Bardhaj", "Liria"
S.V	30	2	28	25	5	-	-	"Branko Kadia", "Mati Logoreci", "Pashko Vasa"

D.H.T	34	-	34	25	9	-	-	"Ismail Qemali"e "Xheladin Fishta"
M.K	33	2	31	14	15	4	-	"Ali Laçej" "Qazim Mehja" Zues "Hasan Dardhanjori" Velinaj "Ruzhdi Daka" "Ernest Koliqi" Zogaj
N.D	25	4	21	21	4	-	-	"Martin Camaj" "Dëshmorët e Prishtinës", "Ndoc Mazi"
Totali	278	25	253	171	89	14	4	

Kjo tabelë na jep një informacion më të detajuar në lidhje me numrin e mësuesve të përfshirë në këto rrjete profesionale, ndërtimin, raportin meshkuj/femra, kategoritë që i përkasin mësuesit të përfshirë në të etj. Konkretisht, numri i mësuesve pjesëmarrës në rrjet varion nga 30 deri 35 persona. Ka një numër të madh mësuesesh femra (N=253) kundrejt mësuesve meshkuj (N=25). Numrin më të madh e përbëjnë mësuesit që i përkasin kategorisë së parë (N=171), më pas renditen mësuesit që i përkasin kategorisë së dytë (N=89) dhe mësues që i përkasin kategorisë së tretë (N=14). Një numër shumë i vogël (N=4) janë mësues që i përkasin kategorisë së katërt. Rrjetet profesionale, siç tregohet edhe nga tabela, mbulojnë shkolla të fshatit edhe të qytetit.

Tabela 3. Struktura e planit vjetor të drejtuesit të rrjetit profesional.

Tematikat e takimit të rrjetit	Rezultatet e pritshme	Veprimtaritë	Personi përgjegjës për realizimin e veprimtarisë	Afati kohor i zhvillimit të veprimtarisë

Në këtë tabelë pasqyrohet struktura e planit vjetor të drejtuesit të rrjetit. Në rubrikën "*Tematika*" drejtuesit në bashkëpunim me mësuesit kanë hartuar tematikat sipas interesit dhe nevojave të tyre.

Në rubrikën "*Rezultatet e pritshme në përputhje me secilën tematikë*", drejtuesit kanë përcaktuar edhe rezultatet e pritshme në fund të takimit.

Në rubrikën "*Veprimtaritë nga drejtuesit e rrjetit*", janë përcaktuar të gjitha veprimtaritë që do të zhvillohen për realizimin e tematikave. Po kështu krahas përgatitjes së materialeve për takimin e radhës, përcaktimit të ditës, orës dhe vendit, të bie në sy përgatitja e linkut të vlerësimit si dhe hartimi i raportit për ecurinë e takimit.

Në rubrikën "*Personi përgjegjës për realizimin e veprimtarisë*", janë përcaktuar personat të cilët do të jenë përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë në përputhje me tematikën. Për t'u theksuar është fakti se nuk është vetëm drejtuesi i rrjetit përgjegjës për veprimtarinë, por edhe mësuesit, si kontribues në dhënien apo ofrimin e informacioneve si dhe përgatitjen e materialeve për të diskutuar në takimet e rrjetit.

Në rubrikën "*Afati kohor i zhvillimit të veprimtarisë*", përcaktohet qartë java dhe muaji i zhvillimit të takimit.

Një tjetër dokument mjaft i rëndësishëm, pjesë e dosjes së rrjetit profesional, është edhe "*Raporti i takimit të rrjetit profesional*". Ky dokument përmban rubrika, të tilla si: *Data e takimit*; *Tema e takimit* - vendoset data e zhvillimit të takimit; *Drejtuesi/ emri i drejtuesit të rrjetit*; *Rrjeti* - Arsim fillor; *Numri i anëtarëve në rrjet* - numri i anëtarëve sipas database *Numri i anëtarëve prezent* - numri i anëtarëve pjesëmarrës në takim; *Rezultatet e pritshme* - renditen rezultatet sipas rezultateve të përcaktuara edhe në planin vjetor; *Çështje të diskutuara në takim* - këtu janë të përcaktuara të gjitha çështjet të lidhura me tematikën; *Materiale burimore* - drejtuesit kanë përcaktuar materialet burimore të domosdoshme për zhvillimin e veprimtarive; *Sugjerime e rekomandime* - në këtë rubrikë janë vendosur sugjerimet dhe rekomandimet e shprehura nga mësuesit në fletën e vlerësimit.

REZULTATET E STUDIMIT

Tabela 4. Tematikat e takimeve të rrjeteve profesionale.

Nr.	Tematika	E.R	V.S H	F.M	L.L	M.D	S. V	DH.T	M. K	N .D
1	Mësimi online. Sfida e përbashkët nxënës - prindër-mësues.	x								
2	Mësimdhënia nëpërmjet mjeteve	x		x	x	x			x	x

	teknologjike dhe dixhitale. Platforma Akademia.al									
3	Projektet lëndore dhe ndërlëndore në AF.	x	x		x			x	x	
4	Kultivimi i vetëbesimit të nxënësit për një shëndet të mirë mendor në këtë situatë Covid-19 që po kalojmë.	x								
5	Disiplina pozitive në klasa gjithëpërfshirëse, mësimdashëse, roli i ambientit në nxënie.	x								
6	eTëning, një platformë për të komunikuar, bashkëpunuar, zhvilluar projekte...	x								
7	Krijimtaria dhe rritja e kreativitetit tek nxënësit e Af. Mësimi në natyrë përmirëson shëndetin mendor dhe mirëqenien e fëmijëve	x								
8	Shkolla dhe komuniteti partnerë për arsim më cilësor	x								
9	Testet në AF dhe hartimi i tyre. Shoqëruar me tabelën e specifikimeve BLUEPRINT	x	x	x	x	x	x	x	x	x
10	Analiza vjetore e punës së rrjetit	x								
11	Programi plotësues 31 gusht- 11 shtator 2021. Planet lëndore			x	x		x	x		
12	Udhëzuesi për fillimin e vitit shkollor 2020-2021. Temat mësimore Cjohë shqipe për klasën II-V për vitin shkollor 2020-2021. Përcaktimi i temave të takimeve tona , rr. prof		x	x	x	x	x		x	x
13	Rregullorja për funksionimin e IA						x			

14	Diversiteti në klasën time. Puna e diferencuar për nxënësit me vështirësi në të nxënë						X			
15	Modele testesh, modele detyrash përmbledhëse						X		X	X
16	Metoda, teknika, strategji të mësimdhënies, nxënies						X			
17	Vlerësimi. Nivelet e arritjeve AF			X	X		X	X	X	X
18	Diskutim i programit për VANAF 2021			X		X	X			X
19	Portofoli i të nxënit. Organizimi i portofolit në kl.1-V		X	X	X		X	X	X	X
20	Kurrikula me zgjedhje		X	X						X
21	Lënda Gjuhë shqipe. Përshatja e programit me tekstin		X			X	X	X	X	
22	Matematikë & Shkenca Natyre Përshatja e programit me tekstin		X			X		X	X	
23	Shkenca Sociale, Histori, Gjeografi, Qytetari		X			X		X		
24	Arte, Art pamor, Ed.muzikor, Aftësim Teknologjik		X			X				X
25	Plotësim dokumentacioni (regjistër, deftesa)		X	X	X	X	X	X		X
26	Lidhja ndërmjet rezultateve të të nxënit dhe niveleve të arritjes së nxënësve				X					
27	Masat mbrojtëse ndaj COVID-19, zbatimi i rregullores, komunikimi mësues-nxënës gjatë orës së mësim					X			X	X

Siç edhe shihet nga tabela, tematikat e trajtuara në takimet e rrjetit, janë të lidhura drejtpërdrejt me ato problematika që shqetësojnë mësuesit në veprimtarinë e tyre të përditshme. Tematikat më të trajtuara në takimet e rrjeteve profesionale janë ato të lidhura me punimin e udhëzimit të

fillimvitet, mësimdhënia nëpërmjet mjeteve teknologjike dhe dixhitale, përdorimi i platformës Akademia.al, komunikimi në mësimdhënien online, hartimi i planeve mësimore, përshtatja e programit me tekstin në të gjitha lëndët, hartimi i testeve sipas tabelës së specifikimeve BLUPRINT, plotësimi i dokumentacionit (regjistra, dëftesa), Portofoli i të nxënës, organizimi i portofolit në kl.1-V, projektet lëndore dhe ndërlëndore në AF, diskutimi i programit për VANAF 2021 etj.

Në planin vjetor të drejtuesit të rrjetit rezultatet e pritshme janë të përcaktuara dhe i përshtaten çdo tematike. Në rubrikën "*Veprimtaritë*" drejtuesit, në përputhje me tematikat e përcaktuara, përcaktojnë ditën dhe orën për secilin takim, materialet për takimin, diskutime sipas tematikave, organizimin e takimit online, hartimin e raportit për ecurinë e takimit. Në rubrikën "*Personi përgjegjës*" krahas drejtuesit të rrjetit janë shënuar edhe emrat e personave që do të përgatisin materialet për çdo takim. Në rubrikën "*Afati kohor*" nga drejtuesit është përcaktuar java e takimit. Ka një takim në muaj, zakonisht në javën e parë apo të dytë të çdo muaji.

Në raportet e takimeve marrim të dhëna në lidhje me pjesëmarrjen e mësuesve në takimet e rrjetit. Pjesëmarrja në këto takime është relativisht e lartë. Rezulton një pjesëmarrje që varion nga 90-94% e mësuesve. Kjo justifikohet me faktin se takimet e rrjetit janë zhvilluar online dhe mund të ketë pasur problematika me internetin, ose edhe me orarin e zhvillimit të takimit të rrjetit. Gjithashtu në raportet e takimeve informohemi me atë se çfarë i shqetësojnë mësuesit në punën e tyre, si: "*Kur mund të vlerësojmë një nxënës me notën 5?*" Në raportet e takimeve gjejmë edhe rekomandime të nevojshme për veprimtarinë e mësuesve: "*Kontaktet me prindërit në lidhje me portofolin e nxënësit të jenë efektive*"; "*Të përdoret me përgjegjësi vlerësimi i portofolit, duke planifikuar orë të veçantë për të*"; "*Për matjen e rezultateve të të nxënës, sipas specifikave të lëndëve, është detyrë e mësuesit të përcaktojë a do të bëhet test, a do të prezantojnë temë apo një detyrë përmbledhëse*"; "*Në një test, kufiri më i ulët i pikëve që duhet të marrë nxënësi për të kaluar është 25% e totalit të pikëve*"; "*Projekti ndërkurrikular është më efektiv, pasi përfshihet çdo nxënës*"; "*Të zhvillohet më shumë se një projekt në vit*"; "*Mësuesi të diskutojë me nxënës tema që ju duken më interesante për thellimin e njohurive*"; "*Temat të përshtatshme me tekstet shkollore, kjo për arsye të unifikimit të planeve mësimore*" etj.

Të dhëna të grumbulluara nga fokus grupet:

1.A mendoni se zhvillimi profesional është i rëndësishëm dhe si e vlerësoni ndikimin e tij të mësuesit?

Drejtuesit e rrjeteve profesionale ndajnë të njëjtin mendim: "Zhvillimi profesional i mësuesve është shumë i rëndësishëm dhe kërkon të ketë në fokus të fuqishëm rezultatet e nxënësit. Të gjithë mësuesve u është dhënë mundësia të marrin pjesë në zhvillim profesional, gjë që i ndihmon ata të perfeksionohen dhe t'u përkushtohen nxënësve në progresin dhe suksesin e tyre. Zhvillimi intensiv i vazhdueshëm profesional i orientuar me standarde dhe tregues të matshëm ndihmon mësuesit të "rriten" dhe të vlerësojnë ecurinë e performancës së tyre". Gjithashtu ata e vlerësojnë pjesëmarrjen e mësuesve në rrjetet profesionale si proces shumë të rëndësishëm dhe të domosdoshëm, duke e konsideruar atë madje jetik për përmirësimin dhe zhvillimin e procesit mësimor dhe të qenit mësimdhënës të suksesshëm. Ata vlerësojnë "Zhvillimi profesional ka një ndikim të lartë tek mësuesit ". Ky ndikim është i kushtëzuar nga ndryshimi i kërkesave të nxënësve, përballimi më me sukses i sfidave që përmban procesi mësimdhënës dhe i nxënies, përshtatja e mësuesve me ndryshimet në sistemin arsimor.

2. Pjesëmarrja në rrjetet profesionale a sjell përfitime për mësuesit në aspektin e rritjes dhe të zhvillimit të tyre profesional?

Për këtë pyetje drejtuesit janë të mendimit se pjesëmarrja e mësuesve në rrjetet profesionale ka shumë përfitime në aspektin e rritjes dhe zhvillimit profesional. Asnjë nga drejtuesit nuk mendon se pjesëmarrja e mësuesve në rrjetet profesionale nuk u shërben fare ose u shërben pak në zhvillimin profesional. Ata e shohin rrjetin profesional "si një mekanizëm bashkëpunimi, i cili u jep mundësi anëtarëve të tij të përditësojnë informacionin, të jenë në kontakt me zhvillimet e fundit në rrjet dhe shprehin mendimet e tyre rreth risive dhe zbatimit të tyre në punën e tyre të përditshme, të konsumojnë dhe qartësojnë idetë, si dhe të përcaktojnë më mirë rrugët që duhet të ndjekin si në fushën e planifikimit, ashtu dhe në metodologji, komunikim, etj."

3. A janë përshtatur dhe si ndihen mësuesit me ndryshimin e kurrikulës?

Drejtuesit e rrjeteve mendojnë që jo të gjithë mësuesit e kanë pasur të lehtë të përshtaten dhe të përqafojnë me lehtësi risitë e reformës në arsim. Kështu ata shprehin se pjesa më e madhe e mësuesve e kanë patur të vështirë dhe vetëm një një pjesë e tyre janë përshtatur plotësisht dhe i kanë kaluar vështirësitë e para më shpejt. Mësuesit ndihen në vështirësi ndonjëherë në lidhje me zbatimin e kurrikulës me kompetenca, pasi realizimi i kërkesave që kërkon kurrikula në lidhje me arritjen e rezultateve dhe zhvillimin e kompetencave nga ana e mësuesve, kërkon materiale e mjete të shumta burimore, infrastrukturë të përshtatshme, të cilat në shkollat tona mungojnë.

4. Sa i ndihmojnë mësuesit rrjetet profesionale në informimin dhe këshillimin në lidhje me risitë dhe zhvillimet në fushën e reformave në arsimin fillor ?

Drejtuesit ndajnë mendim të njëjtë në lidhje me këtë pyetje. Ata shprehen se rrjetet ndihmojnë shumë për përmirësimin e mësimdhënies. Pjesëmarrja në to bën të mundur përshkrimin, zhvillimin dhe shkëmbimin e përvojave, si dhe marrjen e informacioneve të reja.

Një pikë shumë e rëndësishme në trajtimin e kësaj teme është edhe evidentimi i nevojave që mësuesit kanë për përmirësimin e punës së tyre në ushtrimin e profesionit duke qenë vazhdimisht në koherencë me risitë. Për këtë shërbeu pyetja se “Cilat tematika janë në interes të mësuesit për të diskutuar në rrjetet profesionale?”

“Drejtuesit e rrjetit janë shprehur që mësuesit kanë shumë interes në diskutimin e tematikave, të tilla si: puna e diferencuar me nxënësit në vështirësi në të nxënë, hartimi i testeve shoqëruar me tabelën e specifikimeve BLUEPRINT, prezantimi i modeleve të testeve dhe detyrave përmbledhëse, nivelet e arritjes në AF, puna me dokumentacionin (regjistra e dëftesa). Me interes janë analiza e diskutimi i planeve për të gjitha lëndët nga klasa I-V, përshatja e tematikave me tekstin, projektet kurrikulare, portofoli i nxënësit etj.”

5. Sa i realizueshëm është feedback-u i takimeve në rrjetin profesional në punën e përditshme të mësuesve?

Kësaj pyetjeje drejtuesit u janë janë përgjigjur “shumë”, gjë që dëshmon për faktin se diskutimet, bashkëbisedimet, shkëmbimet e përvojave, informacioneve etj., që ata marrin në rrjetet profesionale u shërbejnë plotësisht dhe se arrijnë që t'i zbatojnë ato plotësisht në punën e tyre të përditshme. Asnjë drejtues nuk është i mendimit se feedback-u nuk është fare i realizueshëm, gjë që e dëshmon edhe njëherë rëndësinë e padiskutueshme të ngritjes dhe funksionimit të rrjeteve profesionale në arsim.

6. Me çfarë sfidash janë përballur drejtuesit e rrjeteve profesionale në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19?

Drejtuesit shprehen se situata e krijuar nga pandemia Covid-19 i ka vendosur para sfidash, si mësimi online, përdorimi i platformës Akademia.al apo përshtatjen e planeve sipas udhëzimeve të ardhura nga ASCAP. Ja si shprehet një nga drejtuesit:

Drejtuesit e rrjeteve janë gjendur në një situatë aspak të zakonshme, pa përvojën dhe përgatitjen e duhur. U desh që hapi i parë të ishte vendosja e komunikimit me mësuesit përmes rrjeteve sociale. Për to ishte shumë e rëndësishme dhe që në ditët e para iu dedikuan ngritjes (për ata që nuk i kishin) të grupeve në rrjete të ndryshme sociale duke përzgjedhur si mjetin më të shpejtë “whatsapp”. Askush nuk e mendonte gjatë atyre ditëve, që do të kishim një solidaritet kaq të madh nga mësuesit. Kjo evidentoi një fakt të rëndësishëm, pasi mësuesit kuptuan më thellësisht rolin dhe punën e madhe në ngritjen profesionale të tyre. Po kështu mësuesit filluan të bëjnë kërkime dhe të vënë në zbatim metodat e para të mësimdhënies online. Vështirësitë ishin nga më të ndryshmet duke filluar me aksesin që kishin në telefonat e tyre në internetin e limituar, në përballjen për herë të parë me trajnimin nga telefoni dhe jo direkt në klasë, si e vetmja mënyrë që kishim në dispozicion për të mos u shkëputur nga komunikimi. Vështirësi kanë hasur edhe disa mësues që kishin telefona të thjeshtë e jo smart, internet të limituar, të pamësuar në përdorimin e trajnimeve online. Rrjetet profesionale u riorganizuan duke prodhuar dhe publikuar video online në dispozicion të mësuesve. Mungesa e materialeve mësimore dixhitale është ndër pengesat kryesore për përdorimin e platformave dixhitale nga ana e mësuesve.

8. Si e vlerësoni dobishmërinë e takimeve të këtij viti në krahasim me vitet e tjera për shkak të pandemisë?

Drejtuesit shprehen se takimet e realizuara në vitin akademik 2020-2021 janë realizuar në kushte me të vështira se vitet e tjera, por interesimi ka qenë i madh, pasi edhe vështirësitë kanë qenë të mëdha. Pjesëmarrja e lartë dëshmon se ka patur interes për këto takime, gjithashtu edhe tematikat janë në funksion të vështirësive dhe problemeve të hasura gjatë punës së tyre të përditshme. Tematikat e propozuara dhe të trajtuara dëshmojnë se dobishmëria dhe vlera e tyre ka qenë akoma më e madhe në kushtet e pandemisë COVID-19.

PËRFUNDIME

Rezultatet e studimit treguan se rrjetet profesionale, si një nga format e zhvillimit profesional të mësuesve, shihen si domosdoshmëri dhe nevojë për mësuesit e arsimit fillor.

Gjithë veprimtaria e rrjetit profesional si në drejtim qëllimit të ngritjes, ashtu edhe në drejtim të funksionimit të tij bazohet në udhëzimin

nr. 1, datë 20.01.2017, "*Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë*".

Drejtuesit e rrjetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke kontribuar si në drejtim të hartimit në bashkëpunim me anëtarët e rrjetit e planit vjetor dhe miratimin e tematikave të tij, si në zhvillimin cilësor të takimeve, si në drejtim të përgatitjes së tematikave dhe në përcjelljen e informacionit që merr nga institucione, si: DAR/ ZA-te, IZHA, ISHA, AKP-ja etj., si dhe në përgatitjen e raporteve për takimet dhe raportin vjetor për veprimtarinë e rrjetit përkatës.

Roli i rrjeteve është konsideruar jo vetëm i nevojshëm, por edhe shumë efektiv. Veprimtaria e tyre mbështetet në interesat dhe nevojat e mësuesve në shumë aspekte. Takimet e rregullta të përbashkëta me mësuesit, niveli i bashkëpunimit, klima pozitive, diskutimet konstruktive, krijimi i një ambienti në të cilin mësime më të shpejta shkëmbejnë informacionet, ndajnë përvojat me njëri-tjetrin, janë tregues të funksionimit dhe të parit të tyre si vendi ku mund të ndajnë shqetësimet dhe arritjet e tyre.

Në funksionimin e rrjeteve është evidentuar jo vetëm prezenca e mësuesve si dëgjues, por edhe si kontribues në dhënien apo ofrimin e informacioneve e materialeve për të diskutuar në takimet e rrjetit.

Hartimi dhe diskutimi i planeve mësimore, diskutimi i vlerësimit të nxënësve, hartimi i testeve, përgatitja e portofolit, prezantimi i modeleve të orëve mësimore, prezantimi i fazave të projekteve, diskutimi i programit për VANAF 2021, janë tematika mjaft interesante të cilat ndihmojnë mësuesit në realizimin e mësimit dhe në realizimin me cilësi të kurrikulës.

REKOMANDIME

Të zhvillohen në fund të vitit pyetësorë në lidhje me ecurinë e tematikave duke evidentuar pikat e forta dhe të dobëta, me qëllim përmirësimin e mbarëvajtjen e punës në rrjetet profesionale.

Fakultetet e mësuesisë të jenë pjesë e rrjeteve profesionale në funksion të bashkëpunimit më të mirë shkollë-universitet.

Sigurimi i mjeteve apo pajisja e sallave me mjetet e nevojshme përbën një domosdoshëri për mbarëvajtjen e punës në rrjetet profesionale.

Ngritja e qendrave në funksion të rrjeteve profesionale, të cilat të shërbejë jo vetëm për takimet, por edhe për përhapjen e përvojave pozitive si për mësuesit anëtarë të rrjeteve profesionale, ashtu për mësuesit praktikantë.

BIBLIOGRAFIA:

- Bridges, E. M. (1996). Evaluation for tenure and dismissal. In Millman, J. & DarlingHammond, L. (Eds.), *The New Handbook of Teacher Evaluation* (pp. 147-157). Newbury Park: Sage Publications.
- European Commission (2012a). Supporting the Teaching Professions for Better Learning Outcomes. Strasbourg, 20.11.2012. SĒD (2012) 374 final.
- European Commission (2013a). Supporting teacher competence development for better learning outcomes. Brussels: EC.
- European Commission/EACEA/Eurydice (2013). Key Data on Teachers and School Leaders in Europe. 2013 Edition. Eurydice Report. Luxembourg: Publications Office of the European Union. 14. Eurydice (2006). Quality Assurance in Teacher Education in Europe. Brussels: EACEA.
- Jupp, V. (2006). *The SAGE dictionary of social research methods* (Vols. 1-0). London,: SAGE Publications, Ltd doi: 10.4135/9780857020116
- Matheës. B, & Ross. L, (2010). “*Metodat e hulumtimit*”, Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane, Botim i CDE, Tiranë
- Musset P. (2009). Initial Teacher Education and Continuing Training Policies in a Comparative Perspective: Current Practices in OECD Countries and a Literature Review on Potential Effects, OECD Education Working Papers, No. 48, OECD Publishing.
- Raport, IZHA (2016), *Formimi fillestar i mësuesve në institucionet e arsimit të lartë shqipëtar*,
- Ritchie, J., & Lewis, J. (2003). *Qualitative Research Practice—A Guide for Social Science Students and Researchers*. London, Thousand Oaks, CA: Sage Publications Ltd
- Willig, Carla. *Introducing Qualitative Research in Psychology, 3rd edition*. Maidenhead: Open University Press, 2013.
- Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017, “*Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë*”.

SPECIE INTERESANTE TË FAUNËS SË SHQIPËRISË, TË MUNDSHME PËR T'U NJOHUR NGA SHKOLLARËT

Dritan Dhora, Lulzime Dhora *, Dhimitër Dhora **

Agjencia Rajonale e Mjedisit, Zyra Shkodër

* USh "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Shkencave të Natyrës

** Rruga "Hysej", Nr. 40, Shkodër

PËRMBLEDHJE

Lëndët biologjike në shkolla janë reformuar në këto tre – katër dekada, por përsëri ndihet mungesa e njohjes së diversitetit të specieve të faunës tonë, për rrjedhojë edhe të habitateve të tyre. Për të plotësuar mungesën, në këtë artikull jepen 180 specie makroskopike, të zakonshme, interesante nga pikëpamja taksonomike, ekologjike dhe biogeografike, evolutive dhe gjenetike nga fauna e Shqipërisë, që janë të mundshme për t'u njohur nga shkollarët. Më tej kërkohet interesi i institucioneve qendrore të arsimit, që janë përgjegjëse për zhvillimet përmbajtësore të lëndëve mësimore.

Interesting species of the fauna of Albania,
possible to be recognized by scholars

ABSTRACT

Biological subjects in schools have been reformed in these three - four decades, but again there is a lack of recognition of the diversity of species of our fauna and consequently of their habitats. To fill the gap, this article presents 180 macroscopic and common species, interesting in taxonomic, ecological and biogeographic, evolution and genetic viewpoint from the fauna of Albania, which are possible to be recognized by scholars. Further, the interest of the central educational institutions is required, which are responsible for the substantive developments of the subjects.

Hyrje

Një nga objektivat kryesore të lëndëve biologjike që zhvillohen në shkolla është njohja dhe konkretizimi i dukurive biologjike me

biodiversitetin vendor dhe këtu kuptojmë kryesisht biodiversitetin e specieve, atë gjenetik dhe të habitateve.

Këto tre – katër dekadat e fundit programet e lëndëve biologjike kanë pësuar reformim të thellë, duke i dhënë rëndësi anës përmbajtësore dhe shmangur mësimin mekanik, përmendësh, përshekruar. Mirëpo ky zhvillim pozitiv ka larguar disi nga vëmendja njohjen sa e si duhet të specieve të faunës dhe florës tonë, çka siç dihet janë të nevojshme për gjithë jetën.

Pikërisht, këtë problem përpiqet të zgjidh ky artikull, për kafshët e faunës tonë. Artikulli prezanton specie makroskopike, të zakonshme, interesante nga pikëpamja taksonomike, ekologjike dhe biogeografike, evolutive dhe gjenetike të faunës së Shqipërisë, të mundshme për t'u njohur nga shkollarët.

Speciet përcaktohen si të zakonshme bazuar në praninë tërësore në mjedis (HTTP1, GASTON & FULLER 2008). Njohja e tyre ka rëndësi sepse, siç është shkruar tek DHORA (2018), bazuar tek speciet e zakonshme mund të kuptojmë mjaft për habitatet e tyre, diversitetin dhe situatën e tyre. Edhe anasjelltas, duke njohur habitatet e specieve të zakonshme, mund të diskutojmë rreth pranisë ose mungesës së tyre.

Kafshët kanë rol të madh në mjedis, për shëndetin dhe interesat e ndryshme të njeriut, për bujqësinë dhe blegtorinë etj.

Lista e mëposhtme është hartuar duke marrë parasysh të gjithë këta faktorë, gjithashtu dokumentacionin shkollor, ngarkesën dhe mundësitë.

Artikulli trajton aspektin shkencor, por për më tej realizimi konkret në planin didaktik kërkon angazhimin e institucioneve arsimore qendrore.

Materiali dhe metodat

Speciet e zakonshme, makroskopike, të faunës së Shqipërisë janë marrë në artikullin e DHORA (2018). Më tej përzgjedhja ka vazhduar bazuar në disa të dhëna, që në fakt kanë të bëjnë me interesat e njeriut ndaj tyre: rëndësia studimore, roli ekologjik, dëmet në bujqësi, blegtori dhe pyje, përdorimi për ushqim, dëmet ndaj shëndetit të njeriut, përdorimi për qëllime zbukurimi, artizanati, argëtimi etj.

Emrat shkencorë të specieve, grupimi dhe renditja e tyre dhe e taksave tjera janë si tek artikulli i mësipërm. Brenda grupeve, sipas rastit speciet janë ndarë në të ujërave të kripura, të ëmbla dhe të tokës. Emrat shqip dhe anglisht mund të shihen tek DHORA (2008).

Të dhënat mbi interesat janë shënuar me numër dhe janë vendosur sipas specieve, ndërsa në krye të listës është vënë legjenda përkatëse. Lidhur me këto interesa janë konsultuar ALESSANDRINI (1929), APITZENBERGER (2001), ARNOLD & BURTON (1979), DHORA (2002, 2004, 2014), DHORA, D. (2000), JONSSON (1992), KOTTELAT & FREYHOF (2007), MISJA & DHORA (1999), tekstet e biologjisë që përdoren sot në arsimin parauniversitar etj.

Njohja e specieve të listës mund të bëhet në internet, si dhe në koleksionet faktike ose në versionin elektronik të tyre në laboratorin e Zoologjisë të Universitetit të Shkodrës, ose ndonjë universiteti tjetër të vendit.

Rezultatet dhe diskutimi

Specie interesante të faunës së Shqipërisë, të mundshme për t'u njohur nga shkollarët *

Legjenda:

* Specie të zakonshme, makroskopike, interesante të faunës së Shqipërisë.

- 1 Me rëndësi studimore.
- 2 Me rol të rëndësishëm ekologjik – biologjik.
- 3 Të dëmshme për bujqësinë, blegtorinë dhe pyjet.
- 4 Përdoret për ushqim.
- 5 Të dëmshme për shëndetin e njeriut.
- 6 Përdoret për qëllime zbukurimi, artizanati etj.

PORIFERA

Të ujërave të kripura

Spongia officinalis (6), *Suberites domuncula* (1).

CNIDARIA

Të ujërave të kripura.

Actinia equina (1), *Alcyonium palmatum* (1), *Rhizostoma pulmo* (1).

PLATYHELMINTHES

Fasciola hepatica (3), *Taenia solium* (5).

NEMATODA

Ascaris lumbricoides (5).

MOLLUSCA

Të ujërave të kripura.

Gastropoda: *Aporrhais pespelecani* (6), *Bolinus brandaris* (6), *Cerithium vulgatum* (1, 2), *Haliotis tuberculata* (6), *Patella caerulea* (4), *Phorcus turbinatus* (4), *Tonna galea* (6).

Bivalvia: *Acanthocardia tuberculata* (6), *Lithophaga lithophaga* (1, 4), *Macra stultorum* (6), *Mytilus galloprovincialis* (4), *Pecten jacobaeus* (6), *Solen marginatus* (6).

Cephalopoda, *Octopus vulgaris* (2, 4), *Sepia officinalis* (1, 4), *Todarodes sagittatus* (4).

Të ujërave të ëmbla.

Gastropoda: *Lymnaea stagnalis* (1, 2, 6), *Planorbarius corneus* (6), *Viviparus contectus* (1, 6).

Bivalvia: *Anodonta cygnaea* (1, 2, 6)

Të tokës

Gastropoda: *Cornu aspersa* (1, 3, 4), *Helix lucorum* (1, 3, 4), *Helix secernenda* (1, 3, 4), *Limax maximus* (3).

ANNELIDA

Të ujërave të kripura: *Aphrodita aculeata* (1), *Serpula vermicularis* (1).

Të ujërave të ëmbla: *Hirudo verbana* (1).

Të tokës: *Allolobophoridella eiseni* (1, 2).

CRUSTACEA

Të ujërave të kripura: *Callinectes sapidus* (2, 4), *Carcinus aestuarii* (1,2), *Dardanus arrosor* (1), *Palinurus elephas* (4), *Penaeus kerathurus* (4), *Squilla mantis* (2, 4)

Të ujërave të ëmbla: *Astacus astacus* (1), *Potamon fluviatile* (1).

ARACHNIDA

Araneus diadematus (1, 5), *Euscorpius italicus* (1, 5), *Tegenaria domestica* (2, 5).

MYRIAPODA

Scolopendra cingulata (5), *Scutigera coleoptrata* (2).

INSECTA

Odonata: *Libellula depressa* (1, 2).

Blattoptera: *Blatta orientalis* (1, 5).

Manteoptera: *Mantis religiosa* (1, 2).

Phasmoidea: *Bacillus rossius* (1, 2).

Orthoptera: *Acheta domesticus* (1, 5), *Anacridium aegyptium* (1, 3), *Gryllotalpa gryllotalpa* (1, 3).

Homoptera: *Lyristes plebejus* (1).

Hemiptera: *Cimex lectularius* (5), *Eurydema oleracea* (3), *Graphosoma lineatum* (3), *Nesara viridula* (3).

Coleoptera: *Anomala vitis* (3), *Cerambyx cerdo* (3), *Cetonia aurata* (3), *Coccinella septempunctata* (2), *Lampyris noctiluca* (1), *Leptinotarsa decemlineata* (3), *Lucanus cervus* (1), *Melolontha melolontha* (3).

Lepidoptera: *Gonepteryx rhamni* (3), *Iphiclides podalirius* (1), *Pieris brassicae* (1, 3), *Saturnia pyri* (1), *Vanessa atalanta* (1, 3).

Hymenoptera: *Apis mellifera* (1, 4-mjalta), *Bombus terrestris* (2), *Vespa crabro* (1).

Diptera: *Musca domestica* (1, 5), *Tabanus autumnalis* (3).

ECHINODERMATA

Të ujërave të kripura: *Arbacia lixula* (1, 4, 6), *Astropecten aranciacus* (1, 6), *Holothuria tubulosa* (1).

PISCES (4)

Të ujërave të kripura

Condroichthyes: *Mustelus mustelus* (1), *Raja clavata*, *Squalus acanthias*, *Torpedo marmorata* (1).

Osteichthyes: *Alosa fallax* (2), *Anguilla anguilla* (2), *Dicentrarchus labrax* (2), *Hippocampus hippocampus* (1, 6), *Liza ramada* (2), *Merluccius merluccius*, *Mugil cephalus* (2), *Mullus barbatus*, *Platichthys flesus* (2), *Sardina pilchardus*, *Sparus aurata*, *Thunnus thynnus*, *Trachinus draco* (5).

Të ujërave të ëmbla:

Osteichthyes: *Alburnus scoranza*, *Alosa fallax* (2), *Anguilla anguilla* (2), *Cyprinus carpio*, *Liza ramada* (2), *Mugil cephalus* (2), *Onchorynchus mykiss*, *Leucos basac*, *Salmo farioides*, *Salmo letnica* (1, 2).

AMPHIBIA

Bufo viridis (2), *Lissotriton vulgaris* (1), *Pelophylax kurtmuelleri* (1, 4), *Pelophylax shqipericus* (1, 2, 4), *Salamandra salamandra* (1).

REPTILIA (1, 2).

Të ujërave të kripura: *Caretta caretta*.

Të ujërave të ëmbla: *Emys orbicularis*, *Natrix natrix*.

Të tokës: *Elaphe quatuorlineata* (5), *Hemidactylus turcicus*, *Lacerta viridis*, *Malpolon monspessulanus* (5), *Podarcis muralis*, *Pseudopus apodus*, *Testudo hermanni*, *Vipera ammodytes* (5).

AVES (1, 2)

Të ujërave.

Anseriformes: *Anas platyrhynchos* (4), *Cygnus olor* (6), *Anser anser* (4).

Charadriiformes: *Chlidonias hybridus*, *Chroicocephalus ridibundus*.

Ciconiiformes: *Ciconia ciconia* (6), *Egretta garzetta*.

Gruiformes: *Fulica atra* (4).

Pelecaniformes: *Microcarbo pygmeus*, *Pelecanus crispus* (6).

Podicipediformes: *Podiceps cristatus* (4).

Të tokës

Charadriiformes: *Scolopax rusticola* (4).

Columbiformes: *Columba livia* (4), *Streptopelia decaocto*.

Coraciiformes: *Upupa epops* (6).

Cuculiformes: *Cuculus canorus*.

Falconiformes: *Accipiter gentilis*, *Aquila chrysaetos*, *Falco peregrinus*.

Galliformes: *Alectoris graeca* (4, 6), *Coturnix coturnix* (4).

Passeriformes: *Carduelis carduelis* (6), *Corvus cornix*, *Delichon urbica* (6), *Eritacus rubecula*, *Hirundo rustica* (6), *Luscinia megarhynchos* (6), *Motacilla alba*, *Oriolus oriolus*, *Parus major*, *Passer domesticus*, *Pica pica*, *Sturnus vulgaris* (4), *Turdus merula* (4).

Piciformes: *Dendrocopos major*.

Strigiformes: *Athene noctua*, D:\shkurt 21\OneDrive - Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi\Documents and Settings\user\Local Settings\Temporary Internet Files\Content.IE5\ONOXG709\full_results.php*Otus scops*, *Tyto alba*.

MAMMALIA

Të ujërave të ëmbla: *Lutra lutra* (2).

Të ujërave të kripura: *Tursiops truncatus* (1, 6).

Të tokës: *Apodemus flavicollis* (3, 5), *Canis lupus* (3, 5), *Capreolus capreolus* (4, 6), *Erinaceus roumanicus* (4), *Lepus europaeus* (4), *Martes foina* (2, 3), *Meles meles* (3), *Mus musculus* (5), *Mustela nivalis* (2, 3), *Pipistrellus pipistrellus* (2), *Rattus rattus* (5), *Rupicapra rupicapra* (4, 6), *Sciurus vulgaris* (3), *Sus scrofa* (4), *Talpa caeca* (2, 3), *Ursus arctos* (2, 3), *Vulpes vulpes* (2, 3).

Përfundime

Lista me 180 specie makroskopike, të zakonshme, me interes të faunës sonë, do të ndihmojë për t'i bërë mësimet e biologjisë më konkrete, më interesante, më efektive, sepse bazohet në biodiversitetin e Shqipërisë. Këto specie formojnë ekosistemet në Shqipëri dhe kontribuojnë në funksionimin e tyre.

Realizimi i këtij objekti kërkon vazhdimin më tej të këtij studimi biologjik, tani më në planin didaktik, nga institucionet e specializuara arsimore qendrore.

Ndoshta kërkohet që në ribotimet e teksteve të biologjisë të përfshihen ndryshime që lidhen me këtë studim.

Duhet marrë në konsideratë fakti që një pjesë e specieve njihen nga nxënësit, por edhe se një pjesë e tyre mund të njihen nëpër ekskursionet në natyrë, disa të tjera në konkurset dhe aktivitetet e ndryshme që organizohen me këto pikësnyime.

Një rol njohës mund të kryejë kabineti i biologjisë, me ekzemplarë të grumbulluar në natyrë, me tabela me këto specie etj.

Referencat

- ALESSANDRINI, G. 1929: Parassitologia dell' uomo e degli animali domestici. UTT, Torino. Pag: 565, con 413 figure.
- APITZENBERGER, F. 2001: Die Säugetierfauna Österreichs. BL- und UW. 895 p. Graz.
- ARNOLD, E. & BURTON, J. 1979: Pareys Reptilien – und Amphibienführer Europas. 270 p. Verlag Paul Parey, Hamburg und Berlin.
- DHORA, DH. 2002: Studime mbi molusqet e Shqipërisë / Studies on the molluscs of Albania. *Camaj-Pipa*, Shkodër. 210 faqe.
- DHORA, DH. 2004: Mbi molusqet e Shqipërisë / On the molluscs of Albania. *Camaj-Pipa*, Shkodër. 196 faqe.
- DHORA, DH. 2008: Fjalor i emrave të kafshëve të Shqipërisë, latinisht, shqip, anglisht. 288 faqe. *Camaj-Pipa*. Shkodër.
- DHORA, DH. 2014: Programi i lëndës Zoologji invertebrore (për vitin akademik 2014 – 2015). USh “Luigj Gurakuqi”, FShN, departamenti i Biologji – Kimisë. 4 fq.

- DHORA, DH. 2018: Listë paraprake e specieve të zakonshme të faunës së Shqipërisë. Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi”, Nr. 68, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 88 - 102.
- DHORA, D. 2000: Kafshët tona. 76 f. Camaj – Pipa.
- GASTON, K. J. & FULLER, R. A. 2008. Commonness, population depletion and conservation biology. Trends in Ecology and Evolution, 23, 14-19.
- [HTTP1://en.wikipedia.org/wiki/Common_species](http://en.wikipedia.org/wiki/Common_species)
- JONSSON, L. 1992: Birds of Europe with North Africa and the Middle East. 559 pp. Christopher Helm A & C Black – London.
- KOTTELAT, M. & FREYHOF, J. 2007: Handbook of European freshwater fishes. Cornol, Switzerland. 646 p.
- MISJA, K. & DHORA, DH. 1999: Udhëheqës i praktikave mësimore në terren. 218 f. ShBLU Tiranë.

EVIDENTIM I GJENDJES DHE PERSPEKTIVES SË SPORTIT SHQIPTAR

Arbana Bektashi

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti i Edukimit fizik e Sporte.

ABSTRACT

Studimi ynë bazohet në regjistrat dhe arkivat e federatave sportive dhe në bashkëpunim me to është bërë e mundur nxjerrja e të dhënave për numrin e pjesëmarrësve në aktivitetet sportive për të gjitha grupmoshat, numrin e trajnerëve, numrin e objekteve sportive për garat dhe stërvitja e sporteve, numri i aktiviteteve sportive sipas grupit dhe niveli i rezultateve sportive, veçanërisht për sportin individual.

E gjithë kjo për të analizuar perspektivën e sportit kombëtar dhe përmes këtij studimi mund të arrihet në ngritjen e një grupi ekspertësh për të studiuar legjislacionin sportiv në tërësi. Pas identifikimit të situatës dhe perspektivës, është detyrë e organizatave të vendosin midis politikave të përcaktuara mirë për referimin e studimit.

Theksi vihet edhe një herë në identifikimin e situatës për të ndërtuar një strategji kombëtare për sportin dhe më pas: vizionin dhe përparësitë strategjike, rezultatet e pritshme dhe matricën ekonomike.

Studimi ka si mision pasurimin e historisë së sportit shqiptar si dhe detajet e specifikuar për secilin nga dimensionet e këtij studimi bazohen në punën kërkimore dhe metodologjike të shumë punonjësve të IKSHS të cilët kanë kontribuar në përmirësimin e pjesshëm dhe total të kushtet e strategjive, për të përmirësuar situatën.

Evidence of the state and perspective of Albanian sports

ABSTRACT

Our study is based on the records and archives of sports federations and in cooperation with them it has become possible to extract data on the number of participants in sports activities for all age groups, the number of

coaches, the number of sports facilities for competition and training sports, the number of sports activities by group and the level of sports results, especially for individual sports

The data of this study were compared in two periods: the one in 2003 and the one in 2010. All this to analyze the perspective of national sports and through this study can be achieved in setting up a group of experts to study sports legislation in its entirety. After identifying the situation and perspective, it is the task of the organizations to decide between the well-defined policies on the study referral.

Emphasis is placed once again on identifying the situation to build a national strategy for sport and then: vision and strategic priorities, expected results and economic matrix.

The study has as mission the enrichment of the history of Albanian sport as well as the details specified for each of the dimensions of this study are based on the research and methodological work of many employees of IKSHS who have contributed to the partial and total improvement in terms of strategies, to improve the situation.

Objekti i studimit

Për realizimin e këtij studimi janë shfrytëzuar arkivat e federatave dhe të dhënat e studimeve të mëparshme të realizuara nga IKSHS. Po ashtu, grupi studimor, ka hartuar formularë përkatës për secilën çështje që është marrë në studim në drejtim të:

- Evidencimit të gjendjes së pjesëmarrjes së sportistëve, evidencim i cili është ndarë në tri pjesë; për moshat deri 14 vjeç, 15-19 vjeç dhe mbi moshën 20 vjeç, veç për femra dhe për meshkuj për secilin sport. (formulari nr. 1)
- Evidencimit të gjendjes së licencimit të trajnerëve, nivelit të kualifikimit të tyre në metodologjinë e stërvitjes sportive dhe mosha e trajnerëve e ndarë në dy klasifikime. (formulari nr.2)
- Evidencimit të gjendjes së bazës materiale në tërësi dhe të stërvitjes në veçanti. Numri i tyre në bazë klubesh sportive dhe gjendja e tyre teknike. (formulari nr.3)

- Nivelit të cilësisë sportive dhe premisave për të ardhmen. (Studimi i rezultateve më cilësore)

Këto të dhëna të grumbulluara, me anë të formularëve dhe me ndihmën e sekretarëve të përgjithshëm të federatave, do t'i nënshtrohen analizës krahasimore të vitit 2016 me vitet 2003 dhe 2010.

Synimet e studimit

Synimet e studimit janë konceptuar dhe bazuar në një metodologji të caktuar, të cilat janë të ndërvarura nga të dhënat e dala nga plotësimi i formularëve për një apo më shumë çështje të caktuara. Prej analizës shkakore kemi dalë në nxjerrjen e disa synimeve kryesore për këtë temë studimore, të cilat janë:

1. Nëpërmjet përpunimit të të dhënave të dala nga plotësimi i formularit nr.1 do të arrihet të dalin disa përfundime në drejtim të nivelit të pjesëmarrjes në sportin kombëtar vetëm për atë garistik.
2. Përpunimit të të dhënave të formularit nr.2, i cili do të ndihmojë në daljen e përfundimeve për moshën e trajnerëve dhe rrugët metodologjike të kualifikimit dhe licencimit të tyre.
3. Evidencimit të bazës materiale në përgjithësi dhe atë të stërvitjes në veçanti, për të parë e vlerësuar metodologjinë e mësim-stërvitjes me modelet dhe standardet e përparuara euro-atlantike.
4. Niveli i garimit në përgjithësi dhe ballafaqimi me të përparuarën e kohës ka qenë një prej synimeve të këtij studimi, i cili përveç të tjerave do të evidencojë edhe perspektivën duke u bazuar kryesisht tek masiviteti cilësor i çdo disipline sportive.

Zhvillimi i studimit

Ky studim është i ndarë në dy pjesë kryesore, të cilat janë radhitur si në vartësi me synimet e studimit, ashtu dhe me kërkesat që ka një studim i formatit të evidencimit të gjendjes dhe mundësisë së zhvillimit të tij në

vazhdimësi. Pra, ky studim është i një rëndësie të veçantë, pasi do të shërbejë edhe si parastudim për punimet e tjera shkencore që cekin problemet e cilësisë sportive. Njëherësh, duhet theksuar, se për realizimin e këtij studimi kanë dhënë ndihmesën e tyre edhe sekretarët e përgjithshëm të federatave të atletikës, futbollit, basketbollit, volejbollit, peshëngritjes, mundjes, gjimnastikës, skive, boksit, hendbollit, alpinizmit, karatesë, xhudos, taekwondos, shahut, badybuilding, sportit për të gjithë etj. Përveç sa më sipër, ne mendojmë, se ky studim do të shërbejë edhe për sensibilizimin e mjediseve politiko-ekzekutive, mjedise të cilat shërbejnë për plotësimin e rrugëve, mjeteve dhe metodave për ecuri më cilësore në të ardhmen.

Analiza socialdemografike

Studimi i gjendjes dhe perspektivës së sportit ka një rrugëtim disavjeçar dhe daton me vitin 2003. Që nga ajo kohë e deri më sot Instituti Kërkimor Shkencor i Sportit ka bërë të mundur të pajisë institucionet sportive me të dhëna në drejtim të numrit të pjesëmarrësve në aktivitete sportive, numrit të trajnerëve, numrin e impianteve sportive të garimit dhe të stërvitjes, cilësinë sportive që është shfaqur këto 13 vjetët e fundit etj. Ndërkohë, për ta bërë më të prekshëm këtë studim, po japim nivelin e treguesve në shifra të marra nga bashkëpunimi me drejtuesit e federatave sportive kombëtare dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i sportistëve të licencuar nëpër federatat sportive gjatë vitit 2016.

Tabela nr.1

Nr.	SPORTET	Numri i pjesëmarrësve		Gjithsej
		Meshkuj	Femra	
1.	Atletikë	228	87	315 atletë
2.	Alpinizëm	235	20	255 alpinistë
3.	Basketboll	670	245	915
4.	Boks	240	---	basketbollistë
5.	Çiklizëm	106	---	240 boksierë
6.	Gjymnastikë	62	168	106 çiklistë
7.	Hendboll	120	64	230 gjymnastë
8.	Karate	90	88	184
9.	Mundje	324	---	hendbollistë
10.	Peshëngritje	133	4	178 karateistë
11.	Ski	214	15	324 mundësa
12.	Volejboll	264	612	137
13.	Futboll	13.825	169	peshëngritës
14.	Taekwondo	84	68	229 skiatorë
15.	Xhudo	79	61	876
16.	Tenis	214	126	voleibollistë
17.	Sportet jo olimpike	1486	658	13940
				futbollistë 152 karateistë 140 xhudistë 340 tenistë 2144 sportistë
	Gjithsej	16.598 meshkuj	1.585 femra	18.183 sportistë

Numri i përgjithshëm i sportistëve të licencuar nëpër federatë është 18.183, nga moshat e vogla deri tek të rriturit. E specifikuar është në çështjet e mëposhtme. Grafikisht mund ta paraqesim në këtë format. Fig. nr.1

Ndërkohë, bëme këtë paraqitje me qëllim që të dalim në një përfundim që ka të bëjë me raportin e sportistëve të licencuar krahasuar me

numrin e nxënësve parashkollorë, të arsimit bazë dhe të mesëm të regjistruar në shkollat publike dhe private. Kështu, numri i nxënësve në ciklin shkollor të vendit tonë është (sipas MAS 2013).

Në arsimin parauniversitar dhe universitar, numri gjithsej i nxënësve dhe studentëve është: **779.501**.

- | | | |
|-----------------------------|----------------|----------|
| 1. Në arsimin parashkollor: | 81.865 | nxënës. |
| 2. Në arsimin bazë: | 390.837 | nxënës. |
| 3. Në arsimin e mesëm: | 154.425 | nxënës. |
| 4. Në arsimin e lartë | 152.374 | studentë |

Kjo shifër, 779.501 nxënës dhe studentë, nëse krahasohet me numrin e sportistëve të licencuar në federatat tona, atëherë do të kishim një shifër që është rreth **2%** e numrit të nxënësve dhe studentëve që janë gjithsej. Pra, në vendin tonë, janë të regjistruar dhe kryejnë garime sistematike rreth **2%** e numrit të nxënësve dhe studentëve në vendin tonë. Po ta krahasojmë këtë shifër me shtetet ballkanike, si shtete me arritje minimale në Evropë (Strategie si evoluarë in sport simpozium stiintic internacional, Bucaresti 1996), do të konstatojmë një diferencë shumë të ndjeshme. Nga rreth 2% që praktikojnë sportin garist në vendin tonë, në mbi 8.5% që merren me sport konkurrues në shtetet ballkanike. Shtetet që kanë përqindjen më të lartë në këtë drejtim janë shtetet skandinave dhe ato të Evropës Qendrore, të cilat e kanë këtë përqindje në kufijtë 22-38%. Kjo do të thotë, se 22-38% e nxënësve dhe studentëve gjithsej që ka një shtet merren me sport cilësor. Pra, diferencat me vendin tonë janë të ndjeshme.

Gjendja e sportit garist dhe elitari

Një nga çështjet më të debatueshme sot në Evropë është pjesëmarrja dhe niveli i kualifikimit dhe rikualifikimit të trajnerëve. Për këtë kërkohet të mbahen evidenca të rregullta për numrin e trajnerëve, moshën e tyre dhe kualifikimin. Këto të dhëna kemi synuar të japim në studimin tonë, të cilat do të krahasohen me vitet 2003 dhe 2010, krahasim ky që do të na shërbejë për të dalë në përfundime për gjendjen dhe gjetjen e rrugëve, mjeteve dhe metodave më të mira për ecurinë zhvillimore. Pra, bazuar në të dhënat e dala nga evidencat e federatave, na rezulton kjo gjendje e numrit të trajnerëve në bazë sportesh, të ndarë në dy grupmosha, nën 50 vjeç dhe mbi 50 vjeç.

Tab. Nr.2

Federatat	Viti 2003		Viti 2010		Viti 2016	
	Nën 50	51+	Nën 50	51 +	Nën 50	51 +
Alpinizmi	5	4	8	5	8	6
Atletika	trajnerë	trajnerë	16	19	12	17
Basketbolli	20	11	53	30	45	28
Boksi	28	15	12	22	11	10
Çiklizmi	27	10	12	3	29	30
Futbolli	5	9	180	94	185	97
Gjymnastika	170	118	18	4	15	7
Hendboll	25	13	15	10	10	12
Karate	19	3	12	--	13	--
Mundje	12	1	22	15	20	18
Not	32	15	12	8	11	10
Peshëngritje	4	8	21	1	16	10
Pingpong	9	7	17	7	14	9
Qitje	12	8	3	7	3	6
Ski	2	8	3	6	8	5
Taekwondo	3	2	4	4	3	5
Tenis	6	1	23	4	24	6
Volejboll	4	2	81	27	75	32
Xhudo	45	19	7	2	6	4
Bodybuilding	7	3	-	-	18	2
	-	-				
Gjithsej	435	256	518	267	495	226
	691 trajnerë		785 trajnerë		721 trajnerë	

Bazuar në tabelën e mësipërme na rezultojnë këto të dhëna analitike:

- Numri i përgjithshëm i trajnerëve në vitin 2013-2014 ka një rënie prej 65 trajnerësh në krahasim me vitin 2010.
- Pavarësisht nga numri i trajnerëve sërish është për të evidencuar se mosha e trajnerëve, midis dy kufijve nën dhe mbi 50 vjeç, është në kufijtë optimalë.
- Shumica e sporteve ka mbetje në vend në drejtim të rritjes së numrit të trajnerëve, gjë që do të thotë se puna me trajnerët është e pamjaftueshme. Pa rritur numrin e trajnerëve nuk mund të pretendojmë për rritjen e numrit të sportistëve.
- Raporti mesatar trajner – sportist për sportet kolektive është afësisht 1 – 13, kurse për sportet individuale është 1 – 5. Këto shifra janë të nivelit mesatar Evropian (Strategic Directions for Sport in the UK).

Por që ky problem të marrë formë të plotë kërkohet që në vazhdim të këtij studimi të evidencojmë nivelin e kualifikimit dhe rikualifikimit të trajnerëve në bazë federatash. Pra, është e rëndësishme, që këtë analizë ta bëjmë duke u mbështetur në dy drejtime. E para, ka lidhje me kualifikimin nëpërmjet seminareve periodike. Këtë metodë pune e ka ushtruar KOKSH në bashkëpunim me federatat e peshëngritjes, të sporteve luftarake etj. Njëherësh edhe FSHF ka punuar me një program të qartë në këtë drejtim. E dyta, kualifikimi gjithëvjetor me part time, është metoda kryesore e kualifikimit dhe licencimit të trajnerëve në të gjithë Evropën, dhe jo vetëm. Megjithatë duhet thënë se kualifikimi sidomos licencimi i trajnerëve në vendin tonë bëhet pa marrë parasysh eksperiencat evropiane. Për këtë fakt ne duhet t'i referohemi eksperiencave evropiane, të cilat janë praktikisht të zbatueshme në dy forma. Vetëm në Itali kualifikimi bëhet me strukturat e ngritura nga vetë federatat përkatëse, kurse në vendet e tjera kualifikimi organizohet nga federata, por zbatimi realizohet nga Institutet e Shkencës Sportive. Pra, pa kaluar në kualifikimet dhe rikualifikimet në këto institute, nuk mund të vazhdohet licencimi i trajnerëve. E thënë thjesht, secili trajner, që të licencohet duhet të dorëzojë në federatën përkatëse kërkesën e tij, jetëshkrimin dhe dëshminë e kualifikimit ose rikualifikimit. Më pas federata ka të drejtën të veprojë sipas rregullave të saj. Kjo është eksperiencia evropiane dhe ne jemi të detyruar ta respektojmë atë.

Konkluzioni:

Kualifikimi dhe rikualifikimi i trajnerëve dhe metodistëve të sportit duhet të bëhet sipas një metodologjie të caktuar. Grupi i studimit rekomandon të ndiqet eksperiencia anglo-saksone dhe jo ajo italiane.

Një çështje tjetër me mjaft rëndësi për evidencimin e sportit cilësor është vlerësimi i numrit të pjesëmarrësve në sport dhe krahasimi i tyre ndër vite. Pra, niveli i pjesëmarrjes në sportin cilësor është si më poshtë:

Tab. Nr. 3

Nr.	Sportet	Numri i sportistëve të licencuar						Gjithse j 2016
		MESHKUJ			FEMRA			
		2003	2010	2016	2003	2010	2016	
1.	Atletikë	295	388	228	155	254	87	482
2.	Alpinizëm	132	209	235	--	53	20	255
3.	Basketboll	545	684	670	357	250	245	915
4.	Boks	191	215	240	--	--	-	240
5.	Çiklizëm	108	120	106	--	--	-	106
6.	Gjymnastikë	144	84	62	211	197	168	355
7.	Hendboll	S'ka	576	120	S'ka	167	64	184
8.	Karate	255	230	90	--	36	88	178
9.	Mundje	412	547	324	--	--	-	324
10.	Peshëngritje	120	134	133	--	9	4	137
11.	e	-	-	214	--	--	15	229
12.	Ski	292	348	264	350	416	612	876
13.	Volejboll	11533	10830	13825	--	--	169	13940
14.	Futboll	108	141	84	6	597	68	152
15.	Taekwondo	140	149	79	46	160	91	170
16.	Xhudo	124	194	202	37	9	96	298
17.	Not	68	S'ka	-	35	56	--	--
18.	Qitje Tenis	110	228	214	60	106	126	340

Duke u bazuar në tabelën e mësipërme na rezulton kjo gjendje e sportit:

- Të gjithë sportet individuale po kalojnë disa vështirësi, të cilat janë të lidhura si me bazën materiale të stërvitjes në tërësinë e vet, ashtu dhe me mbështetjen e pamjaftueshme që pushteti ekzekutiv dhe në mënyrë

të veçantë pushteti vendor po u japin këtyre sporteve. Duhet theksuar se me këtë numër pjesëmarrësish do ta kemi mjaft të vështirë që të kemi një perspektivë të qartë në vitet që do të vijnë. Ka sporte që nuk plotësojnë numrin minimal të pjesëmarrësve në fazën finale të garave, ka të tjera gara, të cilat nuk zhvillohen për arsye të mungesës së sportistëve.

- Sportet kolektive kanë një perspektivë më të qartë, por që mjediset sportive të stërvitjes janë mjaft të pakta në numër. Ka ardhur koha që secili qytet duhet të ketë mjediset e tij publike të stërvitjes sportive, por dhe të garimit, të cilat duhet të jenë të mirëpajisura, pasi vetëm kështu do të kemi mundësinë të praktikojmë të rejtat e fundit në stërvitjen sportive. Sporti po konkurren me më të përparuarën e kohës, kurse baza materiale në përgjithësi dhe ajo didaktike në veçanti janë në nivele të prapambetura. Nisma me Qendrën Kombëtare të Sportit është mjaft pozitive, por kërkohet që qendra të tilla stërvitore duhet të kenë të gjitha bashkitë e vendit tonë.
- Është vënë re se shumica e trajnerëve kanë shfaqur disa vështirësi në konceptimin modern të stërvitjes sportive. Këtë gjë grupi i autorëve të këtij studimi e kanë vërejtur në leksionet dhe seminarët e nivelit “Master Shkencor” dhe të “Doktoraturës”. Kur ka paqartësi deri serioze, në drejtim të kuptimit të metodologjisë së stërvitjes sportive, me këta studentë, atëherë mund të mendojmë se më poshtë dobësitë shfaqen më të mëdha. Pra, kërkohet që sistemi i kualifikimit dhe rikualifikimit të trajnerëve, por jo vetëm, duhet të reformohet dhe të shikohet mundësia e eksperiencës më të mirë që për mendimin tonë është ajo anglosaksone ose më mirë e thënë ajo anglo-gjermane.

Lëvizja sportive cilësore është një nga sfidat më të rëndësishme individuale dhe kolektive. Kjo nënkupton se institucionalizimi i sportit duhet ndërtuar në mënyrë të tillë që t’i përgjigjet më mirë se deri më sot sfidave të cilësisë së lartë sportive. Po ashtu, këto institucione sportive, kërkohet të rrisin sensibilitetin e tyre, sidomos në drejtim të pushtetit vendor, por dhe në drejtim të pushtetit ekzekutiv qendror në drejtime të tilla që kanë lidhje direkte me sportin në tërësi dhe atë cilësor në veçanti.

Sporti ynë ka arritje, të cilat në disa raste janë edhe shumë të mira. Peshëngritësit, disa atletë, mundës dhe ndonjë sportist i sporteve luftarake kanë arritur të renditen midis më të mirëve në veprimtaritë evropiane dhe botërore, por kjo nuk mjafton, sidomos kur shikon se perspektiva e sportit i është lënë në dorë rastësisë. Nëse sot kemi dy peshëngritës, një atlete etj., që na përfaqësojnë në nivelet më të larta bashkëkohore, kjo gjë është falë punës së trajnerëve dhe drejtuesve të federatave përkatëse, por që duhet të

na nxisin për të punuar më me përkushtim e dije shkencore. Ndërkohë, këto rezultate duhet të na kujtojnë se edhe në Shqipëri ka sportistë shumë të talentuar dhe që duhen të stërviten në kushte të njëjta me ato të rivalëve të tyre. Kjo duhet të jetë nisma e lëvizjes sportive kombëtare për të sensibilizuar në maksimumin e mundshëm pushtetin ekzekutiv qendror dhe pushtetin vendor, të cilat krahas problemeve të mëdha që këto pushtete kanë duhet të kthejnë kokën edhe nga sporti, pasi sporti ka një mision kompleks dhe tridimensional: shëndet, stil jetese dhe krenari kombëtare.

Pra, nëse duhet të bëjmë një përshkallëzim të faktorëve që ndikojnë në përmirësimin e gjendjes, sigurisht aspekti drejtues dhe menaxherial do të zinte vendin kryesor. Për t'i bërë më të qartë faktorët ndikues në cilësinë e lartë sportive po rendisim disa prej tyre:

- Shoqatizimi dhe shoqërizimi i sporteve duhet të bëhet sipas standardeve evropiane. Kështu siç është nuk mund të na ndihmojë për ecurinë cilësore në të ardhmen.
- Duhet të organizohet liga profesioniste e sporteve, sidomos në futboll ku dhe mudësitë janë më të mëdha.
- Federatat sportive, në të ardhmen, duhet t'i përgjigjen më mirë kërkesave të kohës. Me sportistët më cilësorë duhet punuar sipas standardeve evropiane. Pra, këta sportistë duhet të kenë sponsorizues ekstra, të cilët të marrin përsipër tërë aktivitetin sportiv dhe të stimulit material të tyre. Kjo është detyrë e kryesive të federatave dhe kjo detyrë kërkohet të vihet në jetë sa më parë.
- Pjesa më e madhe e federatave nuk kanë ende sponsorin kryesor dhe situata e donacioneve dhe sponsorizimeve është në nivel të ulët. Vetëm me të ardhurat nga MAS dhe shumë pak nga sektori privat nuk do të kemi mundësi të përmirësojmë punën e federatave.
- Pushteti vendor koncepton vetëm futbollin si sport, duke harruar thuajse tërësisht sportet e tjera, sidomos sportet individuale. Eksperiencia evropiane na rekomandon se pushteti vendor interesohet kryesisht për infrastrukturë publike sportive dhe ndihmon sportet individuale vetë dhe në bashkëpunim me sektorin privat.
- Lidhshmëria midis menaxhimit teknik me atë institucional e financiar është në hapat e parë dhe në disa raste as që njihet si koncept.
- Kualifikimi duhet të njohë standarde të reja, pasi në praktikën e trajningut vërejmë pasaktësi në koncepte dhe disa raste edhe metodologjike.
- Aktivitetet sportive kërkohet të promovojnë edhe vlerat doktrimore, sidomos ato të fair play dhe respektit e dinjitetit sportiv. Sporti konkurrues vetëm për renditje kampionatizmi nuk duhet të jetë qëllim

në vetvete. Sot më shumë se më parë na nevojiten të praktikojmë vlerat doktrinale, të cilat mund e duhet të tregojnë njësimin e sportit me stilin pozitivist të jetesës.

- Për pjesëmarrjen në sport të moshave të reja duhen organizuar edhe veprimtari promovuese zonale, rajonale e kombëtare. Organizimi i përvitshëm i kampionateve midis shkollave të ciklit 9-vjeçar mund të jetë një zgjidhje efikase dhe me pasoja pozitive për rritjen e masivitetit cilësor dhe për pikasjen e talentëve sidomos për sportet individuale. Kjo punë duhet të programohet dhe hartohet nga KOKSH në bashkëpunim me federatat sportive dhe duhet të miratohet nga Këshilli Kombëtar i Sportit.

Kuadri ligjor dhe institucional

Në vendin tonë ka një kuadër ligjor të një niveli të caktuar, por që e kanë mbaruar misionin e tyre. Pra, tërësia ligjore, e cila përfshin edhe sportin janë tashmë ose pjesërisht të panevojshme ose ndonjë prej tyre duhet riparë nga e para. Ligji për sportin duhet riparë tërësisht, sepse nuk mbart me vete problemet që trajton sporti europerëndimor. Në ligjin e ri duhet të përfshihen konventat ndërkombëtare. Këshilli i Lartë i Sportit, duhet riparë në tërësinë e vet, pasi ai nuk ka asnjë kompetence financiare. Problemet e llotarive sportive po shikohen sikur nuk kanë të bëjnë me sportin etj.

Parametra, të tillë si: norma, kategori, modele për hartimin e një ligji për problemet e sportit ka ekzistuar vazhdimisht, por sistemi aktual, koha që jetojmë në sistemin ekonomik - shoqëror të Laissez-Fair apo Liberal Konstitucional ka sjellë ndryshime të ndjeshme në mentalitete, politikëbërje, menaxhime etj., të cilat lejojnë hapësira e mundësi bashkëpunimi dhe zhvillimi të reja. Pra, ligji i ri “Për sportin”, duhet të plotësojë kërkesat duke zgjidhur dhe menaxhuar një hapësirë sa më të gjerë të burimeve njerëzore, materiale e demografike të vendit tonë.

Njëherësh, duhet theksuar, se nga llotaria sportive fusha e sportit nuk përfiton ekonomikisht. Kjo ndodh, sepse ligji i lojërave të fatit, është jashtë eksperiencave botërore. Në legjislacionin e shteteve evropiane për sportin theksohen 4 variante të funksionimit të llotarive sportive. E rëndësishme është që të ndalemi edhe në një aspekt tjetër të financimit në sport që ka lidhje me sponsorizimet dhe donacionet. Edhe sot sponsorizimi në sport është bërë për veprimtari sportive dhe për sportistë cilësorë, por që shuma e shpenzuar për këto qëllime ka qenë minimale ose e papërfillshme, sidomos për sportet individuale. Duhet theksuar se sipërmarrja private ka

qenë ngahera kritike për ligjin e sponsorizimeve. Në ligjin e sponsorizimeve është vendosur vlera 10% e fitimit vjetor, kurse më efektive do të jetë nëse shikohet një variant që ka lidhje me përlllogaritjen e vlerës së investimit para tatimit.

Gjendja e sportit elitari

Duhet pranuar se tashmë kemi medalistë në aktivitetet më të rëndësishme evropiane dhe botërore. Për herë të parë kemi fituar medalje në Lojërat Botërore Studentore dhe këtë prezantim dinjitoz na e bëri atletja e vrapimeve të mesme L. Gega. Po ashtu, kjo vrapuese, ka fituar medalje në veprimtari mesdhetare, ballkanike dhe është nënkampione e Evropës. I.Smajlaj në vitin 2016 është shpallur kampion i Evropës me rezultatin 8.08m. Nivel shumë të lartë kanë prezantuar dy peshëngritësit tanë Erkan Qerimaj dhe Daniel Godelli. Në futboll jemi renditur në fazën midis 24 ekipeve më të mira në kampionatin evropian, Francë 2016. Nuk duhet lënë pa përmendur edhe sportin e mundjes, të xhudos, të karatesë, të boksit, të kikkoksit etj., por që duhet pranuar që janë shumë pak për një vend si i yni që tashmë kemi fatin të bashkëpunojmë me tërë trevat mbarëshqiptare në ballkan dhe jo vetëm.

Gjendja e bazës materiale të stërvitjes dhe garimit

Në sportin e përparuar bashkëkohor ngahera theksi vihet në kushtet e stërvitjes dhe garimit, të cilat janë pararendëse e dhënies së mundësive maksimale fizike dhe funksionale. Janë shtuar mjetet didaktike, mjetet dhe mjediset e riaftësimit etj. Pra, duhet thënë, se mjediset e stërvitjes janë përmirësuar cilësisht në çdo shtet ballkanik, kurse tek ne këto mjedise janë të pamirëmbajtura dhe të pakta në numër.

1. Të analizojmë sportin e peshëngritjes, si sporti që na ka dhënë disa rezultate shumë cilësore. Mjediset stërvitore të peshëngritjes janë shumë modeste. Ekipet sportive në disa qytete, si: Elbasan, Peqin, Shtërmen, Shkodër, Durrës, Korçë, Vlorë, Lushnje, Fier, Tiranë dhe rrethinat e saj stërviten në kushte minimale stërvitore. Në asnjë mjedis stërvitor nuk ka mjete riaftësimi dhe relaksimi. Iniciativa për të ndërtuar një palestër moderne në mjediset e Qendrës së Ekipeve Kombëtare është një nisëm shumë pozitive, e cila duhet të pasohet nga nisma të tilla nga pushteti vendor, sidomos në qytetet e mëdha.
2. Mundja ka gjithsej 16 ekipe sportive, të cilat trajnohen në 13 mjedise stërvitore dhe në 10 qytete. Po të shikosh dhe analizosh

mjediset stërvitore të mundjes duhet pranuar se asnjëra prej tyre nuk plotëson standardet bashkëkohore.

3. Atletika ka gjithsej 11 ekipe sportive. Ky numur është më i vogli ndër 50 vitet e fundit. Madje asnjë ekip atletike nuk plotëson numrin e sportistëve për çdo garë për meshkuj apo për femra.
4. Futbollit është sporti më i shtrirë në vendin tonë. Kërkesat për t'u marrë dhe trajnuar me sportin e futbollit janë në rritje. Falë edhe punës së ekspertëve të futbollit sot janë bërë prindërit njerëzit më të interesuar për të praktikuar fëmijët e tyre në këtë sport. Mjediset e stërvitjes ekzistuese duhen zëvendësuar me të reja, pasi në të kundërtën do të kemi probleme me muskulaturën dhe indet e buta të fëmijëve.
5. Basketbolli, volejboli dhe tenisi tre sporte që ende janë të dashura për fëmijët dhe sidomos vajzat. Në vendet evropiane dhe sidomos ballkanike këto tre sporte janë bërë më të praktikuarat dhe si të tilla pushteti ekzekutiv dhe ai vendor janë duke shtuar dhe përmirësuar kushtet e mjediseve stërvitore.

Analizuar këto sporte kryesisht të traditës jo sepse janë më të rëndësishmet, por kur këto sporte kanë problem me mjediset e stërvitjes dhe garimit atëherë ç'mund të themi për sportet e tjera?

PËRFUNDIMET

Nëpërmjet formularëve të ndryshëm dhe evidentimit të gjendjes dhe perspektivës së sportit kombëtar kemi bërë të mundur të nxjerrim një tablo të qartë veçanërisht në drejtim të krahasimit të gjendjes së sportit ndër vite, krahasim ky që na ka nxjerrë një sërë konkluzionesh:

1. Bazuar në konventat botërore për sportin kërkohet të reformohen institucionet sportive duke nisur me Komisionin Kombëtar për Sportin dhe vazhduar me federatat sportive dhe me shoqatat dhe shoqëritë sportive. Jemi i vetmi vend në Evropë që vazhdojmë të formatohemi dhe funksionojmë me hibrid eksperiencash.
2. Moskoordinimi efikas i politikave sportive i derisotëm midis institucioneve shtetërore, publike dhe private ka sjellë këtë gjendje, e cila ka rezatuar këtë cilësi sportive, kjo më e dukshme në sportet individuale. Shifra prej 2% e numrit të përgjithshëm të sportistëve që janë të licencuar nëpër federata sportive në krahasim me numrin e

- përgjithshëm të nxënësve dhe studentëve, tregon se jemi ende larg praktikave ballkanike në fushën e sportit.
3. Reformimi i institucioneve demokratike në sport është një detyrë që nuk pret, pasi autoritarizmi po gjen ngahera më shumë terren dhe se marrëdhëniet brenda federatave janë, në disa raste, tepër të acaruar. Po ashtu, ngritja dhe fuqizimi i strukturave meritokratike janë një kërkesë e kohës dhe se vetëm nëpërmjet tyre përmirësohet puna në tërë hallkat e sistemit sportiv kombëtar.
 4. Gjendja e pjesëmarrjes me sport është në stanjacion. Krahasimi midis viteve 2003, 2010 me vitin 2016 tregon se nuk kemi rritje në numrin e përgjithshëm të sportistëve të licencuar nëpër federata sportive, kurse numri i nxënësve dhe studentëve është rritur ndjeshëm krahasuar po me të njëjtat periudha.
 5. Kualifikimi i trajnerëve, metodistëve, fizioterapistëve, gazetarëve sportivë, mjekëve sportivë etj., duhet të marrë një format bashkëkohor. Mendimi i autorëve të këtij studimi është që këtë mision duhet ta marrë UST-ja, e cila duhet t’ia delegojë kompetencën IKSHS për të bërë bashkimin e tërë ekspertëve më cilësorë me qëllim që lektimi dhe ekzaminimi i specialistëve të sportit të bëhet sipas arritjeve më të përparuar të kohës.
 6. Amendimi apo edhe riformatimi i ligjeve që cekin fushën e sportit duhet të bëhen sa më shpejt që të jetë e mundur. Ligji “*për sportin*”, “*për lojërat e fatit*”, “*për donacionet dhe sponsorizimet*” kanë nevojë të amendohen brenda legjislaturës së re pas zgjedhjeve 2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

LITERATURA

1. Konventa Botërore e Sporteve Olimpikë nënshkruar në Meksikë më 22 tetor 2010. Konventa e Akapulkos.
2. Konferenca e 14-të Botërore e Sportit për të Gjithë, 2011 - Pekin, Kinë, 20-23 shtator 2011.
3. Kongresi i 13-të Botëror i Sportit për të Gjithë, 2010 - Jyväskylä, Finlandë - Promovimi i Sportit për të Gjithë: Përfitimet dhe Strategjitë për Shekullin e 21-të 16 nëntor 2010.
4. Kongresi i 12-të Botëror i Sportit për të Gjithë 2008 – “sporti për jetën”. Maloret Genting, 6 nëntor 2008, Malajzi.

5. Kongresi i 11-të Botëror i Sportit për të Gjithë 2006 - Havana, Kubë 31 tetor – 3 nëntor 2006.
6. Kongresi i 10-të Botëror i Sportit për të Gjithë 2004 - Romë, Itali, 11-14 nëntor 2004.
7. Kongresi i 9-të Botëror i Sportit për të Gjithë 2002 -“Sporti për të gjithë dhe sporti elitari: rivalë apo partnerë?” Arnhem, Hollandë, 27 – 30 tetor 2002.
8. Kongresi VIII Botëror i Sportit për të Gjithë 2000 - “Sporti për të Gjithë dhe Politikat Qeveritare” 18 – 21 maj 2000, Qyteti Quèbec, Kanada.
9. Kongresi VII Botëror i Sportit për të Gjithë 1998 - “Sporti për të Gjithë dhe Sfidat Globale të Edukimit” 19 – 22 nëntor 1998, Barcelona, Spanjë.
10. Kongresi i 6-të Botëror i Sportit për të Gjithë 1996 - “Familja Globale dhe Sporti në Shekullin e 21-të” Seul, Kore, 21 – 24 prill 1996.
11. Kongresi i 5-të Botëror i Sportit për të Gjithë 1994 - “Sporti për të Gjithë – Shëndeti për të Gjithë” Punta del Este, Uruguai, 10 – 13 mars 1994.
12. Frank W.D. (2009) “ Sport Training Principles”, London ribotuar p.64,82,107.
13. Strategie si evoluare in sport simpozium stiintic internacional, Bucaresti, 1996.
14. INSTAT 2008 – faqe 14, 16, 22.
15. Ministria e Arsimit dhe Sportit – dhjetor, 2013.
16. Kant Immanuel “Kritik der reiner Practicus”, Frankfurt, 1978.
17. Stategic Directions for Sport in the UK, shtator, 2010.

DINAMIKA E MËSIMDHËNIES ONLINE TË DISIPLINAVE GJEOGRAFIKE NË SHKOLLAT E LARTA GJATE PANDEMISË COVID 19

Sokol Axhemi

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Histori - Filologjisë

ABSTRAKT

Ashtu si në vendet e tjera të botës, Pandemia Covid 19 tregoi efektet e saj edhe në vendin tonë. Situata shumë problematike shoqëroi ecurinë e veprimtarisë në fushën e arsimit, në ciklet e ndryshme të saj. Izolimi, zgjatja e periudhave të karantinës në mënyrë periodike, ndikoi që në kuadrin e masave të marra nga qeveritë e vendeve të ndryshme, për të ndikuar që në vendin tonë, arsimit të përfshihet në një sistem masash me karakter specifik, të orientuar kryesisht drejt mësimin në internet. Në këtë kuptim, universitete të ndryshme u përfshinë në qasjen e prezantimit të platformave të ndryshme aktive të të mësuarit, me përfshirjen e studentëve dhe stafit akademik në to.

Në rastin e vendit tonë, mësimdhënia universitare në internet ishte pothuajse diçka e re, për studentët dhe profesorët, në përgjithësi. Megjithëse elementë të tillë nuk munguan të shfaqeshin në mënyrë sporadike në disa institucione të arsimit të lartë, publik dhe privat, në rastin e pedagogëve të ftuar nga universitetet partnere jashtë vendit, ose në rastin e përfshirjes në grupe pune të projektit ose konsulencë në lidhje me çështje dhe tema të ndryshme. Prandaj, përfshirja e universiteteve tona në këtë sistem mësimor paraqiti shumë probleme dhe vështirësi, të cilat hap pas hapi po identifikojnë studiues dhe teknikë të ndryshëm. Vlerësoj qëllimin, për mendimin tim, për të mundësuar hyrjen në sisteme të tilla për zbatim në të ardhmen, në kontekstin e zhvillimeve normale të të nxënësve, si një mundësi dhe alternativë metodologjike e zhvillimeve akademike.

Ashtu si disiplinat e tjera shkencore, gjeografia në shkollat tona të mesme u adaptua nga platforma të ndryshme, për t'u ofruar studentëve nga profesorët e tyre, në internet. Në këtë material jam përpjekur të paraqes një përvojë personale në kontekstin e mësimdhënies në internet në lëndët e shkencave humane në gjeografi. Fokusi im është në temat gjeografike që lidhen me Gjeografinë e Popullsisë dhe Vendbanimeve, Gjeografinë Sociale, Gjeografinë e Zbatuar Sociale dhe Migracionin dhe Zhvillimin Ekonomik Social.

Dynamics of online teaching of geographical disciplines in high schools during the Covid pandemic 19

ABSTRACT

As in other countries of the world, the Covid Pandemic 19 showed its effects in our country as well. The very problematic situation accompanied the progress of the activity in the field of education, in its various cycles. Isolation, the extension of quarantine periods periodically, influenced that in the framework of measures taken by the governments of different countries, to influence that in our country, education be included in a system of measures of a specific character, oriented mainly towards learning online. In this sense, different universities were involved in the approach of introducing different active learning platforms, with the involvement of students and academic staff in them.

In the case of our country, online university teaching was almost something new, for students and professors, in general. Although such elements were not absent to appear sporadically in some institutions of higher education, public and private, in the case of lecturers invited from partner universities abroad, or in the case of involvement in project working groups or consultancy related to various issues and themes. Therefore, the inclusion of our universities in this teaching system presented many problems and difficulties, which step by step different researchers and technicians are identifying. I appreciate the intention, in my opinion, to enable access to such systems for future application, in the context of normal learning developments, as a possibility and methodological alternative of academic developments.

Like other scientific disciplines, geography in our high schools was adapted by different platforms, to be offered to students by their professors, online. In this material I have tried to present a personal experience in the context of online teaching in the subjects of humanities in geography. My focus is on geographical topics related to Population and Settlement Geography, Social Geography, Applied Social Geography and Migration and Social Economic Development.

Realizimi i leksioneve dhe seminareve

Realizimi i leksioneve dhe seminareve përfaqësojnë elementet më të rëndësishme të punës mësimore në shkollën e lartë. Patjetër që vështirësitë për të bërë të mundur realizimin e një mësimdhënieje të tillë në kushtet e

zhvillimit të tyre online për të gjitha stafet akademike ishin të shumta, por kam mendimin e kuptueshëm për kohën dhe momentin në të cilin u ndodhëm. Krijimi i klasave respektive online në platformat e aplikuara ishin fillimi i punës sonë që kërkonin në anën tjetër edhe përfshirjen e studentëve tanë gjeografë të cilët ishin prezentë dhe aktivë. Patjetër, që nuk duhet të harrojmë, se këto studentë do të përballeshin edhe me problematika të tjera, që ishin të harmonizuara me kushtet e jetesës dhe të punës së tyre, anës psikologjike, pajisjeve në dispozicion etj. Vlerësoj se gjatë zhvillimit të orëve të leksioneve dhe seminareve në kuadrin e momenteve hyrëse përfshiheshin në diskutime në lidhje me çështje të tilla edhe për të bërë të mundur një bashkëbisedim për t'i çliruar sadoapak ata nga ajo situatë ku ndodheshim të gjithë së bashku. Kjo më ka ndihmuar edhe për të bërë të mundur më pas tërheqjen e tyre më efektive, aktive dhe gjithëpërfshirëse në diskutimet e ndryshme në seancat e leksioneve dhe seminareve që zhvilloja me ta.

Tashmë është një fakt shkencor dhe metodik i afirmuar, që trajtesat shkencore gjeografike me fokus disiplinat humane i krijojnë gjithmonë mundësi pedagogut për të lançuar tematika për diskutime mjaft të larmishme. Një gjë e tillë përqaset ngushtësisht edhe me fokuset shkencore që kanë të bëjnë me tematikat e gjeografisë së popullsisë dhe gjeografisë sociale. Një ndihmë të rëndësishme në këtë drejtim shfaqte në mënyrë të veçantë edhe situata sociale në të cilën ndodheshim, e cila na ndihmonte për të analizuar konkretisht disa elemente specifike që ishin prezente në hapësirën sociogjeografike të Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë çështjet që lidheshin me tiparet dhe veçoritë e përgjithshme të grupeve të ndryshme sociale, të vendeve dhe funksioneve sociale, të elementeve të planifikimit social dhe tipeve dhe llojeve të politikave sociale, si pjesë e rëndësishme e objektit shkencor të Gjeografisë sociale. Krahas fokusit të përgjithshëm shkencor tematika të tilla nxitën studentët për t'u përfshirë në diskutime të gjera, debate interesante, detyra kursi specifike dhe recensione shkencore cilësore, me anë të të cilave synohej nga pedagogu dhe studentët arritja e realizimit të objektivave shkencore të lëndës.

Njëkohësisht në kuadrin e lëndës së Gjeografisë së popullsisë dhe të vendbanimeve paraqitej me mjaft interes diskutimi mbi faktorët ndikues në zhvillimet e popullsisë, dinamika e popullsisë, shpërndarja gjeografike e saj, migrimet, strukturat e popullsisë dhe vendbanimet, politikat mbi popullsinë etj. Një objekt shkencor i tillë mjaft interesant u tentua që t'u jepej studentëve në mënyrë graduale, duke i përfshirë edhe në kuadrin e shfrytëzimit të literaturave të ndryshme (ndonëse shfaqej vështirësia e kontaktit me burimet e literaturës, ku shpeshherë burimi i vetëm mbetej

interneti). Një gjë e tillë nxiste tek ata edhe një vetorganizim të brendshëm për të hulumtuar mbi këto çështje dhe tematika, me qëllim që të përfshihej gjatë seancës pasardhëse mësimore në diskutime e debate me studentët e tjerë të kursit, apo të grupit të tij.

Format metodike të realizimit të orëve të leksioneve dhe seminareve pësuan deri diku një transformim të ndjeshëm, teksa shfaqej vështirësia e ndjekjes së tyre nga tërësia e studentëve, për arsye dhe shkaqe të ndryshme, objektive dhe subjektive. Ashtu siç studiues dhe ekspertë të arsimit kanë evidentuar në punimet dhe analizat e tyre, kam mendimin se duhet të identifikojmë edhe ne si gjeografë në rastin konkret (mësimdhënës në arsimin e lartë) dimensionet e problematikave që u shfaqën. Në këtë drejtim vlen të përmenden shqetësimet e konstatuara si në aspektin e mbulimit me internet të zonave të ndryshme të vendit (që evidentoheshin nga studentët tanë), pamundësia financiare për shpenzimet e tij, mungesa e pajisjeve teknologjike, energjia elektrike sidomos për zonat rurale etj. Vendosja e stafeve akademike para situatave të tilla nxiste për gjetjen e formave dhe mënyrave nga më të ndryshmet për të bërë të mundur aksesimin e këtyre individëve, pjesë e studentëve tanë që t'u krijoheshin mundësitë për të pasur në dizpozicion materialet e duhura për studim. Në anën tjetër këto vështirësi dhe pengesa nxitën dhe bënë të nevojshme dhe të domosdoshme transformimin e punës metodike të pedagogut për të bërë të mundur përçimin e leksioneve tek studentët që nuk merrnin pjesë në seancat mësimore. Në këtë sens u ndoqën disa rrugë të rëndësishme të karakterit alternativ që u orientuan drejt postimit në klasat përkatëse, të cilat u bënë aktive nga platformat, oraret e veçanta për studentët e ndryshëm, të cilët nuk merrnin pjesë për arsye objektive, nxitjen e bashkëpunimit më të ngushtë të studentëve me njëri-tjetrin në drejtim të shkëmbimit të informacioneve shkencore etj.

Në kuadrin e punës në auditorin online vlerësojmë se një transformim i rëndësishëm që tentuam të realizonim, ishte tendenca për të përfshirë gjatë orës së leksioneve dhe seminareve sa më shumë studentët me anë të disa formave aktive angazhimi. Së pari, në drejtim të paraqitjes së pyetjeve të ndryshme në platformë që kërkonin përgjigje me shkrim dhe angazhim të tyre për tematika të ndryshme, gjë që rriti interesin e tyre jo vetëm për orën e mësimin, por dhe për tematikat shkencore që trajtoheshin. Me anë të këtyre pyetjeve masa e studentëve orientohej për të hulumtuar në lidhje me tematikën dhe të përfshihej aktivisht për të dhënë përgjigjen e tyre. Sidomos forma të tilla të gjetura u paraqitën efikase në lidhje me faktorët ndikues në zhvillimin e hapësirës sociogjeografike në kuadrin e lëndës së Gjeografisë sociale, apo shpërndarja gjeografike e popullsisë dhe

dinamika e popullsisë në lëndën e Gjeografisë së popullsisë dhe vendbanimeve. Njëkohësisht me anë të kësaj forme metodike mundësohej edhe një rritje dhe përqendrim më i zgjeruar i një mase më të madhe studentësh, të cilët ftoheshin që të jepnin komentet e tyre në kuadrin e përgjigjeve që kërkoheshin.

Së dyti, një formë tjetër metodike interesante, sipas mendimit dhe eksperiencës sonë, ishte edhe angazhimi i studentëve në recensione shkencore, të cilat referoheshin nga ana e tyre gjatë orës së zhvillimit të leksionit. Në një minutazh të shkurtër studentëve të ndryshëm, të cilët caktoheshin në seancat paraardhëse, iu ngarkoheshin tematika të veçanta për të hulumtuar në lidhje me çështjet e leksionit të ardhshëm. Në këtë mënyrë studenti angazhohej gjatë javës për të hartuar recensionin e tij shkencor për ta referuar në momentin e duhur, kur pedagogu shpjegonte tematikën e caktuar. Në formate të tilla të recensionit shkencor, vlerësojmë se përfshiheshin studentët me rezultate të mira dhe shumë të mira. Një mënyrë e tillë tërhiqte vëmendjen e studentëve të tjerë, dëshirën për të hulumtuar dhe promovuar vetveten, duke nxitur edhe dëshirën dhe konkurrencën e studentëve me njëri - tjetrin, që të angazhoheshin me punime të tilla konkrete shkencore. Interesante ishin fokuset shkencore të analizës mbi vendet sociale të banimit, prodhimit, shkëmbimit, argëtimit, pushtetit në lëndën e Gjeografisë sociale dhe çështjet e strukturave moshore, gjinore, profesionale, sipas vendbanimeve, faktorëve ndikues, në kuadrin e lëndës së Gjeografisë së popullsisë dhe vendbanimeve. Vlerësojmë se qasje të tilla ishin një mënyrë interesante dhe mjaft motivuese për studentët, duke marrë në konsideratë edhe faktin se numri i tyre shfaqej i lartë në kuadrin e pjesëmarrjes së tyre, gjatë zhvillimit të leksioneve të ndryshme në lëndët e sipërcituara (në të cilat ishin të pranishëm mbi 100 studentë, të ciklit bachelor).

Realizimi i orëve të seminareve paraqitej i një shkalle vështirësie më të ulët, ndikuar edhe nga një pjesëmarrje më e kufizuar e studentëve në to, pasi ato realizoheshin sipas grupeve të veçanta. Gjithsesi edhe në kuadrin e realizimit të tyre u bë i mundur, alternimi i formave nga më të ndryshmet metodiko-shkencore, për të arritur objektivat e realizimit të lëndëve mësimore përkatëse. Krahas realizimit të pyetjeve-përgjigjeve individuale, realizohej edhe puna me nëngrupe të veçanta për tematika dhe çështje të ndryshme të objekteve shkencore përkatëse, nxitja e diskutimeve dhe debateve specifike që lidheshin me tematikat e Gjeografisë sociale dhe asaj të Gjeografisë së popullsisë dhe vendbanimeve. Kështu mund të evidentojmë diskutimet dhe debatet që lidheshin me grupet sociale, faktorët ndikues në shpërndarjen gjeografike të tyre, tipet e tyre, që janë pjesë e

fokusit shkencor të Gjeografise Sociale, apo diskutimet mbi numrin e popullsisë, evolucionin e këtij numri në periudha dhe hapësira të ndryshme sociogeografike, shtesën natyrore të popullsië, dinamikën e lindshmërisë dhe vdekshmërisë, pjesë e fokusit shkencor të Gjeografisë së popullsisë dhe vendbanimeve etj.

Vlerësojmë se në kuadrin e realizimit të mësimdhënies në ciklin e studimeve Master vështirësitë që u shfaqën, ishin më tepër të lidhura me mungesën e kontaktit të drejtpërdrejtë me territorin, ambientin gjeografik, mjedisin, hapësirën sociogeografike. Edhe pse duhet të evidentojmë se studentët e ciklit Master në Gjeografi, u prekën si studentët e tjerë të ciklit të studimeve bachelor, apo si studentët e tjerë kudo në Shqipëri, lidhur ngusht me situatat dhe kushtet e përgjithshme, në planin shkencor konceptimi i punës që zhvillojmë me to në kuadrin e leksioneve, seminareve dhe ushtrimeve e kërkon domosdoshmërisht laboratorin aq specifik që kemi në gjeografët, hapësirën sociogeografike. E një gjë e tillë u ndje gjatë zhvillimit të lëndës së Gjeografisë sociale të aplikuar, ku optika dhe fokusi kryesor në mjaft tematika shkencore ishte aplikimi i dijeve teorike të përftuara gjatë tematikës sociale kërkonte qasjen direkte në grupet sociale përkatëse, larmishmërinë e tyre, hapësirën sociale, vendet dhe funksionet sociale, dinamikën dhe evolucionin e tyre, ndryshimin dhe transformimin që kishin pësuar në momente të ndryshme nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm etj. Gjithsesi tentuam që në mënyrë analitike të aplikojmë teknikalitetet vizive dhe audiovizive të ndryshme për të bërë të mundur qasjen, sigurisht aq sa mundëm për situatën dhe kohën, me qëllim marrjen e sa më shumë të informacioneve shkencore të karakterit praktik.

Situatë e njëjtë ishte edhe në kuadrin e zhvillimit të lëndës mësimore të Migrimit dhe Zhvillimit social e ekonomik. Tentuam të realizojmë anketimet e ndryshme dhe pyetësorë online dhe në kuadrin e thirrjeve telefonike, apo dhe alternativave të tjera të komunikimit me mjetet në përdorim, për të nxitur dhe aktivizuar sa më shumë studentët në kuadrin e tematikave të ndryshme shkencore, që lidhen me këtë disiplinë gjeografike, aq aktuale. Në mënyrë të veçantë çështjet e efekteve sociale dhe ekonomike, të cilat lidhen me lëvizjet migruese, format e reja të shfaqjes dhe aktivizimit të lëvizjeve migruese, dinamika e tyre regjionale dhe globale, nxitën mundësi dhe alternativa hulumtuese edhe në kuadrin e shfrytëzimit të gjerë të literaturës dhe bibliografisë shkencore që kishim në dispozicion.

Detyrat e kursit. Punimet e diplomave. Tezat e masterit. Praktikat mësimore. Ekspeditat në terren.

Situata në të cilën u ndodhën universitetet dhe shkollat e larta bart

në vetvete edhe realizimin e aktiviteteve të tjera akademike, që lidheshin me detyrimet mësimore shkencore në kuadrin e kurrikulës universitare të degës Gjeografi, në Fakultetin Histori - Filologji të Universitetit të Tiranës. Një gjë e tillë bëri të mundur, domosdoshmërinë e angazhimit për të realizuar edhe elemente të tillë të punës mësimore-shkencore, siç ishin detyrat dhe projektet e kursit, diplomat, tezat e masterit, praktikat profesionale me studentët e masterit profesional në gjeografi dhe ekspeditat mësimore shkencore në terren me studentët e ciklit bachelor dhe master. Tashmë imperative ishte për ne, qasja drejt punës online për të bërë të mundur realizimin e tyre sa më cilësor, ndonëse vështirësitë dhe pengesat ishin mjaft prezente dhe reale. Ishte e nevojshme ndërtimi strukturor dhe një planifikim e detajim i hollësishëm i fazave të ndryshme nëpër të cilat duhej bërë i mundur realizimi i detyrimeve dhe angazhimeve të tilla akademiko-shkencore edhe në aspektin administrativ.

Realizimi i detyrave dhe projekteve të kursit, respektivisht me ciklin bachelor dhe master u planifikua nga ana jonë, që të ndiqnim të njëjtën ritëm organizativ dhe procedural si në rastin e punës në auditor. Vështirësia qëndronte në mungesën e kontaktit të vazhdueshëm që kemi vendosur me studentët në rastet e punës në auditor, ku ato janë më të shpeshta dhe me një kohë më të zgjatur, qoftë për të bërë të mundur orientimet dhe sqarimet shkencore, ashtu edhe ato metodike në organizimin e punimeve shkencore të këtij lloji. Një gjë e tillë u mundua nga ana jonë që të realizohej në një minutazh të caktuar gjatë orës së zhvillimit të seminareve, si dhe në takimet e veçanta online që zhvillojmë me tërësinë e studentëve, grupeve të veçanta apo individuale. Tentuam sa patëm mundësi për të realizuar kontakte sa më të shpeshta, sidomos në rastin e projekteve të kursit me studentët e masterit në lëndët Gjeografi sociale e aplikuar dhe Migrim e zhvillim social ekonomik. Madje me studentët e masterit krijuam ndarje të projekteve të kursit në grupe të veçanta studentësh, duke caktuar lider grupesh, të cilët nën orientimin tonë organizonin metodikisht dhe nga pikëpamja shkencore projektin e kursit. Interesim në këtë drejtim paraqitën projektet e kursit në Gjeografinë sociale të aplikuar nën fokuset shkencore “Problemet sociale në Shqipëri. Shpërndarja gjeografike e tyre”, apo “ Roli dhe kontributi i planifikimit social në zhvillimet sociale në vendin tonë”, ku studentët e masterit u përfshinë në mënyrë mjaft aktive për të realizuar punime cilësore nga pikëpamja metodike dhe shkencore. Detyrat e kursit me studentët e bachelorit u fokusuan në zhvillimet e tematikave sociale dhe të zhvillimit të popullsisë në njësitë e tyre administrative. Në mënyrë periodike ato filluan që të prezantojnë format dhe mënyrat që po përdornin, për të bërë të mundur hartimin e këtyre detyrave të kursit (duke ndikuar

edhe në krijimin e eksperiencave dhe përvojave, që i ndanin me njëri-tjetrin) dhe më pas t'i referojnë ato onlinë gjatë zhvillimit të seancave të seminareve. Aktivizimi i metodikave të tilla të punës shkencore nxiti aktivisht pjesëmarrjen dhe dëshirën e studentëve për t'u angazhuar me punën shkencore, ndonëse vlerësojmë se vështirësitë nuk munguan, si në kontaktet me literaturën bibliografike, burimet arkivale, mjetet në përdorim, qasjen drejt aplikimit të teknikave dhe metodave të ndryshme etj.

Një drejtim tjetër mjaft i rëndësishëm, si dhe tërësisht specifik për mënyrën dhe realizimin e punës shkencore me studentët, përfaqësonte edhe angazhimi që duhej realizuar nga ana jonë për udhëheqjen shkencore dhe metodike të punimeve të diplomave me studentët e vitit të tretë të studimeve bachelor në Gjeografi dhe të tezave të masterit, me studentët e Masterit shkencor dhe atij profesional. Theksojmë se, që në fillimin e vitit akademik, mjaft prej studentëve gjeografë kishin realizuar kontaktet e tyre me pedagogët përkatës dhe kishin depozituar kërkesat e tyre për objektet shkencore konkrete të punës së tyre dhe pedagogët udhëheqës në punimet e diplomës dhe të tezës së masterit. Udhëheqja ime metodike dhe shkencore fokusohej tek studentët që objektin e tyre shkencor e kishin orientuar drejt zhvillimeve sociale në gjeografi dhe tematikave të tilla, që kishin të bënin me popullsinë. Vënia përpara këtyre situatave të mungesës së kontakteve të përditshme në fakultet dhe auditor me studentët tanë, nxiti realizimin e përbashkët të punës online në platformat e krijuara. Në këtë mënyrë, intensivisht ndërtoam klasat online të diplomës dhe mikrotezave, ku respektivisht u përfshinë studentët e bachelorit dhe të masterit në gjeografi. Në mënyrë periodike filloi kontakti me to, duke ristrukturuar platformat shkencore të punimeve tyre, për faktin e një pauze që ishte krijuar, që nga momenti i parë i mbylljes apo "lockdaunit" të përgjithshëm. Realizua në mënyrë konkrete periodikisht punën me tërësinë e grupit diplomantë të studentëve të të dy sistemeve (bachelor dhe master), aktivizua vendosjen e afateve përkatëse për punën me kapitujt përkatës, çështjet dhe nënçështjet, pjesë e tyre. Gjatë kësaj periudhe pune intensive nga ana jonë dhe e studentëve të degës së Gjeografisë në Universitetin e Tiranës, Fakultetin Histori-Filologji, institucionalizua një raport konkret diskutimi online në grup, por edhe individual apo nëngrupe, kur fokusi ishte i përafërt në punën shkencore të tyre. Me anë të këtyre elementeve, ndonëse risi në punën tonë shkencore dhe metodike, kemi mendimin se arritëm ta përmbyllim me sukses një drejtim të tillë të punës shkencore pedagog-student, në kuadrin e realizimit të punimit të diplomave të ciklit Bachelor dhe tezat e masterit.

Larmia e punës mësimore shkencore në shkollën e lartë paraqitet mjaft e larmishme. Prandaj edhe përgjegjësia e stafit akademik është evidente në drejtim të realizimit të tërësisë së elementëve përbërës. Nën këtë këndvështrim ishte e nevojshme dhe e domosdoshme ndërmarrja e hapave konkretë në aspektet organizative, administrative, metodike dhe shkencore në drejtim të realizimit të dy elementeve mjaft të rëndësishëm, siç ishin praktikat profesionale me studentët e Masterit profesional në Gjeografi dhe praktikës Mësimore në terren (ekspeditave shkencore, siç i quajmë ne gjeografët) me studentët e ciklit bachelor dhe master. Secila nga këto aktivitete akademike përmbante veçori dhe specifika, të cilat duhet të merreshin në konsideratë, përpara se të ndërtohej e planifikohej se si duheshin realizuar me sukses ato.

Në kuadrin e realizimit të praktikave profesionale iu kërkua studentëve vendi, lokacioni dhe shkolla ku ato dëshironin që të realizonin praktikën e tyre profesionale. Më pas u caktuan pedagogët përgjegjës për ndjekjen e mbarëvajtjes së tyre në shkollat përkatëse. Kalimi drejt sistemit online nxiti edhe në këtë drejtim aplikimin e formave dhe metodave të reja të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet pedagogëve dhe studentëve. Lidhur ngusht me këtë pedagogët përgjegjës ndërtuan klasat online me grupet e studentëve, të cilët ishin pjesë e kësaj praktike profesionale. Në mënyrë periodike filluan të organizohen takime online me tërësinë e grupeve të studentëve, me një pjesë të tyre, sipas njësive administrative ku ato zhvillonin praktikën profesionale apo edhe me studentë të veçantë. Gjatë këtyre takimeve jepeshin udhëzime të ndryshme mbi format, metodat dhe aplikimet e dijeve shkencore gjeografike, që studentët duhet të paraqisnin në orët e tyre mësimore. Vlerësojmë se krahas praktikës pasive disajvare studentët tanë gjeografë përfshiheshin në praktikat aktive apo mësimdhënien aktive. Prania e diskutimeve të ndryshme nga ana e tyre, eksperiencat që ato ndanin, paraqitja e larmisë së planditareve (në mjaft raste të detajuara) që përgatiteshin nga ata, ndikonte dukshëm edhe në përfitim të përvojave metodike, për gjithsecilin nga ata. Interes paraqiste edhe përgatitja e relacioneve nga ana e tyre, sipas udhëzimeve përkatëse të hartuara nga departamenti i Gjeografise. Situatat me të cilat ato u përballën në punën e tyre mësimore i nxiti në aspektin kreativ për të gjetur rrugët dhe mundësitë e kontaktit me nxënësit e tyre në shkollat e ndryshme të vendit në tendencën e disave prej tyre, të aplikonin edhe mësimin në klasë edhe online duke u vënë në këtë mënyrë edhe përballë një sistemi tjetër të punës mësimore. Tërësia e këtyre situatave dhe elementeve të mësipërme ndiqej me mjaft interes dhe debatohej gjatë diskutimit online që realizonim periodikisht me studentët tanë gjeografë praktikantë. Theksojmë se krahas

këtyre takimeve online aktivizonim edhe postime të ndryshme në klasën tonë online apo edhe komunikime individuale në lidhje me ecurinë specifike të studentëve të veçantë.

Realizimi i praktikës në terren, apo ekspeditave të ndryshme, është pritur gjithmonë me kërshtëri dhe entuziazëm nga ana e studentëve tanë. Njohja e hapësirës sociogjeografike të vendit tonë, por edhe e trojeve shqiptare krijonte shpeshherë për gjeografët ndjesinë e padurimit për të hulumtuar e eksploruar hapësirën, territorin, ambientin në aspektin gjeografik. Por, ashtu siç u zhvilluan kushtet dhe rrethanat në aspektin global, vështirësia ishte mjaft e evidente për realizimin e tyre në institucionin tonë, aq më shumë, duke marrë në konsideratë numrin e lartë të studentëve gjeografë, pjesë e ciklit të studimeve bachelor. Nisur nga rrethana të tilla, angazhimi ynë u zhvendos drejt gjetjes së formave dhe mënyrave sa më aktive për realizimin e tyre. Përfshirja në kuadrin e sistemit online të ekspeditave mësimore shkencore, nuk ishte diçka e lehtë, përkundrazi kam mendimin se paraqitej mjaft e vështirë. Në kuadrin e bashkëbisedimit ndërmjet kolegëve me eksperiencë, diskutimet ishin nga më të ndryshmet, për format dhe mënyrat e organizimit. Këndvështrimin tim po e paraqes më poshtë, në lidhje me formën dhe mënyrën e organizimit të realizuar. Krahas krijimit të klasës online planifikuam që çdo ditë të ekspeditës të orientonim studentët në mënyrë individuale, apo në grupe të vogla, sipas njësive administrative të hulumtonin çështje të veçanta. Udhëzimet, sugjerimet dhe orientimet në lidhje me tematika, të tilla si: tiparet e përgjithshme fiziko-gjeografike të njësisë së tyre administrative në ditën e parë të punës shkencore, zhvillimin ekonomik në ditën pasardhëse, duke vazhduar gjatë ditëve të tjera të ekspeditës me zhvillimet e popullsisë, tematikat sociale, zhvillimet mjedisore dhe të turizmit, jepeshin gjatë seancave të mëngjesit, duke i nxituar ato të dilnin dhe të hulumtonin në terren. Ndërsa gjatë seancave të pasdites ata referonin në lidhje me hulumtimet e realizuara nga ana e tyre. Një format i tillë, sipas mendimit tonë, i mbante studentët të angazhuar në hulumtimin e tyre shkencor, nxiste prezencën aktive në hapësirat e tyre gjeografike, profilizonte karakteristikat themelore të profesionit të gjeografit, i nxirrte nga puna rutinën e përditshme e mësimit online. Gjithsesi, eksperiencia të tilla, bartin në vetvete kufizime dhe mangësi, lidhur me kushtet, situatën dhe kohën në të cilat ato zhvillohen.

Konkluzione

Një këndvështrim analitik i mësimit online të gjeografisë në shkollat e larta gjatë periudhës së pandemisë covid-19, kërkon analiza më të detajuara dhe gjithëpërfshirëse. Kam bindjen se mjaft kolegë gjeografë,

studiues të metodikës së gjeografisë do të kenë kohën e duhur në dispozicionin e tyre, për të ndërmarrë analiza sasiore dhe cilësore. Patjetër që në materialin e paraqitur jepen disa mendime dhe eksperiencë e krijuar nga ana jonë gjatë kësaj situate të pazakontë, por edhe në drejtim të pasurimit në aspektin e memories metodike shkencore të mësimdhënies së gjeografisë në universitetet gjatë kësaj periudhe. Si të tilla ato paraqiten me kufizime e dilema për situatën e kohën, debatuese në koncept, mënyra dhe forma të organizimit metodik. Patjetër që larmia e punës shkencore në shkollën e lartë, profilizimi, eksperiencia, pavarësia, ka nxitur gjatë kësaj periudhe një dinamikë interesante edhe të mësimdhënies së gjeografisë.

Nga tërësia e materialit të paraqitur në çështjet e mësipërme mund të arrijmë në disa konkluzione. Së pari, mësimdhënia online, paraqiti një sfidë të rëndësishme për sistemin arsimor në përgjithësi dhe arsimin e lartë në veçanti në disa drejtime. Krahas disiplinave të tjera shkencore, sfida, pengesa, dilema, problematika dhe kufizime shoqëruan edhe gjeografët, studiuesit e gjeografisë, pedagogët dhe studentët e tyre gjeografë.

Së dyti, angazhimi i trupës akademike, në mënyrë të veçantë aktorët direkt kryesorë, siç ishin pedagogët dhe studentët e degës së gjeografisë tejkaloi pritshmëritë dhe objektivat e vendosura. Në mënyrë graduale u vu re qartësisht tendenca në përmbushjen e realizimin e elementeve metodiko-shkencore të realizimit të planeve mësimore të degës së gjeografisë.

Së treti, është emergjente ndërmarrja e një analize të detajuar shkencore e tërësisë së eksperiencës së përfutur gjatë kësaj periudhe të zhvillimit të mësimin online në shkollën e lartë. Një gjë e tillë do të ishte mjaft adekuate drejt qëllimeve të rëndësishme të përcaktimit të qasjeve të reja në të ardhmen në aspektin aplikativ të kombinimit të punës në auditor më atë online në drejtime specifike të aktiviteteve akademike. Vlerësojmë se eksperiencia të tilla tashmë janë të njohura nga kolegë, studiues, mësimdhënës në arsimin e lartë, hartues dhe bashkëpunues në projekte shkencore ndërkombëtare.

Së katërti, duke analizuar në tërësi situatën, konkludojmë se paraqitet mjaft e rëndësishme nevoja dhe domosdoshmëria e plotësimit të bazës material-laboratorike, pajisjeve të ndryshme, didaktike, e tërësisë së stafit akademik, shoqëruar me trajnime intensive në kuadrin e aplikimit të teknologjisë bashkëkohore.

Kemi mendimin se studime të tjera të karakterit metodik e shkencor në të ardhmen, sidomos nga kolegët tanë gjeografë do të pasurojnë mendimin shkencor në këtë drejtim.

LITERATURA:

- Axhemi, Sokol: Shkrimi i punimeve shkencore në gjeografi. Tekst mesimor universitar. Tiranë, 2013.
- Axhemi, Sokol: Ekspeditat gjeografike në terren. Konceptime të reja në organizimin shkencor të tyre. Buletini i shkencave didaktike, 2011, Universiteti i Shkodrës.
- Axhemi, Sokol: Drejtime të nxitjes së shprehive të punës shkencore me studentët e gjeografisë nëpërmjet aplikimit të llojeve të punës shkencore në gjeografi. Buletini i shkencave didaktike, 2016, Universiteti i Shkodrës.
- Guce, Lujeta: <https://sites.google.com/site/luljetaguce92/home/edukimi-ne-distance>
- Kadiu, Lorin: Mësimi online në kohën e Covid 19, pro dhe kundër sistemit të panjohur. Citizens Channel, April 1, 2020.

MUZEU DHE SHKOLLA SI BURIME RECIPROKE BASHKËPUNIMI

Valbona Kraja

Përkthyes zyrtare akredituar nga ministria e Drejtësisë dhe ambasada Italiane

ABSTRACT

Ky artikull trajton disa aspekte rreth rëndësisë që ka rishikimi i metodologjisë së edukimit të trashëgimisë kulturore dhe historisë me anë të vizitave në muze. Kjo bazohet në rezultatin e studimeve të bëra në lidhje me efikasitetin e metodave të vjetra të zbatuara deri më tani, metoda të cilat nuk janë aspak koherente me epokën e teknologjisë ku po jetojmë sot. Lidhja mes muzeut dhe fëmijës deri tani është parë në kuadrin e aktiviteteve didaktiko-edukative të reklamuar nga muzetë në favor të publikut me moshë më të re, në bashkëpunim pak a shumë të ngushtë me shkollën dhe/ose familjet. Për këtë arsye ka ardhur koha që të zgjerohet vizioni për procesin e nxënies në muze i cili nuk varet vetëm nga faktorët cilësorë apo logjistikë, por edhe eksperiencat kulturore duke qenë në marrëdhënie të ngushtë me sjelljen mendore dhe me kushtet në të cilat bëhet një vizitë në muze.

Museum and school as mutual sources of cooperation

ABSTRACT

This article addresses some aspects of the importance of reviewing cultural heritage and history education methodology through museum visits. This is based on the result of studies done on the effectiveness of the old methods implemented so far, methods which are not at all coherent with the age of technology where we live today. The connection between the museum and the child so far has been seen in the context of didactic-educational activities advertised by museums in favor of the younger public, in more or less close cooperation with the school and / or families.

For this reason it is time to expand the vision for the learning process in the museum which depends not only on quality or logistical factors but also on cultural experiences being in close relationship with the mental behavior and conditions in which a visit to the museum takes place .

Vizitat në muze, si pjesë e partneritetit shkollë-muze, janë lloji më i zakonshëm i bashkëpunimit mes shkollave dhe muzeve. Në të gjithë botën muzetë dhe shkollat ofrojnë programe për fëmijët e të gjitha moshave duke pasur gjithnjë primar zhvillimin e tyre fizik, intelektual dhe konjitiv. Muzetë në partneritet me shkollat mbështesin edukimin dhe standardet e mësimdhënies. Gjatë njëqindvjeçarit të fundit, si pasojë e zhvillimeve të situatave politiko-sociale dhe kulturore ndërkombëtare, vihet re një pasurim i kontekstit të termit “institucion muzeal”.

Vlerat e muzeut në shoqërinë bashkëkohore nuk lidhen vetëm me përmbajtjen materiale që paraqesin, por edhe me rritjen personale dhe me tërësinë e proceseve njohëse që ato nxisin tek vizitorët. Muzeu në vetvete është një vend në shërbim të kolektivitetit, duke i bërë njerëzit të ndjehen të inkurajuar për të marrë pjesë në mënyrë aktive në proceset e transmetimit dhe krijimit të vetëdijes e duke bërë të mundur që ata të kenë mbështetje tek një bashkëbisedues institucional i pranishëm dhe stimulues.

Vizitat muzeale shkollore kanë mangësi evidente për shkak se ato janë të shkurtra në kohë dhe fokusohen më shumë në rëndësinë që ka rezultati i të nxënit. Prandaj këto vizita duhet të kenë synimin që fëmijët të fitojnë në muze eksperiencë të paharrueshme apo “lifelong experiences”¹ të cilat do të mbeten në memorien dhe njohuritë e tyre. Por, për mësuesit është primar vetëm konkretizimi i historisë në bazë të programit mësimor. Megjithatë vizitat në muze, në rast se janë eksperiencë pozitive dhe argëtuese kanë shanse të jenë të suksesshme për nga aspekti i të nxënit konceptual.

Punonjësit e muzeut dhe mësuesit i koordinojnë përpjekjet e tyre për vizitat vjetore në muze, por mospërputhja e koncepteve rreth filozofisë edukuese nga secili prej institucioneve ndikon në rezultatet e pritshme nga këto vizita në muze dhe e tkurrin partneritetin duke penguar përparimin në nivele bashkëpunimi dhe integrimi. Ndërkohë që punonjësit e muzeut fokusohen në ofrimin e një eksperiencë në lidhje me historinë, mësuesit synojnë vetëm reflektimin konkret të një ore mësimi, bile në disa raste vetëm përmbushjen e programit. Megjithatë faktet tregojnë se fëmijët transmetojnë dhe përshkruajnë një informacion shumë interesant për

¹ Eksperiencë të përjetshme.

historinë dhe objektet e muzeut gjatë vizitave të tyre me ose pa ndihmën e punonjësve të muzeut.

Të dhënat tregojnë se partneriteti ndërmjet shkollave dhe muzeve për vizitat gjatë vitit shkollor është realisht diçka ekzistuese dhe ka për qëllim të mbështesë programin mësimor. Komunikimi i kufizuar mes mësuesve dhe punonjësve të muzeut po i pengon të dyja grupet të kenë një bashkëpunim më koherent dhe frutdhënës. Të dyja institucionet kanë mundësi të shkëmbejnë potencialet dhe aftësitë e tyre në mënyrë që ky bashkëpunim të ecë në një hap me zhvillimin e fëmijëve të sotëm dhe të shekullit të 21^{të}.

Do të ishte shumë e dobishme që nga mësuesit dhe punonjësit e muzeut të jepeshin rekomandime për një partneritet me mbështetje reciproke ku përfshihet nxitja dhe fitimi i mendimit kritik tek fëmijët. Duke inkurajuar mendimin kritik tek fëmijët dhe duke aplikuar praktikat mësimore në muze para-, gjatë-, dhe pas- vizitave është e mundur të koordinojmë të nxënit eksperimental dhe të nxënit me anë të eksperiencës.

Sot institucionet muzeale botërore evidentojnë një angazhim të theksuar edukativ kundrejt fëmijëve, duke i sjellë në qendër të politikave edukative afatgjata. Në fakt, fëmijët janë qytetarët e ardhshëm, nga të cilët pritet promovimi i një të rrituri të mirëformuar dhe të vetëdijshëm. Shkolla, në lidhje me objektiva të tilla edukative, paraqitet si një homologe ideale e politikave kulturore të muzeve. Në fakt, gjithnjë e më shpesh, ajo po përfshihet në organizimin e iniciativave që synojnë pasurimin e eksperiencës formuese të nxënësve nga kopshti deri në universitet.

Bashkëpunimi me sektorin shkollor do të ishte një bashkëpunim strategjik edhe në lidhje me gamën e gjerë të informacionit që shfaq, informacion i cili nuk kufizohet vetëm tek nxënësit, por edhe tek familjet e tyre. Në këtë mënyrë do të krijohet mundësia e shtimit të shtresave të popullatës të cilat janë më pak frekuentuese të muzeve dhe të vendeve të kulturës, duke i ndihmuar që t'i afrohen vendeve të tilla dhe duke hequr ato barriera që nganjëherë e bëjnë të vështirë për dikë që nuk është mësuar, që të krijojë familjaritet me mjedise të tilla si muzeu.

Kështu ndër vite është fuqizuar ideja e shkollës si burim për muzeun, ashtu siç muzeu përbën një mundësi të çmueshme në lidhje me mbështetjen që mund t'i japë programimit të didaktikës tradicionale. Shkolla dhe muzeu shfaqen si dy realitete që janë të destinuara që të ndërthuren në mënyrë gjithnjë e më të shpeshtë, më të organizuar edhe në lidhje me faktin se shoqëria bashkëkohore po nxjerr në pah nevojën për të krijuar lloje të reja kompetencash dhe aftësish në lidhje me formimin e të rinjve duke përdorur forma pjesëmarrëse të cilat stimulojnë rritjen

personale dhe duke i dhënë nxënësit të sotëm mundësinë për të luajtur një rol aktiv në procesin e të nxënës.

Një risi e vërtetë do të ishte përforcimi i bashkëpunimit mes shkollave në nivele të ndryshme, gjë e cila mund të përbente një element të vlefshëm motivimi për të gjitha palët e përfshira, duke bërë të mundur në të njëjtën kohë pasurimin e eksperiencës shkollore.

Paralelisht me këtë supozim dalin në pah edhe probleme ndër të cilat vendin e parë e zë mungesa e personelit të gatshëm për të shoqëruar klasat, qoftë për mungesë stafi e qoftë edhe për mungesë dëshire për të punuar me orë shtesë nga ana e specialistëve të muzeut. Kësaj i shtohen edhe vështirësi që lidhen me dimensionin logjistik për vizitat si dhe për oraret, të cilat shpesh janë në konflikt me të përditshmen shkollore dhe kur u kërkohet mësuesve zëvendësim orësh apo rikuperim orësh.

Së fundi do të çmohej shumë prania e një personeli të kualifikuar për shoqërim gjatë vizitave në muze në mënyrë që të përballohen më mirë tematikat të cilat lidhen me kompetencat apo mekanizmat e funksioneve të veçanta të cilat kanë të bëjnë me etnografinë, historinë, traditën, artizanatin apo edhe kulturën.

Çdo lloj studimi, qoftë në shkencë humane, shkencore apo artistike ka potencialet e veta edukative edhe kundrejt më të vegjëlve, pasi edhe nocionet më komplekse mund të transmetohen në mënyrë më të thjeshtuar dhe të kuptueshme, duke hapur në këtë mënyrë një dritare në një botë ndoshta të panjohur për fëmijën, por që mund t'i interesojë dhe ta tërheqë. Megjithatë nuk duhen nënvlerësuar aspekte të aftësisë së fëmijëve për të perceptuar dhe kuptuar argumente të cilat duken të përshtatshme vetëm “për të rriturit”, siç ka theksuar edhe Paolo Baratta² me rastin e prezantimit në një aktivitet :“Eksperiencat e jetuara që në vogëli mund të mbjellin farën e pasionit, dhe çelin dyert e një bote të tërë”. Prandaj është me rëndësi të madhe që t'u bëjmë të ditur fëmijëve shumëllojshmërinë e kësaj bote, të gjitha nuancat e saj, në mënyrë që të krijojmë një familjaritet edhe me lëndë komplekse të cilat do të pasurojnë leksikun e tyre të njohjes, duke zgjeruar dijet e tyre dhe vetëdijen ndaj realitetit kulturor dhe historik të vendit. Mësuesit do të vlerësonin shumë kontributin e individëve të jashtëm të cilët me aftësitë specifike do të ndihmonin duke u propozuar fëmijëve disa ide dhe thellime më të specializuara, duke e zgjeruar horizontin shkollor me koncepte të cilat pasurohen me anë të sferave të ndryshme. Të tilla aktivitete mund të zhvillohen edhe në shkollë duke shmangur lëvizjet jashtë

² **Paolo Baratta** (lindur më 11 nëntor 1939) ekonomist italian dhe ish-ministër. Prej vitit 2008 në vitin 2020 ishte Presidenti i Bienales së Venecias.

shkollave, pa qenë nevoja e angazhimit të prindërve apo e shpenzimeve, pasi këto orë do të zhvilloheshin nga studentët e praktikës dhe nuk shpërblehen me pagë. Një raport i tillë mes shkollës dhe praktikantëve mund të ketë ndikime pozitive në mjedisin shkollor, pasi fëmijët, duke qenë në kontakt me individë të niveleve të ndryshme akademike dhe me ata të moshës së re, do të kishin mundësi të vendosnin bazat e dijes së tyre në marrëdhënie me më të rinjtë pa pasur mbi krye emocionin kundrejt mësueses.

Një realizim i mundshëm i gjithë kësaj duhet të kalojë disa faza ku ndër të parat është ajo e miratimit nga ana e autoriteteve institucionale të supozuara për të drejtuar shkollën apo muzeun. Këtu do të hynin në lojë drejtoria arsimore, drejtori i shkollës, mësuesi, nga ana tjetër bashkia apo ministria e kulturës, drejtori i muzeut. Për projektet në fjalë do të duhej edhe mbështetja e mësuesve në lidhje me përzgjedhjen e temave dhe përmbajtjeve, duke siguruar në këtë mënyrë dobishmërinë e tyre si të përshtatshme për secilën klasë në veçanti.

Marrëdhëniet muze-shkollë dhe strategjitë e bashkëpunimit

Marrëdhënia e muzeut me shkollën dhe ajo me institucionet e tjera muzeale realizohet me anë të dialogut mes palëve. Në këtë kohë ku përjetojmë ndryshime radikale në të gjitha fushat, muzeut i del për detyrë që të mund të konkretizojë një mbështetje efikase në fushën e formimit të individit dhe të pasurimit të dijeve të tij, duke shfrytëzuar rrjetet e agjencive kulturore, aparatet dokumentuese dhe shërbimet edukative, të përshtatura edhe me teknologjitë me të fundit informative dhe multimediale, si edhe strategjitë e reja rinovuese për ta kthyer atë në një vend të privilegjuar dhe mjedis nxënieje dhe pasurimi kulturor.

Një muze nuk mundet vetëm të mbledhë dhe nuk i mjafton vetëm të mbrojë, vlerësojë apo të propozojë hapësira të reja ekspozuese. Institucionit muzeal i duhet gjithnjë t'i bëjë vetes pyetje sesi ai mund të rinovohet dhe të ndryshojë me qëllim që të mbetet një pikë e privilegjuar referimi kulturor për gjithë personat që e vizitojnë, sidomos për brezin e ri dhe komunitetin e apasionuar pas tij apo edhe studiuesit.

Komunikimi me shkollat

Në lidhje me strategjitë e komunikimit dhe promovimit të vënë në zbatim nga muzetë për të bërë të mundur arritjen tek shkollat, vihen re një shumëllojshmëri linjash, shpesh të shfrytëzuara njëkohësisht në mënyrë që të shtohet shikueshmëria dhe hapësira e përdorimit.

Në veçanti, do të ishte me vend tashmë përdorimi i dërgesës së njoftimeve dhe të rejave me anë të postës elektronike. Në rastet kur është e mundur këto materiale do të ishte më mirë që t'u dërgoheshin direkt mësuesve në adresat e tyre personale, në rastin kur këta mësues mund të krijojnë një korrespondencë elektronike me muzetë.

Kështu do të bëhej i mundur komunikimi i vazhdueshëm dhe i lehtë ndryshe nga dërgimi i njoftimeve me anë të postës apo me hartimin dhe krijimin e broshurave pranë sekretarive të shkollave apo mësuesve të interesuar. Këto dërgesa mundësisht bëhen që në fillim të vitit shkollor, në mënyrë që t'u jepet kohë mësuesve për të vlerësuar dhe zgjedhur ato më të përshtatshmet, në bazë të programit didaktik të orëve mësimore.

Në shumë qytete të botës, shpërndarja e njoftimeve për muzetë bëhet me anë të shpërndarjes së broshurave në vendet të cilat frekuentohen më shumë nga fëmijët, familjet, si: biblioteka, librari, dyqane me artikuj për fëmijë. Me interes do të ishte edhe mbështetja nga strukturat publike qytetare për veprime reklamuese: në këtë rast mund të aplikohet mënyra e dërgimit të nevojave didaktike pranë Komunës apo bashkisë dhe pastaj këto institucione mund të kujdesen për përcjelljen e informacionit pranë shkollave të tyre.

Përveç këtyre formave të komunikimit direkt ekziston edhe krijimi i faqeve në rrjetin internet për këto institucione. Në fakt, siti internet, shihet si një ndërmjetës thelbësor për publikun shkollor dhe një gjë e tillë është e dobishme jo vetëm për njohjen e iniciativave të programit dhe mënyrave të zhvillimit, por edhe për drejtimin e mësuesve gjatë fazës së prenotimit dhe organizimit praktik. Bashkë me sitin po ashtu edhe rrjetet sociale rezultojnë të kenë një influencë rritëse dhe duhet të jenë shumë efikase në shkëmbimin e informacioneve ndërmjet bashkëbiseduesve në këto rrjete.

Së fundi, një element tejet i rëndësishëm i shfrytëzuar nga muzetë ka të bëjë me forcën e transmetimit të fjalës. Në shumë raste rezulton të jetë tepër efikas efekti i fjalës ndërmjet qytetarëve. Për këtë arsye institucionet i kushtojnë shumë vëmendje ndërveprimit direkt me publikun: takimi dhe komunikimet me zë bëhen të domosdoshme për të përfshirë personat dhe t'i bëjnë të ndjehen pjesë e vendeve historike dhe muzeale të qytetit, duke krijuar atë koncept rrjeti që qëndron në themel të një kulture të gjallë, dinamike dhe qarkulluese.

Të nxësh dhe të mësosh në këtë epokë

Në shekullin e 19^{të} filloi të institucionalizohet gjithnjë e më shumë marrëdhënia midis shkollës dhe muzeut, duke nxjerrë më pah potencialin

formues dhe duke sjellë në jetë aktivitete të ndryshme për fëmijët, të ndryshme nga një vizitë rutinë me guidë, aktivitete të cilat u sajuan për të krijuar dhe vendosur marrëdhënien me fëmijët me anë të kodeve dhe gjuhëve multishqisore të ndryshme nga ajo e të rriturve. Paralelisht me këtë, vihet re se gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit të shekullit të kaluar pati një rritje të ndjeshmërisë ndaj fëmijëve për vitet e tyre të zhvillimit dhe një interes i rinovuar ndaj bërthamës së familjes, mirëqenia e së cilës është fryt i shumë faktorëve, ndër të cilat përmendim mjedisin kulturor, kohën e lirë, dimensionin e marrëdhënies dhe ndjesinë e përkatësisë ndaj komunitetit.

Në këtë drejtim hyn në veprim didaktika muzeale, e cila supozohet të favorizojë zhvillimin formues të fëmijëve duke ju përgjigjur njëkohësisht edhe nevojave të familjeve. Konceptet në bazë të kësaj në fakt ndjekin këtë tendencë duke u shtrirë në fusha të ndryshme disiplinore; falë një ndërthurjeje fitimprurëse njohurish, drejtimi i studimeve mbi arsimin shkollor dhe edukimin që në fëmijëri po ndryshon vazhdimisht. Shkencat ekonomike në veçanti, po hapen ndaj kulturës duke u dhënë udhë teorive të reja. Degë të ndryshme të kërkimit shkencor gjithashtu po shërbejnë për mbështetjen e modeleve matematiko-ekonomike dhe të sistemeve sasiore për të mbledhur dhe analizuar të dhënat në mënyrë sistematike.

Ndër këto eksperiencia, ekonomisti i njohur James Hackman,³ pohon sesi zhvillimi i aftësisë njohëse dhe socio-emotive të një individi varen në një shkallë të gjerë nga faktorë që veprojnë qysh në fëmijëri, madje që nga mosha parashkollore. Më anë të formulimit të një modeli teorik të quajtur në vazhdim “ekuacioni i Hackman”, ai sugjeron se ndikimi qysh në fëmijërinë e hershme bën të mundur që fëmijëve t’u jepen aftësitë të cilat do t’u bëjnë të mundur atyre të afirmohen në vitet e ardhshme në jetën prej të rrituri. Ndër aftësitë e cilësuar si themelore, Heckman evidenton rolin e të ashtuquajturave aftësi jokonjitive apo *soft-skills*, prej të cilave aftësia e krijimit të marrëdhënieve me të tjerët, aftësia për të menaxhuar reagimet e veta dhe besimi në vetvete, mbi të cilat ai mendon se është shumë e rëndësishme të fokusohemi nën këndvështrimin e zhvillimit personal, shoqëror dhe për punën e brezave të rinj. Por, siç nënvizon ai, këto aspekte e kanë të vështirë të gjejnë hapësirë në zhvillimet publike, tek lëndët mësimore dhe zhvillimi shoqëror, që përqendrohen më shumë në moshën shkollore. Hackman insiston me këmbëngulje të veçantë për nevojën e mbështetjes së familjeve, sidomos të atyre familjeve nga ana

³ Ekonomist amerikan i cili merret me ekonominë e aplikuar në zhvillimin e njeriut. Bashkë me kolegun e tij Daniel McFaden ju dha në vitin 2000 çmimi Nobel i ekonomisë për kontributin e tij në zhvillimin e teorisë dhe metodave për analizimin e kampioneve të zgjedhur.

sociale janë më me pak fat, si për nga konteksti dhe zgjedhja familjare “të luajnë një rol vital në ndihmesën ndaj fëmijëve në mënyrë që këta të fitojnë aftësi dhe kompetenca që në moshë të hershme. Jo të gjitha familjet kanë burime të barabarta, por çdo familje duhet të ketë akses të njëjtë tek burimet për të cilat fëmijët e tyre kanë nevojë me qëllim që zhvillimi i tyre të jetë i suksesshëm”⁴. Në vazhdë të kësaj ai i jep rëndësi një politike e cila mbështet familjet në vështirësi dhe se ai i konsideron fëmijët si burim thelbësor për të ardhmen e shoqërisë, duke promovuar metoda edukative të që nuk kalojnë më vetëm nëpërmjet metodave shkollore tradicionale, por mund të pasurohen me anë të eksperiencave të reja didaktike dhe të inkurajojnë fëmijët të shfrytëzojnë aftësitë e analizimit, të arsytimit, të aktiviteteve shoqërore, duke filluar që në vitet e para të jetës së tyre.

Gjithashtu, edhe vetë Maria Montessori⁵, qysh në dhjetëvjeçarët e parë të viteve nëntëqind, i kushtonte kujdes zhvillimit fillestar të fëmijës, në dimensionin e tij konjitiv, por edhe psiko-fizik, në lidhje me sjelljet specifike të vrojtuar tek secili. Metoda e saj, sot tashmë e përhapur në të gjithë botën, ka kontribuar në formimin e disa personaliteteve të spikatura, që janë shquar në dhjetëvjeçarët e fundit për aftësitë e tyre të inovacionit dhe për një prirje të madhe drejt mendimit krijues dhe të veçantë. Will Wright Inovator dhe krijues i videolujërave dhe nxënës i metodës Montessori, tregon sesi një mënyrë e tillë edukative ka qenë thelbësore për zhvillimin e ideve të cilat janë baza e punës së tij: “metoda Montessori më ka mësuar kënaqësinë e zbulimit”⁶. Ai e konsideron veçanërisht përcaktuese trashëgiminë e lënë nga Montessori “Il metodo Montessori” për sa i përket filozofisë e cila e frymëzoi për videolujërat e tij, si një teori e konceptuar për të ndihmuar fëmijët, me anë të lojës, të eksplorojnë, duke bërë pyetje për botën që i rrethon dhe për parimet që e rregullojnë atë. Duke folur për videolujën e tij të re *Spore*⁷, shtron pyetjen:

⁴ Për më tepër shiko sitin dedikuar ekuacionit të Heckman, <www.heckmanequation.org>. citimi ka të bëjë me një tekst informativ të disponueshëm në adresën <<http://www.heckmanequation.org/content/resource/heckman-equation-brochure-0>> (22/06/2014)

⁵ Maria Tecla Artemisia Montessori 3 Gusht , 1870 – 6 maj 1952) ishte mjekë italiane dhe edukatore e njohur me shumë për Filozofinë e edukimit e cila mban emrin e saj, dhe shkrimet e saj për pedagogjinë. Metoda e saj e mësimdhënies përdoret edhe sot në disa shkolla shtetërore apo private në botë.

⁶ S. Pistolini, *Montessori Connection* tek revista “Wired” n. 31, 2011, faqe 67.

⁷ *Spore* është një videolujë e shumëllojshme për një lojtar, e ideuar në vitin 2008 nga Will Wright rreth temës së evolucionit dhe eksplorimit të universit.

Çfarë ndodh nëse i jepni dikujt një planet në formë loje, dhe e lini të luajë me dinamika të ndryshme, çfarë do të mund të ndodhte? çfarë do të mund të mësonte? [...] Në thelb, dua që ata të luajnë e të jenë në gjendje të eksperimentojnë dhe eksplorojnë një numër të madh gabimesh [...]Përdorim lojën për të ristrukturuar intuitën tonë⁸.

Këtu procesi formues kryhet duke kaluar nëpër një eksperiencë konkrete, edhe pse virtuale, procesi i cili u beson fëmijëve rolin e “mësuesit”, pasi i stimulon të pyesin veten për arsyeime rreth gjërave, të formulojnë hipoteza dhe në fund t’i verifikojnë me anë të eksperiencës direkte. Në fakt ky është një ripërkufizim, për nga aspekti i dijes, i metodës eksperimentale shkencore, me anë të një ndërthurjeje të fizikës, teorisë së evolucionit, gjeologjisë, astronomisë, sociologjisë gjë e cila mund të njehsohet me eksperiencën e një fëmije në muze historik dhe etnografik edhe pse në këtë rast do të kemi ndërthurjen e disiplinave të tjera. Këto mjedise nuk i lënë asgjë mangët një laborator didaktik shkencor. Për këtë shumë muze në botë kanë krijuar ambiente të tilla duke aplikuar këtë teori të mësosh duke eksperimentuar, duke shfrytëzuar konkretizimin e gjetjeve të ekspozuara për të nxitur kureshtjen tek fëmijët dhe për t’i stimuluar të pyesin për gjërat dhe faktet e ndryshme. Ashtu si tek loja *Spore* ku ndërveprimi me fëmijët bëhet i mundur me anë të një ndërmjetësimi teknologjik, gjithnjë e më shumë muze kanë filluar të përdorin teknologjitë në aktivitetin e tyre didaktik dhe popullor. Për mendimin tim, ky fakt nuk duhet anashkaluar në këndvështrimin e një vlerësimi të mundshëm për ndikimin që aktivitete të tilla kanë tek procesi konjitiv në epokën e re.

Edhe pse në fakt, një qasje konkrete e gjërave përbën një element shumë të rëndësishëm për të mësuarin, pasi një gjë e tillë i lejon fëmijës (dhe jo vetëm) të prekë me dorë objektet dhe të ndërtojë bagazhin e vet kulturor mbi bazën e eksperiencës personale, mundësia e drejtimit të eksperiencës nëpërmjet teknologjisë, në ditët e sotme përfaqëson një tjetër element pozitiv. Brezat e rinj “ të lindur në epokën së dixhitalizimit” në të vërtetë po zhvillojnë aftësi arsyetimi dhe të të mësuarit, të shkaktuar nga vetë natyra e mediave, të cilat nuk bazohen tek sekuencat, bazohen në llojin

⁸ W. Wright, *Spore, birth of a game*, konferencë e mbajtur nga TED në mars 2007, e disponueshme tek [adresa<http://www.ted.com/talks/will_wright_makes_toys_that_make_worlds>](http://www.ted.com/talks/will_wright_makes_toys_that_make_worlds) (29/06/2014).

e veprimit *multitasking*, në lidhjet mes informacioneve dhe aftësinë e njëkohshme për të reaguuar dhe për të perceptuar stimujt⁹. Prandaj sistemet edukative duhet të shfrytëzojnë këto mjete të reja, por duke ndryshuar disa gjëra në mënyrë që të mos “e pësojmë” nga tepria e përdorimit të teknologjisë. Studimet e specialistëve të kësaj fushe po ecin drejt idesë së një strukture të bashkëndarë të njohjes në vend të “kalimit apo transmetimit nga lart”, gjithsesi pa i anashkaluar mënyrat tradicionale të kulturës.

Në lidhje me këtë mund të citohen eksperimentimet në nivel ndërkombëtar të kryera nga studiuesit Tim Raylands dhe Simon Egenfeldt-Nielsen, të cilët janë duke shfrytëzuar eksplorimet virtuale dhe lodrat strategjike për të shpjeguar koncepte komplekse dhe për të zhvilluar aftësitë gjuhësore, matematike dhe shqisore të studentëve të tyre më të rinj. Pra nga këto raste del në pah sesi çështja e edukimit nuk ka të bëjë vetëm me aftësinë e një mësuesi të vetëm, pavarësisht sa investon për këtë sistemi shkollor në tërësi. I këtij mendimi është edhe Sir Ken Robinson, pedagog dhe shkrimtar anglez, i cili shpreh habinë e tij për rehatinë ku kanë rënë sistemet edukuese dhe shkollore, që akoma operojnë sipas parimeve të konceptuara “në kuadrin kulturor dhe intelektual të epokës së Iluminizmit dhe në rrethanat ekonomike të revolucionit të parë industrial”¹⁰. Sipas mendimit të tij, këto sisteme shkollore, kanë gjeneruar bindjen se janë aftësitë akademike ato që dominojnë konceptin e inteligjencës sonë. “Si rrjedhojë e kësaj, shumë individë brilant mendojnë se nuk janë fare inteligjentë, pasi janë gjykuar sipas një këndvështrimi të caktuar të mendjes dhe inteligjencës”¹¹ Ajo çfarë pedagogu dëshiron të cilësojë është se inteligjenca e njeriut është e ndryshme nga njëri tek tjetri, ajo përdor rrugë të ndryshme shqisore (shikimin, dëgjimin, prekjen) dhe reagon nga mënyra e ndryshme e të parit të gjërave. Sërish nxitet bindja se duhet të organizojmë edukimin e fëmijëve mbi bazën e dhuntive të tyre të lindura, duke u distancuar nga modelet tradicionale të të nxënimit të cilat bazohen tepër në kapacitetin e kujtesës, nga pranimi i stimujve, në kryerjen rigoroze të detyrave dhe tek notat. Rruga që na tregon Robinson është ajo që i jep hapësirë eksplorimit të vetes, improvizimit, autonomisë personale, duke bërë të mundur formimin e njerëzve të cilët do jenë të aftë të mbështeten tek kreativiteti i tyre për të gjeneruar ide me vlerë, të kultivojnë talentin e tyre individual dhe të përballojnë të ardhmen në mënyrë konstruktive. Kështu ai shkruan:

⁹ E. Aprico, M. Simionato, *Cervelli multitasking* tek “Wired” (Revistë) nr. 31, 2011, fq.113.

¹⁰ K. Robinson, *Back to School* tek revista “Wired” n. 31, 2011, fq. 62.

¹¹ *Ibidem*/ketu fq. 4.

Ne duhet të tregojmë kujdes që të përdorim me urtësi dhuntinë e imagjinatës së njeriut [...]. dhe këtë do ta bëjmë vetëm nëse do dimë të shikojmë aftësitë tona krijuese në atë nivel që janë dhe nëse do dimë t'i shohim fëmijët tanë me syrin e shpresës që ata përfaqësojnë. Detyra jonë është t'i edukojmë në tërësinë e tyre në mënyrë që të jenë të aftë të përballojnë të ardhmen. Ndoshta ne nuk do ta shohim këtë të ardhme, por ata po. Prandaj detyra jonë është t'i edukojmë për këtë¹².

Nga këto fjalë të tijat duket qartë dëshira që ai ka për modele të reja edukimi dhe shoqërore të cilat të kalojnë nëpërmjet përdorimit të vetëdijshëm të mendjes së njeriut dhe të potencialeve që ajo mbart në vetvete. Megjithatë autori e kupton se sa e vështirë është të ndryshohet ose madje të rishkruhet një sistem i tërë shkollor i një vendi, supozimet e të cilit janë rrënjësor thellë në vetëdijen kolektive.

Prandaj, për këtë arsye, organizimet kulturore mund të shfrytëzojnë një situatë të tillë duke punuar si urë konceptuale me anë të mënyrave të ndryshme të konceptimit të arsimimit, dhe duke u bërë vetë faktor ndryshimi. Muzeu në veçanti, përderisa është një realitet i shkëputur nga sistemi shkollor i vendit, ka një autonomi të gjerë në projektimin e aktiviteteve didaktike për fëmijët e vegjël. Muzeun nuk e pengon asgjë të eksperimentojë, të ndërthurë ide, të frymëzohet nga modelet ndërkombëtare dhe të udhëheqë studime shkencore me synimin për t'i mësuar fëmijëve marrëdhënien me historinë, traditën dhe trashëgiminë kulturore. Prandaj mund të eksperimentojë dhe të zhvillojë mënyrat e tij në mënyrë më të shpejtë, duke u vënë në rolin e një vrojtuesi të interesuar për potencialet dhe metodat edukative të ndryshme, të cilësuar nga autorët e përmendur.

Instrumente të reja komunikuese dhe kultura dixhitale

Më lart u pa sesi mjetet *teknologjike* po ndryshojnë mënyrën e të mësuarit dhe të arsyetimit tek fëmijët, duke u kërkuar në këtë mënyrë institucioneve një vëmendje të veçantë ndaj politikave edukative më moderne dhe më të kalibruara sipas nevojave të kohës. Aspekti teknologjik vepron paralelisht në një mënyrë më të shpërhapur dhe jo “krejtësisht

¹² K. Robinson, *How schools kill creativity*, Konferenca e TED (organizatë jofitimprurese) në shkurt 2006. Për më tepër shiko në adresën
<http://www.ted.com/talks/ken_robinson_says_schools_kill_creativity> (22/06/2014).

“edukative”, gjë e cila mund të përkufizohet si “shoqërore”. Bëhet fjalë për prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit, apo të rolit të komunikimit në gjirin e shoqërisë. Një rol i tillë është thelbësor edhe në brendësi të muzeut, në një prospektivë të dyfishtë.

Nga njëra anë në fakt kemi angazhimin themelor për të “komunikuar koleksionet”, duke lejuar të kuptuarin nga ana e vizitorëve dhe duke favorizuar si rrjedhojë vlerësimin e tyre. Komunikimi në këtë rast realizohet me anë të një sërë instrumentesh që variojnë nga ato tradicionale të udhëzuara deri në guidat me fletëpalosje, audioguidat, vizitat e udhëhequra deri në artikulime formash pak a shumë të ndryshme të ndërmjetësimit kulturor. Veçanërisht, futja e teknologjive në shërbim të eksperiencës së vizitës ofron mundësi të reja lidhur me aktivitetin dhe me mundësinë e ofrimit të një vizite që nuk konfigurohet si një paketë e parapërgatitur me kujdes, por në fakt ofrohet si një produkt fleksibël, në shërbim të shijeve dhe interesave personale të vizitorit, duke i lejuar atij të zgjedhë vetë rrugën që do të ndjekë dhe temat që dëshiron të thellojë.

Nga ana tjetër, një aspekt që po merr gjithnjë e më shumë rëndësi në gjirin e vetë aktiviteteve kyç të muzeut (misioni dhe vizioni) ka të bëjë me dimensionin e *marketing*, apo tërësinë e proceseve të komunikimit dhe vetëpromovimit të cilat bëjnë të mundur afrimin e publikut dhe besnikërinë e tij. Forma më tradicionale e promovimit përfaqësohet nga publiciteti që kalon nëpërmjet kanaleve mediatike të televizionit, radios, kinemasë ose që propozohet në hapësirat e jashtme me anë të vendosjes së pankartave ose duke shpërndarë materiale informative. Krahas këtyre mënyrave reklamuese dhe një projektimi thellësisht të detajuar dhe me ndikim të gjerë në nivelin territorial, marrin gjithnjë e më shumë rëndësi në panoramën e organizimeve kulturore disa forma të *marketingut* dixhital. Këto kanë një emërtim të përbashkët BTL (*below the line*) pasi, ndryshe nga të mëparshmet të emëtuara (si ATL: *above the line*), kanë kosto aktivizimi shumë më të ulëta: kanë të bëjnë me rastin e marrëdhënieve publike, të aktiviteteve promociionale, të *social media marketing* dhe të gjithë atyre formave të pazakonta të *marketing* që përziejnë përmbajtjen informative me një dozë pak a shumë të theksuar kreativiteti dhe improvizimi¹³.

Ky spostim i interesit në kohët e fundit drejt dimensionit dixhital të komunikimit është fryt i shumë faktorëve kompleksë të cilët siç vëren Alessandro Bolla:

¹³ Për më tepër shiko: A. Bollo, *Il marketing della cultura*, Roma, Botues Carocci, 2012, fq. 90-91.

Janë rrjedhojë e rritjes së vazhdueshme e asaj pjese popullore e cila përdor internetin, nga zgjerimi dhe shpërndarja e përmbajtjeve audiovizive, nga rëndësia që ka marrë fjala, nga përballja, nga shkëmbimi i ideve dhe përmbajtjeve, të mundësive për individualizuar dhe ndërtuar marrëdhëniet me ente tregu shumë të specializuara¹⁴.

- **Rrjeti internet.** Duket qartë sesi menaxhimi dhe projektimi i njërit prej instrumenteve më të përdorshëm, rrjeti internet, mund të përbëjë për institucionet kulturore një burim të madh, i cili po ta konceptonim si një “vitrinë” do ta kufizonim shumë për nga numri dhe shtrirja e përmbajtjeve të cilat vihen në dispozicion të publikut dhe si një mjet i thjeshtë për informimin e ekzistencës. Ndryshe nga kjo, rrjeti internet, mund të pasurohet me një gamë të gjerë funksionesh të cilat do të veprojnë mbi imazhin global që percepton publiku për muzeun, ndikimin konjitiv dhe edukativ, dhe së fundi sipas tendencave më të fundit edhe për përfitim ekonomik. Siç rithekson Alesandro Bolla, rrjeti internet mund të perceptohet si një lloj platforme 2.0 me anë të së cilës vendoset një komunikim në më shumë nivele, duke lejuar zhvillimin e një rrjeti aktiviteteve që plotësojnë e mbështesin njëra –tjetrën dhe duke përfunduar praninë e institucionit në qytet dhe treg:
 - Informacione të përgjithshme mbi historinë dhe identitetin kulturor të institucionit;
 - Informacioni mbi modelet e dhe ngjarjet në vazhdim ose në programacion;
 - Seksione të dedikuara për ata që kërkojnë një shkallë më e gjerë thellimi në ofertën kulturore dhe përmbajtjet e veçanta;
 - Hapësira edukative dhe diturie dedikuar publikut të moshës së re, promovimi i aktiviteteve laboratorike në bashkëpunim me shkollat dhe familjet;
 - Seksioni drejtuar mësuesve për sugjerimin e aktiviteteve didaktike;
 - Momentet e ndërveprimit për të stimuluar kuriozitetin dhe zbatimin;
 - Promovimi i konferencave dhe takimeve informuese;
 - Shërbime rezervimi dhe blerje biletash;
 - Aktivitete *Anëtarësimi* për mbledhjen e fondeve;

¹⁴ Për më tepër shiko: A. Bollo, *Il marketing della cultura*, Roma, Botues Carocci, 2012, fq. 103.

- Hapësira shikueshmërie të dedikuara për sponsorët, partnerët dhe për aksionerë të mundshëm organizatash.¹⁵

- Në këto raste ekziston rreziku që një shumëllojshmëri dhe artikulum i mundësive të ofruara nga rrjeti web është i tejmbushur duke i “bombarduar” vizitorët me shumë stimuj në të njëjtën kohë. Megjithatë një mundësi e tillë mund të reduktohet në minimum me krijimin e një projekti objektivat e të cilit kanë të bëjnë me lundrimin sa më të shpejtë e të qartë. Në një rrjet të mirë përdoruesi duhet në fakt të ketë mundësi të arrijë objektivat me “efikasitet dhe kënaqësi” (kriteri i përdorueshmërisë), dhe në të njëjtën kohë kërkesat dhe preferencat e tij duhet të respektohen pa përjashtim (kriteri i aksesit)¹⁶. Përdorimi i një menyje me shtrirje të gjerë e cila i shërben çdo lloj vizitori me mundësinë për shtrirjen e “eksplorimit” të tij në seksione të lidhura me njëra- tjetrën ose duke përjashtuar nga siti ato elemente të cilat nuk i interesojnë. Mund të cilësojmë sesi sitet institucionale të muzeve po ndryshojnë vazhdimisht dhe po konvertohen në një vend analog në strukturë dhe seksione sipas të cilave janë artikuluar. Vihet re një tendencë e krijimit të menyve për seksionet edukative, gjë e cila mund të interpretohet si shenjë e vullnetit për të vënë në plan në parë angazhimin e vet në lidhje me shpërndarjen e kulturës në shoqëri.

- **Rrjeti social.** Një rol progresiv emergjent në brendësi të reflektimit mbi mundësitë e reja dixhitale mbulohet nga *rrjeti social*. Kanale të tilla si YouTube, Facebook, Twiter, Flickr po tregojnë se mund të ofrojnë një nxitje të vlefshme për qarkullimin e informacioneve në lidhje me kulturën falë aftësisë së tyre për të propaganduar në mënyrë të shpejtë në një proces i cili gjeneron nga poshtë. Për këtë është bërë kohët e fundit edhe një studim nga MTM London¹⁷ i cili ka marrë në shqyrtim raportin mes përdorimit të medias sociale dhe përfshirjes me artin dhe kulturën. Konkluzionet e trajtuara janë shumë informuese, pasi referojnë se interneti po ndryshon në mënyrë radikale mënyrën me të cilën njerëzit konsumojnë kulturën; jo vetëm për sa i takon shpërndarjes së informacionit (për sa u takon modeleve, artistëve, ngjarjeve, ekspozitave) si edhe në mjedisin e bashkëndarjes së eksperiencave dhe krijimit të përmbajtjeve të reja. Mesatarisht, një person në dy (me një

¹⁵ Për më tepër shiko A. Bollo, *Il marketing della cultura*, Roma, Carocci Editore, 2012.

¹⁶ Për më tepër shiko standardeve ISO 9241-11:1998, *Economic requirements for office work with visual display terminals – Guidance on usability*.

¹⁷ Një qendër kërkimi dhe konsulence, me seli në Londër, që merrte klientët në brendësi të tregjeve dixhitale.

pik prej 62% ndërmjet të rinjve 16 dhe 34 vjeç) shfrytëzojnë internetin për të shtuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete dhe iniciativa kulturore. Gjithashtu, kush përfshihet në ngjarje kulturore *online* merr pjesë zakonisht edhe në aktivitete live, duke treguar si “*Angazhimi dixhital duket se plotëson dhe forcon angazhimin e drejtpërdrejtë në vend që të veprojë si një zëvendësues*” edhe duke lejuar për t’i dhënë shtytje idesë se “*ekziston një potencial i madh për audiencën promovuese dhe ndjellëse*”¹⁸. Mediat sociale, dhe në veçanti Facebook dhe YouTube, janë aktualisht kanali i dytë me anë të së cilës merren dhe shpërndahen informacione rreth artit dhe kulturës (kanali më i përdorur mbetet në fakt kërkimi me anë të Google). Në bazë të këtij mendimi, dhe në linjë me sa pohuam më lart, citohet se,

- *Një fushë e mundshme investimi sipas këtij kërkimi shkencor do ishte ajo e marketingut dhe zhvillimit të audiencës. Shoqatat e arteve të cilat janë të specializuara në fushën e marketingut- e sidomos në fusha si media sociale – do të kishin në dyert e tyre më shumë njerëz sesa ato shoqata që akoma mbështeten tek metodat e vjetra Website apo me dërgimin e njoftimeve me anë të postës elektronike. [...] Njerëzit zakonisht bashkëndajnë informacion për artin dhe kulturën me anë të rrjeteve sociale (veçanërisht në Facebook dhe Twitter), duke na bërë të supozojmë se këto site janë tashmë kanalet kyçe të marketingut*¹⁹.

Së fundi studimi pohon se dëshira e njerëzve për të arritur tek produktet artistike dhe kulturore (të të gjitha llojeve) duket shumë superior kundrejt niveleve të tjera të konsumit, duke sugjeruar praninë e një kërkese

¹⁸ MTM London (nga), *Digital audiences: Engagement with arts and culture online*, 2010, shiko linkun <http://www.artscouncil.org.uk/media/uploads/doc/Digital_audiences_final.pdf>, (28/06/2014), fq. 17.

¹⁹ MTM London (nga) *Digital audiences: Engagement with arts and culture online*, 2010, shiko linkun <http://www.artscouncil.org.uk/media/uploads/doc/Digital_audiences_final.pdf>, (28/06/2014), fq 7.

të pashfrytëzuar. Kështu dalin mënyra të reja të ndryshme për të përfituar nga eksperiencia kulturore, të lidhura jo vetëm me pjesëmarrjen fizike, por edhe me pjesëmarrjen virtuale, e cila nxjerr motivimet e veta të kohëve të fundit nga çështje të cilat lidhen me kohën në dispozicion, me ekonominë, dhe jo me modën. Për mendimin tim, janë pikërisht këto të dhëna me të vërtetë thelbësore të cilat bëjnë të mundur reflektimin mbi rolin që merr përsipër kultura në shoqërinë e sotme dhe mbi të gjitha për potencialet e mëdha që hapen për sa i takon raportit të saj me të rinjtë.

Portalet shembulli i kidpass. Një tjetër aspekt për t'u marrë në konsideratë janë edhe disa shërbime të reja pa pagesë, të lidhura me promocionin kulturor dixhital, të cilat po lindin *online* me qëllimin për të asistuar qytetarët në përzgjedhjen e eksperiencave të tyre kulturore. Bëhet fjalë zakonisht për ndërveprime të cilat strukturojnë ofertën kulturore në një zonë të caktuar gjeografike duke bërë të mundur ofrimin e një tabloje të eventeve të programuara dhe iniciativave të reklamuar nga organe të ndryshme lokale. Në këtë mënyrë ai që kontrollon rrjetin mund të organizojë vetë përmbajtjen, me anë të një konsultimi të personalizuar i cili i lejon kujt do të orientohet në sektorin që i intereson më shumë, duke e vënë në kontakt me një numër më të madh dhe të shumëllojshëm aktiviteteve. Një gjë e tillë është e dobishme për të vënë në qarkullim eksperiencat të zhvendosura në territor, të cilat përndryshe do të operonin të shkëputura nga njëra-tjetra, duke shtuar gjithashtu mundësinë e përkimit të kërkesës dhe ofertës falë shikueshmërisë dhe organizimit të përmbajtjes. Pra do të bëhej fjalë për një arkiv me *bazë sociale*, i cili vetushqehet vazhdimisht falë sinjalizimeve të vetë organizatave kulturore nxitëse, ku secila prej tyre mund të gjejë hapësirë. Shumë nga këto portale evidentojnë një pikë kontakti ndërmjet tyre e cila përfaqësohet nga një ndjeshmëri e veçantë për temën e familjes; vërehet një tendencë pozitive për të lehtësuar raportin prind-fëmijë, duke i dhënë një vlerë shtesë gjithçkaje që ofron mundësinë për të ndërtuar eksperiencia të përbashkëta.

Një shembull krejt i fundit jepet nga eksperiencia e rrjetit Kid Pass, i krijuar si start-up në janarin e vitit 2004 me kontributin e tre ortakëve në parkun shkencor dhe teknologjik të Venecias. Duke u nisur nga ideja sesa e vështirë është sot të mund të gjejmë kohën për shkak të angazhimeve të shumta gjatë harkut të ditës, kjo platformë futet në kontekstin e përditshëm të jetës së përditshme duke propozuar një përzgjedhje të vendeve dhe aktiviteteve të cilat lejojnë bashkimin e kërkesave të fëmijëve me ato të prindërve. Përkushtimi social-kulturor i këtij siti është gjithashtu i evidentuar në aktivitete të cilat afrojnë fëmijët me të rriturit me kulturën, artin leximin dhe muzikën.

Këto tendenca të vrojtuar tregojnë se edhe muzeu ka nevojë për rrugët dixhitale dhe shoqërore të përshtatshme që na bëjnë të pranojmë sesi organizimet kulturore kanë nevojë edhe për kanalet dixhitale dhe shoqërore në mënyrë që të mund të transmetojnë identitetin e tyre dhe vlerat historike. Teknologjitë, social *media*, sistemet informative si blogjet, bëjnë të mundur që muzeu ta komunikojë veten për një shumëllojshmëri dëgjuesish, duke u kthyer kështu në një tregues i nivelit të tyre të modernizimit, për hapjen ndaj publikut të jashtëm.

Mbizotërimi i internetit në jetën e përditshme ka konfirmuar një kulturë të re “dixhitale” e cila, duke përhapur gjithnjë e më shumë në popullatë, implikon mënyrat e reja të komunikimit të bazuara në fleksibilitetin e informacionit, për aksesin dhe konceptin e rrjetit. Në këtë situatë, mjetet informatike për të cilat folëm më lart na tregojnë se ato po bëhen gjithnjë e më shumë të nevojshme për të promovuar dhe mbështetur sektorin muzeal historik dhe etnografik, duke bërë që të komunikojë me shtresa të ndryshme të publikut dhe që përforcon marrëdhënien e komunitetit dhe shoqërisë.

Iniciativa të mundshme

Iniciativat specifike për mësuesit rezultojnë të jenë krejt munguese. Gjithsesi nuk është asnjëherë vonë për të filluar të mendohet rreth kësaj dhe për këtë mund të merret për bazë eksperiencat botërore sidomos e atyre vendeve të cilat ashtu si qyteti ynë mund të ofrojnë shumë për sa i përket muzeve të historisë, traditës apo kulturës. Në lidhje me këtë ekzistojnë tre iniciativa kryesore që mund të propozohen për t’iu përgjigjur kërkesave të publikut shkollor.

Opsioni më i përhapur është organizimi i një takimi me kohëzgjatje të ndryshueshme me mësuesit e shkollave, takime në të cilat paraqitet një programim didaktik duke ilustruar aktivitete dhe duke dhënë informacionet praktike. Në disa raste, takimet zhvillohen gjatë një dite të tërë, ku personeli i shërbimeve edukative takohet me mësuesit dhe u shpjegojnë atyre me hollësi ofertën didaktike për vitin shkollor në vazhdim, duke bërë të mundur edhe një vizitë të shkurtër paraprake në mënyrë që të krijohet një ide panoramike e gjithë përmbajtjes që propozohet për orët mësimore. Gjithashtu mund të akordohen takime me anë të organizmave muzeale për të krijuar takim me mësuesit dhe bashkinë në të cilat të paraqiten programet e tyre kulturore dhe ku mund t’i jepet hapësirë dëgjimit dhe diskutimit të kërkesave nga ana e shkollës.

Një tjetër metodë e përdorur në botë është mundësia që u jepet mësuesve që të vizitojnë falas qendra të ndryshme muzeale ku ata njihen

hollësisht me atë çfarë ofrojnë këto muze dhe ku mund të hartojnë programimin e vizitave të klasës së tyre paraprakisht. Në këtë mënyrë ata njihen me informacionin rreth ofertave formuese të ofruara nga muzeu dhe pse jo edhe për krijimin e marrëdhënieve dhe shkëmbimit të eksperiencës mes mësuesve dhe operatorëve të muzeut për një efikasitet sa më të plotë të misionit të tyre.

Një mënyrë tjetër bashkëpunimi mund të ishin kurset e formimit të mësuesve në lidhje me didaktikën muzeale, kurse të tilla mund të ofrohen nga operatorët e muzeut ku mësuesit mund të informohen edhe për risitë dhe të përballojnë tematika të veçanta të kohës. Këto kurse, të cilat duhet të miratohen edhe nga zyra rajonale e arsimit, do të bënin të mundur që mësuesit të shtonin kreditet e tyre të formimit, por edhe të forconin akoma më shumë vlerësimin dhe lidhjen me muzeun.

Një element tjetër i veçantë i një bashkëpunimi të mundshëm mund të jetë edhe vizita e operatorëve të muzeut në shkolla ku mësuesit dhe vetë drejtorja e shkollës mund të njihet me atë çfarë ofron muzeu, tematikat apo projekte të mundshme njëlloj si në rastin e Itinerareve edukuese ku parashikohen takime njohëse për mësuesit në bazë të aktiviteteve didaktike të zgjedhura: gjatë këtyre aktiviteteve mund të shpërndahen materiale ilustruese të cilat më tej mund të përdoren edhe në orët mësimore.

Në qytetin tonë do të ishte sfidë një iniciativë e tillë, por gjithsesi çdo gjë e ka një fillim dhe mund të arrihet nëse gjithë aktorët e lidhur me fushën dhe organizmat përgjegjës të ishin koherent në rastin e synimit të të njëjtit objektiv.

Kur ju kërkohet fëmijëve që të tregojnë shkurtimisht, në bazë të eksperiencës së tyre, se cilat do të ishin elementet që ata duket se vlerësojnë më shumë në zhvillimin e këtyre aktiviteteve, rezulton se fëmijët e shkollës fillore tërhiqen në mënyrë të veçantë nga aktivitete praktike manuale të cilat i lejojnë “veprimin” dhe “të bërit” pavarësisht se njohuritë e tyre janë akoma të kufizuara, fëmijët tregohen në përgjithësi kureshtarë dhe të vëmendshëm, bile edhe të mrekulluar nga mjedisi dhe e veçanta e tyre është se nuk kanë paragjykime, prandaj edhe për këtë arsye shfaqen të lirshëm në pyetjet e tyre, të ndihmojnë dhe t’u përgjigjen pyetjeve gjithashtu. Këto vizita shihen prej tyre si momente zbavitjeje ku kanë mundësi dhe të mësojnë diçka të re dhe konkrete duke e nxitur edhe me shumë arsyetimin e tyre.

Disa herë, në fakt, aktivitetet në muze përjetohen si një imponim, ndërsa herë të tjera konsiderohen si diçka “për t’u bërë sa për të kaluar radhën”, dhe nuk transmetojnë ato elemente kyç për të cilat zhvillohet vizita. Këto sjellje luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin sesi do të

jetë reagimi i fëmijës gjatë vizitës në muze; për rrjedhojë, sukcesi i iniciativave jashtëshkollore mund të jetë i vlefshëm, gjithnjë në varësi të aktorëve të përfshirë në këtë lloj aktiviteti. Një praktikë e mirë për t'u ndjekur do të ishte bashkërendimi mes muzeve dhe institucioneve kulturore, bashkërendim i cili do të pasuronte dukshëm didaktikën tradicionale, duke futur në veprim edhe stimuj multidisiplinorë. Alternimi multidisiplinor shihet në kontekstin e ndërveprimit të historisë-arkeologjisë-artit dhe letërsisë.

Një ide tjetër do të ishte edhe përfshirja e familjeve në disa aktivitete shkollore, duke vënë në veprim ata familjarë të cilët mund të kenë kompetenca specifike apo dëshmi të veçanta për t'i ndarë me fëmijët. Le të themi rasti i ndonjë gjysheje e cila mund të tregonte dëshmitë e saj për kohën e rinisë dhe do ta kthente klasën në një muze provizor me dëshmitë e saj.

Një tjetër element pozitiv është për t'u përmendur nga eksperiencia e Muzeve civilë në disa shtete ku vetë prindërit organizojnë viza të përbashkëta me fëmijët në muze në rastin kur këto mungojnë në programin jashtëshkollor. Prindërit në këtë rast bëhen bashkë duke bërë të mundur një ndërveprim shoqëror mes fëmijëve dhe prindërve me fëmijët.

Kohërat po ndryshojnë me hap galopant e për pasojë duhet të mendohen metodologji të reja koherente me synimin për të mos humbur në këtë vorbull mirëformimin e brezave të rinj të cilët pashmangshmërisht përcaktojnë mbijetesën e një kombi.

BIBLIOGRAFIA

- Adalgisa Lugli, *Museologia*, Shtëpia botuese Jaca Book, Milano, viti i botimit 2009.
- Alberto Angela, *Musei) a misura d'uomo. Come comunicare attraverso gli oggetti*, Roma, Shtëpia botuese -Armando Editore, Viti botimit 1988.
- Alessandro Bollo, *Il marketing della cultura*, Roma, Shtëpia botuese Carocci Editore, Viti botimit 2012.
- Amilcare Acerbi, Daniela Martein, *Musei-non musei, territorio. Modelli per una pedagogia urbana e rurale*, Milano, Shtëpia botuese - FrancoAngeli, Viti botimit 2006.
- Anna Casalino, *Musei per bambini. L'occhio ha saltato il muro*, Bologna, Shtëpia botuese - Edizioni Pendragon, Viti botimit 2002.
- Christian Caliandro, Pier Luigi Sacco, *Italia reloaded. Ripartire con la cultura*, Bologna, shtëpia Botuese - Il Mulino, Viti botimit 2011.
- Consuelo Lollobrigida, *Introduzione alla museologia*, Le Lettere, Firenze, Viti botimit 2010.

- Enrico Aprico, Michele Simionato, “Cervelli multitasking” tek n Revista - “Wired” n. 31, 2011.
- Fabio Severino *Comunicare la cultura*, Milano, shtëpia botuese FrancoAngeli, 2007.
- Fabio Severino, *Economia e marketing per la cultura*, Milano, Shtëpia botuese Franco Angeli, Viti botimit 2011.
- Gian Luigi Zucchini, *Didattica del museo e dell’immagine*, Brescia, Shtëpia Boteuse - La Scuola, Viti botimit 1989.
- Ilaria Romeo, *Ingenuus Leo: l’immagine di Agrippa*, Roma, Shtëpia botuese L’Erma di Bretschneider, Viti botimit 1998.
- Karl Mannheim, *Saggi di sociologia della cultura*, Roma, Shtëpia botuese - Armando Editore, Viti botimit 1998.
- Ken Robinson, *Back to School* tek revista “Wired” n. 31, Viti botimit 2011.
- Ludovico Solima (a cura di), *Il pubblico dei musei. Indagine sulla comunicazione nei musei statali italiani*, Roma, Shtëpia botuese - Gangemi Editore, Viti botimit 2000.
- Maria Laura TomeaGavazzoli, *Manuale di Museologia*, Shtëpia botuese - Etas, Milano, 2003.
- Maurizio Rispoli e Giorgio Brunetti *Economia e management delle aziende di produzione culturale*, Bologna, Shtëpia boteuse Il Mulino, Viti botimit 2009.
- Nathalie Heinich, *La sociologia dell’arte*, Bologna, Shtëpia Botuese Il Mulino, 2001.
- Nicola Abbagnano, *Storia della filosofia. Volume secondo, Filosofia del Rinascimento*, Torino, Utet, Viti botimit 1974.
- Paolo Rossi (a cura di), *Scritti filosofici*, Torino, Shtëpia botuese - Utet, Viti botimit 1975.
- Patrizia de Socio, Chiara Piva, *Il museo come scuola*, Roma, Shtëpia botuese - Carocci Editore, Viti botimit 2005.
- Pieremilio Ferrarese (a cura di), *Brevi note di management delle organizzazioni museali*, Venezia, Libreria Editrice Cafoscarina, Viti botimit 2010.
- Pierre Bourdieu, *La distinzione. Critica sociale del gusto*, Bologna, Il Mulino, 1979.
- Pierre Bourdieu, *Risposte. Per un’antropologia riflessiva*, Torino, Shtëpia Botuese - Bollati Boringhieri, Viti botimit 1992.
- Renate Eco, *A scuola col museo. Guida alla didattica artistica*, Milano, Shtëpia Botuese- Bompiani, Viti botimit 1986.

Artikuj dixhitalë

Ligji nr.9386, dt. 4.5.2005 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

<http://www.kultura.gov.al/files/userfiles/LIGJI_Per_muzete_ëeb1111.pdf>

Alessandro Bollo, *Il museo e la conoscenza del pubblico: gli studi sui visitatori*, 2004.

- <<http://online.ibc.regione.emilia-romagna.it/I/libri/pdf/bollo.pdf>> (12/06/2014).
Alessandro Bollo , investigim mbi publikun e muzeve, 2004,
<http://culturaincifre.istat.it/sito/musei/ricerca_sul_pubblico_dei_musei.pdf>
(11/06/2014).
Cavazzoni, Fondazioni lirico-sinfoniche. Una riforma senza gloria (ma necessaria), 2010.
<http://www.studiliberale.it/uploads/Spettacolo/FONDAZIONI_LIRICO_SINFONICHE.pdf> , (01/06/2014).
<<http://www.studiliberale.it/uploads/Spettacolo/LA%20MUSICA%20COLTA.....pdf>>, (01/06/2014).
Comune di Roma (a cura di), I servizi culturali
<http://www.comune.roma.it/PCR/resources/cms/documents/Cap_V_Cult.pdf>,
(29/06/2014).
Andrea Fantin, La sponsorizzazione dei beni culturali: nuovi orizzonti del partenariato pubblico-privato, 2011.,
< <http://riviste.unimc.it/index.php/cap-cult/article/view/110/86>>, (14/06/2014).
Luigi Guiotto, Sociologia e marketing dei musei, 2009.
<http://www.sociologia.unimib.it/data/insegnamenti/4_2998/materiale/manuale2009-10.pdf>, (29/06/2014).
Nathalie Heinich, The Making of Cultural Heritage in “The Nordic Journal of Aesthetics”, n. 40-41, 2010-1011.
<<http://ojs.statsbiblioteket.dk/index.php/nja/article/view/File/5203/4582>>,
(06/09/2014).
Joseph Lampel, Theresa Iant, Jamal Shamsie, Balancing Act: Learning from Organizing Practices in Cultural Industries, 2000.
<<http://pubsonline.informs.org/doi/abs/10.1287/orsc.11.3.263.12503>>,
(05/06/2014).
Alessandro Monti, Le politiche di privatizzazione dei servizi museali. Il modello organizzativo dei musei del Comune di Roma, 2004.
<<http://www.mps.it/NR/rdonlyres/2E7A84C3-A63C-418A-B277-88C225DAD2E0/34245/091124monti.pdf>>, (14/06/2014).
Irene Moretto, Mantenere il contatto con le scuole: la customer satisfaction nel progetto “A Scuola di Guggenheim”, Tezë doktorature në ekonomi dhe drejtim artesh dhe aktivitetesh kulturore, Universiteti Ca’Foscari, viti akademik 2011-2012, relator Prof. Bruno Bernardi.
MTM London (referuar), Digital audiences: Engagement ëith arts and culture online, 2010.
<http://www.artscouncil.org.uk/media/uploads/doc/Digital_audiences_final.pdf> ,
(28/06/2014).
Giuseppe Piperata, La nuova disciplina dei servizi aggiuntivi dei musei statali in “Aedon. Rivistë e arteve dhe e së drejtës online.” nr. 2, 2008.
<<http://www.aedon.mulino.it/archivio/2008/2/piperata.htm>>, (12/06/2014)

Rrjetet internet

<http://www.hands-on-international.net/home.asp?p=1-0>

<http://www.childrensmuseums.org/>

<http://heckmanequation.org/>

<http://www.ted.com/>

<http://archivio.pubblica.istruzione.it/>

<http://www.beniculturali.it/mibac/export/MiBAC/index.html>

TË NXËNËT NË KUSHTET E MËSIMDHËNIES NË DISTANCË

Lindita Lutaj, Helena Mukli

*Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Edukimit, departmenti i
Pedagogjisë, Fakulteti i Edukimit, departmenti i Gjuhës shqipe*

ABSTRAKT

Kushtet e krijuara për shkak të pandemisë, lindin domosdoshmërinë e ndryshimeve të shumë rregullave dhe metodave të të mësuarit. Shumë polemika u zhvilluan në rrethet e metodistëve mbi dobinë dhe domosdoshmërinë e mënyrës së realizimit të procesit mësimor. Mësuesve iu desh të thellonin njohuritë mbi zhvillimet më të fundit teknologjike, në mënyrë që t'u mundësonin nxënësve të tyre, njohuritë dhe konceptet e kurrikulës. Profesionit i mësimit u përball me kërkesa akoma më të mëdha, të cilat mundësuan një grup kompetencash më të sofistikuar se më parë. Përdorimi i pajisjeve dhe aplikacioneve dixhitale, në veçanti, kërkon që mësuesit të zhvillojnë aftësitë e tyre në këtë drejtim, për përdorimin efektiv të TIK-ut në shkollë.

Për realizimin e këtij studimi dhe për të marrë informacionin e nevojshëm, u realizua një pyetësor online me mësues (N=40) dhe nxënës (N=150) të arsimit fillor në rrethin e Durrësit. Për një informacion më të detajuar u realizua fokusgrup me 15 mësues, për të vlerësuar rëndësinë që ka mësimit dhe të nxënësve në distancë dhe për të theksuar sfidat me të cilat mësuesit u përballën gjatë mësimit online.

Në studim u vu re se shkollat nuk ofrojnë infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimit online, ka mungesë aksesit në internet, internet i dobët në komunikim, në ndonjë rast ndërprerje të energjisë. Ka mungesë të teknologjive personale bashkëkohore, vështirësi në përdorimin e programeve dhe platformave me gjithë potencialin që ato ofrojnë. Përdorimi i teknologjisë gjatë procesit të mësimit ndikon në procesin e të nxënësve, pasi siguron tërheqjen e vëmendjes së tyre, rrit përqendrimin në mësim dhe lehtëson procesin e të nxënësve.

Një pjesë e konsiderueshme e mësuesve kanë qasje të mirë ndaj përdorimit të teknologjisë. Për të patur një performancë akoma edhe më të mirë, kërkohet shumë më tepër prej tyre. Shteti me politikën e tij duhet t'u ofrojë mësuesve trajnimet e nevojshme në përdorimin e teknologjisë, të

sigurojë infrastrukturën e domosdoshme në shkolla, mbështetje për familjet në nevojë, duke mundësuar internet pa limit për çdo nxënës. Të zhvillohen më tej aftësitë dhe qëndrimet e mësuesve në lidhje me përdorimin e programeve dhe platformave bashkëkohore, e cila konsiderohet si një domosdoshmëri për sigurimin e sistemit arsimor cilësor. Mësuesit kanë nevojë për trajnime për shkathtësi kompjuterike, por edhe për nevoja pedagogjike, pasi nxënësit janë larg standardeve ndërkombëtare të edukimit.

Fjalë kyçe: mësimdhënie, të nxënët, mësim online, teknologji.

Teaching challenges and distance learning

ABSTRACT

The conditions created because of the pandemic situation made it necessary to change the rules and learning methods. Many polemics were developed within the researchers on the benefits and necessity of the way the learning process is performed. Teachers had to improve their knowledge on the latest technologic innovations in order to pass to their students the knowledge and curriculum concepts.

Teaching profession faced higher demands which enabled more sophisticated competency sets. The use of equipment and digital applications in particular requires the teacher to develop their skills in this area, in order to effectively teach the technology of information at schools. In order to collect data for this study we used an online questionnaire sent to 40 teachers and 150 pupils of the elementary education in the city of Durres. For a more detailed information we formed a focus group with 15 teachers in order to evaluate the importance that teaching and distance learning have and to emphasize the challenges that teachers faced during the online teaching process.

The study revealed that schools did not offer the necessary infrastructure to perform online teaching, there was lack of internet, weak internet connection, electricity interruption etc. There was lack of contemporary personal technology equipment, difficulty in the use of software and platforms despite the potential offered. The use of technology during teaching process affects the learning process, as it ensures pupils' attention, increases their attention and improves learning process. A considerable part of the teachers had a good approach toward technology use. In order to have a better performance they need to do more. The state and its politics need to offer teachers the necessary training in technology use, to enable the necessary infrastructure in schools, to support families in

need by providing free unlimited internet for each pupil. The skills and beliefs of teachers need to be developed even further in using programs and actual platforms, which are considered crucial to have a qualitative education system. Teachers not only need training on computer skills but also their pedagogic needs should be fulfilled too, as pupils are far from the international education standards.

Key words: teaching, learning, online learning, technology

Hyrje

Teknologjia është një urë që të çon drejt të nxënëtit, pasi brenda një kohe të shkurtër kompjuteri dhe interneti po sjellin ndryshime të mëdha në zhvillimin e nxënësve. Të mësuarit në distancë, që realizohet nëpërmjet teknologjisë së komunikimit, siguron formimin e shkathtësive themelore të nxënësve. Në një mjedis mësimor aktivitetet, materialet mësimore dhe organizimi i tyre konsiderohen si faktorë të rëndësishëm. Në kushtet e mësimdhënies në distancë kjo merr rëndësi të veçantë. Mjedi i të nxënëtit përcaktohet gjithashtu si pjesë e pandarë e kontekstit social, psikologjik dhe pedagogjik të cilat ndikojnë tek të mësuarit, arritjet dhe qëndrimet e nxënësve. Të nxënëtit paraqet ndryshim relativisht të qëndrueshëm të individit. Ai përfshin përvetësimin, modifikimin dhe përpunimin e njohurive, aftësive, shprehjeve, shkathtësive, qëndrimeve dhe sjelljeve të caktuara. Njerëzit nxënë në forma dhe mënyra të ndryshme, të cilat duhet të merren në konsideratë nga ana e mësuesit, për organizimin e procesit mësimor në kushtet e mësimin online.

Qëllimi i këtij studimi është të evidentojë rëndësinë që ka të mësuarit në distancë për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënëtit. Të vlerësohen sfidat me të cilat u përballën mësuesit dhe nxënësit në realizimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënëtit në kushtet e mësimin online.

Objektivat e këtij studimi përqendrohen kryesisht te roli i mësuesit për realizimin e mësimdhënies në distancë dhe sigurimin e të nxënëtit të nxënësve, mundësitë për rritjen e efektivitetit të punës së tyre dhe ndikimi i mësimdhënies online në shkallën e efektivitetit të të nxënëtit të nxënësit.

Rëndësia e studimit konsiston te vlerësimi i përdorimit të teknologjisë dhe mësimin në distancë, te kapërcimi i sfidave me të cilat u përballën mësuesit dhe nxënësit gjatë mësimdhënies online për të rritur efektivitetin e të nxënëtit të nxënësve. Rekomandimet që do të jepen këtu të shërbejnë si pika orientuese për drejtuesit dhe mësuesit në shkolla, për

institucionet qendrore, me qëllim përmirësimin e punës së tyre në të ardhmen, për përfitimin e rezultateve të dëshiruara të nxënësit.

Shqyrtimi i literaturës

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit janë grupe të ndryshme mjetesh dhe burimesh teknologjike që përdoren për të komunikuar, për të krijuar, për të shpërndarë, për të ruajtur dhe për të menaxhuar informacionin (*Blurton, 2002*). Kjo lloj teknologjie është bërë tipar përcaktues i kohës tonë, duke e bërë jetën tonë në mënyrë të dukshme ndryshe nga ajo që ka qenë dikur (*Dearnley & Feather, 2001; Robins & Webster, 1999*). Mjetet e komunikimit nëpërmjet internetit janë bërë pjesë e rëndësishme e jetës sonë (*Subrahmanyam, Reich, Waechter & Espinoza, 2008*).

Zhvillimet teknologjike gjatë dekadave të fundit kanë patur një ndikim të madh në jetën e njerëzve në të gjithë botën, të cilët nuk e kishin imagjinuar dhe ishin të papërgatitur për këtë ndryshim të madh. Ato ndikuan komunikimin tonë dhe rrjedhimisht edhe gjithë proceset e jetës sonë. Janë të shumta studimet që ngrenë teza lidhur me ndikimin pozitiv të teknologjisë në komunikimin, sjelljen, arsimimin në zhvillimet psikologjike dhe sociale. Studiuesi *Cavas (2009)* thotë se përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie tërheq vëmendjen, rrit motivimin dhe përqendrimin e nxënësve. Studiuesi *Barret (2004)* na ofron listë të shkathtësive, aftësive dhe njohurive që fitojnë nxënësit me përdorimin e-learning. Sipas *Rolf Shculmeister* e-learning mund të përdoret për të kaluar pengesa të caktuara në të nxënë dhe kjo është një nga përparësitë e mëdha të saj.

Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në të gjitha fushat e jetës është kthyer në një domosdoshmëri jetike në të gjithë botën e zhvilluar. Në studimin e tij *DiNicola* thekson se kjo teknologji po ndryshon mënyrën sesi individët socializohen, studiojnë, punojnë, harxhojnë kohën e tyre të lirë (*DiNicola.M.D, 2004*).

Sipas *Parayono & Quito*, integrimi i TIK- ut nuk është vetëm mundësi, por edhe domosdoshmëri për të bërë procesin e edukimit më tërheqës (*Parayono & Quito, 2010*). Po ashtu përfshirja e të gjitha këtyre teknologjive dixhitale nga institucionet arsimore dhe politikëbërësit bëhet për arsye që të mbështesin të mësuarit për arritjen e rezultateve të suksesshme të të nxënës; të zhvillojnë aftësinë e shekullit XX si pjesë e përgatitjes së individëve për vendin e punës; të bëhen qytetarë të përgjegjshëm dixhitalë dhe të zhvillojnë të nxënës përgjatë gjithë jetës (*Wan, 2015*).

Shumë studime janë bërë dekadën e fundit, ku theksi është vënë në aftësimin e nxënësve dhe studentëve, për të aplikuar njohuritë dhe aftësitë

që ata kanë fituar në situatë autentike të zgjidhjes së problemeve. Këto aftësi përfshijnë komunikimin, bashkëpunimin, zgjidhjen e problemeve, aftësinë e të menduarit kritik dhe krijues, si dhe aftësitë e nevojshme për të përdorur shumë mirë teknologjinë e cila është në ndryshim të shpejtë (Walser, 2008). Një nga aftësitë dalluese të shekullit XX është dija dixhitale. Pedagogu kanadez, A.Bates, eksperti më në zë për të mësuarit në distancë, evidenton disa pika të forta, si:

- Rritjen e cilësisë e të nxënët dhe mësimit.
- Të nxënët dhe mësimi bëhen më ekonomik.
 - Lidhjet satelitore ju mundësojnë nxënësve forma të ndryshme të të nxënët, të cilat nuk i kanë në vendin e tyre.
 - Tabelat elektronike iu mundësojnë kolegëve që të konsultohen me njëri-tjetrin për procesin e mësimdhënies.
 - Rrjeti kompjuterik mundëson nxënësit nga vende të ndryshme të zgjidhin probleme të caktuara mësimore.
 - Bën të mundur përparimin e nxënësve sipas mundësive individuale që kanë.
 - Mundëson perfeksionin profesional, mësimin permanent dhe të nxënët e nxënësve.

Të mësuarit në distancë mund të llogaritet si komunikim ndërmjet njerëzve në kohë dhe vende të ndryshme. Mbyllja e institucioneve arsimore për shkak të masave parandaluese ndaj përhapjes së Covid-19 ka ndikuar në arsimimin e njerëzve, në mirëqenien dhe mënyrën e funksionimit të sistemit arsimor në botë. Përballë kësaj situatë edhe Shqipëria u përfshi në këtë formë të re të mësimdhënies. Në një situatë të tillë, kur ishte i pamundur zhvillimi i mësimit në klasë, del si detyrë imediate që të shikohet se si ndihmon teknologjia në përmbushjen e programit mësimor. Ministria e Arsimit dhe Shkencës duke u mbështetur dhe në modelet evropiane për arsim, futi integrimin e TIK në mësimdhënie dhe nxënie (MASH, IZHA, 2011). U pa i nevojshëm hartimi i standardeve të TIK-ut në mësimdhënie/nxënie për mësuesit dhe drejtuesit e shkollave. Zhvillimet e sotme kërkojnë nga shkolla pajisjen e nxënësve me kompetenca dixhitale. Kjo nënkupton përdorimin kritik dhe efektiv të TIK-ut në mjediset e shkollës. Kompetenca dixhitale i jep një kornizë më të qartë nxënësit sesi të gjejë, të përpunojë, dhe të analizojë një informacion të caktuar. Kompetenca dixhitale lidhet me një vizion të ri të shkollës për t'u larguar nga metodologjia e vjetër, drejt një qasje të re, për përgatitjen e të rinjve për t'u përballur me nevojat e jetës.

Metodologjia

Metoda që është përdorur në këtë studim është hulumtimi nëpërmjet grumbullimit të informacioneve teorike, duke shqyrtuar literaturën e fushës, në përputhje me temën e studimit. Për finalizimin e studimit u përdor gërshetimi i metodës sasiore me metodën cilësore. Studimi grumbullon të dhëna nëpërmjet metodës sasiore, të realizuar me anë të plotësimit online të pyetësorëve për mësuesit dhe nxënësit. Po ashtu, për një informacion më të detajuar në drejtim të përparësive dhe sfidave me të cilat u përballën mësuesit gjatë mësimit në distancë, u përdor edhe metoda cilësore, e cila u realizua nëpërmjet organizimit të fokusgrurit me disa prej mësuesve pjesëmarrës në studim, të cilët u intervistuan online.

Studimi përshkruan dhe analizon, përdorimin e teknologjisë së mësimdhënies në distancë, nga mësuesit dhe nxënësit e arsimit fillor në disa shkolla të rrethit të Durrësit. Studimi u fokusua në ndikimin që ka të mësuarit nëpërmjet teknologjisë, rolin e mësuesit në procesin e mësimdhënies dhe efektiviteti i të nxënësve në mësimdhënien në distancë. Popullata e studimit janë 40 mësuesit dhe 150 nxënësit e arsimit fillor në rrethin e Durrësit. Në kampionin e studimit u morën mësues dhe nxënës nga shkolla 9-vjeçare “Qemal Mici”, “Marie Kaçulini” dhe “Armath”. Kampioni u përzgjedh në mënyrë rastësore. Në studim u përfshinë gjithsej 40 mësues dhe 150 nxënës të klasës së tretë, të katërt dhe të pestë të shkollave të përfshira në studim. Mësuesit që morën pjesë në studim ishin 12,5% të gjinisë mashkullore dhe 87.5% e tyre të gjinisë femërore. Ndërsa nxënësit që morën pjesë ishin 42.7% ishin të gjinisë mashkullore dhe 57.3% e tyre ishin të gjinisë femërore. Pjesëmarrësit në studim janë informuar për qëllimin që ka ky studim dhe iu është shpjeguar se do të ruhet anonimat i tyre. Plotësimi i pyetësorëve është realizuar në mënyrë elektronike online për shkak të situatës në të cilën ndodhej vendi ynë nga Covit -19. Po ashtu edhe fokusgrupi u realizua online dhe më pas u bë zbardhja e diskutimeve të realizuara me 15 mësuesit lidhur me pyetjen e hapur.

Instrumenti që është përdorur në këtë studim është pyetësori i strukturuar për mësuesit dhe nxënësit. Alternativat e pyetjeve janë bërë sipas shkallës Likert. Ato janë renditur njëra pas tjetrës dhe jo horizontalisht. Sipas Jarp (1967) vendosja më e zakonshme është ajo e cila i rendit kategoritë e përgjigjeve njëra poshtë tjetrës, gjë e cila zvogëlon shumë konfuzionin. Gjithsej janë përdorur 12 pyetje, nga të cilat 11 janë pyetje të mbyllura dhe një është pyetje e hapur. Pyetësorët përfshijnë pyetje të përgjithshme mbi gjininë, klasën, moshën, eksperiencën në mësimdhënie, pyetje informuese për mjetet dhe mënyrat e komunikimit që përdoren mësuesit dhe nxënësit në procesin e mësimit online. Gjithashtu

mësuesit dhanë mendime për rëndësinë që kishte mësimi në distancë, për infrastrukturën që u siguronte shkolla, për arritjet dhe vështirësitë e tyre. Pyetësi përmbante edhe një pyetje të hapur e cila kërkonte opinionet e tyre në lidhje me efektivitetin e zhvillimit të mësimi në distancë dhe sfidat me të cilat ata u përballën. Për realizimin e këtij studimi u morën në konsideratë edhe disa parime etike, të cilat ndihmuan në shmangien e keqinterpretimeve, duke qenë se subjektet shprehën qëndrimet e tyre personale. Pjesëmarrësit u bënë pjesë e këtij hulumtimi me vullnet të plotë, pasi u garantua siguri i kofidencialitetit të tyre.

Rezultatet dhe diskutimi

Në mësimin online aktivizimi i nxënësve gjatë orës mësimore lë shumë për të dëshiruar, pasi jo të gjithë nxënësit kanë të njëjtat aftësi për të nxënë apo dhe njohuritë e duhura në fushën e teknologjisë. Këtu rëndësi merr edhe numri i nxënësve në klasë dhe mundësitë e tyre për angazhim.

Lidhur me pyetjen se sa të informuar janë nxënësit për mundësitë e përdorimit të teknologjisë, 37.5% e mësuesve mendojnë se janë shumë të informuar, 45% mendojnë se janë pjesërisht të informuar dhe 17.5% mendojnë se nuk janë aspak të informuar, pra nuk kanë informacionin e duhur. Të pyetur mësuesit nëse numri i ulët i nxënësve në klasë ndikon në rritjen e nivelit të procesit të të nxënësve dhe lehtësimin e punës së tyre, rreth 70% e mësuesve janë përgjigjur pozitivisht, që ndikon shumë dhe 30% shprehen se kjo ndikon pak.

Gjatë mësimi online mësuesit kanë përdorur aplikacione të ndryshme. 27.5% e mësuesve kanë deklaruar se kanë përdorur aplikacionin WhatsApp për të komunikuar me nxënësit, 15% e tyre kanë përdorur aplikacionin Zoom, 37.5% e mësuesve kanë komunikuar nëpërmjet Facebook dhe 20% komunikim me mesazhe zanore. Për vitin akademik 2020-2021, si në të gjithë sistemin arsimor parauniversitar, edhe në shkollat e rrethit të Durrësit u punua me platformën akademi.al.

Mësuesit u pyetën mbi rëndësinë e përdorimit të teknologjisë, ku 27.5% e tyre mendojnë se teknologjia motivon nxënësit, 17.5% mendojnë se shërben për të nxitur ide të reja të nxënësve, 22.5% shprehen se krijojnë mundësi për të ofruar materiale të reja përtej shkollës dhe 32.5% theksojnë se nxit punën e pavarur të nxënësve.

Mësuesit u pyetën nëse të mësuarit nëpërmjet teknologjisë ndikonte në rritjen e efektivitetit të të nxënësve tek nxënësit dhe se çfarë mund të bëhej ndryshe në këtë drejtim për të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve. Mësuesit u shprehën se teknologjia rrit efektivitetin e të nxënësve tek nxënësit, pasi i motivon ata, krijojnë mundësi për punë të pavarur, mundëson marrjen e informacioneve bashkëkohore, daljen e mësimi përtej

mureve të klasës, shfrytëzimin e materialeve ndihmëse, si: video, tabela, skica, diagrama etj., por ata shprehen të rezervuar përsa i përket pjesëmarrjes së nxënësve në mësimin online. Për këtë ata mendojnë se duhet të ndërhyet në disa drejtime. Kështu rreth 32.5% e tyre mendojnë se duhet të ndryshojë infrastruktura në shkollë; 12.5% mendojnë se mund të përmirësohet procesi i mësimdhënies; 35% theksonin mundësimin e internetit pa pagesë për çdo nxënës në këtë periudhë, në mënyrë që edhe nxënësit që nuk kanë mundësi të mjaftueshme financiare të mos e humbasin mësimin; 20% mendojnë se duhet përmirësuar cilësia e trajnimit dhe përgatitjes së mëtejshme të mësuesve dhe nxënësve.

Të pyetur mësuesit se sa bashkëpunues kanë qenë nxënësit gjatë orëve të mësimin online, 55% e tyre shprehen se kanë qenë shumë bashkëpunues, 27.5% mendojnë se kanë qenë në ndonjë rast bashkëpunues dhe 17.5% shprehen se nuk kanë qenë fare bashkëpunues. Lidhur me pyetjen se a ka ndikuar të mësuarit me anë të teknologjisë në rritjen e përqendrimit të nxënësve në mësim, të gjithë mësuesit pjesëmarrës në studim, janë përgjigjur se ndikimi i teknologjisë ka qenë shumë pozitiv, për nxënësit që merrnin pjesë aktive në mësimin online. Nuk mund të flitet për përqendrim të vëmendjes për nxënësit e tjerë që kishin vështirësi për pjesëmarrjen e tyre në mësimin online apo dhe mungesë bashkëpunimi me mësuesit.

Të pyetur nxënësit se ku kanë konsistuar problemet gjatë mësimin online, 40.7% prej tyre shprehen se nuk kanë hasur fare vështirësi, 24.7% shprehen se kanë patur internet të dobët, 19.3% kanë patur mungesë të internetit dhe 15.3% e tyre kanë pasur mungesë të pajisjeve teknologjike. Të pyetur nxënësit se sa të kënaqur janë nga përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie, 38% e tyre shprehen se janë shumë të kënaqur, 26 % janë të kënaqur, 24% janë të pakënaqur dhe 12% janë shumë të pakënaqur.

Nxënësit u pyetën nëse të mësuarit nëpërmjet teknologjisë ndikonte në rritjen e efektivitetit të të nxënësve të tyre dhe se çfarë mund të bëhej ndryshe nga mësuesit në këtë drejtim për të përmirësuar procesin e mësimdhënies. Nxënësit u shprehën se teknologjia i motivon për të mësuar më shumë, krijon mundësi për të lundruar në internet, mundësi për punë të pavarur, hapësira për të marrë përvoja dhe eksperiencë të ndryshme, por ata shprehen të frenuar në drejtim të mundësive që kanë për shfrytëzimin e internetit nga ana e tyre. Ata janë optimistë se kjo situatë mund të ndryshojë nëse shteti ndërhyt në disa drejtime. Kështu rreth 70% e tyre mendojnë se duhet të ndryshojë infrastruktura në shkollë, 89.3% theksonin mundësimin e internetit pa pagesë për çdo nxënës, 56.6% mendojnë se shkolla duhet të ketë zyrën e këshillimit për nxënësit që kanë nevojë të

ndihmohen në përdorimin e teknologjisë, 100% e tyre mendojnë që të shikohet mundësia e bashkëpunimit me bordin e prindërve për pajisjen e nxënësve me laptop apo tableta.

Nga fokusgrupi që u organizua me mësuesit u evidentua edhe një herë rëndësia që ka mësimi në distancë. Mësuesit kanë nevojë për trajnime për shkathtësi kompjuterike, por edhe për nevoja pedagogjike, pasi nxënësit janë larg standardeve ndërkombëtare të edukimit. Përdorimi i teknologjisë ka efekt pozitiv në qëndrimet e nxënësve, pasi ata ndjehen më të suksesshëm dhe më të motivuar për të mësuar, duke shfaqur më shumë vetëbesim. Prandaj mësimdhënësit theksonin se duhet të punohej akoma më shumë për fitimin e shkathtësive dhe shprehive të tyre, duke rritur kapacitetet për përdorimin e teknologjive të reja në funksion të mësimdhënies dhe të nxënët. Nga mësuesit pranohej se nuk ishte e lehtë që të bëhej ndryshimi, pasi shkollat nuk kanë kushtet më të domosdoshme që të garantojnë cilësinë e mësimdhënies në distancë. Gjithashtu ata pohonin se në kohën e sotme ishte domosdoshmëri zbatimi i teknologjive të përparuara dhe metodave didaktike efektive teknologjike të mësimdhënies.

Konkluzionet

Realiteti ynë shqiptar nuk ka arritur stadin e duhur në përdorimin e teknologjisë në nivelet e kërkuara. Në aspektin e aftësisë teknologjike të stafit akademik, brezi pak më i vjetër në moshë ka hasur vështirësi në përdorimin e teknologjisë, të cilën janë munduar që ta kompesojnë me aftësinë e përdorimit të fjalëve dhe eksperiencën e tyre. Përdorimi sa më efikas i këtyre risive teknologjike në mësimdhënie, kërkon trajnimin e stafit pedagogjik dhe aftësimin e nxënësve me kompetencat dixhitale. Teknologjia mundëson përdorimin e formave të reja të mësimdhënies dhe zhvillon mjedise të reja të të nxënët. Pavarësisht distancës dhe mjedisit se ku ndodhen mësuesit dhe nxënësit, teknologjia mundëson komunikimin në kohë reale me njëri-tjetrin.

Sot kërkohet që të punohet më shumë në drejtim të ndërgjegjësimit të mësuesve dhe nxënësve, mbi rëndësinë që ka përdorimi i teknologjisë për jetën dhe për të ardhmen. Teknologjia duhet të konsiderohet si një mjet i rëndësishëm në dorën e mësuesit, por jo ta zëvendësojë këtë të fundit. Interneti ka bërë që mësuesi të mos jetë e vetmja pikë referimi për informacionet që mund t'u ofrohen nxënësve, por ai iu mundëson atyre të nxënët në mënyrë të pavarur.

Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie kërkon bazën e nevojshme materiale nga ana e institucioneve përgjegjëse, trajnim dhe kualifikim të mësuesve në përgjithësi, sidomos mësuesve të vjetër në veçanti, për

përdorimin e teknologjisë bashkëkohore, të cilët për arsye të ndryshme, kanë hasur vështirësi në këtë drejtim. Zotërimi i njohurive më të fundit në fushën e teknologjisë, është urë lidhëse dhe mundësi e mirë komunikimi midis mësuesit dhe nxënësit, e cila mundëson që informacionin e marrë teorikisht ta zbatojnë në praktikë.

Në të ardhmen, rëndësi merr hartimi i politikave dhe strategjive arsimore afatgjata, me qëllim integrimin e teknologjisë dhe aftësimin pedagogjik të mësuesve dhe nxënësve. Mësuesi duhet të gjejë forma dhe mundësi për organizimin e orës mësimore në shërbim të të nxënësve të nxënësve. Të pasurohen bibliotekat e shkollave me libra mbi përdorimin e teknologjisë dhe të jenë ato në dispozicion të stafit pedagogjik dhe të nxënësve. Përgatitja për mësimdhënien online të mësimit duhet të jetë pjesë integrale e procesit të trajnimit të mësuesve, ku ata të përgatiten në përdorimin e programeve dhe platformave të ndryshme. Të shikohet mundësia e përmirësimit të infrastrukturës në shkolla dhe shërbimit të internetit. Shteti me politikën e tij të mbështesë familjet në nevojë, me qëllim që t'iu mundësojë të gjithë nxënësve përdorimin e internetit falas. Shkollat të kenë zyrën e këshillimit për nxënësit që kanë nevojë për ndihmë në drejtim të përdorimit të teknologjisë. Të shikohen mundësitë e bashkëpunimit me bordin e prindërve të shkollës për pajisjen e nxënësve me laptop apo tableta. Realizimi i mësimdhënies në distancë të mbështetet në përvojën evropiane.

Bibliografia

- Brouse, C. H., Basch, C., & Chow, T. HF. (2011). Use and efficiency of various technological methods in the different aspects of teaching and learning a foreign language at 16 universities in New York.
- Chambers, A. (2005). Integrating corpus consultation in language studies. *Language Learning and Technology*, 9(2), 111-125.
- DiNicola, M. D. (2004). Pathological Internet use among college students: The prevalence of pathological Internet use and its correlates. *Dissertation Abstracts International*, 65 (05), 1675. Retrieved January 18, 2010, from Pro Quest Digital Dissertations database (UMI No.AAT 3133723).
- Glover D., & Miller, D. (2001). Running with technology: The pedagogic impact of the large scale.
- Hiltz, S.R. and Wellman, B. Asynchronous learning networks as a virtual classroom. *Commun. ACM* 40, 9 (1997), 4449.
- Hoëard, P., Elizabeth, R.H., Matt, K.& Kim, M. (2007) Using Technology with classroom instruction that works.USA.
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Instituti i Zhvillimit në Arsim (2011). Standardet e mësuesit për zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në shkollë.
- Parayno & Quito, BG, (2010). Meta-analysis of ict Integration in Vocational and Technical, Education in Southeast Asia.Seavern: Research Report 2009/2010.

METODIKË E ZHVILLIMIT TË LABORATORËVE TË FIZIOLOGJISË SË PËRGJITHSHME GJATË PANDEMISË COVID-19

Sidita Zaganjori (Karini), Neira Medja

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti i Biologji-Kimisë

ABSTRAKT

Në qendër të këtij punimi janë trajtuar praktikat laboratorike online të “Fiziologjisë së përgjithshme” gjatë periudhës pandemike. Ndryshimet e metodikës së mësimdhënies para periudhës së pandemisë Covid-19 dhe gjatë kësaj periudhe janë trajtuar gjerësisht. Kjo punë analizuese është zhvilluar me studentët e vitit të tretë të programit të studimit të biologji-kimisë në nivelin Bachelor. Metoda online e mësimdhënies është konkretizuar me një temë mësimore “Dominanca e syve”, duke nxjerrë në dukje transformimet e këtyre metodave bashkë me pikat e forta dhe të dobëta. Kontributi i këtij punimi konsiston në dhënien e risive të laboratoreve online në lëndën e “Fiziologjisë së përgjithshme”, duke treguar përparësitë dhe vështirësitë që mund të kapërcehen për një proces mësimor sa më efektiv. Aplikimi i teknologjive të reja online siguron një edukim më profesional të studentëve në fushën e fiziologjisë dhe të shkencës.

Fjalë kyçe: pandemi Covid-19, praktika laboratorike, Fiziologji e përgjithshme, metodikë e mësimdhënies, dominanca e syve.

The methodology of general physiology laboratories development during pandemic Covid 19

ABSTRACT

On the focus of this article, there are analyzed practical online laboratories of the “General Physiology” course during the pandemic period. The changes in teaching methodology before and during the Covid-

19 pandemic period are widely analyzed. This analytical study takes place with the third years students of Biology-Chemistry study program at Bachelor level. The online teaching method is concretized with the learning topic titled "Ocular dominance", highlighting the transformations of these methods with the swot analysis. The contribution of this paper consists of showing the innovations of online laboratories in the course of "General Physiology", showing the advantages and disadvantages that can be overcome for a more effective learning process. The new online technologies applications provide a more professional education of students in the Biology fields of studies as well as the science.

Keywords: Covid-19 pandemic, practical laboratories, General Physiology, teaching methodology, Ocular dominance

Hyrje

E gjithë bota, duke filluar nga vjeshta e vitit 2020, u kërcënua nga një armik i padukshëm (Coronovirusi), që kërcënoi jetën e secilit, përfshirë edhe atë të studentëve dhe pedagogëve.

Të kushtëzuar nga situata e përhapjes së sëmundjes të gjitha universitetet e botës u mbyllën duke kaluar në mësimin online.

Në krahasim me vitet e kaluara edhe praktikët laboratorike kanë pësuar ndryshime në formën e mësimdhënies dhe në procesin e të nxënës, por kanë ruajtur standarde të larta akademike. Kjo mënyrë online e praktikave, pavarësisht vështirësive, ka siguruar cilësi të lartë të përvojës studentore dhe rezultate të mira në procesin e të nxënës sipas programeve përkatëse të studimit.¹ Për vendin tonë kjo mënyrë mësimdhënieje përbën një risi, ndërsa në vendet e tjera është njohur që në vitet 90'. Tashmë për shumicën prej tyre përbën një mënyrë dominuese.

Ekziston një ndryshim i madh mes metodës online të zhvillimit të laboratorëve të fiziologjisë dhe metodës tradicionale të praktikave laboratorike pranë laboratorit të fiziologjisë së universitetit.


Universitetet janë përpjekur të përshtasin sipas mënyrave të ndryshme metoda të reja të mësimdhënies. Pedagogët e universitetit tonë, si të gjithë kolegët e universiteteve të tjera në botë, kanë shpalosur dhe përcaktuar metoda efikase për arritjen e objektivave të larta gjatë procesit mësimor. Fokusi i këtij studimi është mënyra se si transmetohen orët praktike tek studentët apo nxënësit, përmes metodave tradicionale dhe bashkëkohore të shkruara me metodologjinë e re online.

¹ IVAPPAN, V., & SUBRAMANI, N. 2018: Innovative methods of teaching and learning.


Metodologjia

Metodologjia është përzgjedhur në përputhje me qëllimin e studimit me anë të mënyrave dhe instrumenteve të ndryshme për mbledhjen e informacionit të nevojshëm. Informacioni i marrë është përdorur për prezantimin në artikull, duke e konkretizuar me një shembull konkret të një ore laborator online nga lënda e “Fiziologjisë së përgjithshme” me studentët e vitit të tretë të programit të studimit në Biologji-Kimi në nivelin Bachelor. Fokus i këtij studimi është mënyra se si transmetohen orët praktike tek studentët, përmes metodave tradicionale dhe bashkëkohore të shkruara me metodologjinë e re online. Mënyra se si ata arrijnë të transmetojnë temat e praktikës laboratorike nga pedagogu tek studenti dhe anasjelltas gjatë periudhës së pandemisë Covid -19 në mënyrë online, përbën metodologji më vete. Për mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave lidhur me praktikën laboratorike, janë përdorur opinione dhe intervista nga pedagogët, shkëmbime eksperience me kolegë të universiteteve të tjera të botës si dhe literaturë e gjerë.²

Figura 1 a- b. Shkëmbim eksperience me kolegë të huaj mbi platformat online të laboratorëve.



² CROPLEY, A 2001: Creativity in education & learning.



Skema 1. Transformimet e orës së laboratorit e “Fiziologjisë së përgjithshme” gjatë periudhës online.³

Siç shihet nga skema e mësipërme laboratorët e “Fiziologjisë së përgjithshme” janë transformuar gjatë periudhës pandemike. Metoda tradicionale i shmanget parashikimeve të orës laboratorike në etapa të ndryshme të saj. Eksperimentet konkrete, në disa raste transformohen në konkretizime abstrakte, meqë jo gjithmonë mund të zhvillohen në kushtet jashtë laboratorit. Në rastet kur mungojnë eksperimentet aktive, reflektimi nuk mund të realizohet nëpërmjet ekperimentit aktiv, por përmes vëzhgimeve ilustruese. Transformimet shpesh zëvendësojnë njëra-tjetrën, për të pasur një proces mësimor sa më me efekt.

Në vijim jepet tabela e metodikës së laboratorëve të “Fiziologjisë së përgjithshme” në formë krahasimore, mes dy periudhave (para pandemisë dhe gjatë pandemisë).

³ JESCHOFNIG, L., & JESCHOFNIG, P. 2011: Teaching lab science courses online resources for best practices, tools, and technology.

Laboratori i Fiziologjisë së përgjithshme	
Para pandemisë Covid-19	Gjatë pandemisë Covid-19
<i>Laborator tradicional</i>	<i>Laborator virtual</i>
Prezencë fizike	Domosdoshmëri interneti për prezencën virtuale.
Laboratori i Fiziologjisë së përgjithshme	Kushte ambientale jo të njëjta me laboratorin e Fiziologjisë së përgjithshme.
Orar i përcaktuar në grup për zhvillimin e orës mësimore.	Pavarësi, përshtatje dhe vetëdisiplinim në procesin mësimor në 24 orët e ditës.
Angazhim Full time (jo opsionale)	Angazhim Part time (opsionale).
Grup laboratorik me numër të përcaktuar studentësh apo nxënësish	Grupe laboratorike me numër variabël studentësh apo nxënësish.
Metoda standarde të strukturës së punës laboratorike në temat përkatëse	Metoda fleksibël (opsionale) të strukturës së orës laboratorike.
Punë aktive gjatë orës mësimore praktike	Pasivitet gjatë orës mësimore (jo gjithmonë).
<i>Marrja e njoftimeve</i>	
Komunikim me njoftime direkte në klasa-laboratore Njoftime në nivel departmenti, Fakulteti apo Universiteti	E-mail Njoftime online përmes platformave të njohura nga universiteti Telefoni Rrjete sociale
<i>Materiali teorik paraprak i nevojshëm për zhvillimin e punës laboratorike</i>	
Komunikimi paraprak mes mësimitdhënësit dhe studentëve, për lidhjen e njohurive teorike me ato praktike. Praktikumi i Fiziologjisë së përgjithshme. Teksti i Fiziologjisë së përgjithshme.	Video ilustruese e postuar në platformë. Material përmbledhës-shpjegues, mbi punën e laboratorit. Punë e pavarur (burime informacioni opsionale-fakultative).
<i>Mjetet e punës</i>	
Janë gjithmonë, që në fillim të orës laboratorike, në tryezën e punës.	Listohen, përmenden apo demonstrohen virtualisht sipas metodës së përzgjedhur që në fillim të orës së praktikës laboratorike.
<i>Zhvillimi i punës praktike</i>	
Në laboratorin e fiziologjisë, pranë departamentit përkatës. Pjesëmarrje aktive e kombinuar edhe me punën në grup.	Jashtë laboratorit të fiziologjisë (kushte shtëpie). Sinkronizim në web sipas platformave të ndryshme si LMS (Learning Management System) nëpërmjet prezantimit në PowerPoint, Microsoft Teams, në Meeting zoom (Studentë-mësimdhënës), regjistrime audio, video ilustruese e postuar në platformë. Pjesëmarrje jo gjithmonë aktive, por individuale dhe të pavarur.

<i>Përvetësimi i temës së laboratorit</i>	
Të mësuarit nëpërmjet punës praktike të zhvilluar Analizë e punës	Të mësuarit nëpërmjet vëzhgimit virtualisht (WEB). Komentim i rezultatit
<i>Diskutimi i rezultateve të punës laboratorike të realizuar</i>	
Rrjet diskutimesh në laborator mbi punën praktike të zhvilluar. Analizë argumentuese e rezultateve të marra nga vetë puna e studentëve.	Audiokonferencë. Videokonferencë. Rrjete sociale. Mesazhe të çastit.
<i>Plotësimi i rezultateve të punës laboratorike</i>	
Plotësim i tabelave të rezultateve në praktikum.	Dërgim online nëpërmjet kartelave të personalizuar në platformën e zgjedhur. Postim i punës së zhvilluar nga ata me foto apo video (demonstruese) në mënyrë online.
<i>Konkluzionet e orës mësimore</i>	
Nxirren nga diskutimet e rezultateve të punës të secilit student, duke analizuar faktorët ndikues në rezultat të përgjithësuar me argumente teorike.	Shpeshherë janë individuale (përveç rasteve kur ka bashkëbisedim në grup), ku bëjnë një analizë të pavarur nga anëtarët e tjerë të kursit apo grupit përkatës.

Tabela 1. Krahasimi i orës së laboratorit të “Fiziologjisë së përgjithshme” para pandemisë dhe gjatë pandemisë Covid – 19.⁴⁻⁵

Mësimdhënësi në varësi nga tema e punës praktike, kushtet e paparashikuara që krijohen gjatë procesit mësimor (ku përfshihen edhe ato teknike), përzgjedh format dhe metodat më të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosura. Është aftësia e tij të përzgjedhë metodën e duhur në kohën e duhur.⁶

⁴ BACOW, L.S., BOWEN, W.G., GUTHRIE, K.M., LACK, K.A., & LONG, M.P. 2012: Barriers to Adoption of Online Learning Systems.

⁵ AZEMI, A. (2008). AC 2008-1944: Enhancement of Traditional and distance learning.

⁶ ALMARZOOQ, Z., et.al 2020: Virtual Learning During the COVID-19 Pandemic: A Disruptive Technology in Graduate Medical Education.

TEMA: DOMINANCA E SYVE

Për zhvillimin e kësaj ore laboratorike mësimore kemi zgjedhur platformën *Microsoft Teams* dhe komunikimin direkt në orarin e përcaktuar, me të gjithë grupin laboratorik të kursit. Fillimisht studentët kanë marrë njoftimin me anë të email-it për orën e laboratorit online, nëpërmjet *Teams meeting*.

Në orarin e përcaktuar, çdo anëtar i grupit laboratorik hyn në mësimin online.



(a)

(b)

Figura 2. Zhvillimi i punës laboratorike në lëndën e “Fiziologjisë Humane”
(a) Në laboratorin e “Fiziologjisë së përgjithshme” (b) Gjatë
Pandemisë Covid -19, online Para Pandemisë Covid -19.

1. Ndryshe nga situata normale e zhvillimit të mësimin, studentët janë në mjediset e tyre të improvizuara, të gatshëm për të vazhduar orën mësimore, por jo në kushte të barabarta me njëri-tjetrin. Pandemia i ka bërë ata të ndryshojnë mënyrën e organizimit të ditës, ndër të cilat është edhe aktiviteti mësimor. Në orarin e përcaktuar secili nga anëtarët e grupit laboratorik, hyn nëpërmjet platformës online.⁻⁷
2. Ambienti i zhvillimit të orës së laboratorit nuk është i njëjtë për të gjithë. Ai është individual, i pavarur dhe i improvizuar. Përgjithësisht priren drejt estetikës dhe rregullit të ambientit ku ata ndodhen se sa

⁷ DEVINE, J., & LOKUGE, W. 2012: Engaging Distance Students Through Online Tutorials.

drejt përafrimit me ambientin real laboratorik. Shpesh hapësira kufizohet sa më shumë të jetë e mundur.

3. Mësimdhënësi dhe laboranti mund të jenë në laboratorin e fiziologjisë, për të qenë pranë mjeteve laboratorike demonstruese.
4. Studentëve u prezantohet tema e re “**Dominanca e Syve**⁸ Fillimisht studentëve u jepen objektivat e temës së re, të cilat janë përshtatur me kushtet e zhvillimit të orës mësimore.

Objektivat e kësaj ore janë:

- Të njohin dukurinë e dominimit të syrit si veprimtari pamore.
- Të përshkruajnë mënyrën se si mund të përcaktojnë syrin dominant.
- Të kryejnë provat që përcaktojnë syrin dominant tek ata.
- Të interpretojnë rezultatet e provave, duke u mbështetur në njohuritë e marra dhe të nxjerrin konkluzione të argumentuara.

Atyre u shtrohen disa pyetje hyrëse për të qenë më bashkëpunues dhe për të nxitur interesin mbi temën e re të lëndës, si përshembull:

- a- Cilën dorë përdorni më shumë se tjetra në mënyrë të pandërgjegjshme?
- b- A keni preferenca të tjera për syrin, këmbën, veshin e djathtë apo majtë?
- c- Si mendoni, a aktivizohen njëllot sytë në veprimtarinë e tyre pamore?
- d- Kur e keni kuptuar për herë të parë aktivizimin jo të njëjtë të syve tuaj në veprimtarinë pamore?
- e- Si mund të përcaktojmë në mënyrë të thjeshtë se cili nga sytë tanë është më aktiv se tjetri?

Studentët angazhohen me radhë dhe japin përgjigjet e tyre.

Përgjigjet përfundimtare të pritshme mund të jenë:

- a, b - Secili nga ne ka një dorë, sy, këmbë apo vesh më të predispozuar për t’u përdorur më shumë se tjetra, në mënyrë të ndërgjegjshme apo të pandërgjegjshme.
- c - Veprimtaria dhe aktivizimi pamor i të dy syve tanë nuk është njëllot.

⁸ POINTER JS 2007: The absence of lateral congruency between sighting dominance and the eye with better visual acuity. *Ophthalmic & Physiological Optics*.

- d- Moshë, gjendja dhe perceptimi mbi aktivizimin e syve nuk janë të njëjta për të gjithë.
- e- Ekzistojnë prova dhe mënyra të ndryshme hetimi të aktivizimit të syve tanë.

Pasi studentët kryejnë bashkëbisedimin e orientuar nga mësuesi, në ekranin e tyre postohen slide-t e materialit teorik paraprak të nevojshëm për zhvillimin e orës së praktikës laboratorike. Materiali mund të punohet në *Power Point*, duke kaluar slidet një nga një.






Figura 3. a-b-c-d-e. Slidet ilustruese të pjesës teorike mbi temën “Dominanca e syrit”⁹

5. Në dritaren e *Chat* –it , studentët shkruajnë pyetje në privat mbi ndonjë paqartësi nga ajo që afishohet.
6. Pedagogu demonstron para studentëve provën mbi përcaktimin e syrit dominant.
7. Njëkohësisht me sqarimin e pyetjeve, postohen video ilustruese dhe u kërkohen studentëve të vëzhgojnë pamjen.⁻¹⁰



Figura 4. Video ilustruese mbi përcaktimin e syrit dominant.

⁹ KHAN AZ, CRAWFORD JD 2001: Ocular dominance reverses as a function of horizontal gaze angle. *Vision. Research*.

¹⁰ MEHRABIAN, A., ALVARADO, K., & NAHMENS, I. 2007: Application of Technology in Project-based distance learning. *EISTA 2007*.

8. Studentët organizohen në zhvillimin e punës praktike nga ata vetë. Ata përshtasin komunikimin dhe fushën e shikimit me pjesëtarët e grupit. Secili nga ata kryen provat për të përcaktuar syrin dominant.
9. Në dritaren “assignment”, *testit* apo *kuiceve* të platformës, i afishohet kartela e radhës me pyetje reflektuese dhe tabelën e rezultateve të provave të kryera nga ata.

PYETJE RRETH TEMES:

- Cfare eshte dominanca e syve ?
- Si mund te percaktojme syrin dominant tek ne?

TABELA E REZULTATEVE

DOMINANCA E SYVE		
	Djathte	Majte
Syri		




Figura 5. Tabela e rezultateve dërguar studentëve mbi rezultatet e provave. ⁻¹¹

10. Studentët, nga provat e kryera, kryejnë një diskutim të organizuar mbi rezultatet e tyre dhe nxjerrin përgjithësime.
11. Secili nga ata dërgon rezultatet e provave, në *kartelën personale* online.
12. Pedagogu bën vlerësimet individuale në dritaren e “grade” për secilin student.

¹¹ CHENG CY., YEN MY., LIN HY., HSIA WW., HSU WM 2004: Association of ocular dominance and anisometric myopia. Investigative Ophthalmology & Visual Science.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Nga gjithë sa parashtruar më lart dalin disa përfundime e rekomandime si më poshtë:

- Teknologjia dhe pandemia Covid- 19, kanë ndryshuar mënyrën e mësimdhënies dhe të nxënit duke transformuar pjesërisht edhe rezultatin e këtij procesi.
- Përdorimi i teknologjisë me qasjet konstruktiviste nga mësimdhënësit dhe studentët sigurojnë integritet e shfrytëzim më të mirë të mjeteve të teknologjisë në mësimdhënie në mënyra më të përshtatshme dhe efektive. Kjo ndërlikohet mes atyre të dyjave i jep procesit të mësimdhënies/nxënies mjetin e nevojshëm për të përmirësuar metodat e mësimin, të cilat kanë në fokus të tyre studentin.
- Mësimdhënësi përdor teknologjinë e komunikimit për të nxitur shkëmbimet e informacionit ndërmjet studentëve, për të përmirësuar procesin e mësimdhënies e nxënies si dhe nxit mësimin bashkëveprues si mënyrë e vetme gjatë periudhës së Covid-it.
- Mësimdhënësi pavarësisht metodës online të zhvillimit të punëve praktike mbështetet në katër pika kyçe të ndërlidhura në procesin mësimdhënies/nxënies, si në:

- a - përmbajtjen akademike
- b- qëllimet mësimore
- c- metodat dhe procedurat
- d- vlerësimin e rezultateve të të nxënit

- Pjesëmarrja e studentëve është e kushtëzuar me mundësinë e pajisjes së tyre me internet, telefona apo kompjutera të përshtatshëm, kushtet e ambienteve të shtëpisë, impenjimin në punë, angazhimet familjare, gjendjen shëndetësore të tyre dhe të familjarëve. Ndonjëherë vihet re mungesë motivimi apo plogështi gjatë orëve mësimore.

Mbi këtë bazë do të rekomandonim:

- Për një proces mësimor me efikasitet të lartë, mësimdhënësi duhet të zhvillojë një orë mësimore që mbështetet në:
 - a- ndërveprimin mes studentëve apo mes studentëve dhe mësimdhënësit,
 - b- krijimin e grupeve virtuale të punës apo grup-analize,
 - c- pyetje dhe ushtrime që tentojnë të rrisin interesin dhe gjykimin mbi çështjen në shqyrtim.
- Në rastet kur studenti humbet vëmendjen gjatë zhvillimit të orës laboratorike, mësimdhënësi duhet të ndërhyjë me pyetje që kërkojnë argument në përgjigje.

Kjo mënyrë do të ndikojë në shfaqjen e interesit në çdo etapë të orës mësimore.

- Gjatë prezantimit të materialit:
 - a- mësimdhënësi duhet t'i paraqesë slide-t një e nga një,
 - b- numri i slideve nuk duhet të jetë i madh në mënyrë që studenti të mos humbë durimin.
 - c- prezantimi nuk duhet të jetë shumë i gjatë dhe i tejmbushur me informacion, sepse studenti mbingarkohet nga informacionet e dhëna nga mësimdhënësi, por edhe nga hulumtimet e pavarura të vetë atij.
- Temat e praktikave laboratorike duhet të përshtaten në metodikë dhe në përmbajtje me mundësinë e zhvillimit të tyre online, për të mos devijuar nga qëllimet reale të përcaktuara për temën përkatëse.
- Studentët apo nxënësit do të duhej të motivoheshin në pjesëmarrjen aktive të tyre online në laboratore, duke u vlerësuar me pikë shtesë, të cilat mund t'i mbartin në provim.
- Mësimdhënësi do të duhej të ndryshonte apo kombinonte metodat e zhvillimit të orës online, jo vetëm në tema të ndryshme, por edhe brenda së njëjtës orë të praktikës laboratorike.

REFERENCA:

- ALMARZOOQ, Z., et.al 2020: Virtual Learning During the COVID-19 Pandemic:A Disruptive Technology in Graduate Medical Education.
- AZEMI, A. (2008). AC 2008-1944: Enhancement of Traditional and distance learning
- BACOE , L.S., BOW EN, W .G., GUTHRIE, K.M., LACK, K.A., & LONG, M.P. 2012: Barriers to Adoption of Online Learning Systems.
- CROPLEY, A 2001: Creativity in education & learning.
- CHENG CY., YEN MY., LIN HY., HSIA È È ., HSU È M 2004: Association of ocular dominance and anisometric myopia. Investigative Ophthalmology & Visual Science.
- DEVINE, J., & LOKUGE, È . 2012: Engaging Distance Students Through Online Tutorials.
- INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT (udhëzues për mësuesit), 2015:Të nxënit me situata, konstruktivizmi dhe teknologjia.
- I.S.P. Grup autorësh1995: Strategjitë e të mësuarit.
- IVAPPAN, V., & SUBRAMANI, N. 2018: Innovative methods of teaching and learning.
- JACKSON,T. 2003: Activities that teach. New York.
- JESCHOFNIG, L., & JESCHOFNIG, P. 2011: Teaching lab science courses online resources for best practices, tools, and technology.

- KAMPOURAKIS, K., & REISS, M. 2018. Teaching Biology in schools: Global Research, Issues, and Trends Teaching and Learning in Science Series through hybrid-learning approach. Retrieved 2009 from conference link of asee.org
- KHAN AZ, CRAË FORD JD 2001: Ocular dominance reverses as a function of horizontal gaze angle. Vision Research.
- KHARE, S., & KHARE, R. 2018: Human Physiology, for NEET, Medical & Biotech Students.
- KHUARANA, I. 2018: Concise Textbook of Human Physiology
- MEHRABIAN, A., ALVARADO, K., & NAHMENS, I. 2007: Application of Technology in Project-based distance learning. EISTA 2007.
- POINTER JS 2007: The absence of lateral congruency between sighting dominance and the eye with better visual acuity. Ophthalmic & Physiological Optics.

TRENDET E PËRDORIMIT TË MEDIAS SOCIALE NË PROCESIN E REKRUTIMIT

Galsvida Biba, Aurilda Mali

Universiteti i Shkodrës, departamenti Psikologji-Punë Sociale

ABSTRAKT

Shumë organizata luftojnë me krizën globale të tregut dhe janë në një kërkim të vazhdueshëm të mënyrave për të rritur avantazhin e tyre konkurrues përkundrejt organizatave të tjera. Shfrytëzimi i mjeteve të duhura strategjike për të rritur shanset organizative në treg është një domosdoshmëri për të kapërcyer çdo problem të mundshëm. Për shkak të përhapjes mjaft të gjerë, punëdhënësit dhe punëmarrësit i përdorin mediat sociale si një mjet efektiv rekrutimi.

Në tërësi, mediat sociale mund të interpretohen si një mjet rekrutimi efektiv dhe efikas të cilat lidhen me metodat tradicionale të rekrutimit si reklamata e shtypura, bordet e punës dhe agjencitë rekrutuese.

Ky punim ka për qëllim të eksplorojë mbi trendet e përdorimit të medias sociale si një mjet rekrutues nga biznesi privat dhe publik që operojnë në bashkinë Shkodër. Metodologjia e kërkimit është sasiore dhe instrumenti i kërkimit është pyetësori. Instrumenti është i ndarë në tre blloqe kryesore kërkimi, njohjen e masës së përdorimit të medias sociale në procesin e rekrutimit, eksplorimin e arsyeve të përdorimit apo mospërdorimit të saj si mjet rekrutimi, çështje etike të lidhura me besueshmërinë e informacionit të kandidatëve. Studimi është realizuar në një kampion 100 institucione shtetërore dhe biznese private në qytetin e Shkodrës, nga të cilat 87 pyetësorë ishin të vlefshëm për t'u analizuar.

Ndër avantazhet e përdorimit të rekrutimit social, respondentët rënditën, kursimin e kostos monetare, kursimin e kostos kohore dhe pasjen e mundësisë për të zgjedhur nga një gamë të gjerë kandidatësh.

Ky kërkim evidentoi se mjedisi organizativ në qytetin e Shkodrës e konsideron median sociale si një mjet efikas reklamimi, por jo rekrutimi. Trendi i përdorimit të saj është në rritje, por mungesa e kapaciteteve njohëse dhe përdoruese në rekrutim ka ende vend për t'u përmirësuar.

Fjalë kyçe: media social, rekrutim, organizatë, besueshmëri.

Trends of using social media in the recruitment process

ABSTRACT

Many organizations struggle with the global market crisis, and are in a constant search of ways to increase their competitive advantage over other organizations. Utilizing the right strategic tools to increase organizational changes in the market is a necessity to overcome any potential problems. Due to its widespread use, employers and employees are using social media as an effective recruitment tool.

Overall, social media can be interpreted as an effective and efficient recruitment tool which is related to traditional recruitment methods like print advertising, job boards and recruitment agencies.

This paper aims to explore trends in the use of social media as a recruiting tool by private and public businesses operating in the municipality of Shkodra. The methodology of this research is quantitative and the research instrument is the questionnaire. The instrument is divided into three main research blocks, recognizing the extent of social media use in the recruitment process, exploring the reasons for using or not using it as a recruitment tool, ethical issues related to the reliability of candidates' information. The study was conducted in a sample of 100 public institutions and private sector in the city of Shkodra.

Among the advantages of using social recruitment, respondents ranked, saving money, saving time and having the opportunity to choose from a wide range of candidates.

This research showed that the organizational environment in the city of Shkodra considers social media as an effective way of advertising but not recruitment. The trend of its use is growing but still has a lot for improvement.

Keywords: social media, recruitment, organization, credibility.

Rishikim literature

Rritja e përdorimit të internetit ka kontribuar në ndryshimin e shumë fushave të jetës. Është një burim informacioni, një mjet i përdorur për punë, një instrument i përdorur për argëtim dhe komunikim, një vend për të blerë ose shitur produkte, për të kërkuar partnerë biznesi etj.(Correa, Hinsley, De Zúñiga et al., 2009). Numri i mënyrave të përdorimit të

internetit është jashtëzakonisht i madh pavarësisht industrisë ose natyrës së subjektit (individë, kompani dhe institucione të tjera). Mediat sociale janë një fazë e rëndësishme e rritjes së vazhdueshme të shërbimeve të internetit dhe inovacionit të tyre. Ata janë bërë një mjet i cili përdoret nga një numër i madh i njerëzve në mbarë botën. Numri i përdoruesve të internetit në botë është 3,916,734,900¹ nga të cilët rreth 1,932,024 janë përdorues nga Shqipëria.² Mënyra dhe karakteri i përdorimit të mediave sociale varet para së gjithash nga nevojat e njerëzve dhe nga shkalla për të cilat përdorimi korrespondon me nevojat. Për shembull, nevoja për të ndarë udhëtimin e dikujt, kujtimet me miqtë e tyre, mund të përmbushen duke përdorur një faqe interneti ose komunikues si Facebook, Instagram ose Snapchat (Nadkarni & Hofmann, 2012).

Përdorimi i medias sociale në aspektin e punës. Përdorimi i MS për aktivitete të lidhura me punën mund të shikohet nga dy këndvështrime, i një punonjësi dhe një punëdhënësi. Nga këndvështrimi i një punonjësi, komunitetet virtuale ndihmojnë në dhënien e informacionit (jo gjithmonë objektiv) rreth një punëdhënësi potencial ose aktual, duke shkëmbyer mendime në forume ose në rrjetet sociale. Rrjetet e miqve në SNS mund të jenë gjithashtu të dobishme kur kërkojnë punë. Për më tepër, MS mund të jetë një burim i ofertave të reja të punës nëpërmjet vendosjes së një informacioni të tillë në faqet e rrjeteve sociale të korporatave, faqet e punëdhënësve potencialë (Williams & Verhoeven, 2008). Gjithashtu, media të veçanta, p.sh. LinkedIn, u mundësojnë punonjësve të paraqesin profilin e tyre, arsimimin, përvojën dhe karrierën (Gerard, 2012).

Një arsye për të përdorur faqet e mediave sociale për të përzgjedhur punonjësit është se punëdhënësit mund të verifikojnë informacionet e ofruara nga aplikuesit. Arsyet e tjera për përdorimin e rrjeteve sociale për qëllime përzgjedhjeje është se ato kanë disa përparësi kundrejt mjeteve tradicionale të përdoruara nga burimet njerëzore, si kostoja e ulët (Jacobs, 2009) dhe fakti që perceptohen si burime të besueshme nga përdoruesit (Kluemper dhe Rosen, 2009). Kështu, rrjetet sociale, u ofrojnë punëdhënësve informata shitesë që mund të përdoren për të seleksionuar aplikantët.

Rekrutimi dhe përzgjedhja

Rekrutimi i referohet procesit të përgjithshëm të gjetjes, tërheqjes, përzgjedhjes, seleksionimit dhe emërimit të kandidatëve të përshtatshëm

¹ <http://www.internetlivestats.com/>

² <https://www.internetworldstats.com/stats4.htm#europe>

për punë (të përhershëm ose të përkohshëm) brenda një organizate.³ Është procesi i krijimit të një grupi kandidatësh të aftë që aplikojnë në një organizatë për punësim (Gold, 2007). Mund të zgjidhen aplikantët më me përvojë dhe kualifikime që lidhen më ngusht me specifikimet e punës. Vëzhgimi i El-Kot dhe Leat (2008) është se rekrutimi fillon me reklamimin e vendeve vakante. Për shumicën e organizatave, aplikimet direkte me postë ose direkte, përbëjnë burimin më të madh të aplikimeve. Burime të tjera të rekrutimit përfshijnë kontaktet personale, rekrutimin nëpërmjet kampuseve të universitetit dhe të shkollave, panairët e punës, agjencitë e rekrutimit, reklamat në median e shkruar apo atë vizive.

Selektimi është procesi i përzgjedhjes së kandidatit me kualifikimet dhe aftësitë e duhura për të plotësuar vendin e punës vakant në organizatë.⁴ Mondy (2010, f.136) i referohet selektimit si “procesi i përzgjedhjes nga një grup aplikantësh, ata individë, të cilët janë të përshtatshëm për një pozitë të caktuar në një organizatë”. Ndërkohë që procesi i rekrutimit është i lidhur me inkurajimin e individëve për të kërkuar punë në organizatë, procesi i përzgjedhjes ka të bëjë me identifikimin dhe punësimin e individëve më të kualifikuar dhe të përshtatshëm për pozita specifike.

Kostoja e përdorimit të mediave sociale në procesin e rekrutimit dhe selektimit

Në burimet njerëzore, ‘rekrutimi social’, ‘punësimi social’ ose ‘marrja sociale’, është përdorimi i medias sociale në rekrutim dhe selektim që zakonisht përfshin reklamat për punë, shqyrtimin e aplikantit dhe markimin e punëdhënësit. Është raportuar të jetë burimi i punësimit i tretë më efektiv, pas faqeve të rekrutimit dhe programeve të referimit të punonjësve.

Një studim i kryer nga Jobvite (2012)⁵ zbuloi se 92% e punëdhënësve përdorin ose planifikojnë të përdorin median sociale për të rekrutuar dhe se globalisht, LinkedIn kryeson listën e mediave sociale të përdorura për rekrutim dhe selektim. I ndjekur më pas nga Facebook, Twitter, YouTube dhe Instagram (Jobvite, 2013)⁶. Po sipas Jobvite, si rekrutuesit ashtu dhe punëkërkesit e përdorin median sociale si një mjet verifikimi përpara një interviste për punë, rreth 78% e rekrutuesve kanë punësuar aplikantë nëpërmjet medias sociale, dhe rreth rreth 92% e tyre

³ <https://en.wikipedia.org/wiki/Recruitment#Process>

⁴ <https://businessjargons.com/selection-process.html>

⁵ http://web.jobvite.com/rs/jobvite/images/Jobvite_2012_Social_Recruiting_Survey.pdf

⁶ http://web.jobvite.com/rs/jobvite/images/Jobvite_SocialRecruiting2013.pdf

përdorin LinkedIn, 24% përdorin Facebook dhe rreth 14% Twitter-in.⁷ LinkedIn vlerësohet si media më efektive.⁸

Rekrutimi nëpërmjet mediave sociale ofron një shumëllojshmëri ekonomike kundrejt shumë metodave tradicionale të rekrutimit. Brown dhe Vaughn, (2011) shtojnë se mediat sociale madje mund të përdoren si pjesë të mundësive të barabarta, veprimit social dhe politikave të diversitetit të organizatave, pasi lejon që rekrutuesit të marrin pjesë në diskutime dhe forume on-line dhe të angazhojnë me sukses kandidatët potencialë në grupe të cilët nuk do mund të bëheshin pjesë përmes burimeve tradicionale të rekrutimit, si reklamat në gazeta.

Përfitimet e përdorimit të mediave sociale në rekrutim dhe përzgjedhje

Ekziston një gamë e gjerë përfitimesh që lidhen me përdorimin e mediave sociale në rekrutim, duke u përqendruar kryesisht në kursimet e kostos, rritjen e numrit të aplikantëve dhe mundësia për të planifikuar rekrutimin në grupe specifike të kandidatëve të mundshëm (Davison, Maraist dhe Bing, 2011). Në një mesatare, çdo ofertë e punës së korporatave tërheq 250 rezume. Nga këta kandidatë, 4-6 do të thirren për një intervistë dhe vetëm 1 do të marrë vendin e punës. (Glasdoor)

Faqet e mediave sociale ofrojnë mjete për të shqyrtuar aspektet e një kandidati që metodat e tjera të rekrutimit nuk do të mund të arrinin kurrë, si personaliteti dhe përshtatshmëria e tyre me organizatën. Më parë, për të rekrutuar punonjës, organizatat do të duhej të reklamnin vendet vakante në shtypin lokal, të pajtonin një agjenci rekrutimi, ose të postonin mundësitë e punësimit në faqet e internetit të kompanisë ose në tabelat e njoftimeve. Sot, me evolimin e mediave sociale, menaxherët e burimeve njerëzore dhe firmat e rekrutimit janë detyruar të ndërmarrin një qasje proaktive, duke i joshur talentet nëpërmjet përdorimit të platformave të rrjeteve sociale (Brown & Vaughn, 2011). Mediat sociale kanë aftësinë për të rritur komunikimin në përgjithësi, i cili për organizatat e sektorit publik është shumë i dobishëm. Ky lloj komunikimi i ndihmon organizatat që të tregojnë se janë të arritshme dhe ndoshta do të inkurajojnë njerëzit të pranojnë punën e dëshiruar në një korporatë të tillë.

Diversiteti në kërkimin e talenteve

Faqet e mediave sociale mund të përdoren për të identifikuar aplikuesit potencialë me karakteristika ose kualifikime të caktuara dhe për të përfshirë edhe aplikantët jotradicionalë – p.sh., ata që nuk janë target

⁷ http://www.jobvite.com/rs/jobvite/images/Jobvite_SocialRecruiting2013.pdf

⁸ <https://www.jobvite.com/wp-content/uploads/2016/09/RecruiterNation2016.pdf>

grupet e zakonshme ose që kanë kualifikim dhe përvoja të ndryshme - shpejt dhe me lehtësi. Për më tepër, përdorimi i mediave sociale mund të rrisë cilësinë e aplikimeve. Siç thekson Jobvite (2013), "43% e rekrutuesve që implementuan rekrutimin social panë një rritjeje në sasinë e kandidatëve dhe 49% vunë në dukje një rritje në cilësinë e kandidatëve". Cilësia në këtë kontekst do të thotë se kualifikimet, përvoja dhe përshtatshmëria e përgjithshme e kandidatëve përputhet me specifikimin e vendit të punës.

Saktësia e informacionit


Shfletimi i faqeve të mediave sociale zakonisht nuk është një aspekt formal i procesit të rekrutimit. Kjo sugjeron që mund të mos jetë e arritshme për të verifikuar që të dhënat e marra janë të sakta (Davison, Maraist dhe Bing, 2011). Të dhënat që individët preferojnë të ndajnë në faqet e mediave sociale mund të jenë të ndryshuara ose të shtrembëruara nga shqetësimi i të qenurit i pëlqyer nga shoqëria dhe kjo mund të varet fuqimisht nga audienca e perceptuar. Për shembull, dikush, ndoshta mund të postojë fotografitë e veta duke u socializuar dhe duke konsumuar alkool në festa për të shfaqur hapur socializimin e tyre dhe për të impresionuar miqtë. Megjithatë, kjo nuk mund të impresionojë rekrutuesit potencialë. Disa faqe të mediave sociale, si LinkedIn, janë të dizajnuara shprehimisht për t'u shqyrtuar nga punëdhënësit potencialë. Megjithatë, të tjerat, si Facebook, i shërbejnë më shumë performancave personale.

Punëdhënësit mund të kenë akses në të dhënat për një kandidat nëpërmjet palëve të treta në këto faqe të mediave sociale - të dhëna që edhe njëherë nuk mund të verifikohen (Davison, Maraist & Bing, 2011). Këto probleme çojnë në pyetjen nëse karakteristikat përkatëse të punës mund të maten me saktësi nëpërmjet mediave sociale (Davison, Maraist & Bing, 2011). Nëse të dhënat nuk mund të verifikohen, do të jetë e mundimshme për të justifikuar shfrytëzimin e të dhënave të tilla të mbledhura nga faqet e mediave sociale në marrjen e vendimeve. Për më tepër, Smith dhe Rupp (2004), pyesin nëse duhet t'u besohet programuesve kompjuterikë një detyrë e tillë thelbësore si vlerësimi i zotësive dhe kompetencave të një personi. Bullhorn Reach (2013) vëren se një tjetër aspekt jetik i lidhur është se potenciali për të bërë gabime kur përdorim mediat sociale, sidomos me mjetet që lëvizin me shpejtësi si mesazhet e Twitter-it 'tweeted' që janë tmerrësisht shpejt dhe joformalisht dhe reagimet janë të shpejta ato në mënyrë tipike nuk u ofrojnë organizatave apo njerëzve një kohë të mirë për t'u pasqyruar dhe faktori më i thjeshtë për t'u përpjekur dhe për t'u bërë është të bërit përsëri e një "tweet" dhe ta korrigjojë atë që të jetë relativisht i relaksuar për sa i përket bërjes së gabimeve.

Si të përdorim mediat sociale si mjet rekrutimi: LinkedIn

LinkedIn është media sociale e duhur për profesionistët e biznesit. Me mbi 467 milionë anëtarë në mbarë botën, ajo është një nga mediat sociale më të përdorura në aspektin e përdoruesve aktivë. E disponueshme në mbi 24 gjuhë në më shumë se 200 vende, LinkedIn fokusohet në lidhjet e biznesit dhe kontaktet për punëdhënësit dhe profesionistët e punës, duke u lejuar kompanive të prezantojnë veten përmes faqeve në internet dhe për përdoruesit të gjejnë listat e vendeve vakante të punës dhe të rrisin lidhjet në zonën e tyre të aftësive, mjeshtërive.⁹

Raporti i Society for Human and Resousce Management (SHRM 2016), zbuloi se 96% e punëdhënësve që përdorin mediat sociale favorizojnë LinkedIn, afërsisht e njëjtë me 95% që e përdorën atë në vitin 2011.



Metodologjia e kërkimit

Ky punim ka për qëllim të eksplorojë mbi trendet e përdorimit të medias sociale si një mjet rekrutues nga biznesi privat dhe publik që operojnë në bashkinë Shkodër. Metodologjia e kërkimit është sasore dhe instrumenti i kërkimit është pyetësori. Instrumenti është i ndarë në tre blloqe kryesore kërkimi, njohjen e masës së përdorimit të medias sociale në procesin e rekrutimit, eksplorimin e arsyeve të përdorimit apo mospërdorimit të saj si mjet rekrutimi, çështje etike të lidhura me besueshmërinë e informacionit të kandidatëve. Studimi është realizuar në një kampion 100 institucione shtetërore dhe biznese private në qytetin e Shkodrës, nga të cilat 87 pyetësorë ishin të vlefshëm për t'u analizuar.

⁹ <https://www.statista.com/topics/951/linkedin/>


Popullata e studimit tonë janë institucionet publike dhe private që operojnë në qytetin e Shkodrës. Stratifikimi i kampionit u përqendrua në institucione publike të cilat kishin më shumë peshë në punësimin e punonjësve në qytetin e Shkodrës, duke marrë në konsideratë numrin e të punësuarve dhe kështu u zgjodhën institucionet: OSHEE, Bashkia, DRSH, Ndërmarrja e Ujësjiellit. Për sa i përket biznesit privat u përzgjedhën bizneset me një qarkullim të madh të punonjësve, si: dyqane, parukieri, bar-kafe, hotele.

Analiza e të dhënave


Në Shqipëri nuk ekzistojnë statistika të punëkërkesve nëpërmjet mediave sociale. Në mënyrë që të kemi një ide më të qartë të përdorimit të medias sociale si një mjet punë-kërmimi, nga ana e popullatës, kemi zhvilluar një studim me një kampion prej 200 personash. Kampioni ka qenë rastësor, një ndër çdo tre kalimtarë. Pyetjet kanë qenë dy, “A e përdorni median sociale për të kërkuar vende pune?” dhe “Nëse po, cilën media sociale përdorni?”.

Pjesë e kampionit kanë qenë 120 femra dhe 80 meshkuj.


Pyetja e parë ka marrë 127 përgjigje pozitive (63.5% e kampionit) dhe 73 përgjigje negative (36.5% e kampionit).



Përsa i përket dallimeve gjinore, ndër respondentët të cilët janë përgjigjur pozitivisht, 69 prej tyre (rreth 54%) kanë qenë femra dhe 58 (rreth 45%) kanë qenë meshkuj.




Media sociale më e përdorur si mjet punë-kërkues rezultoi të ishte Facebook (49%), Instagram (27%), Twitter (12%), LinkedIn (10%) dhe Yahoo me (2%).



Ndërsa përsa i përket dallimeve gjinore në përdorimin e medias sociale në

procesin e punë-kërkimit, Facebook-un e përdornin më shumë meshkujt (rreth 60%) ndërsa instagramin më shumë femrat (rreth 66.6%). Twitter dhe LinkedIn përdoren më shumë nga gjinia mashkullore, me rreth (60%).




Siç shihet, edhe përsa u përket rekrutuesve, Facebook dhe Instagram kanë nivelin më të lartë të përdorimit. Facebook gjithashtu rezulton të jetë media sociale më e përdorur në procesin e rekrutimit.

Cilën nga keto media sociale përdornin më shumë për të rekrutuar në biznesin tuaj

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
facebook	41	47.1	47.1	47.1
instagram	15	17.2	17.2	64.4
Valid google	14	16.1	16.1	80.5
youtube	17	19.5	19.5	100.0
Total	87	100.0	100.0	

Pyetjes “A e përdorni median sociale për të rekrutuar staf në biznesin/drejtorinë tuaj?”, respondentet janë përgjigjër kështu:



Rreth 49% prej tyre dhanë përgjigje pozitive. Alternativa të tjera të përdorura për të rekrutuar, në mungesë të përdorimit të medias sociale, ishin: *përhapja e lajmit, lajmërimet në tv apo gazeta, përhapja e lajmit mes punonjësve, lajmërimet në biznes.*

PËRFUNDIME

Pjesa më e madhe e respondentëve rezultuan të mos përdornin rekrutimin social. Përkatesisht rreth 55.2% e kampionit nuk e përdornin rekrutimin social, ndërsa pjesa tjetër, rreth 44.8 %, po. Vërehet një disbalancë mes përdorimit të medias sociale nga ana e punë-kërkuesve dhe rekrutuesve, megjithëse pika e takimit ishte media sociale më e përdorur Facebook në ndryshim nga statistikatat botërore që e nxirrnin LinkedIn si më të përdorur. Një pjesë e mirë e të anketuarve nuk e përdornin median sociale si mjet rekrutimi, por e përdornin atë si një mjet të mirë reklamimi. Një pjesë e konsiderueshme e respondentëve e cilësuan rekrutimin social si mjaft efektiv.

Pjesa më e madhe e përdoruesve të rekrutimit social e cilësuan atë si një mjet efektiv. Arsye të përdorimit të rekrutimit social u përmendën, kostoja e ulët kohore dhe monetare dhe pasja mundësi e përzgjedhjes në një gamë të gjerë kandidatësh. Ndërsa, si arsye të mungesave të përdorimit, u

permend mungesa e besueshmërisë dhe mungesa e aftësive të duhura në përdorim. Ndër avantazhet e përdorimit të rekrutimit social, respondentët rënditën, *kursimin e kostos monetare, kursimin e kostos kohore dhe pasjen e mundësisë për të zgjedhur nga një game të gjerë kandidatësh.*

REKOMANDIME

Media sociale është një mjet rekrutimi i fuqishëm i cili gjithnjë e më shumë po përdoret sot në botën e punës. Në Shqipëri duhet më shumë orientime dhe besueshmëri në përdorimin e këtij instrumenti me kosto më të ulët dhe me mundësi për të siguruar diversitetin e talenteve në organizatë.

BIBLOGRAFIA:

- Shea, K., Wesley, J., 2006. How social networking sites affect students, career services, and employers. *National Association of Colleges and Employers Journal* 66,
 - Levashina, J., 2009. Expected practices in background checking: review of the human resource management literature. *Employee Responsibilities and Rights Journal* 21,
 - Kluemper, D.H., Rosen, P.A., 2009. Future employment selection methods: evaluating social networking web sites. *Journal of Managerial Psychology* 246,
 - Gold, J. (2007). Recruitment and selection. In J. Bratton & J. Gold (Eds.), *Human resource management: Theory and practice*,
 - Smith, A.D. and Rupp, W.T. (2004) 'Managerial challenges of e-recruiting: extending the life cycle of new economy employees', *Online Information Review*, Vol. 28
 - Clements, A. (2012), 'Social media and recruitment: time for a coherent HR strategy?' *HR Magazine*, 16th February 2012
 - Scott, P. R., & Jacka, J. M. (2011). *Auditing Social Media: A Governance and Risk Guide*.
 - Slovensky, R., & Ross, W. H. (2012). Should Human Resource Managers Use Social Media To Screen Job Applicants?
 - <https://www.journals.elsevier.com/international-journal-of-hospitality-management>
 - Vicknair, J., Elkersh, D., Yancey, K., & Budden, M. C. (2010). The Use of Social Networking Websites as a Recruiting Tool for Employers. *American Journal of Business Education*, Vol 3, nr. 11;
 - Zielinski, D. (2012). Group learning: *Use social media to engage employees in knowledge sharing*. *HR Magazine*
- <http://www.naceweb.org/store/2016/recruiting-benchmarks-survey-2016/>
<https://www.jobvite.com/wp-content/uploads/2016/09/RecruiterNation2016.pdf>
<http://www.acas.org.uk/index.aspx?articleid=2056>
<https://data.worldbank.org/indicator/IT.NET.USER.ZS?end=2016&locations=AL&start=1990&view=chart>
<https://www.statista.com/>
<https://uptowork.com/blog/hr-statistics#online-recruiting-and-social-media-statistics>

PERSONALITETI I OFICERIT TË POLICISË

Lediana Xhakollari, Eralda Zhilla, Entela Xhakollari

*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Universiteti i Tiranës
Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut*

ABSTRAKT

Shumë njerëz thonë se puna e fundit që ata do të mendonin të bënin është të ishin policë. Ata shumë shpejt numërojnë të gjitha aspektet negative të punës. Pavarësisht kësaj, ka shumë të rinj, të cilët duan të bëhen policë. Shkencëtarët e sjelljes kanë studiuar kandidatët për policë për të përcaktuar nëse ekzistojnë modele të veçanta të personalitetit të tyre që i dallojnë nga popullata civile. Kjo fushë kërkimi përqipet të përcaktojë nëse ka faktorë të personalitetit që e bëjnë një individ më të predispozuar që të pëlqejë apo të tërhiqet nga puna e policisë. Pra, a kanë oficerët e policisë karakteristika të personalitetit që i dallojnë ata nga njerëzit e tjerë? Ndaj kësaj pyetjeje i janë dhënë përgjigje të ndryshme.

Fjalët kyç: oficer i policisë, personalitet.

Police officer personality

ABSTRACT

Many people say that the last job they would think of doing is being a police officer. They very quickly enumerate all the negative aspects of the job. Despite this, there are many young people who want to become police officers. Behavioral scientists have studied police candidates to determine if they have specific personality patterns that distinguish them from the civilian population. This field of research tries to determine if there are personality factors that make an individual more predisposed to like or withdraw from police work. So, do police officers have personality traits that distinguish them from other people? Different answers have been given to this question.

Keywords: police officer, personality.

Hyrje

Policia ofron shërbime shumë të vlefshme për shoqërinë, duke garantuar një mjedis të sigurt për komunitetin, i cili sjell përmirësim në cilësinë e jetës së qytetarëve. Misioni i saj është shërbimi ndaj shtetit dhe komunitetit për të mbajtur rendin e qetësinë e vendit dhe për të zbatuar ligjin. Detyrat e policisë janë të shumta, duke nisur që nga mbikëqyrja dhe drejtimi i trafikut rrugor, mbikëqyrja dhe kontrolli i kufijve shtetërorë, ruajtja e rendit dhe sigurisë publike, mbrojtja e jetës, shëndetit dhe pronës publike e private, e deri tek parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale dhe autorëve të dyshuar të kryerjes së tyre. Ka një larmi të madhe të përgjegjësive të policisë, por në këtë temë ne do të trajtojmë se si shkenca e psikologjisë ndihmon policinë në përmbushjen e misionit të saj.

Fillimisht do të flasim për historinë e zhvillimit dhe aplikimit të psikologjisë policore. Më pas do të trajtojmë temën e personalitetit të policit, duke parashtruar studime të ndryshme për sa i përket pyetjes nëse oficerët e policisë janë njerëz të zakonshëm, apo kanë karakteristika dhe tipare të veçanta që i dallojnë nga njerëzit që kryejë profesione të tjera.

Historiku i psikologjisë policore

Mund të mendohet se praktika e psikologjisë policore është po aq e gjatë sa edhe vetë profesioni i policisë e cila daton rreth 200 vjet më parë, por psikologjia policore është një specialitet relativisht i ri nën ombrellën e psikologjisë ligjore (Thomas, 2011). Hugo Munsterberg shpesh është konsideruar si psikologu i parë ligjor. Edhe sot në shumë mënyra ai konsiderohet si psikologu i parë policor, pasi në fillim të shekullit të 20-të shkroi se si ligji, shqyrtimi kriminal, mekanizmat në procesin gjyqësor dhe zbulimi i kriminelëve, bashkoheshin të gjitha së bashku nën syrin vigjilent të psikologut eksperimental. Në librin e tij me titull “On the Witness Stand” (1908), Munsterberg foli për shumë çështje të ndryshme, si: iluzionet, kujtesa e dëshmitarëve, efektet e emocioneve, deklaratimet e rreme, sugjestionimi i dëshmitarëve, hipnozot dhe parandalimi i krimit (Kitaëff, 2011).

Testi i parë i inteligjencës për përzgjedhjen e policëve u administrua nga Terman et al. (1917). Terman dhe kolegët e tij administruan Testin e Inteligjencës së Simon-Binet, pasi sipas tyre përveç integritetit moral, në përzgjedhjen e kandidatëve për policë, testimi i inteligjencës së përgjithshme ishte një faktor shumë i rëndësishëm. Në fillimet e viteve 1920 u realizuan disa shqyrtime eksperimentale të testimit psikologjik për qëndrimet dhe rendimentin e policisë. Për shembull, në vitin 1922 L. L. Thurstone aplikoi testin Army Alpha Intelligence tek një grup oficerësh që

shërbenin në Departamentin e Policisë së Detroit. Ai zbuloi se, në përgjithësi, policët e patrullimit rrugor fitonin më tepër pikë në testin e inteligjencës se sa togerët që i komandonin ata (policët rrugorë). Thoursone arriti në përfundimin se kjo shpjegohej me faktin se, ndër të tjera, forcat e policisë më inteligjente shpesh dilnin jashtë sistemit të policisë për të gjetur punë të tjera më tepër të paguara, pasi promovimi në karrierë brenda sistemit të policisë zgjaste shumë kohë ose edhe mund të mos ndodhte asnjëherë. Në vitet 1950 Kates administroi tek një grup oficerësh të Nju Jorkut testin e njollave të bojës të Rorschach dhe zbuloi se disa ndryshore të këtij testi mund të përdreshin për të parashikuar kënaqësinë nga puna dhe motivimin për promovim (Kitaeff, 2011).

Nga perspektiva historike ka pasur tri epoka zhvilluese ose tradita që përkufizojnë fushën e psikologjisë policore.


1. Periudha e parë lidhet me zhvillimin e standardeve të përzgjedhjes së personelit të oficerëve të policisë.
2. Faza e dytë lidhet direkt me ofrimin e shërbimeve psikologjike ndaj personelit të policisë.
3. Faza e tretë sot është gjerësisht e përhapur dhe përfshin zhvillimin në karrierë dhe aplikimin e parimeve të psikologjisë në fusha të ndryshme, si profilizimi kriminal, negocimi në rastet e pengmarrjes, identifikimin e dëshmitarit okular (Thomas, 2011).

Përkufizimi i psikologjisë policore

Një përkufizim i thjeshtë i psikologjisë policore mund të jetë: “Aplikimi i parimeve të psikologjisë tek forcat e ligjit” (Thomas, 2011). Për shumë vite vetëm specialitetet e praktikës së përgjithshme të psikologjisë klinike, organizative, shkollore dhe të këshillimit ishin të njohura nga Shoqata Amerikane Psikologjike. Më 21 tetor 2011, brenda Bordit Amerikan për Psikologjinë Profesionale, i cili merret me njohjen e fushave të ndryshme në psikologjinë profesionale si specialitetet, u krijua edhe një Bord Special i quajtur Bordi Amerikan i Psikologjisë Policore dhe Sigurisë Publike, i cili krijoi specialitetin e “Psikologjisë Policore the Sigurisë Publike”. Aplikimi për njohjen zyrtare të “Psikologjisë Policore dhe Sigurisë Publike” në Shoqatën Amerikane Psikologjike u bë në vitin 2011, ndërsa njohja fillestare zyrtare e saj u bë në 31 korrik të vitit 2013. Ky aplikim i prezantuar nga kjo shoqatë në vitin 2011 siguroi një përkufizim gjithëpërfshirës të psikologjisë policore: “*Psikologjia Policore dhe e Sigurisë Publike ka të bëjë me ndihmën në zbatimin e ligjit të personelit dhe agjencive të tjera të sigurisë publike në përmbushjen e misioneve të tyre dhe të funksioneve shoqërore me efikasitet, siguri, në mbrojtje të shëndetit*

dhe më pajtueshmëri me ligjet dhe etikën”.

Psikologu policor perceptohet sikur ka një pushtet të madh mbi oficerët e policisë, pasi psikologu mund të përcaktojë nëse një kandidat është i përshtatshëm apo jo për t’u punësuar, mund t’i kërkohet të këshillojë një oficer pas një incidenti kritik, mund t’i kërkohet të bëjë një vlerësim mbi përputhjen e aftësive të policit me punën e tij, mund t’i kërkohet të përcaktojë nëse një oficer është apo jo i përshtatshëm për detyrën e cila mund të rezultojë edhe në një rekomandim për lirim të oficerit nga detyra (Shiko Diagramin 1: *Specialiteti i Psikologjisë Policore*) (Thomas, 2011).



Diagrami 1. Specialiteti i Psikologjisë Policore (Thomas, 2011).

Personaliteti i policit

Nuk ka një të dhënë bindëse për origjinat e personalitetit të policit, por të dhënat kërkimore sugjerojnë që një “personalitet” i tillë ekziston dhe se policët ndryshojnë nga grupet e tjera të profesioneve (Bull et al., 2009).

Perspektiva psikologjike

Sipas perspektivës psikologjike, personaliteti është i fiksuar dhe nuk ndryshon shumë nga zgjedhjet profesionale apo përvojat personale. Pra, secili person ka një personalitet bazë që qëndron statik përgjatë jetës (Adlam, 1982). Bazuar në këtë perspektivë është zhvilluar edhe modeli i predispozicionit të sjelljes së policisë. Sipas këtij predispozicioni, sjellja është e paracaktuar nga personaliteti statik (para ekzistues) që kanë njerëzit të cilët futen në profesionin e zbatimit të ligjit. Ky model i predispozicionit të sjelljes së policisë dhe perspektiva e personalitetit të fiksuar kanë bërë që

disa studiues të dalin në përfundimin se rekrutët e policisë janë më autoritarë se sa njerëzit që zgjedhin profesione të tjera. Personaliteti autoritar karakterizohet nga sjellje e matur, agresive, cinike dhe e ngurtë (Gaines & Kappeler, 2014).

Një nga konceptimet më ndikuese të personalitetit të policit është përshkrimi i Lefkowitz për psikologjinë e policit. Pasi studioi një mori ndryshorësh, ai arriti në përfundimin se polici nuk dallon nga grupet e tjera në termat e çrregullimeve psikologjike ose të inteligjencës, por ai, gjithashtu, sugjeroi se ka dallime të tjera të rëndësishme. Sipas Lefkowitz (1975), ekziston një grup tiparësh dhe qëndrimesh ose një perspektivë e përgjithshme për botën të cilat karakterizojnë policin. Ky grup përfshin tipare të ndërthurura, si: autoritarizmi, dyshimi, guximi fizik, cinizmi, besnikëria, konservatorizmi, të mbajturit e sekreteve, vetëkëmbëngulja (Lefkowitz, 1975). Tipare, si: autoritarizmi, dogmatizmi, konservatorizmi dhe cinizmi, duket se janë të pranishme në radhët e policisë, por, nëse kandidatët futen në shërbimin policor me një personalitet të tillë, apo është trajnimi i policisë që modelon sjelljen e oficerëve, kjo është e vështirë të përcaktohet. Të dhënat në dispozicion sugjerojnë se ndoshta ato rrjedhin më tepër nga trajnimi i policisë, se sa nga qëndrimet e njerëzve kur hyjnë në shërbimin policor. Studime të ndryshme kanë demonstruar se autoritarizmi zhvillohet ndërkohë që oficerët fitojnë më tepër përvojë në punë (Bull et al., 2009).

Ka kërkues që e shikojnë personalitetin si dinamik dhe të ndryshueshëm përgjatë përvojave jetësore individuale. Ata studiojnë se si trajnimi në polici, mjedisi i punës dhe kolegët ndikojnë dhe i japin formë personalitetit të oficerit të policisë dhe sjelljes së tij përgjatë kohës (Gaines & Kappeler, 2014).

Perspektiva sociologjike

Sipas perspektivës sociologjike, sjellja bazohet në socializmin në grup dhe profesionalizimin. Profesionalizimi është procesi me të cilin përvetësohen normat dhe vlerat ndërkohë që punonjësit mësojnë profesionin e tyre të ri. Proces i socializimit që përjetojnë policët ndikojnë në qëndrimet dhe vlerat e tyre (Gaines & Kappeler, 2014).

Edhe oficerët e policisë, ashtu sikundër të tjerët, kalojnë përmes stadeve të ndryshme të zhvillimit të personalitetit njerëzor dhe socializimit. Pasi dikush ka hyrë në shërbimin policor, vlerat dhe qëndrimet tashmë të formuara dhe të fuqizuara, mund të modifikohen nga procesi i vazhdueshëm i socializimit. Sapo një person bëhet oficer policie, ai përpiqet të përvetësojë vlerat që ka nevojë për të funksionuar si një oficer

policie i orientuar nga njerëzit. Ashtu sikundër familja dhe më vonë shkolla ndikon zhvillimin e tipareve të personalitetit dhe botëkuptimeve, institutet e trajnimit të policisë mund të ndikojnë të trajnuarit për të modifikuar qëndrimet dhe perspektivat ndaj ngjarjeve, çështjeve dhe individëve. Periudhat e hershme të trajnimit institucional kanë një ndikim të fortë në formimin e vlerave të reja, perspektivave sociale dhe tipareve të dëshirueshme të personalitetit. Sigurisht që socializimi dhe formimi i qëndrimeve i hyrjeve të reja në profesionin e policit përcaktohet nga disa faktorë të ndryshëm, si: normat e organizatës, vlerat dhe qëndrimet e trajnerëve, marrëdhënia trajnerë-i trajnuar, klima e përgjithshme e disiplinës që mbizotëron në institucion e trajnimit etj. Çdo modifikim në sjellje i shkaktuar nga instituti i trajnimit vazhdon të forcohet gjatë periudhës pas trajnimit në stacionet e policisë. Kjo ndodh përmes procesit të të nxënimit, komunikimit dhe vëzhgimit në terren (Vadackumchery & Kattakayam, 1995).

Perspektiva antropologjike

Ndryshimi më i madh në karakterin social të policit ndodh kur oficerët bëhen pjesë e kulturës profesionale. Termi kulturë shpesh përdoret për të përshkruar dallimet mes grupeve të mëdha sociale. Grupet sociale ndryshojnë në shumë aspekte dhe njerëzit nga kultura të ndryshme kanë besime, ligje, morale, zakone unike dhe karakteristika të tjera, që i dallojnë nga grupet e tjera. Këto qëndrime, vlera dhe besime, transmetohen nga njëri brez tek tjetri përmes një procesi të nxënimit të njohur si shoqërizim. Dallimet kulturore janë të lehta për t'u parë kur, për shembull, krahasohet kultura e Japonisë me atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Por mund të ketë dallime kulturore edhe midis njerëzve të së njëjtës kulture ose grupi social. Njerëzit që formojnë një grup unik brenda një kulture quhen anëtarë të një nënkulture. Dallimi mes kulturës dhe nënkulturës është se anëtarët e nënkulturës, ndërsa ndajnë shumë vlera dhe besime me kulturën e gjerë, kanë, gjithashtu, një grup vlerash të veçanta që i dallojnë nga të tjerët. Qartazi policia ndan trashëgiminë kulturore me anëtarët e tjerë të shoqërisë ku shërben, pasi flasin të njëjtën gjuhë, veprojnë nën të njëjtat ligje dhe ndajnë shumë nga vlerat e përbashkëta. Megjithatë, aspekte të caktuara të nënkulturës profesionale të policisë i dallojnë policët nga anëtarët e tjerë të shoqërisë. Polica është pjesë e veçantë nga grupet e tjera profesionale dhe nga anëtarët e shoqërisë, pasi kanë rol dhe status social unik (Dunham & Alpert, 2015).

Komponentë që ndikojnë zhvillimin e personaliteti të policit

Sipas Thomas (2011), personaliteti i policit ekziston, por ai nuk është i lindur. Ai zhvillohet përgjatë kohës duke nisur me trajnimin në akademi, përfundimin me sukses të programit të trajnimit në terren, ekspozimit konstant të thirrjeve për shërbime, ballafaqimit me publikun, kur ky i fundit ka nevojë, faktorët stresues të jashtëm (p.sh., paratë), politikat e agjencisë, kërkesat familjare, presioni i kolegëve, ndjenja e detyrës ndaj komunitetit dhe kolegëve, preokupimet etike dhe marrja e vendimit dhe përgjatë këtyre nevojave për të mbrojtur veten (Thomas, 2011).



Diagrami 2. Komponentët që ndikojnë zhvillimin e personalitetit të policit (Thomas, 2011).

Pavarësisht nëse ekziston apo jo “personaliteti i policit”, duket qartazi se procesi gjatë së cilës dikush bëhet një oficer policie prodhon ndryshime për të cilat edhe vetë policët nuk janë të ndërgjegjshëm (Howitt, 2009). Kërkimet tregojnë se oficerët e policisë nuk posedojnë ekstreme patologjike të personalitetit. Shumica e studimeve tregojnë se si grup, ata janë “normalë” ose “të shëndetshëm” në aftësitë e tyre për t’u përshtatur (Greene et al., 2006). Arsyeet se përse njerëzit zgjedhin t’u bashkohen shërbimeve policore dhe motivet e tyre të brendshme në këtë fushë janë akoma duke u studiuar. Arsyeet se përse disa oficerë mbeten dhe zhvillohen në shërbim për

një karrierë të plotë ndërsa të tjerë e braktisin, nuk janë të qarta akoma. Kërkimet për ekzistencën e mundshme të “personalitetit të policit” janë të rëndësishme, pasi ndihmojnë në përcaktimin se cili kandidat për oficer do të përshtatej më mirë me detyra të caktuara, si dhe cili mund të përballojë faktorë të caktuar të stresit. Nuk ka një të dhënë bindëse për origjinat e personalitetit të policit, por të dhënat kërkimore sugjerojnë që një “personalitet” i tillë ekziston dhe se policët ndryshojnë nga grupet e tjera të profesioneve (Bull et al., 2009).

BIBLIOGRAFIA:

1. Adlam, K. R. (1982). The Police Personality: Psychological Consequences of Becoming a Police Officer. *Journal of Police Science and Administration* , 10 (3), 347–348.
2. Arrigo, B. A., & Shipley, S. L. (2005). *Introduction to forensic psychology: Issues and controversies in crime and justice* (bot. i 2nd). Academic Press.
3. Barker, T., & Carter, D. L. (1994). *Police Deviance* (bot. i 3rd). Cincinnati, OH: Anderson Publishing.
4. Brown, J.M., & Campbell, E.A. . (1994). *Stress and policing: Sources and strategies*. New York, NY: John Wiley & Sons.
5. Bull, R., Bilby, C., Cooke, C., & Grant, T. (2009). *Criminal psychology: A beginner's guide*. Oneworld Publications.
6. Dunham, R. G., & Alpert, G. P. (2015). *Critical issues in policing: Contemporary readings*. Waveland Press.
7. Fulero, S. M., & Wrightsman, L. S. (2008). *Forensic psychology*. Cengage Learning.
8. Gaines, L. K., & Kappeler, V. E. . (2014). *Policing in America*. Routledge.
9. Greene, E., Heilbrun, K., Fortune, W., & Neitzel, M. (2006). *Wrightsman's psychology and the legal system*. Cengage Learning.
10. Howitt, D. (2009). *Introduction to forensic and criminal psychology*. Pearson Education.
11. Kitaeff, J. (2011). *Handbook of police psychology*. Routledge.
12. Lefkowitz, J. (1975). Psychological attributes of policemen: A review of research and opinion. *Journal of Social Issues* , 31 (1), 3-26.
13. Pozzulo, J., Forth, A. E., & Bennell, C. (2018). *Forensic psychology*. Pearson Prentice Hall. 5th edition (bot. i 5th). Pearson Prentice Hall.
14. Shipley, S. L., & Arrigo, B. A. (2012). *Introduction to forensic psychology: Court, law enforcement, and correctional practices* (3rd ed.). Academic Press.
15. Terman, L. M., Otis, A. S., Dickson, V., Hubbard, O. S., Norton, J. K., Howard, L., & Casingham, C. C. (1917). A trial of mental and pedagogical tests in a civil service examination for policemen and firemen. *Journal of Applied Psychology*, 1(1), , 17-29.
16. Thomas, D. J. (2011). *Police Psychology: A New Specialty and New Challenges for Men and Women in Blue*. ABC-CLIO.
17. Vadackumchery, J., & Kattakayam, J. (1995). *Human behaviour and law enforcement*. APH Publishing.
18. Violanti, J. M., & Marshall, J. R., (1983). The police stress process. *Journal of Police Science and Administration* , 11, 389-294

STRATEGJITË E PËRBALLIMIT TË BULLIZMIT KIBERNETIK DHE SIMPTOMAT DEPRESIVE TEK ADOLESHENTËT E QYTETIT TË SHKODRËS

Elona Hasmujaj

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, epartamenti Psikologji-Punë Sociale

ABSTRAKT

Bullizmi kibernetik është përcaktuar si një fenomen që përfshin sjellje agresive, të qëllimshme dhe të përsëritura në kohë, që kryhen përmes mjeteve elektronike nga një ose disa individë kundrejt një të treti.

Ky studim ka për qëllim të përcaktojë nëse ky fenomen është i pranishëm edhe tek adoleshentët e qytetit të Shkodrës, si dhe cilat janë disa nga strategjitë që ata përdorin për t'u përballur me bullizmin kibernetik. Një tjetër qëllim është të verifikohet, nëse ekziston, një marrëdhënie mes strategjive të përballimit të bullizmit kibernetik me simptomat depresive dhe cila nga këto strategji parashikon më pak shfaqjen e tyre. Për realizimin e këtij studimi u përdor metoda sasiore. Të dhënat u mbledhën përmes instrumentëve matës, përfshirë këtu Pyetësorin mbi Strategjitë e Përballimit të Bullizmit Kibernetik (CWCBQ) dhe Inventarin e Depresionit të Beck (BDI).

Nëpërmjet kampionimit joprobabilitar të qëllimtë, u përzgjedhën 180 adoleshentë të disa prej shkollave të mesme të qytetit të Shkodrës të moshës 15 – 18 vjeç, nga ku $n = 61$ janë meshkuj dhe $n = 119$ janë femra. Rezultatet e analizës përshkruese treguan se ky fenomen është i pranishëm në 27% të respondentëve. Rezultatet e analizës korrelacionale treguan një lidhje të moderuar pozitive dhe statistikisht domethënëse midis strategjive të përballimit të bullizmit kibernetik dhe simptomave të depresionit. Po ashtu, përmes regresionit u arrit të zbulohet se disa strategji të përballimit si p.sh., të kërkuarit ndihmë të specializuar tek profesionistët, parashikojnë më pak shfaqjen e simptomave të depresionit tek adoleshentët, në krahasim me disa strategji të tjera. Këto rezultate mund të shërbejnë si pikënisje për studime më të gjera me të njëjtin fokus, ku për të identifikuar target grupet më të rrezikuara dhe për të hartuar programe të parandalimit dhe trajtimit psikologjik, mund të nevojiten studime longitudinale ose të natyrës cilësore fenomenologjike.

Fjalë kyçe: bullizëm kibernetik, strategji të përballimit, depresion, adoleshentë.

Cyberbullying coping strategies and symptoms of depression among adolescents of Shkoder City

ABSTRACT

Cyberbullying is defined as a phenomenon that involves aggressive, intentional act, carried out by a group or individual, using electronic forms of contact, repeatedly and over time against a victim. The first purpose of this study is to find out if this phenomenon is present among adolescents of the city of Shkoder, as well as to identify some of the strategies they use to deal with cyberbullying. Another purpose was to investigate the relationship between cyberbullying coping strategies and depressive symptoms and which of these strategies predict lower levels of depressive symptoms. Quantitative method was used to conduct this study. Data was collected from assessment measures, including the Cyberbullying Coping Strategies Questionnaire (CWCBQ) and the Beck Depression Inventory (BDI).

In a non-probability purposive sample, we selected 180 adolescents from some of the high schools in the city of Shkoder, aged from 15 - 18, where $n = 61$ were male and $n = 119$ were female. The descriptive analysis results showed a prevalence of 27 % of the phenomenon. The results of the correlation analysis showed that there is a moderate positive and significant relationship between coping strategies of cyberbullying and depressive symptoms. The regression results also indicated that some coping strategies such as seeking professional help was less likely to predict depressive symptoms in adolescents, compared to some other strategies. The findings from the current study will serve as a starting point for more extensive studies with the same focus. To identify the most vulnerable target groups, to develop appropriate interventions and prevention psychological programs, *are required* to conduct longitudinal or qualitative phenomenological studies.

Keywords: cyber bullying, coping strategies, depression, adolescents.

1. Hyrje

Studimet e kohëve të fundit janë përqendruar mbi një formë të re të bullizmit, që shfaqet si efekt anësor i përdorimit të internetit dhe mjeteve të tjera të komunikimit elektronik dhe që njihet me emrin si

bullizëm kibernetik.

Një përkufizim i përdorur gjerësisht nga Olweus dhe Limber (2010) është ai që e përcakton bullizmin dhe viktimizimin kibernetik si persekutim, frikë ose nënshtrim të përsëritur në kohë dhe që karakterizohet nga një mosbarazi në forcë mes viktimës dhe agresorit.

Si një analog i bullizmit tradicional, bullizmi kibernetik, mund të jetë shumë i dëmshëm, sepse përdoruesit më fanatikë të internetit janë pikërisht fëmijët dhe adoleshentët (Cappadocia dhe të tjerë, 2013). Studimet tregojnë se madje bullizmi kibernetik mund të jetë më i rëndë (siç perceptohet nga viktimat) sesa ai tradicional, për shkak të publikimit, shpesh të pashmangshëm, të sulmeve në internet (Sticca dhe Perren, 2013). Audiencia e pakufizuar në internet nga njëra anë dhe pamundësia për të ushtruar kontroll mbi sulmet e vazhdueshme nga ana tjetër, mund të shoqërohen me pasoja serioze psikologjike tek viktimat dhe, në rastet më të rënda, mund të degradojë deri në depresion madhor apo akte të vetëvrasjes (Bonanno dhe Hymel, 2013).

Është vërtetuar se të qenit viktimë e bullizmit kibernetik nga bashkëmoshatarët shoqërohet me pasoja negative afatshkurtra dhe afatgjata në shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve. Viktimat e bullizmit kibernetik përjetojnë emocione negative, të tilla si: zhgënjim, zemërim, pashpresmëri dhe trishtim (Juvonen dhe Gross, 2008). Si pasojë, viktimat e bullizmit në internet, kanë një nivel më të lartë depresioni dhe ankthi, si dhe karakterizohen nga një vetëvlerësim më i ulët në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre që nuk kanë rënë pre e ngacmimeve të vazhdueshme në internet (Hay dhe Meldrum, 2010).

Ndërsa, strategjitë e përballimit, u referohen përpjekjeve sjellore e konjitive për 'të luftuar' me stresorët e jashtëm (Lazarus dhe Folkman, 1984). Këto strategji luajnë një rol të rëndësishëm në mirëqenien fizike dhe psikologjike të një individi kur ai ose ajo përballet me ngjarje negative ose stresuese të jetës së përditshme (Endler dhe Parker, 1990). Stilet e veçanta të përballimit mund të përmirësojnë ose të rëndojnë shëndetin mendor dhe fizik të personave dhe, për këtë arsye, grupohen në dy kategori të mëdha: strategji të trajtimit të problemit dhe strategji të shmangies. Strategjitë e trajtimit përbëjnë një përpjekje të drejtpërdrejtë për të ndryshuar situatën stresuese, duke u përfshirë në zgjidhjen e problemeve dhe kërkimin e mbështetjes sociale. Ndërsa, ato të shmangies, janë përpjekje indirekte për të mënjeluar stresorët, ku përfshihen distancimi, brendësimi dhe shfaqja e problemit në një mënyrë të papërshtatshme (Kochenderfer-Ladd dhe Skinner, 2002).

Studimet e fundit kanë zbuluar se viktimat e bullizmit kibernetik që përdornin strategji të shmangies së kontaktit me agresorët ishin më të prirura të shfaqnin simptoma depresive në krahasim me ata që përdornin strategji të përballimit (Völlink dhe të tjerë, 2013).

Mbështetja e perceptuar sociale është një tjetër strategji që viktimat mund të përdorin në përballjen e tyre me bullizmin kibernetik. Viktimat e sulmeve të vazhdueshme që perceptojnë pak mbështetje sociale nga familjarë, miq, ose të tjerë të rëndësishëm në jetën e tyre, është zbuluar se kanë më shumë të ngjarë të vuajnë pasoja afatgjata, si: depresion, ankth dhe karakterizohen nga një vetëbesim i ulët (Matsunaga, 2010).

Disa lloje të strategjive të përballimit janë studiuar në lidhje me përvojat e të qenit viktimë e bullizmit kibernetik, ku përfshihen: strategjitë mbështetëse (p.sh., kërkimi i mbështetjes sociale nga të rriturit, mësuesit, miqtë ose institucionet e tjera), reagimet ndaj sulmeve kibernetike (p.sh., hakmarrja, konfrontimi), strategjitë teknike (p.sh., raportimi i abuzimit, fshirja e mesazheve apo bllokimi i dërguesit), shmangia dhe strategjitë e përqendruara në emocione (p.sh., të mos bësh asgjë, të injorosh, të ndihesh i lodhur dhe i pafuqishëm) (Pouwelse dhe të tjerë 2011).

Qëllimi i parë i këtij punimi është të përcaktojë shtrirjen e viktimizimit kibernetik në radhët e subjekteve të studimit. Një tjetër qëllim është të përcaktojë shtrirjen e strategjive të përballimit të bullizmit kibernetik dhe të identifikojë se cila prej tyre parashikon më pak shfaqjen e simptomave të depresionit tek ky target grup.

1.1 Pyetje kërkimore

1. Si paraqitet niveli i viktimizimit kibernetik tek adoleshentët e qytetit të Shkodrës?
2. Cilat janë strategjitë e përballimit që përdorin më shpesh viktimat?
3. A ekziston një marrëdhënie mes strategjive të përballimit me simptomat depresive?
4. Cila nga strategjitë e përballimit parashikon nivel më të ulët të simptomave depresive?

2. Metodologjia

2.1 Dizajni i kërkimit

Ky studim mbështetet mbi parimet e dizajnit sasior përshkrues dhe korrelacional, si dhe është në përputhje me modelin e kërkimit shkencor, të planifikuar për të shpjeguar marrëdhënien mes strategjive të përballjes së bullizmit kibernetik me simptomat e depresionit tek adoleshentët e qytetit të Shkodrës.

2.2 Kampioni

Për shkak të gjendjes së pandemisë, përzgjedhja e kampionit u realizua duke përdorur tekniken joprobabilitare, të qëllimtë. Kampioni përbëhet nga 180 subjekte, ku 40% (n = 61) janë meshkuj dhe 60% (n = 119) janë femra. Subjektet e studimit bëjnë pjesë në intervalin moshor 15 deri në 18 vjeç, me një moshë mesatare prej $M = 16.3$ dhe $DS = 1.08$. Adoleshentët janë nxënës të shkollave të mesme “28 Nëntori”, “Oso Kuka”, “Jordan Misja”, “Pjetër Mëshkalla” të qytetit të Shkodrës, ku përsë cilën shkollë janë përzgjedhur nga 45 nxënës.

2.3 Instrumentët

A. Pyetje filtruese: “A jeni ngacmuar përmes internetit përgjatë dy muajve të fundit (marrje e mesazheve ofenduese, fotove, videove kërcënuese ose injorimit nga të tjerë përdorues të internetit)?” Respondentët duhet t’u përgjigjen njëres nga alternativat: 1 = asnjëherë; 2 = një ose dy herë; 3 = disa herë; 4 = shpeshherë.

B. *Coping with Cyberbullying Questionnaire (CWCBQ)* (Sticca et.al, 2015).

Ky pyetësor përfshin 36 pyetje me 5 pikë të shkallës Likert që synojnë të vlerësojnë strategjitë e ndryshme të përballimit të bullizmit kibernetik që përdorin subjektet e studimit. Pra, ata duhet të përgjigjen sipas një shkallë nga 1 = kurrë, 2 = herë pas here, 3 = shpesh, 4 = shumë shpesh dhe 5 = pa përgjigje. Versioni aktual i CWCBQ përfshin 7 nënshkallë, ku secila prej tyre përbën një strategji të veçantë të përballimit (d.m.th., ndihmë e specializuar, suport nga të afërm, vetëfajësim, shmangie, hakmarrje, përballje dhe zgjidhje teknike). Koeficienti alfa i Cronbach për këtë pyetësor rezulton të jetë i lartë ($\alpha = .916$).

C. *Inventari i Depresionit i Beck (BDI)* (Beck, 1996).

Është një pyetësor me 21-pyetje me 4 pikë të shkallës Likert, një nga testet më të përdorura psikometrike për matjen e ashpërsisë së depresionit. Zhvillimi i tij ka shënuar një ndryshim të rëndësishëm në përcaktimin e depresionit nga psikologët, pasi deri atëherë e shihnin nga një perspektivë thjesht psikodinamike.

BDI është projektuar për individët mbi moshën 13 vjeç dhe përbëhet nga pohime në lidhje me simptomat e depresionit, si: mungesë e shpresës, nervozizëm, faj, ndjenjat e të qenit të papërshtatshëm dhe simptoma fizike, të tilla si: lodhje, humbje peshe, pagjumësi apo gjumë i tepërt etj. Pikët minimale që mund të grumbullojë një subjekt janë 0 dhe pikët maksimale janë 63. Koeficienti alfa i Cronbach për këtë pyetësor rezulton po ashtu i lartë ($\alpha = .943$).

2.4 Procedura e studimit

Si fillim u procedua me gjetjen, përkthimin dhe përshtatjen e instrumentëve të studimit. Testi mbi Strategjitë e Përballimit (CWCBQ) dhe Inventari i Depresionit nga Beck (BDI) u morën nga interneti dhe iu nënshtruan më vonë procesit të përkthimit dhe ripërkthimit nga gjuha angleze në shqip dhe anasjelltas.


Pyetësorët si fillim u pilotuan në 30 adoleshentë të disa prej shkollave të mesme të qytetit të Shkodrës. Para se të fillohej me aplikimin e pyetësorëve tek kampioni final, të gjithë nxënësit pjesëmarrës morën udhëzimet përkatëse dhe u informuan në lidhje me qëllimet e studimit, lirshmërinë për të qenë pjesëmarrës si dhe çështje të tjera të etikës, si: anonimati, privatësia, qëllimi i përdorimit të informacionit të marrë prej tyre etj. Koha për plotësimin e pyetësorëve varionte nga 15-20 minuta. Administrimi i pyetësorëve dhe procesi i mbledhjes së të dhënave u realizua në muajt shtator - tetor 2020. Menjëherë pas mbledhjes së pyetësorëve u procedua me hedhjen e të dhënave në programin kompjuterik SPSS-23, ku, pas pastrimit nga vlerat ekstreme, ato iu nënshtruan analizave statistikore në përputhje me hipotezat dhe pyetjet kërkimore të studimit.

3. Rezultatet e studimit

3.1 Të dhëna përshkruese

Përsa i përket pyetjes nëse janë ngacmuar përgjatë dy muajve të fundit në internet, nga Figura 1, vihet re se 32% e kampionit raportojnë se nuk janë ngacmuar asnjëherë, 41% e tyre një ose dy herë, 17% disa herë dhe raportojnë të jenë ngacmuar shpeshherë 10% e tyre.

Figura 1. Shtrirja e nivelit të ngacmimit përmes internetit e shprehur në %.



Analizave të tjera statistikore iu nënshtruan 27% (n = 49) e kampionit të adoleshentëve (n = 180), që raportuan ngacmime përgjatë dy

muajve të fundit nga “disa herë” në “shpeshherë”.

Përsa i përket nivelit të përdorimit të strategjive të përballimit të bullizmit kibernetik, siç shihet edhe nga Figura 2, shtrirjen më të lartë e ka strategjia e kërkimit të ndihmës së specializuar [M = 10.6, SD = 3.6], e ndjekur nga strategjia e suportit emocional nga të afërm [M = 9.7, SD = 3.8], ajo e zgjidhjeve teknike [9.7, SD = 2.9] dhe me shtrirje më të ulët rezultojn strategjia e vetëfajësimit [M = 8.8, SD = 3.5]. Megjithatë, vlen të theksohet që diferenca e mestareve mes tyre është shumë e vogël.




Figura 2. Mesatarja e strategjive të përballimit të bullizmit kibernetik.

3.2 Marrëdhënia mes strategjive të përballimit të bullizmit kibernetik me simptomat e depresionit

Nisur nga Tabela 1, rezultatet e kësaj analize sugjerojnë një korrelacion pozitiv, të një niveli mesatar dhe statistikisht domethënës mes CWCBQ dhe simptomave të depresionit ($r = .501^{**}$, $n = 180$, $p < .01$). Po ashtu, vihet re një marrëdhënie e një niveli të moderuar, por statistikisht domethënëse edhe mes nënshkallëve të CWCBQ me depresionin, përkatësisht me kërkimin e ndihmës ($r = .337^{**}$, $n = 180$, $p < .01$); me suportin ($r = .490^{**}$, $n = 180$, $p < .01$); me hakmarrjen ($r = .435^{**}$, $n = 180$, $p < .01$); me përballimin ($r = .393^{**}$, $n = 180$, $p < .01$); me shmangien ($r = .428^{**}$, $n = 180$, $p < .01$); me vetëfajësimin ($r = .470^{**}$, $n = 180$, $p < .01$); dhe me zgjidhjet teknike ($r = .378^{**}$, $n = 180$, $p < .01$); depresionit.

Tabela 1. Koeficientët e korrelacionit të Pearson për variablat e studimit.

Koeficientët e korrelacionit Pearson									
	CWCBQ	Kërkim ndihmë	Suport	Hakmarrje	Përballje	Shmangie	Vetëfajësim	Zgjidhje teknike	Depresion
CWCBQ	1	.840**	.919**	.874	.833	.856	.865**	.779*	.501**
Kërkim ndihmë		1	.763**	.633**	.743**	.625*	.664**	.657*	.337**
Suport			1	.741**	.696**	.734*	.788**	.662*	.490**
Hakmarrje				1	.720**	.802*	.686**	.574*	.435**
Përballje					1	.621*	.646**	.789*	.393**
Shmangie						1	.699**	.576*	.428**
Vetëfajësim							1	.725*	.470**
Zgjidhje teknike								1	.378**
Depresion									1

**Korrelacioni është domethënës në nivelin 0.01 (2-drejtimësh).

Nga rezultatet mund të vihet re që adoleshentët të cilët përdorin strategjitë e ndërhyrjeve konkrete, si: kërkimi i ndihmës së specializuar, ata që përballen me agresorin dhe që aplikojnë zgjidhje teknike të problemit, shënojnë nivele më të ulëta të korrelacionit me simptomat e depresionit.

3.3 Strategjitë e përballimit të bullizmit kibernetik si parashikuese të simptomave të depresionit

Analiza e regresionit linear të shumëfishtë përlllogaritet me strategjitë

e bullizmit kibernetik si variabël parashikues dhe me simptomat depressive si variabël i varur.

Rezultatet e regresionit gjithashtu tregojnë se përdorimi i disa strategjive të përballimit të bullizmit, i parashikon më pak simptomat depressive në krahasim me disa strategji të tjera. Kështu p.sh., kërkimi i ndihmës së specializuar e parashikon depresionin në masën 11.3% $\{R^2 = .113, F(1,179) = 22,775, p < .001\}$; suporti në masën 24% $\{R^2 = .24, F(1,179) = 56,139, p < .001\}$; hakmarrja në masën 18.9% $\{R^2 = .189, F(1,179) = 41,468, p < .001\}$; përballimi me agresorin në masën 15.5% $\{R^2 = .155, F(1,179) = 32,555, p < .001\}$; shmangia në masën 18.3% $\{R^2 = .183, F(1,179) = 39,874, p < .001\}$; vetëfajësimi në masën 22.1% $\{R^2 = .221, F(1,179) = 50,465, p < .001\}$; zgjidhjet teknike të problemit në masën 14.3% $\{R^2 = .143, F(1,179) = 29,677, p < .001\}$. Sipas të dhënave, të gjitha rezultatet janë statistikisht të rëndësishme ($p < .001$).

Duke iu referuar serisë së regresioneve lineare të ndryshoreve të studimit, mund të konkludohet se depresioni parashikohet shumë pak nga strategjia e kërkimit të ndihmës tek profesionistët dhe nga ajo e zgjidhjeve teknike të problemit dhe, nga ana tjetër, më shumë parashikohet nga strategjia e suportit nga familjarë dhe nga të afërm dhe nga strategjia e vetëfajësimit. E thënë me fjalë të tjera, adoleshentët që kërkojnë ndihmë të specializuar përjetojnë më pak simptoma depressive, ndërsa ata të cilët mbështeten tek të afërmit dhe e fajësojnë veten për ngacmimet e pësuar, janë të prirur të përjetojnë një nivel më të lartë të simptomave depressive.

Tabela 2. Analiza e regresionit linear të shumëfishtë me strategjitë e përballimit si variabla parashikues.

Modeli	Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientët e standardizuar	t	r ²	p
	B	Gabimi standard	Beta			
Kërkim i ndihmës	1.115	.234	.337	4.78	.113	.000
Suport	1.463	.195	.490	7.49	.240	.000
Hakmarrje	1.301	.202	.435	6.44	.189	.000
Përballim	1.488	.261	.393	5.71	.155	.000
Shmangie	1.218	.193	.428	6.32	.183	.000
Vetëfajësim	1.531	.216	.470	7.11	.221	.000
Zgjidhje teknike	1.431	.263	.378	5.48	.143	.000

a Parashikues: (Konstant) Strategjitë e përballimit të bullizmit kibernetik.

b Variabli i varur: Simptomat e depresionit.

3. Diskutime

Përqindja e pjesëmarrësve viktime të bullizmit kibernetik (27%) është më e lartë sesa e studimeve të tjera në lidhje me këtë temë, që raportojnë një prevalencë prej rreth 23% (Beran dhe Li, 2005). Sidoqoftë, hulumtimet më të fundit, gjithashtu, kanë treguar për një rritje të shtrirjes së këtij fenomeni (Calvete dhe të tjerë, 2015). Këto ndryshime mund të shpjegohen me përhapjen e shpejtë të teknologjisë midis adoleshentëve, gjë që i bën ata më të prekshëm nga ky lloj agresiviteti. Një fakt tjetër, i cili duhet të merret në konsideratë, është edhe evolucioni në fushën kërkimore përsa i përket bullizmit kibernetik, gjë që ka ndikuar edhe në avancimin e instrumentëve matës apo metodave të tjera të grumbullimit të të dhënave.

Studimi evidentoi edhe strategjinë më të përdorur të përballimit të bullizmit kibernetik nga adoleshentët, që ishte pikërisht kërkimi i ndihmës nga organet kompetente ose nga profesionistët e tjerë me të cilët fëmija kishte kontakt, si: drejtori, mësuesit kujdestarë, psikologu i shkollës etj. Po ashtu, kjo strategji parashikonte më pak shfaqjen e simptomave të depresionit në krahasim me të gjitha strategjitë e tjera.

Biseda me miqtë ose prindërit mund të jetë një nga idetë e para që të vjen në mendje kur mendon se çfarë mund të bëjmë kur përballemi me ngacmimin apo persekutimin e vazhdueshëm nga të tjerët. Për më tepër, adoleshentët theksojnë që personat e rëndësishëm për ta janë të gatshëm për t'i ndihmuar, janë të besueshëm dhe i marrin seriozisht incidente të tilla (Hinduja dhe Patchin 2007; Smith dhe të tjerë, 2008). Megjithatë, në studimin tonë, është e rëndësishme të theksohet se mbështetja na shfaqet e lidhur më fort me simptomat depresive nga të gjitha strategjitë e tjera të përballimit. Ndoshta kjo shpjegohet me faktin se nganjëherë nuk mjaftojnë vetëm fjalët ngushëlluese dhe mbështetja emocionale e prindërve apo miqve, por adoleshentëve mund t'u nevojitet ndihmë instrumentale nga profesionistë të mirëfilltë të fushës, në mënyrë që të përballen me trishtimin, frikën apo frustrimin. Por, një tjetër arsye, mund të jetë edhe që prindërit kanë tendencë të nënvlerësojnë seriozitetin e problemeve që vijnë nga teknologjia e re, një aspekt pak i njohur nga ata dhe që mund t'i pengojnë t'u japin mbështetjen e duhur fëmijëve të tyre. Në fakt, ky supozim mbështetet edhe nga Slonje dhe Smith (2008) të cilët raportojnë se të rriturit janë më pak të vetëdijshëm për viktimizimin kibernetik dhe nuk e shohin atë si një kërcënim real. Ose mund të jenë vetë fëmijët që nuk flasin me prindërit dhe të afërmit e tyre nga frika se mund të ndihen të pakuptuar, pasi, sipas tyre, prindërit nuk ia kanë idenë sesi funksionon realiteti kibernetik. Një konstatim i tillë mbështetet edhe nga Campbell (2005). Një arsye tjetër pse viktimat e ngacmimit në internet mund të shmangin mbështetjen, për shembull te miqtë e tyre, është mendimi që nuk mund të

bëjë askush asgjë për ta parandaluar atë që po ndodh (Mishna dhe të tjerë, 2009).

Strategjia e vetëfajësimit, po ashtu rezulton e lidhur më fort me simptomat e depresionit në krahasim me shtrategjitë e tjera dhe ky rezultat është në përputhje me hulumtimet mbi strategjitë e përballimit shmangës (Seiffge-Krenke dhe Klessinger 2000), që zbuluan se reagimet e pafuqisë (inJORimi, tërheqja dhe vetëfajësimi) lidhen pozitivisht me simptomat depressive. Tendenca e adoleshentit për të fajësuar veten mund të jetë gjithashtu e lidhur ngusht me dështimin për ta kontrolluar teknikisht ngacmimin, me reagimet e papërshtatshme të prindërve ose me mendimin që të tjerët nuk mund t'i ndihmojnë. Po ashtu, audienca më e madhe, e cila karakterizon hapësirën kibernetike, mund të rrisë ndjenjat e pafuqisë dhe të turpfit tek viktimat.

Strategjia e zgjidhjeve teknike, po ashtu, përdoret shumë nga subjektet e studimit dhe parashikon më pak shfaqjen e simptomave depressive. Fshirja e agresorit nga listat e kontakteve dhe bllokimi i tij janë dy nga sjelljet që shoqërojnë më shpesh përdorimin e kësaj teknike. Megjithatë mund të shoqërohet edhe më sjellje më “radikale”, të tilla si: ndryshimi i emrit të përdoruesit/ numrit të telefonit ose fshirja e profilit të tij në rrjetet sociale. Në bazë të rezultateve të këtij studimi, po ashtu rekomandohet përdorimi i strategjive teknike. Ne e pranojmë që disa nga këto strategji përbëjnë ndryshime relativisht të mëdha në zakonet e jetës së përditshme dhe të rinjtë mund të ngurojnë që të kufizojnë aktivitetet në internet, pasi dihet rëndësia që kanë marrëdhëniet e krijuara aty, por në rastet kur ngacmimi në internet zhvillohet në një mjedis të veçantë (p.sh., në një rrjet social), duke lënë këtë mjedis, atëherë mund të kemi edhe një zgjidhje teknike të problemit. Kështu, viktimat pushon së qeni i ekspozuar ndaj materialeve lënduese. Ky konstatim mbështetet edhe nga autorët Subrahmanyam dhe Šmahel (2011).

Shmangia po ashtu është një ndër strategjitë që përdoret më shpesh dhe që parashikon një nivel më të lartë të simptomave depressive në krahasim me disa strategji të tjera. Në pamje të parë mund të na duket e ngjashme me strategjinë e zgjidhjeve teknike, pasi të dyja përfshijnë “izolimimin” nga agresori. Por nëse në rastin e zgjidhjeve teknike viktimat e merr situatën në dorë dhe kjo i jep njëfarë besimi që mund të ketë kontroll mbi të, në rastin e shmangies viktimat preferon të mos flasë, madje as të mendojë në lidhje me atë që po përjeton, pasi që kjo i shkakton dhimbje. Duke iu referuar teorisë psikoanalitike të Frojdit, ne e dimë që sa më tepër të mundohemi t'i shtypim emocionet negative, aq më me intensitet do të shfaqen ato, pavarësisht se në formë të maskuara, si në rastin konkret

përmes simptomave të depresionit. Holahan dhe kolegët e tij (2005) sugjeruan që përdorimi i strategjive të shmangies çon në nivele më të larta të stresit dhe të simptomave depressive.

Përballimi me agresorin është një tjetër strategji që përdoret më shpesh dhe nga ana tjetër parashikon një nivel më të ulët të simptomave të depresionit. Këto rezultate janë në kundërshtim me ato të studimit të kryer nga Machmutow dhe të tjerë (2012), të cilët sugjerojnë që çdo kontakt me agresorin, madje edhe konstruktiv qoftë, është i dëmshëm dhe duhet të shmanget për të zvogëluar efektet e mëtejshme negative të këtij fenomeni. Kontakti me ngacmuesin, duke i thënë se sjellja e tij është e papërshtatshme, mund ta zemërojë këtë të fundit, duke e bërë që të reagojë edhe agresivisht ndaj viktimës, duke qenë se zakonisht bullizmi karakterizohet nga një mosbarazi fuqie midis ngacmuesit dhe viktimës, shtojnë autorët. Një përfundim logjik do të ishte shmangia e çdo kontakti me ngacmuesin, me shpresën që ai do të humbasë motivimin e tij dhe, si përfundim, do të ndalojë ngacmimin. Por jo, me sa duket, adoleshentët në studimin tonë shmangien nuk e shohin si një mënyrë të mirë përballimi, madje ata shkojnë më tej, duke provuar edhe hakmarrjen ndaj viktimës.

Megjithatë, duhet të merren në konsideratë disa kufizime të studimit aktual. Fillimisht, këto rezultate nuk mund të përgjithësohen për të gjithë adoleshentët e qytetit të Shkodrës, sepse kampioni nuk është përfaqësues, duke qenë se përbëhet vetëm nga nxënës të katër shkollave të mesme dhe, për më tepër, të përzgjedhur me teknika joprobabilitare të kampionimit.

Një tjetër limit vjen nga kufizimi i instrumentëve me vetëraportimet, që limitojnë përgjigjet e thelluara në lidhje me një çështje të caktuar dhe, nga ana tjetër, duke qenë se mbështeten vetëm në perceptimet e pjesëmarrësve, saktësia e studimit mund të ndikohet nga vetëraportimet e pasakta apo perceptimet e gabuara. Po ashtu, pjesëmarrësit mund të përpiqen të shfaqen shoqërisht të dëshirueshëm, gjë që ndikon në besueshmërinë e instrumentëve.

Së fundi, një tjetër kufizim, janë pyetjet me natyrë retrospektive mbi veprimtari, sjellje dhe ndjesi të së shkuarës. Është vënë re se, për arsye kryesisht konjitive, që lidhen me aftësinë për të mbajtur mend, njerëzit janë të prirur të japin përgjigje të pasakta.

5. KONKLUZIONE

- Prevalenca e viktimizimit kibernetik tek subjektet e këtij studimi është 27% (n = 49).
- Strategjia e përballimit më e përdorur nga adoleshentët është kërkimi i ndihmës së specializuar tek profesionistët.
- Të gjitha strategjitë e përballimit rezultojnë të kenë një marrëdhënie pozitive të moderuar dhe statistikisht të rëndësishme me simptomat e depresionit (nga $r = .337^{**}$, $p < .01$ deri $r = .490$, $p < .01$).
- Më të predispozuar për të përjetuar simptoma të depresionit janë adoleshentët që përdorin strategjinë e suportit nga të afërmit ($R^2 = .24$, $p < .01$), të ndjekur nga ata që përdorin strategjinë e vetëfajësimit dhe pashpresmërisë ($R^2 = .22$, $p < .01$).
- Më pak të predispozuar për të përjetuar simptoma të depresionit janë ata adoleshentë që kërkojnë ndihmë të specializuar ($R^2 = .11$, $p < .01$), të ndjekur nga ata që përdorin zgjidhje teknike të problemit (si p.sh., bllokimi i agresorit apo fshirja e mesazheve të papërshtatshme) ($R^2 = .14$, $p < .01$). Pra, këto strategji, i parashikojnë më pak simptomat e depresionit në krahasim me strategjitë e tjera të përballimit.

6. REKOMANDIME

Rekomandime për komunitetin

- Të realizohen programe të përshtatshme informative, sensibilizuese ose trajnime me qëllim që individët të njihen me shenjat e riskut dhe identifikimin e bullizmit kibernetik.

Rekomandime për shkollat

- Programet e disa lëndëve me natyrë psiko-sociale duhet të ridimensionohen, duke vënë theksin edhe tek problematikën, që lindin si rezultat i zhvillimit të teknologjisë së re.
- Organizim i workshop-eve dhe seminareve të hapura në lidhje me parandalimin dhe reduktimin e pasojave negative të bullizmit kibernetik.

Rekomandime për profesionistët e ndihmës psikologjike

- Reklamimi si online ashtu edhe në komunitet i programeve mbi trajtimin e personave që vuajnë pasojat negative të përdorimit të teknologjisë së re.

- Psikologët shkollorë duhet të mbështesin adoleshentët për adresimin dhe menaxhimin e ngacmimeve që mund të marrin nga bashkëmoshatarë të tyre, përdorues të teknologjisë.
- Qendrat e këshillimit dhe shërbimeve psiko-sociale duhet të investojnë në zhvillimin e seminareve të programuara për të rritur ndërgjegjësimin e adoleshentëve, stafit akademik dhe komunitetit në tërësi për rreziqet që vijnë nga ngacmimi përmes mjeteve teknologjike.

Rekomandime për adoleshentët, familjarët dhe miqtë

- Adoleshentët për të kërkuar ndihmë, duhet të heqin dorë nga mendimi se mund t'ia dalin mbanë vetëm.
- Prindërit të përpiqen që të mos mbajnë qëndrim kritik ndaj sjelljes “së çuditshme” të fëmijëve të tyre.
- Miqtë duhet të nxisin viktimat e bullizmit kibernetik të shpenzojnë më shumë kohë me ta si dhe të angazhohen në aktivitete të përbashkëta sociale larg përdorimit të telefonit apo internetit.

REFERENCA

- Bonanno, R. & Hymel, Sh. (2013). Cyber Bullying and Internalizing Difficulties: Above and Beyond the Impact of Traditional Forms of Bullying. *Journal of Youth and Adolescence A Multidisciplinary Research Publication*, 42:685-697 DOI 10.1007/s10964-013-9937-1.
- Campbell, M. A. (2005). **Cyber bullying: An old problem in a new guise?** *Australian Journal of Guidance and Counselling*, 15 (2005), pp. 68-76.
- Cappadocia, M. C., Craig, W. M., & Pepler, D. (2013). Cyberbullying: Prevalence, stability, and risk factors during adolescence. *Canadian Journal of School Psychology*, 28(2), 171–192.
- Endler, N. S., & Parker, J. D. A. (1990). Multidimensional Assessment of Coping: A Critical Evaluation. *Journal of Personality and Social Psychology*, 58, 844-854 [Link].
- Hay, C., & Meldrum, R. (2010). Bullying victimization and adolescent self-harm: testing hypotheses from general strain theory. *Journal of youth and adolescence*, 39(5), 446–459.
- Hinduja, S., & Patchin, J. (in press). Cyberbullying: An exploratory analysis of factors related to offending and victimization. *Deviant Behavior*.
- Holahan, C.J., R.H. Moos, C.K. Holahan, P.L. Brennan, and K.K. Schutte. (2005). Stress generation, avoidance coping, and depressive symptoms: A

- 10-year model. *Journal of Consulting and Clinical Psychology* 73: 658-66.
- Juvonen, J., & Gross, E. F. (2008). Extending the school grounds? Bullying experiences in cyberspace. *Journal of School Health*, 78(9), 46–54.
 - Kochenderfer-Ladd, B. and Skinner, K. (2002) Children's Coping Strategies: Moderators of the Effects of Peer Victimization. *Developmental Psychology*, 38, 267-278 [Link].
 - Lazarus R. S., Folkman S. (1984). *Stress, Appraisal and Coping*. New York: Springer [Google Scholar].
 - Machmutow, K., Perren, S., Sticca, F., & Alsaker, F. D. (2012). Peer victimisation and depressive symptoms: Can specific coping strategies buffer the negative impact of cybervictimisation? *Emotional and Behavioural Difficulties*, 17, 403–420.
 - Matsunaga, M. (2010). Testing a mediational model of bullied victims' evaluation of received support and post-bullying adaptation: A Japan-US cross-cultural comparison. *Communication Monographs*, 77(3), 312-340. doi: 10.1080/03637751003758235.
 - Mishna, F., Saini, M., & Solomon, S. (2009). Ongoing and online: Children and youth's perceptions of cyber bullying. *Children and Youth Services Review*, 31(12), 1222–1228.
 - Olweus, D., & Limber, S. P. (2010). Bullying in school: Evaluation and dissemination of the Olweus Bullying Prevention Program. *American Journal of Orthopsychiatry*, 80(1), 124–134 [Link].
 - Pouwelse, M., Bolman, C., Lodewijkx, H., & Spaa, M. (2011). Gender differences and social support: Mediators or moderators between peer victimisation and depressive feelings? *Psychology in the Schools*, 48(8), 800–814.
 - Seiffge-Krenke, I and N. Klessinger. 2000. Long-term effects of avoidant coping on adolescents' depressive symptoms. *Journal of Youth and Adolescence* 29: 617-30.
 - Smith, P. K., Mahdavi, J., Carvalho, M., Fisher, S., Russell, S., & Tippett, N. (2008). Cyberbullying: Its nature and impact in secondary school pupils. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 49, 376–385.
 - Sticca, F., & Perren, S. (2013). Is cyberbullying worse than traditional bullying? Examining the differential roles of medium, publicity, and anonymity for the perceived severity of bullying. *Journal of Youth & Adolescence*, 42, 739-750. doi: 10.1007/s10964-012-9867-3.
 - Subrahmanyam, K., & Šmahel, D. (2011). *The Darker Sides of the Internet: Violence, Cyber Bullying, and Victimization Digital Youth* (pp. 179-199): Springer New York.
 - Völlink, T., Bolman, C.A.W., Dehue, F., & Jacobs, N.C.L. (2013). Coping

with cyberbullying: differences between victims, bully-victims and children not involved in Bullying. *Journal of Community and Applied Social Psychology*, 23, 7-24.

IMPAKTI I NDRYSHIMIT ORGANIZACIONAL NË PËRJETIMIN E NIVELIT TË STRESIT TEK PUNONJËSIT

Edvin Lame

*Universiteti i Tiranës, departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë,
Fakulteti i Shkencave Sociale,*

ABSTRAKT

Literatura pohon se ekziston një marrëdhënie midis ndryshimit organizativ dhe nivelit të stresit që përjetojnë punonjësit. Duke u mbështetur në këtë literaturë, ky studim kishte si objektiv kryesor të përcaktonte në qoftë se ka një marrëdhënie statistikisht të rëndësishme midis ndryshimit organizacional dhe stresit të punonjësve në bankën ProCredit Bank në Shqipëri. Një tjetër objektiv mbi studimin ishte të studionte diferencat midis nivelit të stresit tek punonjëset femra dhe tek punonjësit meshkuj. Për të realizuar këtë studim, 100 individë të moshës 25-55 vjeç, nga të cilët 50 ishin femra dhe 50 meshkuj, u përzgjedhën në mënyrë të qëllimshme në qytetin e Tiranës, konkretisht në bankën ProCredit. Metoda që u përdor ishte ajo sasiore. Pjesëmarrësit plotësuan dy instrumentet: instrumentin vetëraportues të ndryshimit organizacional (Garg, 2013) dhe instrumentin vetëraportues të stresit në punë (HSE, 2011). Nëpërmjet korrelacionit u vërtetua se ka një lidhje midis ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit në punë të punonjësve. Gjithashtu, rezultatet treguan se ka diferenca gjinore në përballimin e nivelit të stresit që vijnë si pasojë e ndryshimit organizacional. Këto rezultate mbështetën hipotezat e ngritura në fillim. Analiza nëpërmjet T-Test tregoi diferenca gjinore në nivelin e stresit në punë. Rekomandohet të kryhen studime të ngjashme në të gjithë Shqipërinë, për të verifikuar marrëdhënien midis variablave përkatës.

Fjalët kyçe: Ndryshimi organizacional, stresi në punë.

**The impact of organizational change on employee
experiencing stress levels.**

ABSTRACT

Literature claims that there is a relationship between the organizational change and the level of stress experienced by the employees. Based on this literature, this study had the main objective to determine whether there is a statistically significant relationship between organizational change and employee stress at the ProCredit Bank bank in Albania. Another objective of the study was to study the differences between the level of stress among female employees and male employees. To complete this study, 100 individuals aged 25-55, of whom 50 were female and 50 males, were deliberately selected in the city of Tirana, specifically at ProCredit Bank. The method used was the quantitative one. Two instruments were conducted: the self-reporting instrument of organizational change (Garg, 2013) and the self-reporting stress inventory tool (HSE, 2011). Through correlation, it was found that there is a link between organizational change and the level of work stress of the employees. Also, the results showed that there are gender differences in coping with the level of stress that comes as a result of organizational change. These results supported the hypotheses raised earlier. The T-Test analysis showed the gender difference at the work stress level. It is recommended to carry out similar studies across Albania to verify the relationship between the respective variables.

Key words: Organizational change, stress at work.

KAPITULLI I

Hyrja

Tendenca e ndryshimeve organizative po ndihet vazhdimisht në organizatat dhe kompanitë e ndryshme brenda Shqipërisë, por ashtu edhe jashtë saj. Shumë njerëz e pranojnë se ne po jetojmë në një kohë ndryshimi të madh të biznesit. Shumica e organizatave kanë pranuar se duhet “të ndryshojnë ose të vdesin”. Kjo tendencë ndryshimi ndihet prej vitesh. Ata që ndikojnë drejtpërdrejt nga ndryshimi organizativ janë punonjësit. Këtu nisi edhe ideja e realizimit të këtij studimi lidhur me ndryshimin organizativ që ndodh në kompani të ndryshme dhe përshtatjes së punonjësve gjatë ndryshimit organizativ.

Studimet lidhur me këtë fushë janë gjithnjë duke u rritur. Shpesh organizatat janë joefektive në menaxhimin e aspekteve psikologjike të ndryshimeve organizative. Si e perceptojnë punonjësit procesin e ndryshimit? Si mund të realizohet me sukses përshtatja e tyre me këtë proces? Studiuesi i njohur në fushën e sjelljes organizative, Chris Argyris ka thënë “Asgjë nuk ndryshon nëse nuk ndryshon sjellja”. Kotter është shprehur se gati 90% e iniciativave për ndryshim dështojnë të arrijnë objektivat e tyre strategjike, kryesisht për shkaqe që lidhen me faktorë njerëzorë, siç janë qëndrimet dhe sjelljet e lidhura me ndryshimin.

Sipas Armenakis, Harris dhe Mossholder (1993) qëndrimet e punonjësve rreth ndryshimeve organizative ndikojnë jo vetëm në suksesin e procesit, por edhe tek tregues të tjerë të rëndësishëm organizativë, siç janë: kënaqësia nga puna, produktiviteti, morali dhe largimi nga vendi i punës.

Ndryshimi organizativ është një nga burimet kryesore të stresit në punë, i cili mund të ketë efekt negativ mbi aspekte, të tilla si: kënaqësia në punë dhe gjendja psikologjike (Terry, 1996). Literatura tregon se efektiviteti i ulët i punonjësve që kanë më pak kënaqësi nga puna dhe moral më të ulët, mund të dëmtojë shumë aspekte të performancës organizative. Ndikimi i ndryshimeve organizative mbi përshtatjen e punonjësve po bëhet një fushë e rëndësishme kërkimi për shkak të kostos së lartë emocionale dhe financiare të punonjësve dhe organizatave kur ndryshimi nuk menaxhohet mirë.

Fokusi i studimit është sektori i shërbimeve financiare, konkretisht në një institucion bankar, ProCredit Bank Albania. Punonjësit në këtë bankë kanë kaluar ndryshime të rëndësishme organizative gjatë viteve të fundit. Banka është një institucion i përshtatshëm për të studiuar grupet me status të ndryshëm në kontekstin e ndryshimeve organizative. Në një organizatë të tillë pozicionet grupohen në mënyrë hierarkike sipas kualifikimeve dhe eksperiencës së punonjësve. Gjithashtu, ka dallime midis pozicioneve në degët lokale dhe pozicionet në zyrat qendrore. Punonjësit e bankës ProCredit Bank Albania janë përballur dhe po përballen me ndryshime të shumta në vendin e punës. Këto faktorë e bëjnë këtë bankë vendin e duhur për shqyrtimin e aspekteve të klimës organizative që mundësojnë përshtatjen e punonjësve gjatë ndryshimit.

Qëllimi i këtij studimi është: zbulimi i lidhjes midis ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit në punë. Ai fokusohet në identifikimin e ndryshimeve organizacionale dhe nivelit të stresit që përjetojnë punonjësit. Në këtë studim do të shqyrtohet diferenca që ekziston midis gjinive në përjetimin e nivelit të stresit që shkaktohet si pasojë e ndryshimeve organizacionale që ndodhin në punë. Gjithashtu, në këtë

studim do të hulumtohet lidhja korrelacionale midis ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit në punë.

Hipotezat e studimit:

Ky studim synon që të zbulojë dhe të analizojë marrëdhënien midis ndryshimit organizacional që ndodh brenda një organizate dhe stresit që përjetojnë punonjësit nga ky ndryshim. Hipotezat të cilat ngrihen në këtë studim janë:

Hipoteza 1: Ekziston një marrëdhënie statistikisht e rëndësishme midis ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit në punë.

Hipoteza 2: Punonjëset femra raportojnë nivele më të larta stresi në raport me punonjësit meshkuj si pasojë e ndryshimeve organizacionale.

Shqyrtimi i literaturës

Kultura e një organizate ndikon në çdo aspekt të asaj se si vepron organizata dhe se si bëhet puna. Në kërkimin për një performancë të qëndrueshme, sigurimi i kulturës së tyre është i përshtatshëm për të ardhmen dhe është një prioritet i lartë për shumë organizata. Gjetjet nga hulumtimet e studimit të kohëve të fundit tregojnë se ndryshimi i kulturës është i lartë në listën e prioriteteve të Burimeve Njerëzore (Clarke, N., Higgs, M. & Meyer, E. 2011)

2.1.1 Menaxhimi i ndryshimeve organizacionale

Menaxhimi i ndryshimeve është disiplina që udhëzon se si ne përgatisim, pajisim dhe mbështesim individët për të miratuar me sukses ndryshimet në mënyrë që të nxisin suksesin organizativ dhe rezultatet. Menaxhimi i ndryshimeve organizative është një kuadër për të menaxhuar sjelljet njerëzore që ndodhin kur bëhen ndryshime të mëdha brenda ndërmarrjeve. Ndërsa të gjitha ndryshimet janë unike dhe të gjithë individët janë unikë, dekadat e hulumtimit tregojnë se ka përkufizime të ndryshme për menaxhimin e ndryshimit organizativ. Secili përkufizim i paraqitur është i lidhur me natyrën e organizatës që e ka paraqitur.

Menaxhimi i ndryshimeve (CM) i referohet çdo qasjeje në tranzicion të individëve, ekipeve dhe organizatave duke përdorur metoda që synojnë të riorientojnë përdorimin e burimeve, proceseve të biznesit, ose mënyrave të tjera të operimit, që në mënyrë të konsiderueshme, riorganizojnë një kompani ose organizatë. Menaxhimi i ndryshimeve organizative (OCM) e konsideron organizimin të plotë dhe çfarë duhet të ndryshojë. Menaxhimi i ndryshimeve në organizatë fokusohet në mënyrën se si njerëzit dhe ekipet janë prekur nga një tranzicion organizativ. Ai merret me shumë disiplina të ndryshme, duke filluar nga sjellja dhe shkencat shoqërore tek teknologjia e informacionit dhe zgjidhjet e biznesit.

Ndryshimi organizativ ndikon drejtpërsëdrejti të gjitha departamentet dhe

punonjësit. E gjithë kompania duhet të mësojë se si të trajtojë ndryshimet në organizatë. Efektiviteti i menaxhimit të ndryshimeve mund të ketë një ndikim të fortë pozitiv ose negativ në moralin e punonjësve (Pfeffer, J. 1997).

Në shumicën e literaturës së menaxhimit të ndryshimit paraqiten dy shkolla mendimi rreth asaj se si ndryshimi strategjik ndodh në organizatë. E para e sheh ndryshimin si të vazhdueshëm, me organizata që transformohen vazhdimisht për të ecur në një ritëm me mjedisin e tyre në ndryshim (Brown & Eisenhardt, 1998).

Shkolla e dytë e sheh ndryshimin si strategjik, si një proces ekuilibri të ndërprerë. Në këtë këndvështrim, periudhat e ndryshimeve adaptive përzihen me periudha më të shkurtra ndryshimi revolucionar. Ndryshimi adaptiv është përshtatja me mënyrën ekzistuese të bërjes së gjërave, ai çon në zgjerim dhe në vazhdim të asaj që është bërë në të kaluarën, ndërkohë që ndryshimi revolucionar është një ndryshim i njëkohshëm në strategji, strukturë, në sisteme dhe në kulturën e një organizate dhe çon në një mënyrë plotësisht të ndryshme të operimit. Ndryshimi përshtatës çon me kalimin e kohës në apati të konsiderueshme dhe rezistencë ndaj mënyrave të reja të bërjes së punës.

Ekzistojnë pak të dhëna empirike për të mbështetur këto këndvështrime. Të dy modelet e ndryshimit mund të jenë të drejta, por aplikohen në lloje të ndryshme organizatash dhe ndoshta në stade të ndryshme të ciklit të jetës së organizatës (Burnes, 2000). Modelet e ndryshimit të vazhdueshëm mund të jenë më të përshtatshme për organizatat në ato industri ku ritmi i ndryshimit është i shpejtë, si për shembull industrinë hi-tec, ku ndryshimi konstant është i domosdoshëm për mbijetesë. Megjithatë nuk është e qartë se çfarë forme merr ndryshimi i vazhdueshëm.

2.2.1 Stresi në vendin e punës

Stresi në vendin e punës po ngre shqetësim në statusin aktual të ekonomisë, ku punonjësit gjithnjë e më shumë po ndeshen me punë jashtë orarit, pasiguri, nivele të ulëta të kënaqësisë në punë dhe mungesë të autonomisë. Ky lloj stresi ka treguar që është bërë një efekt determinues në shëndetin dhe mirëqenien e punonjësve, si dhe ka impakte negative në produktivitetin dhe fitimin në vendin e punës. Ekzistojnë masa të ndryshme që njerëzit dhe organizatat mund të marrin për të lehtësuar impaktin negativ të stresit ose dhe vetë fillimin e tij. Megjithatë, punonjësit më parë duhet të arrijnë të dallojnë shenjat që tregojnë fillimin e stresit, si dhe punëdhënësit duhet të jenë në dijeni të efekteve të stresit në shëndetin e punonjësve të tyre dhe të fitimit të kompanisë së tyre. Kjo është një thirrje për të gjithë punëdhënësit që të veprojnë për eliminimin e stresit në vendet e tyre të punës.

Kërkimi në këtë studim përqendrohet në burimet e stresit tek punonjësit në jetën organizative. Cooper dhe kolegët e tij kanë identifikuar gjashtë lloje stresuesish profesionalë: stresuesit e lidhur me natyrën e punës, konflikti i rolit dhe pasiguria, marrëdhëniet ndërpersonale, zhvillimi i karrierës, struktura organizative dhe kultura dhe ndërveprimi shtëpi-punë (Roney & Cooper, 1997). Ndryshimi organizativ ndikon mbi të gjitha këto burime të stresit. Për shembull, pasiguria e vendit të punës dhe zhvillimi i karrierës kohët e fundit janë vërtetë burime stresi për punonjësit, për arsye të ristrukturimeve, pushimeve nga puna, shkrirjeve të kompanive etj.

2.2.2 Strategjitë e menaxhimit (të stresit)

Efekti i stresuesve mbi punonjësit mund të influencohet nga strategjitë e tyre të menaxhimit të stresit. Strategjitë menaxhuese synojnë të kundërshtojnë ndikimin e stresorëve. Sipas Lazarus (1984) këto strategji mund të jenë të fokusuar tek emocionet ose problemet dhe çdo ngjarje stresuese mund të provokojë një kombinim të të dy llojeve të strategjive. Shpeshherë këto strategji përfshijnë largimin mendor nga problemi dhe përpjekjen për të minimizuar efektin e tij. Këto strategji (shmangia e problemit, fajësimi i vetes etj.) zakonisht nuk merren me problemin apo stresuesin dhe sipas studimeve, kanë efekt negativ mbi përshtatjen (Barton & Folkard, 1993). Në të kundërt, strategjitë që fokusohen tek problemi konsistojnë në menaxhimin dhe përballjen direkte me problemin. Sipas studimeve (Pisarsky, 1998) këto strategji kanë përgjithësisht efekte pozitive mbi përshtatjen e punonjësve. Megjithatë, duhet përmendur se përdorimi i kësaj strategjie varet nga kontrolli i perceptuar i individit mbi situatën stresuese. Kur kontrolli mbi situatën është në nivel të ulët, njerëzit tentojnë të përdorin strategjitë emocionale duke patur kështu më vonë nivele të ulëta përshtatjeje.

2.3 Ndryshimi organizacional dhe stresi në punë

Ndryshimi organizacional është një nga burimet kryesore të stresit në punë, i cili mund të ketë efekt negativ mbi aspekte, të tilla, si: kënaqësia në punë dhe gjendja psikologjike (Terry, 1996). Literatura tregon se efektiviteti i ulur i punonjësve që kanë më pak kënaqësi nga puna dhe moral më të ulët, mund të dëmtojë shumë aspekte të performancës organizative (Quick, 1997). Ndikimi i ndryshimeve organizacionale mbi përshtatjen e punonjësve po bëhet një fushë e rëndësishme hulumtimi, për shkak të kostos së lartë emocionale dhe financiare të punonjësve dhe organizatave kur ndryshimi nuk menaxhohet mirë.

Individët dallojnë midis tyre nga aftësia për të mësuar rolet e reja dhe nga mënyra e përjetimit të stresit ndërkohë që fitohen sjelljet dhe aftësitë e reja (Callan, 1993). Kur ndryshimet janë rrënjësore, aftësitë e zakonshme bëhen

më pak efektive, duke rezultuar në pasiguri më të mëdha. Kështu që aktivizohen proceset e menaxhimit dhe përshtatjes ndaj stresit. Individët që kanë vështirësi të përshtatjes do të kenë nivele edhe më të larta të stresit. Menaxhimi joadaptues i stresit, sipas O'Driscoll & Cooper (1994) gjatë një periudhe të gjatë kohore, mund të shkaktojë një formë të rënduar dhe kronike të stresit, e njohur si tejlodhje (burnout). Ndryshimet, midis individëve apo variablave të personalitetit, luajnë rol të rëndësishëm në parashikimin e perceptimeve të ndryshimit dhe nivelit të përshtatjes gjatë ndryshimit (Terry & Callan, 1997).

Johnson dhe Sarason (1979) argumentuan se ndryshimi organizacional në varësi të asaj si perceptohet, është një nga shkaqet kryesore të stresit në punë. Parandalimi dhe menaxhimi i efekteve negative të stresit duhet të jetë një nga shqetësimet kryesore të psikologëve. Është në interes të organizatës, nga pikëpamja etike dhe financiare, të ndërhyjë dhe të minimizojë dëmin që shkaktojnë tek punonjësit efektet negative të stresit nga ndryshimi organizativ (Mack, 1998). Shumë studime kanë treguar lidhjen midis përkushtimit organizativ dhe largimeve nga vendi i punës. Sipas tyre përkushtimi është parashikuesi më i rëndësishëm i planeve të punonjësve për të lënë vendin e punës (Bennet & Durkin, 2000). Sugjerohet që edhe qëndrimet e punonjësve ndaj ndryshimit mund të kenë ndikim mbi planet për t'u larguar.

KAPITULLI III

Metodologjia e studimit

3.1 Dizajnimi i studimit

Ky studim është një studim sasior, i llojit deduktiv. Një proces kërkimi deduktiv nënkupton që studimi bazohet në disa teori të cilat përdoren për të shpjeguar gjetjet në procesin e analizës së të dhënave. Është një studim korrelacional në të cilën janë përdorur dy instrumente. Sipas Goodwin shumë studime në psikologji janë sasiore. Të dhënat mbledhen në formën e numrave, mesatareve dhe përqindjeve. Një studim është korrelacional në rastet kur thuhet se ekziston një marrëdhënie midis dy variablave. Studimi u zhvillua për të përcaktuar nëse ekziston një marrëdhënie midis dy variablave. Pjesëmarrësit në këtë studim ishin punonjës të bankës ProCredit Bank Albania. Ata u përzgjedhën në mënyrë të qëllimshme për arsye të studimit që u krye. Grupmosha e kampionit ishte 25-55 vjeç.

3.2 Kampioni

Kampioni i këtij studimi përbëhet nga 100 individë të grupmoshës 25-55 vjeç, të cilët janë punonjës të bankës ProCredit. Në përgjithësi, një kampion minimal prej 50-100 personash mund të jetë i përshtatshëm për të

përfaqësuar një popullatë më të madhe për pothuajse pjesën më të madhe të pyetjeve kërkimore (National Audit Office, 2016). Nga ana tjetër, numri i grupeve që duhet të përfshihet në kampion mbetet ende një problem për t'u përcaktuar duke qenë se ende nuk sugjerohet ndonjë zgjidhje plotësisht e kënaqshme në literaturë (Yan, 2005). Për këto arsye konkludova, që në pamundësi për të përfshirë në studim të gjithë stafin e bankës, përfshirja e 50% të tyre do të përfaqësonte në mënyrë të kënaqshme të gjithë këtë popullatë. Kampioni u zgjodh pikërisht në këtë bankë, pasi vitet e fundit kjo bankë ka pësuar shumë ndryshime organizacionale. Një nga momentet kryesore përpara se të fillonte aplikimi i pyetësorëve ishte procesi i vendosjes së kontakteve dhe të krijimit të marrëdhënieve me pjesëmarrësit e përzgjedhur në studim.

Mosha e të anketuarve në këtë kampion varion nga 25-55 vjeç. Mesatarja e moshës së pjesëmarrësve është 39.8 dhe me një devijim standard $SD=7.999$ ($M=39.8$; $SD=7.999$). Mosha mesatare e meshkujve është 36.1 ($M=36$), ndërsa mosha mesatare e femrave është 41.2 vjeç ($M=41.2$). Pjesën më të madhe të kampionit e përbëjnë individë të grupmoshës 25-30 vjeç, rreth 40% të tyre. 25% prej tyre i përket grupmoshës 36-40 vjeç. Më pas 21% i përket grupmoshës 31-35 vjeç, 7% i përket grupmoshës 41-45 vjeç, 5% i përket grupmoshës 46-50 vjeç dhe së fundmi 2% i përket grupmoshës 51-55 vjeç. Mosha mesatare e meshkujve është 36.1, ndërsa mosha mesatare e femrave është 41.2 vjeç.

Nga 100 individë që morën pjesë në këtë studim 50% prej tyre janë femra dhe 50% janë meshkuj. Të dhënat e mbledhura nga studimi ishin të vlefshme. Individët të cilët morën pjesë në këtë studim duhet të kishin të paktën 6 muaj eksperiencë si punonjës të asaj banke.

3.3 Analiza e të dhënave

Për analizën e të dhënave të këtij studimi është përdorur programi i paketës statistikore për shkencat sociale SPSS, versioni 23. Të dhënat u futën në bazën e të dhënave. Analizat përshkruese janë përdorur për të dhënë një informacion të detajuar në lidhje me të dhënat demografike të kampionit të cilat janë paraqitur nëpërmjet tabelave dhe grafikëve (mesatare, devijim standard, vlerat maksimale dhe minimale, frekuencat dhe përqindjet). Gjatë përpunimit të tyre është bërë kujdes që të referohen dhe të përpunohen me shumë saktësi.

Për të testuar qëndrueshmërinë e brendshme të instrumenteve është përdorur alfa e Cronbach.

Analiza korrelacionale: Për të zbuluar nëse ka një marrëdhënie midis ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit tek punonjësit është përdorur korrelacioni Pearson. Duke qenë se një nga objektivat e këtij

studimi ishte të studiohet diferenca midis nivelit të stresit tek punonjësit femra krahasuar me punonjësit meshkuj, u përdor testi T për kampion të pavarur.

KAPITULLI IV DHE V

4.1 Analiza e besueshmërisë Cronbach's Alpha

Tabela 1

Tabela e Cronbach's Alpha për testin e Garg

Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.745	.751	15

Tabela 2

Tabela e Cronbach's Alpha për testin e HSE

Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.689	.658	20

Tabelat e mësipërme japin rezultatet mbi besueshmërinë ose qëndrueshmërinë e të dy instrumenteve që janë përdorur në këtë studim, konkretisht: Instrumenti vetëraportues i ndryshimit organizacional (Garg, 2013) dhe Instrumenti vetëraportues i stresit në punë (HSE, 2011). Tabela 1 jep rezultatet mbi testin e ndryshimit organizacional, ndërsa Tabela 2 jep rezultate mbi testin e stresit në punë. Duke u bazuar në këto tabela, vihet re se instrumenti që ka Cronbach's alpha më të lartë është instrumenti që mat ndryshimin organizacional me $\alpha = .745$, që sipas George dhe Mallery (2003) tregon një qëndrueshmëri të shkëlqyer. Po ashtu, edhe në instrumentin e dytë, atë të stresit në punë besueshmëria ose qëndrueshmëria është e mirë me një $\alpha = .685$. Në qoftë se do të bazoheshim përsëri tek George dhe Mallery (2003), do të tregohej përsëri për qëndrueshmërinë e mirë të testit të stresit në punë.

DISKUTIMET DHE PËRFUNDIMET

Në këtë kapitull paraqiten gjetjet kryesore të studimit të ndërthurura me analizën e literaturës, teoritë dhe studimet mbi fushën e studimit. Siç edhe e

kemi theksuar, ky studim u dizanjua për të marrë informacion rreth marrëdhënies së ndryshimit organizacional dhe stresit në punë, ndikimin që ka ndryshimi organizacional në uljen apo rritjen e stresit. Rezultatet e nxjerra nga ky studim ishin deri diku të pritshme dhe të ngjashme me studimet e kryera më parë.

Qëllimi i këtij studimi ishte përcaktimi i ekzistencës së një lidhjeje midis ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit në punë. Studimi dhe analiza e ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit në punë përbëjnë objektivat që ne kishim vendosur paraprakisht për studimin tonë. Objektivat e vendosura për këtë studim u realizuan të gjitha pa përjashtim. Rezultatet e këtij studimi do të analizohen si më poshtë duke u krahasuar me studime të ngjashme të kryera në vendet e tjera dhe me teoritë e caktuara. Në studim është marrë parasysh edhe variabli “gjini” për të bërë një krahasim midis subjekteve femra dhe meshkuj në lidhje me ndikimin që ka ndryshimi organizacional në stresin në punë.

Hipoteza 1: Ekziston një marrëdhënie statistikisht e rëndësishme midis ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit në punë.

Ajo se çfarë rezultoi është se koeficienti i fortësisë së marrëdhënies ndërmjet ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit që përjetojnë punonjësit është statistikisht i rëndësishëm për nivelin $p < .05$. Kjo tregon se ka një marrëdhënie midis ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit te punonjësit. Kjo mbështetet edhe nga studimi i realizuar nga Armenakis & Bedeian, 1999, të cilët kanë vërtetuar, nga studimi i tyre i kryer në një organizatë, se ndryshimi organizacional do të sjellë stres tek punonjësit. Sipas tyre, çdo punonjës do të përballej me situatë stresante kur puna e tyre do të ndryshonte. Ata supozojnë se kjo gjë do të ndodhte vetëm muajt e parë të përshtatjes, sepse më pas çdo punonjës do të stabilizohej me ndryshimet që do të kishte struktura dhe kultura e organizatës.

Shumë studime që kanë hetuar efektet e ndryshimeve organizacionale mbi mirëqenien psikologjike të punonjësve janë përqendruar tek ndryshimi si burim i stresit në punë (Ashford; Mack, 1998). Përgjigjet emocionale të punonjësve ndaj ndryshimeve organizacionale shpesh përmbajnë pasiguri dhe ankth, sidomos përsa i përket efektit që do të ketë ndryshimi mbi sigurinë për vendin e punës, natyrën e punës, karrierën dhe marrëdhëniet midis punonjësve. Ndryshimi organizacional mund të jetë kërcënues për shumë individë, me pasoja negative, si për shembull humbjen e vendit të punës, humbjen e statusit, humbjen e identitetit dhe konfliktet me punonjësit e tjerë (Schweiger & Ivancevic, 1985).

Janë kryer studime të shumta të cilat mbështesin këtë hipotezë. Një studim tjetër i cili është kryer nga Jutila, në Hämeenlinnan (Finlandë) në 2007, ka

rezultuar po me të njëjtat gjetje. Ky studim është kryer në një organizatë mjedisore dhe është parë nëse ndikonte ndryshimi organizacional në nivelin e stresit që do të përjetonin punonjësit. Gjetjet e këtij studimi, gjithashtu, ishin në përputhje me hipotezat e ngritura në fillim të hulumtimit.

Në një artikull të publikuar në revistën shkencore të psikologjisë, *Journal of Occupational and Organizational Psychology*, paraqitet një studim i cili është kryer nga Cunningham, të cilët kishin për qëllim të shikonin se si ndikonte ndryshimi organizacional në kulturë dhe në strukturë. Studimi është kryer te punonjësit e një spitali kanadez. Gjetjet e studimit kanë qenë të shumta duke e lidhur ndryshimin organizacional jo vetëm me aspektin e stresit që shkaktohet, por edhe nga anët pozitive dhe aspektet e mira që këto ndryshime sjellin për punonjësit. Gjithashtu, ndryshimi organizacional në këtë studim është i lidhur edhe me variabla të tjerë, si: stili i lidershit, marrëdhëniet lider-punonjës etj. Në pjesën e metodologjisë studiuesi tregon se ky studim do të bëhet një studim longitudinal, pasi ai pas 1 viti, të njëjët pyetësorë që shpërndau te këta punonjës, do t'i shpërndajë sërish po tek ata, për të parë se si kanë ndryshuar perceptimet e punonjësve për ndryshimin organizacional që ka pësuar spitali ku u aplikua ky studim. Pritshmëritë e studiuesit janë se perceptimet e punonjësve do të jenë përmirësuar dhe do të jenë përshtatur me ndryshimet në vendin e tyre të punës.

Cooper (1998) ka shpjeguar se arsyeja kryesore pse ndryshimi shkakton stres është pasi individët gjenerojnë përgjigje automatike ndaj ngjarjeve në jetë dhe në punë, të cilat i ndihmojnë të përballojnë ngjarjet. Këto përgjigje sigurojnë një ndjenjë kontrolli dhe reduktojnë pasigurinë në marrëdhëniet e përditshme. Ndryshimi organizacional mund të nxjerrë “jashtë lojë” këto sjellje dhe qëndrime. Më pas ndodh një proces kompleks reciprok midis ndryshimit në nivel organizativ dhe stresit në nivel individual (Mack, 1998). Ndryshimi ndikon mbi punonjës, duke e detyruar atë të funksionojë në një tjetër mënyrë. Nga ana tjetër, punonjësi ka ndikim mbi ndryshimin, pasi pranimi/mospranimi aktiv apo pasiv, do të ketë efekt direkt mbi rezultatet e ndryshimit. Kështu, stresi i shkaktuar nga presioni mbi individin për të patur sjellje të reja, mund të krijojë një barrierë për implementimin e duhur të ndryshimit (Armenakis & Bedeian, 1999).

Hipoteza 2: Punonjëset femra raportojnë nivele më të larta stresi në raport me punonjësit meshkuj, si pasojë e ndryshimeve organizacionale.

Duke iu referuar rezultateve të këtij studimi u arrit në përfundimin se punonjëset femra përjetojnë nivele më të larta stresi se punonjësit meshkuj, pra hipoteza vërtetohet. Këto gjetje janë në përputhje edhe me disa studime të mëparshme të realizuar nga studiues të ndryshëm. Femrat dhe meshkujt

raportojnë reagime të ndryshme ndaj stresit në punë, fizikisht dhe mendërisht. Ata përpiqen të menaxhojnë stresin në mënyra shumë të ndryshme dhe, gjithashtu, e perceptojnë aftësinë e tyre për ta bërë këtë në mënyra të ndryshme. Gjetjet sugjerojnë se punonjëset femra kanë më shumë gjasa të raportojnë simptoma fizike të lidhura me stresin, krahasuar me punonjësit meshkuj (APA, 2016).

Studimi i Nagina Praveen (2009) thotë se niveli më i lartë i stresit në punë tek femrat në raport me meshkujt shpjegohet në terma të kërkesave të shoqërisë dhe përgjegjësitë e shumta të lidhura me rolin e nënës, gruas, dhe amvisës. Një tjetër studim i cili raporton nivele më të larta të stresit tek femrat është realizuar nga Nicholson (1995) dhe shpjegohet në terma të mosarritjes së pritshmërive për realizimin e roleve të shumta. Studimi i realizuar nga Greenhaus, Collins & Shaw, (2003) e shpjegon nivelin më të lartë të stresit tek femrat në raport me meshkujt, me faktin se femrat vazhdojnë të mbajnë përgjegjësi të plotë lidhur me përkujdesjen ndaj fëmijëve dhe punëve të shtëpisë. Në bazë të këtyre studimeve, edhe të përfundimeve nga studimi i kryer në kontekstin shqiptar, mund të thuhet se kërkesat e shumta të shoqërisë ndaj femrës nuk kanë ndryshuar edhe aq sa pretendohet. Në shoqërinë shqiptare me orientim ende të fuqishëm maskilist dhe me doza të forta të mentalitetit tradicional nga një femër që është e martuar, edhe nënë, pritshmëritë janë shumë të larta. Por çfarë lehtësirash ka një femër, që është nënë, por që është edhe në një punë me kohë të plotë? Mesa duket jo dhe aq sa për të lehtësuar sfidat e jetës së përditshme me të cilat ajo përballlet. Në këtë pikë lind stresi i cili akumulohet si nga puna edhe nga jeta në familje, duke shkaktuar dëme, si psikologjike, ashtu edhe fiziologjike.

Shpjegimet për gjetjet e këtij studimi në kontekstin shqiptar mund të jenë disa. Një punonjëse femër përveçse duhet t'u përgjigjet kërkesave dhe detyrave të punës së saj, duhet të kujdeset për fëmijët, për punët e shtëpisë, për njerëzit e tjerë në familje. Por, gjithashtu, duhet të jetë edhe një bashkëshorte e mirë. Kur femrat nuk kanë mjaftueshëm ndihmë në kujdesin e fëmijëve dhe punëve shtëpiake nga bashkëshortët e tyre dhe punojnë në punë shumë kërkuese psikologjike, shëndeti dhe mirëqenia e tyre mund të dëmtohet. Gjithashtu, tensione të tjera brenda familjes janë të lidhura ngusht me stresin që një femër përjeton. Belle (1982) ka gjetur se problemet financiare janë dukshëm të lidhura me stresin, duke përfshirë familjen, prindërit dhe problemet në marrëdhëniet intime. Por edhe fëmijët janë parë si një burim i stresit në familje. Në bazë të këtij studimi dhe gjetjeve të studimit të kryer tek disa kompani të tjera, mund të themi se niveli i të ardhurave, moshë e femrave, si dhe niveli arsimor kanë një

rëndësi të pashmangshme në përjetimin e stresit tek një femër. Edhe vitet në institucion ndikojnë në përjetimin e ngjarjeve në punë. Ky rezultat mund të ndikojë në mënyrën e zgjidhjes së problematikave të hasura në ambientin e punës, të cilat rrjedhimisht sjellin stres.

Punonjëset femra përjetojnë më shumë stres në vendin e punës sesa punonjësit meshkujt, kryesisht sepse ato duhet të luftojnë me kërcënimin stereotip që u bëhet, një fenomen ky që është pothuajse i panjohur për meshkujt. Kërcënimi i stereotipit ndodh kur një femër është e vetëdijshme për një stereotip që çon në mendimin te femrat që ato e kryejnë keq një detyrë të caktuar krahasuar me meshkujt. Duke ditur ekzistencën e një stereotipi gjinor, një gjë e tillë mund të shkaktojë tek punonjëset femra përqendrimin e dëmtuar dhe rritjen e stresit (Callan, 1993).

Në vendet perëndimore zakonisht nga femra nuk pritet që të gjitha detyrimet ndaj fëmijëve t'i kryejë ajo edhe mashkulli të jetë thjesht kryefamiljari që sjell të ardhura në shtëpi. Në shoqëritë perëndimore femra që është njëkohësisht punonjëse, bashkëshorte edhe nënë ndihmohet nga bashkëshorti i saj duke ia lehtësuar lodhjen edhe duke i krijuar hapësirë për të pasur kohë për veten. Në Shqipëri rrallëherë funksionojnë familjet në këtë mënyrë. Duke pasur kaq shumë kërkesa nga jeta, brenda dhe jashtë ambienteve të punës, një individ përjeton stres. Nga ana tjetër, një individ i cili nuk ka kaq shumë role në shoqëri e ka më të lehtë të përmbushë objektivat e tij, si edhe pritshmëritë.

Duke qenë se çdo organizatë është në proces ndryshimi për arsye të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe përparimin e teknologjisë, punonjësit duhet të përshtaten me ndryshimet e bëra. Kur ndryshimet në vendin e punës nuk përthithen si duhet, punonjësit përjetojnë stres. Pohimet kanë të bëjnë me mundësinë që kanë punonjësit për t'u informuar në lidhje me ndryshimet, konsultimin me kolegët si dhe përdorimin në praktikë kur ndodhin ndryshime. Në rastin konkret, kur një punonjës nuk mirinformohet për ndryshimet në vendin e punës, procesi i përshtatjes bëhet më i vështirë, edhe më i ngadaltë.

Një analizë e kohëve të fundit nga konsulentët e shëndetit dhe sigurisë Arinite ka zbuluar se nivelet e stresit të tepruar te femra janë 1.5 herë më shumë sesa tek meshkuj.

Një gjetje tjetër e këtij studimi të cilin do të doja ta veçoja është fakti se gjatë hedhjes së të dhënave të pyetësorëve të aplikuar, ajo që vura re ishte fakti se në instrumentin e përdorur të stresit në punë, pohimi 7 "Vendi im i punës nuk është shumë i sigurt" ishte pohimi i rankuar me përgjigje më të larta. Nga 100 punonjës të marrë në studim, 83 (83%) prej tyre janë përgjigjur duke vendosur numrin 5 (plotësisht dakord) në hapësirën bosh.

Gjithashtu, në instrumentin e aplikuar të ndryshimit organizacional, pohimi 13 “Ndryshimi organizativ ka ndikuar në reduktimin e punonjësve” ishte pohimi i rankuar me përgjigjet më të larta. Nga 100 punonjës 91 (91%) prej tyre janë përgjigjur duke vendosur numrin 5 (pajtohem plotësisht) në hapësirën bosh.

Qëllimi i këtij studimi ishte të përcaktonte në qoftë se ekziston një marrëdhënie statistikisht e rëndësishme midis ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit që përjetojnë punonjësit. Po ashtu, ky studim synonte që të përcaktonte në qoftë se ka diferenca në raportimin e nivelit të stresit ndërmjet gjinive të ndryshme, si pasojë e ndryshimeve organizacionale që kanë ndodhur në institucionin përkatës.

Pas analizës së hollësishme, u arrit në konkluzionin se ndryshimi organizacional është një variabël i rëndësishëm që ndikon në nivelin e stresit që përjetojnë punonjësit. U pa se ekziston një marrëdhënie korrelacionale ndërmjet ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit në punë. Në raportimin e nivelit të stresit vihen re se femrat shfaqin një nivel më të lartë të stresit në krahasim me meshkujt.

KAPITULLI VI

Rekomandimet

6.1 Rekomandimet për kampionin e studimit

Vlerësimi i ndryshimit organizacional dhe nivelit të stresit në punë tregoi se stresi që përjetojnë punonjësit në punë është një faktor i rëndësishëm i cili ndikohet nga ndryshimet organizacionale. Duke iu referuar rezultateve të studimit unë rekomandoj që:

1. Duke iu referuar bankës ProCredit, do të ishte më efektive nëse ndryshimet që ndodhin brenda bankës, të mos jenë të shpeshta dhe të shtrira në afate të shkurtra kohore.
2. Duke qenë se punonjëset femra, ashtu edhe punonjësit meshkuj rezultuan me nivele të larta stresi, rekomandohet që të ketë më shumë fleksibilitet në orarin e punonjësve.
3. Punonjësit e kësaj banke është e nevojshme që të konsultohen me psikologun e institucionit. Psikologu organizacional në këtë bankë mungon. Është patjetër e nevojshme të punësohet një i tillë, në mënyrë që t’iu vijë në ndihmë punonjësve të stresuar, që përjetimet e stresit nga ndryshimet organizacionale të reduktohen.
4. Kompensimi i punonjësve të mos bëhet vetëm nëpërmjet trajnimeve që kjo bankë organizon, por edhe në shpërblime monetare, në bonuse të ndryshme etj.

6.2 Rekomandime për studime të mëtejshme

1. Të bëhet pjesë e studimit jo vetëm sektori privat, por edhe ai publik.
2. Një rekomandim tjetër mund të lidhet me numrin e subjekteve pjesëmarrëse në studim. Që rezultatet të jenë të besueshme dhe përfaqësuese të një popullate më të gjerë është e nevojshme që të rritet numri i kampionit. Sa më i madh të jetë numri i pjesëmarrësve, aq më i besueshëm bëhet një studim. Ky lloj studimi nuk duhet të kufizohet në një institucion të vetëm të Tiranës, apo në një qytet të caktuar. Ky studim duhet të shtrihet më tej, duke rritur kështu, përfshirjen e më shumë punonjësve që janë pjesë e ndryshimeve organizacionale.
3. Të mblidhet një informacion i saktë për numrin e përgjithshëm të popullatës, si dhe të përcaktohet, me një procedurë shkencore rigoroze, numri minimal i kampionit të përfshirë në studim, në mënyrë që rezultatet të jenë më të sakta.
4. Për të interesuarit në këtë fushë studimi rekomandojmë përfshirjen e sa më shumë informacioni demografik i cili mund të ndikojë në nivelin e stresit.
5. Studimi im u realizua me një grupmoshë të caktuar, por studimet e tjera mund të përfshijnë edhe grupmosha të tjera për të vërtetuar hipotezat e tyre. Sigurisht që studimi duhet të bëjë përshtatjet e nevojshme me grupmoshën në të cilën do të realizohet.
6. Gjithashtu, rekomandohet që studime të tilla të shtrihen në kohë. Kjo nënkupton që subjektet të pyeten në kohë të ndryshme dhe të merren parasysh ndryshimet që pëson niveli i tyre i stresit.

BIBLOGRAFIA:

- Armenakis, A. & Bedeian, A (1999) "Organizational change: A review and research in the 1990's" Journal of Management
- Armenakis, A. A., Harris, S. G., & Mossholder, K. W. (1993). Creating readiness for change. Human Relations
- Ashford, S., (1988) "Individual strategies for coping with stress during organizational transitions" Journal of applied behavioural science
- Bennet, H. Durkin, M. (2000) "The effects of organizational change on employee psychological attachment" Journal of managerial psychology
- Brown, S. & Eisenhardt, K. (1988) "Competing on the edge: Strategy as structured chaos", Harvard Business School
- Burnes, B. (2000) "Managing change: A strategic approach to organizational dynamics" Harlow: Prentice Hall
- Callan, V. (1993) " Individual and organizational strategies for coping with organizational change" Work and stress

- Clarke, N., Higgs, M. & Meyer, E. (2011) Developing organization culture: Six case studies. University of Southampton School of Management, UK.
- Cooper, C. & Palmer, S. (2000) Conquer Your Stress. London: Institute of Personnel.
- Deming, W. E. (1989). Out of the Crisis. Cambridge, MA: MIT Press.
- European Committee for Standardization. Ergonomic principles related to mental work load-Part 1: General terms and definitions (EN ISO 10075-1) and Part 2: Design principles. Brussels (Belgium): CEN; 1999
- George, J. M., & Jones, G. R. (2002). Understanding and Managing Organizational Behavior (3rd). New York: Pearson Education, Inc.
- George, J. M., & Jones, G. R. (2007). Understanding and Managing Organizational Behavior (5rd). New York: Pearson Education, Inc.
- Johnson, J. (1979) "Human stress and cognition" Wiley and sons
- Lazarus, R. S., & folkman, S. (1984). Stress, appraisal, and coping. New York: Springer.
- Mack, A. Quick, J. (1988) "The stress of organizational change: A dynamic process
- Pfeffer, J. (1997) "New direction for organisational theory" Oxford University Press
- Qucik, J., Nelson, D. (1997) "Preventing stress management in organisations" Washington
- Raymond C, "Stress the real millennium bug", Stress News, Vol.12 No.4, 2000
- Reynold, S. Shapiro, D. (1991) "Stress reduction in transition: Stress management interventions" Human Relations
- Schein, E. H. (1992). Organizational Culture and Leadership (2nd. ed.). San Francisco: Jossey-Bass. Van de
- Schweiger, D. (1987) "Executive action for managing human resources before and after asquisition" Academy of Management Executive
- Terry, D. & Callan, V. (1998) "Intergroup differentiation in response to an organisational merger" Group dynamics: theory, research and practise

VETËVRASJET E PACIENTËVE TË HOSPITALIZUAR ME INFEKSIONIN SARS-COV-2, NË SHQIPËRI

Alfred Nela

Psikolog në Policinë e Shtetit, Tiranë

ABSTRAKT

Masat e ndërmarra për shkak të pandemisë COVID-19, ndikuan në përkeqësimin e shëndetit mendor tek një pjesë e popullsisë. Frika nga infektimi, izolimi social, pasiguria dhe vështirësitë ekonomike, influencuan shfaqjen e simptomave të depresionit, ankthit, stresit dhe akteve të vetëvrasjes. Disa studime të zhvilluara në disa vende të prekuara nga pandemia, treguan përkeqësim të gjendjes mendore, simptoma të stresit post traumatik, frikë nga infektimi i mundshëm, pagjumësi, rritje të përdorimit të substancave narkotike dhe një pjesë e kishin menduar seriozisht vetëvrasjen.

Në Shqipëri pesë pacientë të infektuar me SARS-CoV-2, janë vetëvrasur duke u hedhur nga dritaret e spitalit ku merrnin trajtimin. Katër nga këta vdiqën menjëherë, ndërsa tjetri vdiq një ditë me pas.

Aktualisht, burimet njerëzore për shëndetin mendor pranë spitaleve, janë në numër më të vogël krahasuar me vendet e rajonit. Në kushtet e hospitalizimit të pacientëve të prekur me COVID-19, mbështetja psikologjike është e reduktuar për shkak të numrit të kufizuar të psikologëve dhe mungesës së një strategjie për mbështetjen psiko-sociale nga institucionet përgjegjëse. Shtimi i burimeve njerëzore të shëndetit mendor, pranë spitaleve ku trajtohen pacientët e infektuar me SARS-CoV-2, do të ndikonte pozitivisht në aspektin psikologjik tek pacientët dhe tek stafi mjekësor.

Fjalë kyçe: Vetëvrasjet në spitale, pandemia COVID-19, depresion, ankth, mbështetje psikologjike.

Suicides of patients hospitalized with SARS-CoV-2 infection in Albania

ABSTRACT

The measures undertaken due to the COVID-19 pandemic affected the worsening of the mental health for a section of the population. Fear of infection, social isolation, uncertainty and economic difficulties influenced

the appearance of symptoms of depression, anxiety and suicidal acts. Some studies conducted in countries affected by the pandemic indicated a worsening of the patients' mental state, post-traumatic stress symptoms, fear of a possible infection, insomnia, an increase in narcotic substances abuse, and a number of persons had seriously considered the suicide. In Albania, since August 2020, five patients infected with SARS-CoV-2 committed suicide by jumping off the hospital's windows or floors. In four cases, the patients suffered an immediate death, whereas one case died a day later. Currently, the human resources dedicated to mental health in hospitals are few in numbers, compared to the countries of the region. Under the circumstances of hospitalization for COVID-19 patients, the psychological support has been reduced due to the limited number of psychologists and the lack of a strategy for psychosocial support by the responsible institutions. An increase in mental health human resources in COVID-19 hospitals is suggested as well among other key recommendations.

Keywords: Suicides in hospitals, COVID-19 patients, depression, anxiety, psychological support.

1. Hyrje

Të ndikuar nga përhapja e shpejtë e pandemisë COVID-19, Qeveria Shqiptare, hartoi një plan masash dhe aktesh ligjore, për t'u mbrojtur ndaj depërtimit të koronavirusit të ri dhe parandalimit të përhapjes. Në fazën e parë të shfaqjes masat ishin në formën e rekomandimeve dhe këshillimeve, më vonë këto masa u ashpërsuan. Disa nga masat e ndërmarra ishin: mbyllja e aktiviteteve publike dhe jopublike, të tilla si: aktivitetet sportive, kulturore dhe edukative. Distancimi fizik, karantinimi apo izolimi i detyruar, ndikoi në shëndetin mendor tek një pjesë e popullatës. Tek individët e infektuar, ndodhën edhe akte të vetëvrasjes.

Në realizimin e këtij studimi janë shfrytëzuar hulumtime shkencore, dokumente strategjike dhe artikuj me dëshmi të botuar në median publike. Pas sintetizimit analitik janë filtruar studimet kyçe më në zë nga ekspertët e shkencave shëndetësore. Literatura e shqyrtuar në këtë studim shtjellon një larmishmëri këndvështrimesh, pasqyron diskutimet dhe debatet e kohëve të fundit që po zhvillohen rreth ndikimit psikologjik të pandemisë COVID-19, dhe ofron një pikëpamje bazuar tek konteksti Shqiptar.

2. Pandemitë në Shqipëri

Megjithë mungesën e të dhënave, Shqipëria është prekur nga disa shpërthime epidemike që përfshijnë gripin Spanjoll, gripin Aziatik, gripin e

Hong Kongut etj. Gripi spanjoll, midis viteve 1918 dhe 1919, shkaktoi vdekjen e 20-50 milionë njerëzve, me një nivel vdekshmërie prej rreth 2%, duke prekur në shumicën e rasteve fëmijët, të rinjtë dhe gratë shtatzëna. Në 1957-1958, gripi aziatik me origjinë nga Kina Jugore ishte përgjegjës për 1 deri në 4 milionë jetë të humbura me një vdekshmëri prej 0.1 – 0.2%, dhe preku kryesisht fëmijët. Pandemia e parë për të cilën vendi ynë disponon të dhëna është shpërthimi epidemik i AH1N1, i cili filloi në Meksikë dhe shkaktoi një pandemi të butë të gripit me rreth 18000 vdekje, dhe një nivel vdekshmërie prej më pak se 0.025%, duke prekur kryesisht fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe ata me sëmundje kronike. Për fat të mirë, Shqipëria nuk është prekur nga shpërthimi i Sindromës Respiratore Akute të Rëndë (SARS) midis 2001 dhe 2002 dhe nga Sindroma Respiratore e Lindjes së Mesme (MERS) që filloi në vitin 2012, të dyja me shkallë të lartë të vdekshmërisë të vlerësuar rreth 10% dhe 30%, respektivisht dhe që prekën përkatësisht moshën e mesme dhe të moshuarit¹.

1. Efektet e pandemisë COVID-19 në sjelljet vetëvrasëse

Edwin Shneidman (1897) e përcakton suicidin si vdekje të qëllimshme, të vetëshkaktuar, në të cilën një person bën përpjekje të qëllimshme, të drejtpërdrejta dhe të vetëdijshme për t'i dhënë fund jetës. Tentativat suicidale janë veprime për suicid që nuk përfundojnë me vdekje. Shumica e tyre bëhen në mënyrë impulsive, pra janë të paplanifikuara mirë².

Teoritë kryesore të vetëvrasjes theksojnë rolin kryesor të lidhjeve shoqërore që luajnë në parandalimin e akteve të tilla. Individët që përjetojnë ide vetëvrasjeje mund të kenë mungesë lidhjesh sociale. Gjatë shpërthimit të SARS në 2003 në Hong Kong, shkalla e vetëvrasjeve ishte në nivelin më të lartë historik, 18.6% për 100,000 banorë. Rritja më e konsiderueshme u gjet në mesin e të rriturve të moshuar të moshës 65 vjeç e lart³. Në studimin e tyre, (Yip et al., 2010), gjetën shtim të stresit dhe rritje të numrit të vetëvrasjeve tek të moshuarit. Ata gjithashtu sugjeruan që

¹ **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Instituti i Shëndetit Publik. (2019).** *Plan veprimi për Shqipërinë: COVID – 19; Parandalimi, përgatitja dhe përgjigja kundër COVID-19.*

² **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Instituti i Shëndetit Publik. (2011).** *Të dhëna të përgjithshme mbi vetëvrasjet. Revista Mjekësore, Nr: 1.*

³ Y. T. Cheung., P. H. Chau., Paul S. F. Yip. (2008) . A revisit on older adults suicides and Severe Acute Respiratory Syndrome (SARS) epidemic in Hong Kong. <https://doi.org/10.1002/gps.2056>

nivelet e vetëvrasjeve ishin rezultat i vetmisë dhe mosangazhimit shoqëror⁴. Për më tepër, (Chan et al., 2006), raportoi se rreziku i rritur i vetëvrasjes u gjet në mesin e të moshuarve femra, sesa tek meshkujt e moshuar.

Një studim i realizuar në Amerikë në periudhën 24-30 qershorit 2020 tregoi, se 40.9% e të anketuarve, raportuan përkeqësim të gjendjes mendore, 30.9%, kishin simptoma të depresionit, 26.3% kishin simptoma të stresit post traumatik, 13.3% raportuan rritje të përdorimit të substancave narkotike dhe 10.7%, raportuan se e kishin konsideruar seriozisht vetëvrasjen muajin e fundit⁵. Në SHBA mediat vendase kanë raportuar rritje në shitjet e armëve, ndërsa pandemia COVID-19, po përparon. Armët e zjarrit janë metoda më e zakonshme e vetëvrasjes në SHBA⁶. Në Indi, një hulumtim paraqiti 69 raste vetëvrasjeje gjatë periudhës së COVID-19, nga moshë 19 deri 65 vjeç, ku 63 raste ishin meshkuj. Sipas gjetjeve shkaqet kryesore ishin, frika nga infeksioni, kriza financiare, vetmia dhe presioni për të qëndruar në karantinë (Armstrong et al., 2019; Bangladesh, Mamun and Griffiths, 2020; Mamun et al., 2020a, 2020b; Pakistan, Mamun & Ullah, 2020)⁷.

Rasti i parë i vetëvrasjes së një pacienti të infektuar me SARS-CoV-2, në Itali u raportua më 13 mars 2020. Një 65-vjeçar u vetëhodh nga kati i tretë i spitalit në Maugeri di Montescano.⁸ Më 25 mars 2020, një 73-vjeçar i cili sapo ishte shëruar nga koronavirusi u vetëhodh nga kati i shtatë i spitalit të Kremonës.⁹ Më 14 tetor 2020 një 78-vjeçar u vetëhodh duke gjetur vdekjen në spitalin “San Pio” në Benevento.¹⁰

⁴ Sher, L. (2020). The impact of the COVID-19 Pandemic on Suicide Rates: *An International Journal of Medicine*, Vol. 0, No. 0. <https://doi.org/10.1093/qjmed/hcaa202>

⁵ Czeisler, E. M., Lane, I. R., Petrosky, E., Wiley, F. J., Christensen, A., Nj, R., Weaver, D. M., Robbins, R., Facer - Childs, R. E., Barger, K. L., Howard, E. M., Rajaratnam, M.W.Sh. (2020). Mental Health, Substance Use, and Suicidal Ideation During the COVID-19 Pandemic - United States, June 24 – 30, 2020: *MMWR, Weekly*, Vol. 69, No. 32. 69(32);1049–1057

⁶ Reger, M. A., Stanley, MS, Thomas, E. J. (2020) Suicide Mortality and Coronavirus Disease 2019-A Perfect Storm? *JAMA Psychiatry*. <https://doi:10.1001/jamapsychiatry.2020.1060>.

⁷ Dsouza, D, D., Quadros, Sh., Hyderabadwala, Z, J., Mamun, M, A. (2020). Aggregated COVID-19 suicide incidences in India: Fear of COVID-19 infection is the prominent causative factor. *Psychiatry Research* 290. <https://doi.org/10.1016/j.psychres.2020.113145>

⁸ Agatti A. (2020, November 20). Aspetta il risultato del tampone, si getta dalla finestra e muore, *La Provincia*

⁹ ANSA. (2020, November 27). Positivo al coronavirus sisuicida buttandosi da unafinestraddell'ospedale di Cremona, *huffingtonpost.it*

¹⁰ Anteprema.it. (2020, December 10). “San Pio”, dramma in mattinata: 78enne positivo al covid-19 si toglie la vita

Masat e kërkuara për të ngadalësuar përhapjen e virusit, duke përfshirë edhe vetizolimimin nga punëtorët dhe konsumatorët, mbylljen e bizneseve dhe ndalimin e ngjarjeve sportive, ishin të dëmshme për ekonominë. Miliona njerëz në të gjithë botën humbën vendet e tyre të punës. Historikisht, rëniet ekonomike ishin të shoqëruara me çrregullime të shëndetit mendor dhe vetëvrasje¹¹. Në SHBA, vetëvrasjet u rritën gjatë Depresionit të Madh. Vdekshmëria nga vetëvrasjet arriti kulmin me papunësinë në vitet më recesionare, 1921, 1932 dhe 1938¹². Varnik raportoi një rritje të vdekjeve nga vetëvrasjet në Estoni në fillim të viteve 1930.¹³ Bazuar në raportet e analizuara pothuajse të gjitha vendet evropiane kanë përjetuar nivele në rritje të vetëvrasjeve gjatë krizës financiare 2008-2010, theksoi Reeves et al (2014).¹⁴

Recensioni ekonomik, papunësi, varfëria dhe pabarazitë sociale, ishin faktorë të rëndësishëm që ndikuan në sjelljet vetëvrasëse, raporton një studim i zhvilluar në Bangladesh gjatë pandemisë COVID-19 (Mamun dhe Griffiths, 2020a)¹⁵.

Në një hulumtim, të dhënat ditore të vetëvrasjes në Angli dhe Uellsin, u përputhën me një indeks të pasigurisë së politikës ekonomike ditore gjatë periudhës 2001-2015. Autorët zbuluan se një rritje e pasigurisë ekonomike mund të çojë në rritjen e rrezikut të vetëvrasjeve.¹⁶ Në një

¹¹ Vantoros S, Avendano, M., Kawachi, I. (2019) The Association Between Economic Uncertainty and Suicide in the short-run. *Social Science & Medicine*, Vol 220. <https://doi.org/10.1016/j.socscimed.2018.11.035>

¹² Ahmedani BK, Peterson E.L., Hu, Y., Rossom, R.C., Lynch, F., Lu, C.Y., Waitzfelder, B.E., Owen-Smith, A.A., Hubley, S., Prabhakar, D., Williams, L.K., Zeld, N., Mutter, E., Beck, A., Tolsma, D., Simon, G.E. (2017). Major physical health conditions and risk of suicide. *American Journal of Medicine* Vol 53. <https://doi.org/10.1016/j.amepre.2017.04.001>.

¹³ Värnik, A. (1991). Suicide in Estonia. *Acta Psychiatr Scand*, Vol: 84: pp 229–230. <https://doi.org/10.1111/j.1600-0447.1991.tb03135.x>

¹⁴ Reeves, A., McKee, M., Stuckler D. (2014). Economic suicides in the Great Recession in Europe and North America. *The British Journal of Psychiatry*, Vol: 205. <https://doi.org/10.1192/bjp.bp.114.144766>

¹⁵ Bhuiyan I, A. K. M., Sakib, N., Pakpour, A H., Griffiths, M, D., Mamun, M A. (2020). COVID-19-Related Suicides in Bangladesh Due to Lockdown and Economic Factors: Case Study Evidence from Media Reports, diction, *International Journal of Mental Health and Addiction*. <https://doi.org/10.1007/s11469-020-00307>

¹⁶ Dawel, A., Shou, Y., Smithson, M., Cherbuin, N., Banfield, M., Calcar, A. L., Housen, T., McCallum, S.M., Morse, A.R., Murray, K., Newman, E., Rodney Harris, R.M., Battergam, P. J. (2020). The Effect of COVID-19 on Mental Health and Wellbeing in a Representative Sample of Australian Adults, *Frontiers in Psychiatry*. <https://doi.org/10.3389/fpsy.2020.579985>

anketë online realizuar në fund të muajit mars në Shqipëri me 1031 pjesëmarrës rezultatet e vjelura pasqyruan se 43%, i mendonin jashtëzakonisht seriozisht pasojat sociale, financiare apo të lidhura me punën, nëse do të infektohen nga COVID-19¹⁷. Ekspertët e shëndetit mendor theksojnë se ekspozimi i përsëritur i informacioneve në lidhje me krizën e koronavirusit në media dhe rrjetet sociale mund të rrisin frikën dhe rrezikun e vetëvrasjes¹⁸.

2. Vetëvrasjet në Shqipëri të ndikuara nga pandemia COVID-19

Pas vitit 2000, Shqipëria e mbështetur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) nisi një proces reformues, i cili u mbështet tek ndryshimet e kuadrit ligjor për shëndetin mendor, krijimin e një Dokumenti Politik dhe më pas në Planet e Veprimit dhe një sërë dokumentesh rregullatore¹⁹. Sipas raportit të WHO të vitit 2017 Shqipëria ka numër të përafërt me vendet e ngjashme të rajonit të personave më çrregullime mendore për 100 000 banorë²⁰.

çrregullime depresive, 104,925 raste me çrregullime të ankthit, bazuar në të dhënat e WHO të vitit 2017.¹ Sipas statistikave të Instat, pas vdekjeve natyrale dhe aksidenteve, vetëvrasja është shkaku kryesor i vdekjeve¹. Krahasuar me vendet e rajonit Shqipëria

Shqipëria ka një total prej 131,048 rastesh të personave me ka numrin më të ulët të vetëvrasjeve për 100.000 banorë²¹.

Tabela: Numri i vetëvrasjeve për 100.000 banorë.

Shteti	Vetëvrasjet në %
Shqipëria	6.3
Maqedonia e Veriut	7.9
Bosnja dhe Herzegovina	8.8
Mali Zi	10.3
Serbia	15.6

Burimi: WHO; 2017

Në një studim të realizuar në fund të muajit mars, sapo filluan masat

¹⁷ Nela, A. (2020). Nela, A., Puci, A., Nika, A., Froku, B. (2020). Praktikimi i distancimit social gjatë pandemisë COVID-19: *Perceptime dhe qëndrime*

¹⁸ Gunnell, d., applepy, l., arensman, e., hawton, k., john, a., kapur, n., khan, m., o'connor, r.c., pirkis, j and COVID-19 Suicide Prevention Research Collaboration. (2020). Suicide risk and prevention during the COVID-19 pandemic, *Lancet Psychiatry*, Vol 7. [https://doi.org/10.1016/S2215-0366\(20\)30171-1](https://doi.org/10.1016/S2215-0366(20)30171-1)

¹⁹ USAID, Avokati i Popullit (2018). *Raport Tematik: Transparenca në sistemin shëndetësor mendor.*

²⁰ WHO. (2017). Mental Health ATLAS 2017 Member State Profile.

²¹ WHO (2017). Mental Health ATLAS 2017 Member State Profile.

kufizuese dhe karantinimi në Shqipëri, në një anketë online me 1031 pjesëmarrës të dhënat e përfuara treguan se 38%, ishin dakord se qëndrimi në shtëpi më shumë se një muaj, ndikon negativisht në aspektin psikologjik²².

Në muajin gusht brenda 20 ditëve, dy persona të prekur me COVID-19, i kanë dhënë fund jetës duke u hedhur nga dhomat e spitalit ku trajtoheshin. Viktima e parë, ishte një 29- vjeçar, ku prej 4 ditësh qëndronte nën kujdesin e mjekëve të spitalit, por teksa ka qenë në rrugën e trajtimit, në rrethana të paqarta, ka ndër marrë aktin duke u hedhur nga dritarja e spitalit raportuan mediat. Një burrë tjetër 65- vjeçar i cili kishte vetëm 24 orë që trajtohej në ambientet e spitalit, u hodh po nga kati i tretë, duke u vetëfljuar.²³

Më 1 nëntor, një tjetër pacient 52 vjeç u vetëhodh nga dritarja e dhomës ku po trajtohej në spitalin universitar "Shefqet Ndroqi" duke gjetur vdekjen. Sipas të dhënave të disponueshme gjatë kohës së qëndrimit në spitali pacienti nuk ka manifestuar shenja të çrregullimeve psikologjike si në momentin e shtrimit edhe gjatë terapive të mjekimit, janë shprehur autoritetet e spitalit.²⁴ Rasti i tjetër ndodhi më 10 nëntor tek spitali Infektiv, ku një pacient 69- vjeçar, u vetëhodh nga kati i tretë dhe pësoi dëmtime të rënda. Një ditë pas aktit mediat publike raportuan se pacienti humbi jetën.²⁵ Në datën 30 nëntor një tjetër pacient i infektuar me SARS-CoV-2, i moshës 60 vjeç, ku merrte trajtim, u vetëhodh nga dritaret e spitalit universitar "Shefqet Ndroqi", duke gjetur vdekjen e menjëhershme.

3. Ofrimi i mbështetjes psikosociale gjatë pandemisë COVID-19

Krahasuar me shtetet e rajonit të ngjashme me Shqipërinë burimet njerëzore për shëndetin mendor për 100.000 banorë, janë më të ulëtat²⁶.

²² Nela, A., Puci, A., Nika, A., Froku, B. (2020). Praktikimi i distancimit social gjatë pandemisë COVID-19: *Perceptime dhe qëndrime*.

²³ Euronews Albania. (2020, December 12). Third COVID-19 patient in three months commits Suicide in hospital. *Euronews Albania*

²⁴ Halili, E. (2020, November 28). 4th Patient Tries Suicide from Covid. *Albaniandailynews*

²⁵ Exit.al. (2020, December 18). Covid-19 patient commits suicide in Albania. *Exit*

²⁶ WHO (2017). Mental Health ATLAS 2017 Member State Profile

Tabela: Burimet njerëzore për shëndetin mendor.

Shteti	Psikolog	Psikiatër	Punonjës social
Shqipëria	0.56	0.87	0.78
Maqedonia e Veriut	2.40	14.43	1.44
Bosnja dhe Herzegovina	1.53	8.03	0.59
Mali Zi	2.57	8.28	0.80
Serbia	4.55	8.64	0.36

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; 2018., WHO; 2017.

Gjatë fillimit të pandemisë COVID-19, disa institucione publike dhe jopublike, ngritën ofrimin e këshillimeve psikologjike online. Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë, u angazhua dhe ofroi shërbimin psikologjik online falas nga psikologë të shpërndarë në të gjithë territorin e vendit. Gjithashtu dhe disa NGO, filluan të ofronin shërbime online falas. Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, ngriti shërbimin psiko-social pranë shkollave, ku psikologët shkollorë ofruan mbështetje psiko-sociale për nxënësit dhe stafin mësimor. Në një fazë të mëvonshme dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet telefonatave ofroi mbështetjen psikologjike falas. Komunikimet publike nga ekspertët e shëndetit publik, mbeten akoma të kufizuara në transmetimin e informacioneve rreth shëndetit mendor, gjithashtu dhe artikujt e publikuara na websitet zyrtare vendase janë në numër të vogël.

4. Diskutim

Me gjithë ndryshimet e arritura, shërbimet e shëndetit mendor vazhdojnë të jenë të kufizuara dhe të centralizuara, duke mospërdoruar aksesin në to dhe vazhdimësinë e kujdesit për një pjesë të madhe të popullatës së vendit. Ndryshimet e ndodhura në rrjetin e shërbimeve të shëndetit mendor kërkojnë zgjerimin e gamës së profesionistëve të përfshirë në to, jo vetëm në numër, por dhe me profesione të reja. Në Shqipëri u hartua Plani i veprimit për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor 2013-2022, ku theksohet shtimi i shërbimeve të specializuara, në spitale dhe komunitet²⁷. Akoma ky plan nuk është përmbytur dhe paraqet mangësi në burimet njerëzore për shëndetin mendor.

²⁷ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2013). *Plani i veprimit për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor në Shqipëri 2013-2022*.

Si masë parandaluese pas rastit të parë të vetëvrasjes, drejtuesit e spitalit vendosën të mbyllnin me hekura dritaret e godinës së spitalit universitar “Shefqet Ndroqi”. Shoqata e infermierëve ka reaguar në rrjetet sociale lidhur me aktet e vetëvrasjes duke vënë theksin te ngarkesa psikologjike si e pacientëve të shtruar ashtu edhe e stafit mjekësor²⁸.

Drejtuesja e shërbimit të pneumologjisë në spitalin universitar “Shefqet Ndroqi”, ku u vetëvranë katër pacientë të infektuar me SARS-CoV-2, është shprehur në median publike se mjekët krahas punës së tyre e ofrojnë edhe mbështetjen psikologjike.²⁹ Nëna e djalit 29 - vjeçar të vetëvrasë, ka rrëfyer në një televizion publik, se është neglizhuar mbështetja psikologjike për të birin nga stafi mjekësor³⁰. Një mjek që kishte trajtuar pacientin 60-vjeçar i cili u vetëvra më 30 nëntor 2020, raportoi drejtpërdrejt në mediat televizive se pacienti ishte mjekuar për depresion para se të pranohej në spital³¹. Familjarët e pacientit të ndjerë kanë rrëfyer në media se pacienti ishte ankuar në telefon, disa orë para se të kryente vetëvrasjen, se ai nuk po merrte kujdesin e duhur në spital³².

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i raportuar në media nga pacientët e infektuar me COVID-19, është stigma. Disa pacientë të prekur nga koronavirusi, janë shprehur se janë ndier të paragjykuar nga komuniteti ku jetojnë. Sipas tyre janë detyruar të telefonojnë urgjencën në mesnatë, për shkak të mos diktohen nga fqinjët, rrethi shoqëror apo kolegët e punës. Gjithashtu edhe pasi shërohen miqtë e tyre qëndrojnë të distancuar duke i etiketuar si burim infeksioni.³³

²⁸ Kadriu, E. (2020, dhjetor 26). COVID-19, vetëvrasjet në spitale dhe nevoja për këshillim psikologjik. *Citizens-channel*.

²⁹ Euronews Albania. (2020, nëntor 12). Euronews brenda spitalit “COVID Nr: 2”. *Euronews Albania*.

³⁰ Top Channel Albania. (2020, nëntor 27). Neglizhencë nga stafi mjekësor, Lira Koca ngre gishtin e akuzës, djali ishte shumë i shëndetshëm. *Top Channel Albania*.

³¹ ABC News Albania. (2020, nëntor 3). Vetëhidhet nga spitali, mjeku: 60- vjeçari kurohej për probleme të shëndetit mendor *ABC News Albania*.

³² Opinion. (2020, janar 4). Vetëvrasja e 60 - vjeçarit tek “COVID2”, motra: *Më tha këtu duan vetëm lekë. Opinion.al*.

³³ Ristani, J. (2020, Dhjetor 5). Njerëzit e prekur nga Covid-19, krahas problemeve fizike, mendore, financiare që duhet të kapërcejnë, përballen edhe me paragjykimet e njerëzve. *Top Channel Albania*.

5. PËRFUNDIME

Shqipëria kaloi një situatë të vështirë dhe me pasoja njerëzore, sociale dhe ekonomike nga tërmeti i vitit të kaluar. Kjo situatë u pasua edhe me përhapjen e pandemisë COVID-19.

Tashmë efektet psikologjike të pandemisë, ndikohen edhe nga pasojat e trashëguara të tërmetit. Studime të realizuara në disa vende të ndryshme të prekuara nga epidemitë apo pandemitë, paraqesin prezencë të shqetësimeve dhe çrregullimeve psikologjike, të tilla si: depresioni, stresi post-traumatik, ankthi dhe vetëvrasjet. Institucionet përgjegjëse dhe ekspertët e shëndetit publik akoma nuk janë ndërgjegjësuar për rëndësinë e mbështetjes psikologjike për pacientët e infektuar me COVID-19 që trajtohen në spitale. Mospërfshirja e shërbimeve psiko-sociale tek pacientët e hospitalizuar, ndikon në përkeqësimin e shëndetit mendor dhe në sjelljet vetëvrasëse, ku dy raste ndodhën në mjediset spitalore. Krijimi i një linje këshillimi anonime siç po e zbaton sheti i Maltës, do të kotribuonte pozitivisht në ofrimin e mbështetjes psikologjike për stafin mjekësor dhe në rritjen e vetëdijësimit të disa prej drejtuesve të ekipeve mjekësore.

Rekomandime

1. Rritjen e numrit të psikologëve pranë spitaleve që trajtojnë pacientët me COVID-19.
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet të nxisë bashkëpunimin midis stafëve mjekësorë dhe shërbimeve psikosociale në spitale.
3. Ofrimi i shërbimit psiko-social pranë shërbimit shëndetësor parësor.
4. Krijimi i task-force lokale të mjekëve të familjes dhe profesionistëve të shëndetit mendor pranë qendrave të shërbimit parësor, për të trajtuar bashkërisht individët që paraqesin shqetësime psikologjike nga infeksioni SARS-CoV-2.
5. Hapja e qendrave për ofrimin e shërbimeve psiko-sociale në zonat e disavantazuara.

Referenca

- ABC News Albania. (2020, Nëntor 3). Vetëhidhet nga spitali, mjeku: 60-vjeçari kurohej për probleme të shëndetit mendor *ABC News Albania*. <https://www.youtube.com/watch?v=-2Fq2XaL1UY>
- Agatti A. (2020, November 20). Aspetta il risultato del tampone, si getta dalla finestra e muore. *La Provincia*.

<https://laprovinciapavese.gelocal.it/pavia/cronaca/2020/03/13/news/aspeta-il-risultato-del-tampone-si-getta-dalla-finestra-e-muore-1.38590571>

- Ahmedani BK, Peterson E.L., Hu, Y., Rossom, R.C., Lynch, F., Lu, C.Y., Waitzfelder, B.E., Owen-Smith, A. A., Hubley, S., Prabhakar, D., Williams, L.K., Zeld, N., Mutter, E., Beck, A., Tolsma, D., & Simon, G.E. (2017). Major physical health conditions and risk of suicide. *American Journal Medicine, Vol 53*, 308–15. [https://doi: 10.1016/j.amepre.2017.04.001](https://doi.org/10.1016/j.amepre.2017.04.001).
- ANSA. (2020, November 27). Positivo al coronavirus sisuicida buttandosi da una finestra dell'ospedale di Cremona, *Huffingtonpost.it*, https://www.huffingtonpost.it/entry/positivo-al-coronavirus-si-suicida-buttandosi-da-una-finestra-dellospedale-di-cremona_it_5e7b2d95c5b6d01bd154b3af
- Anteprima.it. (2020, December 10). “San Pio”, dramma in mattinata: 78enne positivo al covid-19 si toglie la vita. *Anteprima24.it*. <https://www.anteprima24.it/benevento/tragedia-suicidio-covid-sanpio/>
- Bhuiyan I, A. K. M., Sakib, N., Pakpour, A. H., Griffiths, M, D., & Mamun, M A. (2020). COVID-19-related suicides in Bangladesh due to lockdown and economic factors: Case study evidence from media reports, diction. *International Journal of Mental Health and Addiction*, 1-5. <https://doi.org/10.1007/s11469-020-00307>
- Czeisler, E. M., Lane. I. R., Petrososky, E., Wiley, F. J., Christensen, A., Nj, R., Weaver, D. M., Robbins, R., Facer-Childs, R. E., Barger, K. L., Howard, E. M., & Rajaratnam, M.W.Sh. (2020). Mental health, substance use, and suicidal ideation during the COVID-19 Pandemic United States, June 24–30, 2020: *MMWR, Weekly, Vol. 69, No. 32*. 69(32), 1049–1057. <https://www.cdc.gov/mmwr/volumes/69/wr/pdfs/mm6932a1-H.pdf>
- Dawel, A., Shou, Y., Smithson, M., Cherbuin, N., Banfield, M., Caelear, A. L., Housen, T., McCallum, S.M., Morse, A.R., Murray, K., Newman, E., Rodney Harris, R.M., & Battergam, P. J. (2020). The Effect of COVID-19 on mental health and wellbeing in a representative sample of australian adults. *Frontiers in Psychiatry, 1-5*. <https://doi.org/10.3389/fpsy.2020.579985>
- Dsouza, D, D., Quadros, Sh., Hyderabadwala, Z, J., & Mamun, M. A. (2020). Aggregated COVID-19 suicide incidences in India: Fear of COVID-19 infection is the prominent causative factor. *Psychiatry Research 290*, (2020), 113-145. <https://doi.org/10.1016/j.psychres.2020.113145>
- Euronews Albania. (2020, nëntor 12). Euronews brenda spitalit “COVID Nr: 2”. *Euronews Albania*.

- <https://www.youtube.com/watch?v=2BS3ILqYial&feature=youtu.be>
- Euronews Albania. (2020, December 12). Third COVID-19 patient in three months commits Suicide in hospital. *Euronews Albania*. <https://euronews.al/en/daily-news/2020/11/01/third-covid-19-patient-in-three-months-commits-suicide-in-hospital>
 - Exit.al. (2020, December 18). Covid-19 patient commits suicide in Albania. *Exit.al* <https://exit.al/en/2020/11/30/covid-19-patient-commits-suicide-in-albania/>
 - Gunnell, D., Applepy, L., Arensman, E., Hawton, K., John, A., Kapur, N., Khan, M., O'Connor, R.C., Pirkis, JandCOVID-19 Suicide Prevention Research Collaboration. (2020). Suicide risk and prevention during the COVID-19 pandemic. *TheLancet Psychiatry*, Vol 7, 468-470. [https://doi.org/10.1016/S2215-0366\(20\)30171-1](https://doi.org/10.1016/S2215-0366(20)30171-1)
 - Halili, E. (2020, November 28). 4th Patient Tries Suicide from Covid. *Albaniandailynews*.<https://albaniandailynews.com/news/4th-patient-commits-suicide-by-jumping-from-covid-hospital-1-1-1-1>
 - Instat. (2018). Treguesit e shëndetit publik, pp 6. <http://www.instat.gov.al/media/6116/treguesit-e-shendetit-publik-2018.pdf>
 - Kadriu, E. (2020, dhjetor 26). COVID-19, vetëvrasjet në spitale dhe nevoja për këshillim psikologjik. *Citizens-channel*. <https://citizens-channel.com/2020/09/04/covid-19-vetevrasjet-ne-spitale-dhe-nevoja-per-keshillim-psikologjik/>
 - MedCOI. (2020). *Country Policy and information note albania: Mental healthcare, Version 1.0*, https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/886754/ALB_-_Mental_Health_-_CPIN_-_V1.0_May_2020.pdf
 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Instituti i Shëndetit Publik. (2011). Të dhëna të përgjithshme mbi vetëvrasjet. *Revista Mjekësore*, Nr: 1, pp 108-109.
 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2013). *Plani i veprimit për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor në Shqipëri 2013-2022*, pp 14-17. https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Plani_i_Vperimit_per_Zhvillimin_e_Sherbimeve_te_Shendetit_Mendor_2013_-_2022.pdf
 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Instituti i Shëndetit Publik. (2019). Plan veprimi për Shqipërinë: COVID – 19; Parandalimi, përgatitja dhe përgjigjja kundër COVID-19, pp 5. https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Covid_AL-spreads.pdf

- Nela, A., Puci, A., Nika, A., Froku, B. (2020). Praktikimi i distancimit social gjatë pandemisë COVID-19: Perceptime dhe Qëndrime, pp 34 *Opinion*. (2020, Janar 4). Vetëvrasja e 60-vjeçarit tek “COVID2”, motra: Më tha këtu duan vetëm lekë. *Opinion.al*. <https://opinion.al/vetevrasja-e-60-vjecarit-tek-covid2-motra-me-tha-ketu-duan-vetem-leke/> 2.12.2020
- Reeves, A., McKee, M., Stuckler D. (2014). Economic suicides in the Great Recession in Europe and North America. *The British Journal of Psychiatry*, Vol, 205, 246–247. <https://doi: 10.1192/bjp.bp.114.144766>
- Reger, M. A., Stanley, MS, & Thomas, E. J. (2020). Suicide mortality and coronavirus disease 2019-A perfect storm? *JAMA Psychiatry*. <https://doi:10.1001/jamapsychiatry.2020.1060>
- Ristani, J. (2020, Dhjetor 5). Njerëzit e prekur nga Covid-19, krahas problemeve fizike, mendore, financiare që duhet të kapërcejnë, përballen edhe me paragjykimet e njerëzve.. *Top Channel Albania*. <https://top-channel.tv/2020/09/27/covid-19-dhe-paragjykimi-i-telefonojne-naten-127-es-pasi-duan-qe-te-mos-marrin-vesh-fqinjjet/>
- Sher, L. (2020). The impact of the COVID-19 Pandemic on suicide rates: *An International Journal of Medicine*, Vol 0, No. 0, 1–6. <https://doi.org/10.1093/qjmed/hcaa202>
- Top Channel Albania. (2020, Nëntor 27). Neglizhencë nga stafi mjekësor Lira Koca ngre gishtin e akuzës, djali ishte shumë i shëndetshëm. *Top Channel Albania*. <https://top-channel.tv/video/neglizhence-nga-stafi-mjekesor-lira-koca-ngre-gishtin-e-akuzes-djali-ishte-shume-i-shendetshem/>
- USAID, Avokati i Popullit (2018). Raport Tematik: Transparenca në sistemin shëndetësor mendor, pp 10. https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORT%20TEMATIK%20-%20Transparence%20ne%20sistemin%20e%20shendetit%20mendor_mRz92bi.pdf
- Vantoros S, Avendano, M., & Kawachi, I. (2019) The Association between Economic Uncertainty and Suicide in the short-run. *Social Science&Medicine*, Vol 220, 403–10. <https://doi: 10.1016/j.socscimed.2018.11.035>
- Värnik, A. (1991). Suicide in Estonia. *Acta Psychiatr Scand*, Vol: 84, 229–230. <https://doi: 10.1111/j.1600-0447.1991.tb03135.x>
- WHO. (2017). *Mental Health ATLAS 2017 Member State Profile, 1*. https://www.who.int/mental_health/evidence/atlas/profiles-2017/ALB.pdf?ua=1
- Williams. A, G., Scarpetti, G., Bezzina, A., Vincenti, K., Grech, K., Kowalska-Bobko, I., Sowada, Ch., Furman, M., Gałazka-Sobotka, M.,

- & Maier. B, C. (2020). How are Countries Supporting their Health Workers During COVID-19? *Eurohealth* 2020, 26(2), 60, 61. <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/336298/Eurohealth-26-2-58-62-eng.pdf>
- Y. T. Cheung., P. H. Chau., & Paul S. F. Yip. (2008). A revisit on older adults suicides and Severe Acute Respiratory Syndrome (SARS) epidemic in Hong Kong, 1232-1234, <https://doi.org/10.1002/gps.2056>

PROJEKTI EDUKATIV “TAKOJ EMOCIONET”.

*Ndërhyrje parësore ndaj varësive
dhe promovuese e shëndetit mendor të njeriut*

Loreta Tomaj

*Psikologe klinike, drejtoreshë e Komunitetit Edukativ,
shërbim rezidencial për të mitur jetimë të Bashkisë Shkodër*

ABSTRAKT

“Takoje emocionet” është një projekt edukativ projektuar dhe realizuar nga shkruësja e këtij punimi, përshkruës dhe ilustrues, për nxënësit e klasave X të Gjinnazit “Atë Pjetër Meshkalla”. Meqë ka si objekt njohjen dhe mbarështimin e emocioneve, projekti shërben si ndërhyrje parësore ndaj varësive dhe promovuese e shëndetit mendor të njeriut.

Metodologjia didaktike e përdorur për mbërritjen e këtij qëllimi është ajo eksperienciale/përvojore (*experiential learning*): nxënësit përfshihen emocionalisht, shfaqin marrëdhënien me botën që i rrethon, bëjnë përvoja dhe reflektime që e kthejnë formimin në nxënie.

Karakteret e përzier cilësor dhe sasior të këtij hulumtimi vihet re në përdorimin p.sh. të fokus-grupeve, role playing-ve apo në bërjen e paratesteve dhe pastesteve, të pyetësorëve mbi punën në grupe dhe vlerësimin final të projektit, si dhe në hartimin e këtyre të fundit me pyetje të hapura dhe të mbyllura.

Kohëzgjatja e projektit, 18 orë, nuk është e mjaftueshme që të brendësohen skema të reja sjelljeje për t’i përdorur ato në situata të tjera dhe në mënyrë krijuese. Ai do të kishte rezultate më të qëndrueshme nëse para ose njëkohësisht një projekt i tillë do të zhvillohej edhe me mësuesit dhe prindërit.

Pjesëmarrësit mbivlerësojnë inteligjencën konjitive ndaj asaj emocionale; kanë një fjalor të varfër në emërtimin e emocioneve dhe aftësi relative reflektimi, duke e bërë kështu të domosdoshëm zhvillimin e tij, edhe ashtu siç është programuar, në çdo fushë ku synohet t’i kushtohet vëmendja e duhur botës emocionale dhe mbarështimit të pjekur të saj.

Fjalët kryesore: emocion, mbarështim, inteligjencë emocionale, përvojë, reflektim, veprim.

**Educational project “Meet the emotions”.
Primary intervention against addictions
and promoter of human mental health**

ABSTRACT

“Meet the emotions” is an educational project designed and realized by the author of this article, descriptive and illustrative, for the students of the 10th grades of the High School “Atë Pjetër Meshkalla”. As it focuses on the recognizing and nurturing emotions, the project serves as a primary intervention against addictions and a promoter of mental health.

The didactic methodology used to achieve this goal is the experimental learning: students are emotionally involved, they display the relationship with the world around them, they make experiences and reflections which transform formation into learning.

The mixed qualitative and quantitative character of this research is observed in the use of focus groups, role playing or in doing pre-tests and post-tests, of questionnaires on group work and the final evaluation of the project, as well as in their compiling with open and closed questions.

The project duration of 18 hours, is not enough to internalize new behavioral schemes in order to use them in other situations and creatively. It would have more stable results if before or at the same time such a project would be developed with teachers and parents.

The participants overestimate cognitive versus emotional intelligence; they have a poor vocabulary in naming emotions and relative reflection skills, thus making its development necessary, even as it is programmed, in any field where it is intended to pay attention to the emotional world and its mature management.

Key words: emotion, management, emotional intelligence, experience, reflection, action.

1. “Takoj emocionet” si përgjigje ndaj kontekstit

Gjatë punës si psikologe shkolle kam asistuar në situata ku të rriturit kanë udhëzuar njëri-tjetrin apo më të vegjlit se çfarë duhet të ndiejnë dhe çfarë jo (“Mos u dëshpëro për një fjalë goje”, “S’mund të jesh xheloz/e për vëllain/motrën tënd/e”) dhe si duhet t’i shprehin emocionet (“Ti je djalë dhe djemtë nuk qajnë”, “Mos i thuaj kujt se si ndihesh, pasi ta marrin për

dobësi”) dhe jam njohur me raste ku personat, duke parë reagimin e të tjerëve, kanë mësuar t’i filtrojnë ato, duke u dhënë disave të drejtën për të ekzistuar e disa të tjerëve jo (Cerato, 2003, f. 70-71).

Gjatë seancave si psikologe klinike kam njohur persona që vuanin nga çrregullimet e ankthit apo nga varësi të ndryshme (Tramacere, 1985, f. 41), që ndiheshin pasivë dhe izoloreshin (Montuschi, 1983, f. 139), të paaftë për të falur (Testa, 2016, f. 10; Monbourquette, 2020, f. 7; Grün, 2020, f. 47-52), që kishin nevojë për t’u motivuar (Orhani, 2006, f. 36) dhe që besonin se dalja nga kjo gjendje ishte e pamundur (Harris, 2014 f. 90).

Nga ana tjetër, gazetatat përmbajnë shkrime që flasin për “vrasje për motive të dobëta”¹ apo për persona që dhunohen e dhunojnë².

I gjithë ky kuadër, sintetik dhe jo shterrues, realizuar përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë, tipik i kërkimeve cilësore (Dizdari, 2012), vë në dukje se ajo që i bashkon këta persona është mënyra se si ata i perceptojnë emocionet dhe se si i mbarështojnë ato (Bissi, 2020, f. 144-176). Prej këtujve rrjedh domosdoshmëria për ta përqendruar vëmendjen personale dhe profesionale te zhvillimi i aftësive të inteligjencës emocionale, përmes njohjes dhe mbarështimit³ të emocioneve, gjë që do të çonte në një edukim të gjithanshëm dhe harmonik të një njeriu të lirë dhe të përgjegjshëm (Piccolo, 2019, f. 12-13).

Duke ditur se varësitë janë një mënyrë për t’i shmangur pakënaqësitë që lindin prej realitetit ku njerëzit jetojnë⁴ dhe se ndjenjat e

¹ Pa autor (2020.11.28). *Vrasja e Ridvan Ramazanit, policia: Ka ndodhur për motive të dobëta*. KOHA JONË. Marrë nga: <https://kohajone.com/vrasja-e-ridvan-ramazanit-policia-ka-ndodhur-per-motive-te-dobeta/>; Pa autor (2014.01.08). *Masakër xhelozie në Korçë, 4 të vrarë për një lidhje jashtë martese*. MAPO. Marrë nga: <https://gazetamapo.al/masaker-xhelozie-ne-korce-4-te-vrare-per-nje-lidhje-jashte-martese/>.

² Pa autor (2018.08.22). *Violenza psicologica sul lavoro, non solo "mobbing": c'è anche lo "straining"*. TODAY. Marrë nga: <https://www.today.it/economia/mobbing-straining-differenza.html>.

³ Sipas *Fjalorit të Shqipësisë së Sotme* emri *mbarështim* ka kuptimin “2. Tërësia e mënyrave që përdoren dhe e masave që merren për të mbarështuar një pasuri a diçka tjetër me vlerë”, kurse folja *mbarështoj* ka kuptimin: “Kujdesem për tokën, për shtëpinë e për çdo gjë me vlerë që të vejë mirë e mbarë, ashtu si duhet”. Në këtë artikull janë përdorur termat *mbarështim* dhe *mbarështoj*, edhe pse në literaturë të ndryshme në shqip apo në përdorimin e përditshëm, edhe për këtë tematikë, përdoren termat *menaxhim*/*menaxhoj*, pikërisht për të treguar se në këtë “pasuri a diçka tjetër me vlerë” bën pjesë edhe bota jonë emocionale e afektive dhe gjithçka tjetër që ka lidhje me të, me qëllim që gjithçka “të vejë mirë e mbarë, ashtu si duhet” [Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002). *Fjalori i Shqipërisë së Sotme* (2). Tiranë: Toena].

⁴ Pa autor (2015.08.30). *Cosa nascondono le dipendenze*. LA MENTE È MERAVIGLIOSA: Marrë nga: <https://lamenteemeravigliosa.it/cosa-nascondono-le-dipendenze/>.

boshllëkut apo të apatisë shpesh shfaqen me qëndrime hiperaktive apo agresive, sjellje vetshkatërruese, përdorim alkooli etj. (Tramacere, 1985), Atë Mario Marafioti, themelues i Komunitetit Emanuel⁵, pohon se varësia parandalohet edhe përmes hartimit të projekteve për adoleshentë e të rinj⁶, ndërhyrje këto që, duke qenë parësore, mund t'u drejtohen të gjithëve, por kryesisht grupmohës që potencialisht mund të shfaqë një problematikë të tillë, me qëllim promovimin e kompetencave specifike⁷.

Gërshetimi i interesave personale me angazhimet e mia profesionale çoi në hartimin për adoleshentë të Projektit edukativ “Takoj emocionet”, i cili, në fushën klinike, është një ndërhyrje parësore ndaj varësive dhe, si e tillë, promovuese e shëndetit mendor të njeriut. Kjo “praktikë e mirë” u ofron pjesëmarrësve mundësinë për të njohur dhe mbarështuar në mënyrë të pjekur botën e tyre emocionale, që, përmes një metodologjie didaktike eksperienciale/përvojore, nxit te ata nxënien dhe aktivizimin e disa *aftësive* dhe *kompetencave* specifike, si p.sh.: aftësitë për të pritur apo kompetencën për të zgjidhur problemet, me qëllim parandalimin e mundshëm të disa prej çrregullimeve të aksit të parë të DSM 6: çrregullimet e ankthit, të humorit, të sjelljes ushqimore dhe të çrregullimeve të lidhura me përdorimin e substancave psikotrope, në fushën e marrëdhënieve brendapersonale dhe ndërpersonale⁸.

Gjimnazi privat “Atë Pjetër Meshkalla” Shkodër, duke njohur kontekstin e paraqitur më sipër dhe duke dëshiruar të japë kontributin e vet në përmirësimin e tij, sidomos në fushën e varësive, e ka vlerësuar projektin edukativ “Takoj emocionet” si një instrument që i përgjigjet këtij qëllimi dhe që është në përkim me pedagogjinë e vet didaktike injaciane⁹. Duke e përfshirë projektin në Planin e Ofertës Formative të shkollës, përmes të cilit vë në jetë Projektin e vet Edukativ¹⁰, kjo shkollë ka vendosur

⁵ Pa autor dhe pa datë. *La Comunità Emmanuel*. Sito della Comunità Emmanuel. Marrë nga: <https://www.emmanuel.it/chi-siamo/>.

⁶ Marafioti, M. *Problemi drogë*. Siti i Komunitetit Emanuel Shqipëri. Marrë nga: <http://www.komunitetiemanuel.org/?p=151>.

⁷ Valenti, L. (2012.10.31). *Prevenire o curare? Tipi e modalità di intervento in ambito clinico*. STATE OF MIND: il giornale delle scienze psicologiche. Marrë nga: <https://www.stateofmind.it/2012/10/prevenire-curare-intervento/>.

⁸ Gabbard, G.O. (2002). *Psichiatria psicodinamica* (3). Milano: Raffaello Cortia Editore. Osmanaga, F. (2011). *Psikopatologji*. Shkodër: Dispencë universiteti e fotokopjuar.

⁹ Carmagnani, R., Danieli, M. e Denora, V.C.M. (2017). *Një paradigmë pedagogjike didaktike për një shkollë që ndryshon. Një sfidë edukative për mijëvjeçarin e tretë*. Shkodër: VOLAJ.

¹⁰ Projekti Edukativ i Gjimnazit privat “Atë Pjetër Meshkalla” Shkodër vë në qendër personin dhe ka si qëllim rritjen e gjithanshme e harmonike të të riut (...) i cili arrin të bëhet gjithnjë e më i pjekur sa më shumë që të gjitha pasuritë e tij të brendshme

që ai të zhvillohet me nxënësit e klasave X, në fillim të çdo viti të ri shkollor.

2. “Takoj emocionet” në krijim e sipër

Titulli i projektit edukativ, “Takoj emocionet”, në mënyrë konçize shpreh qëndrimin e atij, që në një rol apo në një tjetër, është pjesë e tij.

“Takoj” është folje¹¹ dhe tregon se subjekti po kryen një veprim dhe mënyrën se si po e kryen atë: në qendër të ndërhyrjes edukative, protagonist i përmirësimit të vetes dhe të shoqërisë, i ftuar që të jetojë “këtu dhe tani” (Stewart e Joines, 2013, f. 31).

Emri “Emocionet”¹² tregon në mënyrë të menjëhershme se cili është objekti i projektit dhe tregon gjendjen e brendshme të personit që merr pjesë në të, siç e shpreh edhe etimologjia e termit¹³. Numri shumësi tregon se ne provojmë një larmi emocionesh, gjë që nuk merret si e mirëqenë prej të gjithëve.

Me konceptet kyç të librit të Bissi-it (2020), psikologe dhe psikoterapeute italiane, është hartuar një dispencë që nxënësit përmes studimit, diskutimeve në fokus grupet dhe përgatitjes së roleve playing-ve mbi to, t’i kthejnë në njohuri dhe, përmes aftësive e kompetencave, t’i integrojnë ato, me qëllim që të ruajnë në zemër kujtimin e tjetrit, edhe kur ndaj tij provojnë ndjenja të forta tensioni dhe zemërimi (Bissi, 2004, fq. 68-69).

Sipas saj, emocionet¹⁴, në varësi të drejtimit të shtytjes që ushtrojnë brenda nesh, ndahen në *Emozione larg...* përfshihen emocionet që i provojmë kur ndihemi të kërcënuar prej dikujt/diçkaje (frikë), kur kemi

(sensibilitet, afektivitet, inteligjencë, vullnet etj.) do të zhvillohen e integrohen për një realizim sa më të plotë të vetvetes dhe për krijimin e marrëdhënieve të drejta e të sinqerta me të tjerët (Shkolla e mesme jopublike “Atë Pjetër Meshkalla” (2006). *Projekti Edukativ*. Shkodër: Broshurë e fotokopjuar, f. 4.6).

¹¹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002), vep. cit.

¹² Po aty.

¹³ Termi *emocion* në shqip vjen nga italishtja *emozione*, që e ka marrë nga frëngjishtja *emotion*, që rrjedh nga latinishtja e vonë *emotiōne(m)*, emër ky i formuar nga pjesorja e shkuar *emōtus* e foljes *emovere*, që do të thotë tund, shkund, luaj nga vendi, siç e shpreh mirë përbërja e saj: *parashtesa e* do të thotë *jashtë, përjashta*, kurse rrënja *movere* do të thotë *nxis, lëviz, tund, shkund* (Kotsou, 2012, f. 6. De Mauro, T. e Lorenzetti, L. *Lemma emozione*. Lemma. Marrë nga: <http://www.educational.rai.it/lemma/testi/radioelevisione/emozione.htm>.)

¹⁴ Në këtë tekst autorja përdor termin “emocion” si sinonim të termave “gjendje shpirtërore” dhe “ndjenjë”. Për më shumë shih: Ianes, D. e Demo, H. (2007). *Educare all'affettività. A scuola di emozioni, stati d'animo e sentimenti*. Trento: Erickson.

frikë prej pasojave që mund të vijnë nga realizimi i asaj që duam (mërzi), kur vlerësojmë veten negativisht (turp) dhe kur thyejmë normat/rregullat (ndjenjë faji); në *Emocione kundër...* përfshihen emocionet që i provojmë kur dikush/diçka na pengon në arritjen e një qëllimi që i kemi vënë vetes (zemërimi), kur dikush ka diçka që ne nuk e kemi dhe që dëshirojmë ta kemi (zili) apo kur kemi frikë se humbasim lidhjen e privilegjuar që kemi me dikënd (xhelozia); në *Emocione pa...* përfshihen emocionet që i provojmë kur dikush/diçka, e çmueshme, largohet prej nesh në mënyrë të përhershme (dëshpërimi) apo të përkohshme (trishtimi, malli) dhe në *Emocione drejt...* përfshihen emocionet që na bëjnë të ndihemi mirë me veten (eufori), me të tjerët (gëzimi) dhe që na shtyjnë t'u afrohemi të tjerëve (dhembshuria, solidariteti, simpatia, mirënjohja, tërheqja, pasioni dhe mahnitja).

Niveli i pjekurisë së një personi shfaqet edhe prej mënyrës se si ai i mbarështon emocionet e veta, domethënë nëse përdor mënyra të papjekura apo të pjekura për mbarështimin e tyre. Mënyrat e papjekura përfshijnë dy tipologji: *përgjigjet e menjëhershme*, ku bëjnë pjesë: plotësimi instinktiv (përdorimi i substancave, ngrënia pa limit), acting out (kërcitja e gishtave, lëvizja e këmbës gjithë kohën) dhe fight or flight (mësymja e dikujt apo largimi nga situata që shkakton tension); përdorimi i *mekanizmave mbrojtës* kur nuk pranojmë emocione të caktuara: mospranimi i brishtësisë çon në përdorimin e projektimit dhe të mohimit, mospranimi i nevojës çon në izolim, mospranimi i agresivitetit bën që të racionalizojmë dhe të zhvendosim objektin e shkarkimit të emocionit tonë, mospranimi i trishtimit vë në veprim reagimin e kundërt dhe mospranimi i fajit kompensohet nga shfuqizimi prapaveprues, gjë që sjell njohjen e dinamikave të pavetëdijshme të gjithsecilit (Pangrazzi, 1997, f. 57-65). Ndërsa mënyrat e pjekura kanë të bëjnë me *aftësinë për të hequr dorë*, duke shtyrë për një moment më të përshtatshëm plotësimin e një nevoje apo dëshire; me përdorimin e *mekanizmave përshtatës*, siç është hershimi, pezullimi dhe humorizmi; si dhe me *aftësinë për të integruar* kriterin e zgjedhjeve më pëlqen/s'më pëlqen me më bën mirë/s'më bën mirë, duke gjetur kështu kohën e përshtatshme dhe rrethanën e duhur për t'i bashkëndarë ato me të tjerët (Carmagnani e Titta, 2012, f. 29).

Këto njohuri pjesëmarrësit i kanë vënë në zbatim gjatë zgjidhjes së problemeve që u kanë lindur, duke ushtruar atë që Goleman (2011), psikolog amerikan, quan inteligjencë emocionale: aftësia e personit për të provuar emocione joracionale dhe për t'i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme. Ajo ushtrohet përmes pesë aftësive: *vetëdija emocionale* ka të bëjë me aftësinë për të dalluar momentin e lindjes së një emocionit dhe për

t'i dhënë një emër atyre në një situatë të caktuar, për të njohur sinjalet fiziologjike që shoqërojnë lindjen e një emocioni dhe për të kuptuar shkaqet që çojnë në lindjen e një emocioni; *kontrolli emocional* shfaqet kryesisht nëpërmjet kontrollit të impulseve dhe të emocioneve, kontrollit të agresivitetit drejtuar kah të tjerët dhe kontrollit të agresivitetit drejtuar kah vetvetja; *motivimi* ka si tregues kryesor aftësinë për të kanalizuar dhe harmonizuar fluksin e emocioneve pozitive dhe neutralizuar ato negative, me qëllim arrijtjen e një objektivi dhe prirjes për të reaguar në mënyrë aktive ndaj dështimeve dhe frustrimit; *empatia* përfshin aftësinë për të njohur treguesit emocionalë të të tjerëve, ndjeshmërinë ndaj emocioneve dhe bashkëndarjen e tyre dhe marrjen e perspektivave të të tjerëve; kurse *mbarështimi i efektshëm i marrëdhënieve ndërpersonale* përcakton aftësinë për të negociuar konfliktet duke gjetur një zgjidhje dhe aftësinë për të komunikuar në mënyrë të efektshme me të tjerët.

Të gjitha këto njohuri dhe aftësi, kthehen në kompetenca¹⁵ *learning cycle/ciklit* të të nxëniet, i cili, sipas Kolb (1984), teoricien edukativ amerikan, përcakton katër fazat e *experiential learning-ut*/të të nxëniet përvojor: *përvoja konkrete*: në fazën e parë pjesëmarrësit vënë në provë aftësitë dhe njohuritë e veta të mëparshme nëpërmjet një veprimtarie të simuluar; *vëzhgimi reflektiv*: në këtë fazë pjesëmarrësit reflektojnë mbi veprimtarinë e simuluar dhe shqyrtojnë atë që ka dalë prej përvojës së bërë; *konceptualizime abstrakte*: informacionet e fituara skematizohen për t'u ambientuar dhe zbatuar në realitetin konkret të pjesëmarrësve dhe *eksperimentimi aktiv*: në këtë fazë të fundit, përmes vënies në praktikë të njohurive të reja, ndodh verifikimi i tyre dhe krijimi i një përvoje të re konkrete.

Kompetencat që fitojnë personat kur marrin pjesë në veprimtari të organizuara sipas metodologjisë përvojore janë: *problem solving-u*: veprimtaritë e propozuara kërkojnë zgjidhjen e një sfide duke përdorur saktësisht aftësitë që pjesëmarrësit përdorin në mjedisin e tyre të jetës (Stewart e Joines, 2013, f. 341); *krijimtaria*: të menduarit krijues, duke qenë mjet për lindjen e ideve të reja dhe gjithnjë e më komplekse (Orhani, 2004, f. 164), nxitet prej nevojës për të eksperimentuar strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi apo organizimin e një veprimtarie përpara se të arrihet deri te gjetja më funksionale; *feedback-u i efektshëm*: veprimtaritë janë projektuar për ta nxitur grupin që të komunikojë, të

¹⁵ Ventura, B.M. (2011, nëntor). *Abilità e competenze*. Sito del Liceo economico-sociale
Marrë nga: <https://www.liceoeconomicosociale.it/wp-content/uploads/2013/04/COMPETENZE-Documenti.pdf>.

diskutojë dhe të japë *feedback*-e të sakta dhe të dobishme për njëri-tjetrin; *besimi*: dalja nga zona e konfortit në një kontekst mbështetës dhe sigurie psiko-fizike për të zbatuar me sukses aftësitë vetjake rreth një problemi të panjohur përforcojnë besimin te vetja dhe te të tjerët.

3. “Takoj emocionet” në veprim e sipër

Projekti është paraprirë nga një mbledhje informuese me mësuesit kujdestarë të klasave X dhe nga dy mbledhje përgatitore me animatorët, ish-nxënës të shkollës apo jo¹⁶, ku janë paraqitur qëllimet dhe objektivat e “Takoj emocionet”, programi i projektit dhe roli i tyre gjatë zhvillimit të projektit. Ai është zhvilluar të shtunave dhe ka pasur në dispozicion 18 orë, të cilat janë ndarë në gjashtë takime: takimi i parë 6 orë, takimi i dytë deri te takimi i pestë nga 2 orë dhe takimi i gjashtë 4 orë. Duke qenë 5 klasa X, ato janë ndarë në dy grupe: klasat XA, XB e XC dhe klasat XD e XE.

Takimin e parë, pas bans-eve¹⁷ është bërë paraqitja e “Takoj emocionet” dhe janë bashkëndarë pritshmëritë e pjesëmarrësve. Është vijuar me shikimin e filmit¹⁸ dhe me *brainstorming*-un¹⁹, gjatë të cilit nxënësit kanë bashkëndarë emocionet që kanë përjetuar gjatë tij. Më pas, janë ndarë në grupe, të cilëve u kanë vënë nga një emër²⁰, dhe mbi bazën e asaj që ka dalë gjatë *brainstorming*-ut kanë përcaktuar një temë, të cilën e kanë thelluar gjatë projektit dhe mbi të cilën kanë përgatitur një punim, që e kanë paraqitur takimin e fundit të projektit. Pas bërjes së paratestit të njohurive dhe dhënies së detyrave të shtëpisë kjo ditë është mbyllur me një tjetër bans.

¹⁶ Në projekt janë përfshirë, me dëshirën e tyre, 32 ish-nxënës dhe 4 jo të tillë, në rolin e animatorit, trajtuar në dy takime paraprake. Kanë bashkëdrejtuar apo drejtuar ushtrimet klimëngrohëse, kanë lehtësuar punën në grupe të nxënësve, kanë marrë pjesë në mbledhjet verifikuese bërë në fund të çdo takimi dhe në fund të krejt projektit etj.

¹⁷ Bans-et (**B**alli **a**nimati = Kërcime të gjallëruara) përdoren për të bashkuar grupet që nuk njihen dhe për të mbushur momentet e zbrazëta mes një aktiviteti dhe një tjetri (Pa autor dhe pa datë. *Bans*. ScoutWiki. Marrë nga: <https://it.scoutwiki.org/Bans>).

¹⁸ Filmi, si strategji stimuluese, lind si nevojë për të pasur një instrument të aftë për ta marrë vëmendjen e pjesëmarrësve dhe për të zvogëluar ndërhyrjen e të rriturve. Ai duhet të ketë disa karakteristika: të respektojë ndjeshmërinë personale dhe kulturore të shikuesve, të jetë i përshtatshëm për moshën e tyre dhe i aftë të aktivizojë procese identifikimi “pozitiv”. Gjatë zhvillimit të projektit janë përdorur dy filma: “The Truman Show” dhe “Into the Wild”.

¹⁹ Grom, B. (1981). *Metodi per l'insegnamento della religione, la pastorale giovanile e la formazione degli adulti*. Torino: ELLE DI CI, f. 44. Vopel, K.V. (1994). *Giochi di interazione per adolescenti e giovani*. Volume 4. Torino: ELLE DI CI, f. 162-164.

²⁰ Disa prej këtyre emrave janë: Sherraxhijtë, Unikët, Rain Bow, Emo Girls.

Takimin e dytë dhe të tretë, pas ushtrimeve klimëngrohëse²¹, realizuar sipas metodologjisë përvojore, secila klasë në oraret përkatëse ka vijuar me bashkëndarjen e detyrave të shtëpisë. Sipas programit, secili prej grupeve të nxënësve ka studiuar nga një emocion, të një kategorie të caktuar emocionesh, ka biseduar rreth tij dhe mënyrës se si secili e jeton atë emocion në jetën e vet dhe ka përgatitur një dramatizim, të cilin pastaj e ka paraqitur përpara klasës. Me dhënien e detyrave të shtëpisë dhe banset janë mbyllur edhe këto dy ditë.

Takimin e katërt dhe të pestë, pas ushtrimeve klimëngrohëse, secila klasë ka vijuar me bashkëndarjen e detyrave të shtëpisë. Sipas programit, secili prej grupeve të nxënësve ka studiuar nga një përgjigje të pjekur apo të papjekur për mbarështimin e emocioneve, ka biseduar rreth saj dhe mënyrës se si secili i mbarështon emocionet në jetën e vet dhe ka përgatitur një dramatizim, të cilin pastaj e ka paraqitur përpara klasës. Ditën e pestë çdo nxënës ka plotësuar pyetësorin për vlerësimin e punës në grup. Dhënia e detyrave të shtëpisë dhe banset kanë shënuar mbylljen edhe të këtyre dy takimeve.

Takimin e gjashtë, kanë marrë pjesë të gjitha klasat që kanë filluar projektin së bashku, pas ushtrimeve klimëngrohëse është vijuar me një përmbledhje të shkurtër të projektit, që nxënësit të lidhnin bashkë të gjitha veprimtaritë dhe të arrinin të përpunonin përvojën e bërë. Pasi grupet kanë paraqitur punimin e tyre mbi temën e zgjedhur në fillim, në forma të larmishme, është vijuar me vlerësimin e punimeve dhe me zgjedhjen e fituesve. Është vijuar me plotësimin e pastestit të njohurive dhe të pyetësorit të vlerësimit të projektit. Shikimi i fotove bërë gjatë projektit, fotoja-kujtim sipas klasave dhe intervistimi me dëshirë i disa nxënësve dhe mësuesve ka shënuar mbylljen e projektit edukativ “Takoj emocionet”.

Në fund, është përgatitur një relacion mbi mbarëvajtjen e projektit, i cili është bashkëndarë me drejtorinë e shkollës.

Pikërisht sepse testet e njohurive, si instrumente matës të rezultateve dhe të objektivave të arritura pas një ndërhyrjeje të caktuar, vlerësojnë atë që personi mund të bëjë në atë moment dhe parashikojnë rendimentet e tij në të ardhmen (Anastasi, 2002, f. 523-527), çdo klasë, në fillim dhe të fund të projektit i është nënshtruar një paratesti dhe pastesti mbi njohuritë mbi emocionet dhe mënyrat e mbarështimit të tyre, hartuar për këtë rast, si edhe testet e tjera.

²¹ Grom, B. (1981), vep. cit., f. 61-62.66. International Institute for Environment and Development, UK (2006). *50 lojëra dhe ushtrime për trajnerë*. Përk. Zana Lita e Anduena Shkurti. Tiranë: Mirgeeralb, f. 8.12.17.67.52.

Në Tabelën 1 janë paraqitur përgjigjet e dy pyetjeve, dhënë prej 27 nxënësve të klasës XD.

Tabela 1: Përgjigjet e paratestit dhe të pastestit

Nr	Pyetjet	Përgjigjet PARATEST			Përgjigjet PATEST		
		Po	Jo	Nuk e di	Po	Jo	Nuk e di
1	A e ke provuar ndonjëherë emocionin e mërzi-së?	19	4	4	27	0	0
2	A është njëlloj si të thuash mërzi si të thuash trishtim?	20	5	2	0	27	0

Siç shihet nga Tabela 1, për pyetjen e parë, në paratest kanë pohuar se e kanë provuar mërzinë 19 nxënës, në pastest ky numër kalon në 27; për pyetjen e dytë, në paratest kanë pohuar se është njëlloj si të thuash mërzi si të thuash trishtim 5 nxënës, në pastest kjo shifër është 27. Ky ndryshim numrash tregon se informacionet e marra gjatë takimit janë kthyer në njohuri dhe nxënësit duke ushtruar aftësinë e tyre të *vetëdijes emocionale*, kanë arritur të dallojnë sinjalet fiziologjike që shoqërojnë lindjen e emocionit të mërzi-së dhe të trishtimit dhe të kuptojnë se mërzia dhe trishtimi lindin për shkaqe të ndryshme, gjë që ka çuar në vënien e saktë të emrit emocionit të ndier. Duke u vënë në kontakt me botën e tyre emocionale, nxënësit janë bërë më të vetëdijshëm, më të lirë dhe më të përgjegjshëm për emocionet që përjetojnë, që janë edhe frytet e fazës së parë dhe të dytë të rrugëtimit të mbarështimit të emocioneve (Bissi, 2020, f. 203-208).

“Qoshja ime”²² është një ushtrim klimëngrohës, zhvilluar takimin e dytë në oborrin e shkollës. Ka shërbyer për “ngrohjen e klimës” mes nxënësve, duke i vënë në situatën që të zgjedhin për të kultivuar një

²² International Institute for Environment and Development, UK (2006), vep. cit., f. 52.

mendësi konkurrence apo bashkëpunimi (Carmagnani e Danieli, 1990, f. 96). Përbëhet nga dy pjesë, është realizuar sipas metodologjisë përvojore dhe ka zgjatur 40-45 minuta.

Gjatë pjesës së parë, nxënësve u është kërkuar të ndahen sipas grupeve përkatëse dhe të kapen për dore; më pas, u është thënë që të zgjedhin, pa u treguar të tjerëve, një qoshe të vendit ku ndodhen dhe të bëjnë çmos që të shkojnë te kjo qoshe, pa folur asnjë fjalë dhe pa i shkëputur duart prej njëri-tjetrit, brenda 3 minutave (faza I: *përvoja konkrete*).

Me mbarimin e kohës së ushtrimit, nxënësit janë mbledhur bashkë dhe kanë reflektuar mbi ushtrimin e sapobërë përmes disa pyetjeve, përgjigjet e të cilave janë dhënë aty për aty. Ja disa prej pyetjeve: *Kush ka/s'ka shkuar te qoshja e vet?*, *Si ndihesh që ke/s'ke shkuar?*, *Pse mendon se ke/s'ke shkuar te qoshja jote?*, *A të ka ndihmuar ky qëndrim në arritjen e objektivit tënd?*, *Çfarë mendon se të ka ndihmuar/penguar tjetër në arritje e këtij objektivit?*, *A ke përjetuar ndonjë situatë të tillë në jetën tënde?*, *A dëshiron ta bashkëndash me ne?* (faza II: *vëzhgimi reflektiv*).

Pyetja: *"A dëshironi të shkoni te qoshja juaj?"*, drejtuar veçanërisht atyre që nuk kanë shkuar te qoshja e tyre, i ka dhënë fillësë pjesës së dytë të ushtrimit. Ushtrimi do të zhvillohej njëlloj si në fillim, me të vetmin ndryshim se këtë herë ata mund të flisnin me njëri-tjetrin (faza I: *përvoja konkrete*).

Kështu, nxënësit janë ndarë sërish sipas grupeve përkatëse, janë kapur për dore dhe kanë zgjedhur qoshen e tyre. Pyetjet e bëra në këtë pjesë të dytë të ushtrimit kanë shërbyer për skematizimin e njohurive, me qëllim zbatimin e tyre në realitetin konkret të nxënësve. Ato kanë qenë: *A ke shkuar te qoshja jote?*, *Si ndihesh prej kësaj gjëje?*, *Si është bërë e mundur një gjë të tillë?*, *A ke shkuar edhe te ndonjë qoshe tjetër?*, *Si ndihesh prej kësaj gjëje?* *Si është bërë e mundur një gjë të tillë?* *A ke përjetuar ndonjë situatë të tillë në jetën tënde të përditshme?* *A dëshiron ta bashkëndash me ne?* (faza II: *vëzhgimi reflektiv*). *Ku mund t'i përdorësh në jetën tënde të përditshme mënyrat e reja të bashkëpunimit që gjetët?* (faza III: *konceptualizime abstrakte*).

Detyrat e shtëpisë, dhënë në fund të takimeve dhe bashkëndarë në fillim të takimeve pasardhëse, kanë synuar që nxënësit, përmes vënies në praktikë të njohurive të fituara, t'i verifikojnë ato dhe të krijojnë kështu një përvojë të re konkrete (faza IV: *eksperimentimi aktiv*).

Takimin e pestë, nxënësit e përfshirë në projekt (nr. 137) kanë plotësuar pyetësorin për vlerësimin e punës në grup përgjigjet e të cilave janë paraqitur në Tabelën 2.

Tabela 2: Përgjigjet e pyetësorit mbi punën në grup.

Nr	Pyetjet	Përgjigjet	Nr. i nx.
1	A do të punoje përsëri me të njëjtin grup?	1. Po	136
		2. Jo	2
2	Pse?	1. Gjetëm një gjuhë të përbashkët.	40
		2. Mësuam nga njëri-tjetri.	11
		3. Patëm ide të larmishme.	30
		4. Zgjdhëm konfliktet e krijuara.	55
		5. S'u ndieva i marrë parasysh.	2
3	Ç'të pëlqeu më shumë?	1. Njohja më e mirë e shokëve.	26
		2. Sinqeriteti dhe bashkëndarja e përvojave personale.	50
		3. Pjesa e role playing-ve.	38
		4. Bashkëpunimi.	24
4	Si e vlerëson paraqitjen e grupit tënd?	1. E arrirë.	24
		2. Interesante.	39
		3. Krijuese.	55
		4. Jo aq e përshtatshme.	20
5	Si e vlerëson paraqitjen e grupeve të tjerë?	1. Emocionuese.	38
		2. Pak shprehëse.	25
		3. E saktë.	40
		4. Secili dha maksimumin.	35


Përgjigjet vënë në dukje kompetencat dhe aftësitë e fituara apo të zhvilluara më tej gjatë pjesëmarrjes në projekt. “Gjetëm një gjuhë të përbashkët”, përgjigjja 2.1 dhënë nga 40 nxënës, është arritur falë kompetencës së *problem solving*-ut ushtruar gjatë punës në grup; “Zgjdhëm konfliktet e krijuara”, përgjigjja 2.4 dhënë nga 55 nxënës, tregon ushtrimin e aftësisë së *kontrollit emocional* dhe të *mbarëshimit të efektshëm të marrëdhënieve ndërpersonale*, siç dëshmon një mësues

kujdestar: “Nxënësit kapërcyen vështirësitë dhe kuptuan rëndësinë e bashkëpunimit”. Kompetencën e *krijimtarisë* e kanë ushtruar 30 nxënës (përgjigjja 2.3), ndërsa *feedback-un* për veten dhe të tjerët e kanë shfaqur 138 nxënës, përmes përgjigjeve të pyetjeve 4 dhe 5. *Besimi* dhe *empatia* dalin qartas te përgjigjja 3.2: “Sinqeriteti dhe bashkëndarja e përvojave personale” (50 nxënës), gjë që pohohen edhe prej një tjetër mësueseje kujdestare: “Nxënësit kanë bashkëndarë edhe momente jo të lehta të jetës së tyre”.

Në fund të “Takoj emocionet”, nxënësit e çdo klase kanë plotësuar pyetësorin e vlerësimit të projektit për të verifikuar arritjen e objektivave të projektit dhe për të kuptuar se cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të tij, me qëllim përmirësimin e tij.

Pyetjes: “Si e vlerëson përvojën e bërë?” (Kodi A1), përgjigjet e të cilës janë paraqitur në Figurën 1, 99% e nxënësve i është përgjigjur se e vlerëson pozitivisht atë, duke konfirmuar atë që është vënë re gjatë takimeve dhe atë që ka dalë prej pastestit dhe pyetësorit të punës në grup.

Figura 1: Përgjigjet e pyetësorit për vlerësimin e projektit.



Në Tabelën 3 janë paraqitur përgjigjet e pyetjeve me kod B1-B10 të

pyetësorit për vlerësimin e projektit.

Tabela 3: Përgjigjet e pyetësorit për vlerësimin e projektit.

KODI	FUSHA	XA (28)	XB (29)	XC (28)	XD (27)	XE (26)	Totali
B1	Kam shprehur emocionet.	21	19	25	19	18	113
B2	Kam përmirësuar marrëdhëniet me shokët.	21	21	20	16	14	100
B3	Ndihem më protagonist në shkollë.	14	9	11	6	9	57
B4	Kam përmirësuar dhe zgjeruar njohuritë.	20	14	10	18	13	84
B5	Kam kuptuar gjëra të reja për jetën time.	18	17	22	15	19	102
B6	Ndihem më mirë në shkollë.	16	12	12	2	10	64
B7	Kam arritur ta shpreh veten më mirë.	23	18	19	13	14	107
B8	Ndihem më i/e sigurt.	8	7	8	9	6	47
B9	E vlerësoj më shumë veten time.	11	12	11	11	7	59
B10	Ndihem më i/e pranuar.	14	12	10	5	6	55

Gjatë projektit nxënësit kanë shprehur emocione të ndryshme (B1: 113 nxënës), shenjë kjo se kanë përjetuar, me shumë gjasa, edhe emocione që më përpara nuk i kishin përjetuar apo nuk e kishin dalluar se i kishin përjetuar dhe, falë kontekstit nxitës dhe pranues, i kanë bashkëndarë ato me veten e tyre dhe të tjerët. Falë njohurive të fituara (B4: 84 nxënës), ata kanë shoshitur filtrat vënë nga të tjerët apo vetja e tyre dhe, në mënyrë të lirë, kanë vendosur që t'i ndiejnë emocionet dhe t'i shprehin ato, gjë që ka ulur përdorimin e mekanizmave mbrojtës dhe ka rritur harmoninë e tyre të brendshme, siç ka pohuar gjatë intervistës një nxënëse: “Kam kuptuar


rëndësinë e mbarështimit të emocioneve: kjo më ka bërë më të qetë dhe më të vendosur”.

Nxënësit kanë kuptuar gjëra të reja për veten e tyre (B5: 102 nxënës), gjë që ka çuar në njohjen më mirë të vetes së tyre, siç shprehet një nxënës gjatë intervistës: “E kam njohur veten time për gjashtë të shtuna siç nuk e kam njohur për 15 vite”, në vlerësimin më të madh të saj (B9: 59 nxënës), në të ndierit i sigurt (B8: 47 nxënës) dhe në shprehjen më të mirë të vetes (B7: 107 nxënës), pikërisht falë ushtrimit të kompetencës së besimit.

Përmirësimi i marrëdhënieve me shokët e shoqet e klasës (B2: 100 nxënës), mundësia për të qenë protagonistë në shkollë (B3: 57 nxënës) dhe të ndierit më mirë në shkollë (B6: 64 nxënës) tregojnë jo vetëm për një përmirësim të klimës brenda dhe jashta personit, por lënë të shpresojnë edhe për një angazhim të tyre të mëtejshëm në aktivitetet që ofron shkolla, për një motivim më të madh në mësim apo për mbajtjen e një marrëdhënieje të shëndetshme me njëri-tjetrin.

Për një lexim më të menjëhershëm të vlerësimit të projektit nga ana e nxënësve, totali i përgjigjeve që ndodhet te Tabela 3, kolona e fundit, është paraqitur në Figurën 2.

Figura 2: Përgjigjet e pyetësorit mbi projektin.



4. “Takoj emocionet” në perspektivë

Edhe pse projekti edukativ “Takoj emocionet” ka lindur si një projekt drejtuar adoleshentëve, përfshirja aktive e familjes e shkollës (p.sh. prindër dhe mësues kujdestarë), me një rol specifik në projekt, do të bënte që këto dy institucione të shërbenin si freskuese të njohurive të marra nga

nxënësit (Orhani, 2004, f. 91) dhe si nxitëse të qëllimshme të këtyre aftësive dhe kompetencave, gjë që do ta bënte më të plotë ndërhyrjen dhe do të siguronte qëndrueshmërinë e fryteve të arritura.

Zhvillimi, po nga ekspertë të fushës, i një cikli takimesh formimi me prindërit dhe mësuesit mbi këto tematika, para apo ndërsa zhvillohet “Takoj emocionet”, do të ndikonte edhe më shumë në ruajtjen e këtyre rezultateve dhe në zhvillimin e tyre, siç sugjeron edhe Cunico (2004), i cili, në pjesën e dytë të librit të tij (f. 129-162) ndalet te paraqitja e një veprimtarie për edukimin emocional, që u drejtohet jo vetëm nxënësve, por edhe prindërve dhe mësuesve.

Që ndërhyrjet edukative mbi shëndetin mendor të mos u delegohen apo të mos jenë pronë vetëm e ekspertëve, “Takoj emocionet”, i përshtatur dhe pas një formimi përkatës, do të mund të zhvillohej prej mësuesve gjatë orës së mësimit të lëndës së tyre, siç ka bërë edhe Rete dei Servizi ASL për il PED (2008) në bashkëpunim me shkollat e mesme italiane. Kjo gjë që do të fuqizonte rolin dhe kompetencat e mësuesit në shkollë dhe do të bënte që vëmendja e saj, mbi emocionet dhe mbarështimin e tyre, të kishte një kohëzgjatje më të madhe se 18 orë.

REFERENCAT

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002). *Fjalori i Shqipes së Sotme* (2). Tiranë: Toena.
2. Anastasi, A. (2002). *I test psicologici*. Përk. Adriana Bottini. Milano: FrancoAngeli.
3. Bissi, A. (2004). *Il colore del grano. Crescere nella capacità di amare* (5). Torino: Paoline.
4. Bissi, A. (2020). *Rrahja e jetës. Njoh dhe mbarështoj emocionet e mia*. Përk. Loreta Tomaj. Shkodër: SHKODRA.
5. Carmagnani, R. e Danieli, M. (1990). *Uomini per gli altri. Contenuti e metodi per operatori scolastici, docenti di religione e animatori spirituali*. Messina: Cooperazione Editrice Libreria.
6. Carmagnani, R. e Titta, S. (2012). *Diventare guide spirituali III. Discernimento, identità e relazioni. Chiavi di lettura dell'Analisi Transazionale*. Bologna: Quaderni di Villa San Giuseppe.
7. Carmagnani, R., Danieli, M. e Denora, V.C.M. (2017). *Një paradigmë pedagogjike didaktike për një shkollë që ndryshon. Një sfidë edukative për mijëvjeçarin e tretë*. Shkodër: VOLAJ.
8. Cerato, M. (2003). *Emozioni e sentimenti. Curare il cuore e la mente*. Torino: EFFATÀ.
9. Cunico, M. (2004). *Educare alle emozioni: riflessioni e proposte di attività per insegnanti e genitori*. Roma: Città Nuova.
10. Dizdari, V. (2012). *Formim kërkimor*. Shkodër: Dispencë universiteti e fotokopjuar.
11. Gabbard, G.O. (2002). *Psichiatria psicomodinamica* (3). Milano: Raffaello Cortia Editore.

12. Goleman, D. (2011). *Intelligenza emotiva: che cos'è e perché può renderci felici*. Bergamo: bestBUR.
13. Grom, B. (1981). *Metodi per l'insegnamento della religione, la pastorale giovanile e la formazione degli adulti*. Torino: ELLE DI CI
14. Grün, A. (2020). *Rrënjët. Një mbështetje e qëndrueshme në jetë*. Përk. Loreta Tomaj. Shkodër: SHKODRA.
15. Harris, Th.A. (2014). *Io sono Ok, tu sei OK. Guida all'analisi transazionale*. Bergamo: bestBUR.
16. Ianes, D. e Demo, H. (2007). *Educare all'affettività. A scuola di emozioni, stati d'animo e sentimenti*. Trento: Erickson.
17. International Institute for Environment and Development, UK (2006). *50 lojëra dhe ushtrime për trajnerë*. Përk. Zana Lita e Anduena Shkurti. Tiranë: Mirgeeralb.
18. Kolb, D. (1984). *Experiential Learning: experience as the source of learning and development*. Englewood Cliffs: Prentice Hall.
19. Kotsou, I. (2012). *Quaderno d'esercizi per l'intelligenza emotiva*. Përk. Rossella Franceschini. Milano: Avallardi.
20. Monbourquette, J. (2020). *Si të falësh. Udhëzues praktik për faljen*. Përk. Loreta Tomaj. Shkodër: SHKODRA.
21. Montuschi, F. (1983). *Vita affettiva e percorsi dell'intelligenza*. Brescia: La Scuola.
22. Orhani, Z. (2004). *Imazhet mendore, imagjinata dhe fantazia*. Tiranë: GERVIS.
23. Orhani, Z. (2006). *Psikologjia e motivacionit dhe motivimi gjatë të nxëniet*. Tiranë: GERVIS.
24. Osmanaga, F. (2011). *Psikopatologji*. Shkodër: Dispencë universiteti e fotokopjuar.
25. Pangrazzi, A. (1997). *Sentieri verso la libertà. L'enneagramma come teoria della personalità*. Milano: San Paolo.
26. Piccolo, G. (2019). *Mendja o zemra? Arti i shoshtijes*. Përk. Gjovalin Simoni. Shkodër: SHKODRA.
27. Rete dei Servizi ASL per il PED (2008). *PED: Percorso Esperienziale Didattico*. Milano: FrancoAngeli.
28. Shkolla e Mesme Jopublike “Atë Pjetër Meshkalla” (2006). *Projekti Edukativ*. Shkodër: Broshurë e fotokopjuar.
29. Stewart, I. e Joines, V. (2013). *L'Analisi transazionale. Guida alla psicologia dei rapporti umani*. Milano: Garzanti.
30. Testa, Xh. (2016). *Falja është një fitesë e madhe. Një ecje e thjeshtë drejt pajtimit*. Përk. Loreta Tomaj. Shkodër: Volaj.
31. Tramacere, A. (1985). *Dal drogarsi all'amarsi. Un cammino di libertà nella Comunità Emmanuel*. Fasano di Puglia: Schena Editore.
32. Vopel, K.V. (1994). *Giochi di interazione per adolescenti e giovani*. Volume 4. Torino: ELLE DI CI.

Webgrafia

1. <https://kohajone.com/vrasja-e-ridvan-ramazanit-policia-ka-ndodhur-per-motive-te-dobeta/>
2. <https://gazetamapo.al/masaker-xhelozie-ne-korce-4-te-vrare-per-nje-lidhje-jashte-martese/>
3. <https://www.today.it/economia/mobbing-straining-differenza.html>
4. <https://lamenteemeravigliosa.it/cosa-nascondono-le-dipendenze/>

5. <https://www.emmanuel.it/chi-siamo/>
6. <http://www.komunitetiemanuel.org/?p=151>
7. <https://www.stateofmind.it/2012/10/prevenire-curare-intervento/>
8. <http://www.educational.rai.it/lemma/testi/radioelevisione/emozione.htm>
9. <https://www.liceoeconomicosociale.it/wp-content/uploads/2013/04/COMPETENZE-Documenti.pdf>
10. <https://it.scoutwiki.org/Bans>

MODELET THEMELORE PËR SHPJEGIMIN E ÇRREGULLIMIT TË SPEKTRIT AUTIK: NGA TEORIA TEK PËRVOJA

Megi Shllaku

*Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti Psikologji-Punë
Sociale*

ABSTRAKT

Në vitet e fundit, studimet mbi autizmin janë përpjekur të kuptojnë shkaqet themelore të çrregullimit, duke ndjekur rrugë të ndryshme që nuk çojnë në një shkak të vetëm, por në një sërë faktorësh ndikues. Nocioni i autizmit si një "spektër", term që nënkupton variacionet mes individëve me këtë çrregullim dhe kombinimin unik të simptomave të çrregullimit të secili, përqafohet nga të gjithë studiuesit. Megjithatë, përtej variacioneve mes individëve, ka disa modele themelore që shpjegojnë Çrregullimin e Spektrit Autik: Teoria e Mendjes dhe Perspektiva e Mendjes Inaktive.

Qëllimi i këtij studimi është të ndërthurë këto dy modele teorike me përvojën shkollore me fëmijët e diagnostikuar me Çrregullim të Spektrit Autik, duke analizuar episode specifike të këtyre fëmijëve që lidhen me shpjegimet e dy modeleve, si dhe duke krahasuar këto reagime me ato të fëmijëve me zhvillim neurotipik.

Fjalët kyç: Çrregullim i Spektrit Autik, Teoria e Mendjes, Perspektiva Inaktive, përvoja shkollore.

Basic models for explaining Autistic Spectrum Disorder: from theory to experience

ABSTRACT

In recent years, studies on autism have attempted to understand the underlying causes of the disorder, following different pathways that lead not to a single cause but to a range of influencing factors. In recent years,

the notion of autism as a "spectrum", a term that implies variations between individuals with this disorder and the unique combination of symptoms of the disorder in each, has been fully shared among researchers. However, beyond the variations between individuals, there are some basic models that explain Autism Spectrum Disorder: Theory of Mind and Perspective of Inactive Mind.

The purpose of this study is to combine these two theoretical models with school experience with children diagnosed with Autism Spectrum Disorder, analyzing specific episodes of these children related to the explanations of the two models, and comparing these reactions with those of children with neurotypical development.

Key words: Autism Spectrum Disorder, Mind Theory, Inactive Perspective, School Experience

Hyrje

Në vitin 1797, në një pyll të Aveyron, në Jug të Francës, një djalë 12-vjeçar endet i zhveshur mes pemëve. Njerëzit e përshkruajnë atë si "një djalë të egër" i rritur larg qytetërimit njerëzor. Djali i besohet një mjeku dhe edukatori të ri, Jean Itard, i cili i vendos emrin Viktor, studion sjelljen e tij dhe vendos ta riedukojë atë. Viktori herë pas here ka reagime agresive; ai dëshiron që objektet të jenë gjithmonë në të njëjtin rend; nuk dëshiron të shoqërohet me njerëzit; nuk toleron ndryshimin dhe nuk mëson në mënyrën tradicionale, të gjitha këto karakteristika të një fëmije me autizëm (Itard, 1962).

Autizmi është një çrregullim që me kalimin e viteve ka tërhequr vëmendjen e studiuesve, duke mos pasur një shkak të vetëm dhe duke paraqitur një ecuri që shpesh nuk është shumë e parashikueshme. Më shumë se sa për shkaqe, flitet për një funksionim të ndryshëm të sistemit nervor dhe rrjedhimisht edhe për një rrugë atipike zhvillimi. Komuniteti i studiuesve në fushën e Çrregullimit të Spektrit Autik e trajton çrregullimin sipas dy perspektivave të rëndësishme për studimin e reagimeve atipike të fëmijëve me këtë diagnozë: Teorinë e Mendjes dhe Perspektivën e Mendjes Inaktive.

Sipas Teorisë së Mendjes (Baron-Cohen 1989), personat me autizëm kanë vështirësi të orientohen në botën ndërpersonale. Këto vështirësi lidhen me atribuimin e gjendjeve mendore, aftësinë për të kuptuar këndvështrimin e bashkëbiseduesit dhe qëllimet e tij. Personat me autizëm mendojnë që të gjithë personat që takojnë, janë duke parë dhe menduar njëlloj si ata.

Një tjetër model i rëndësishëm është Perspektiva e Mendjes Inaktive (Klin, Jones, Schulz e Volkmar, 2004). Sipas këtij modeli, rrënjët e vështirësive sociale të fëmijëve me autizëm, kërkohen tek drejtimi i shikimit të tyre. Sipas këtij modeli, fëmijët me autizëm e drejtojnë shikimin te disa aspekte të parëndësishme të situatave sociale, duke lënë jashtë fokusit elemente që ndihmojnë në kuptimin e asaj që po ndodh mes dy personave që ndërveprojnë.

Ky punim synon arritjen e disa objektivave:

Së pari, të pasqyrojë dy nga pikëpamjet më të rëndësishme në shpjegimin e Çrregullimit të Spektrit Autik, duke ndërthurur studimet me provat praktike që studiuesit kanë përdorur për arritjen e rezultateve.

Së dyti, të analizojë studimet teorike në funksion të aspekteve pragmatike në kontekstin shkollor, duke prezantuar shembuj dhe episode të konkretizimit të treguesve të secilës pikëpamje.

Metodologjia


Ky studim ka një qasje cilësore. Studimi është realizuar në klasat e ciklit parashkollor dhe fillor në shkollën "Maria Ndhimëtare" dhe metoda e përdorur është vëzhgimi me pjesëmarrje. Në secilën klasë ka një fëmijë me Çrregullim të Spektrit Autik që ndërvepron dhe bashkëndan përvojën shkollore me fëmijë me zhvillim neurotipik. Nga vëzhgimi me pjesëmarrje i zhvilluar gjatë 1 muaji në 3 ditë/ javë, kemi shënuar disa nga episodet që lidhen me dy perspektivat teorike.

Teoria e mendjes

Kërkimi mbi teorinë e mendjes u frymëzua nga kërkimi shkencor i Premack dhe Woodruff (1978) mbi aftësinë e shimpanzeve për t'ua atribuar gjendjet mendore njerëzve dhe për të parashikuar sjelljen e tyre bazuar në ato gjendje. Në vitet 1980 psikologu Baron-Cohen formuloi një hipotezë, e cila më pas çoi në kërkime të tjera (Wimmer dhe Perner, 1983; Baron-Cohen, Leslie dhe Frith, 1985), sipas së cilës, njerëzit me autizëm kanë një deficit në aftësinë për t'u atribuar gjendje mendore njerëzve të tjerë. Të dhënat e para që mbështesin këtë hipotezë u botuan nga Baron-Cohen dhe kolegët në 1985 në lidhje me një test të quajtur "testi i besimit të rremë" (Dennett, 1980) i cili u propozohet tre grupeve (një grupi fëmijësh me autizëm, një me Sindromën Down dhe një me zhvillim neurotipik). Në këtë detyrë, shfaqej imazhi i dy personazheve: Sally dhe Anna, duke luajtur me një top. Fëmijëve u shpjegohet që Sally ka një shportë, ndërsa Anna ka një kuti (shih Fig. 1). Sally vendos topin në shportën e saj dhe del nga dhoma. Gjatë mungesës së saj në dhomë, Anna e nxjerr topin nga shporta e Anës dhe e

vendos në kutinë e saj. Të gjithë fëmijëve u thuhet se Sally më pas kthehet në dhomë. Atyre u bëhet pyetja: Ku do ta kërkojë Sally topin? Përgjigjja e saktë është që Sally do ta kërkojë atje ku e kishte lënë para se të dilte nga dhoma, pra në shportën e saj. Gjetja e kësaj përgjigjeje nënkupton aftësinë e fëmijës për të kuptuar që protagonistin e historisë ka një përfaqësim të realitetit ndryshe nga situata aktuale. E thënë ndryshe, ai duhet të kërkojë objektin atje ku ai beson se është dhe jo aty ku është në të vërtetë.

Fig. 1. Sally-Anne Test, Simon Baron-Cohen, Alan M. Leslie e Uta Frith,1985,64



Duke iu referuar studimit të mësipërm, 80% e fëmijëve me autizëm dështuan në këtë detyrë, ndërsa 86% e fëmijëve me sindromën Down arritën ta kapërcenin atë, duke sugjeruar që problemet e interpretimit të mendjes nuk lidhen me vonesën konjitive, por me një problematikë që lidhet specifikisht me autizmin. Nëse një fëmijë me zhvillim neurotipik, nga mosha 4 vjeç, arrin ta zgjidhë këtë detyrë në mënyrë të shkëlqyeshme, shumica e fëmijëve me autizëm nuk mund të zgjidhin detyrën e besimit të rremë, edhe nëse kanë një moshë mendore shtatë vjeç ose më shumë (Baron-Cohen, Leslie dhe Frith, 1985).

Te një fëmijë me zhvillim neurotipik, teoria e mendjes fillon të zhvillohet rreth moshës katër vjeç, një pozicion për të cilin nuk pajtohen të gjithë studiuesit. Jo të gjithë studiuesit bien dakord për këtë pozicion. Në rishikimin nga Camaioni (2001) thuhet se midis moshës dy dhe tre vjeç, fëmijët në zhvillim neurotipik tashmë kanë një njohuri të konsiderueshme të gjendjeve mendore dhe janë të aftë të manipulojnë përfaqësime që janë të ndryshme nga realiteti, të tilla si të kuptuarit e lojës “bëj sikur..”, krijimin e një besimi të rremë, njohjen e ndryshimit mes objekteve reale dhe imazheve mendore të objekteve dhe parashikimin e sjelljes së njerëzve të tjerë. Fëmijët me zhvillim neurotipik janë në gjendje t'u atribuojnë mendime dhe dëshira të tjerëve, duke qenë kështu në gjendje të parashikojnë sjelljen e bashkëbiseduesit, por ata ende nuk janë në gjendje të zgjidhin konfliktin midis njohurive të tyre dhe të tjerëve, në rast se të dy njohjet nuk janë të përputhshme.

Në fazat e ndryshme të zhvillimit, tek fëmija me autizëm, shfaqen reagimet që janë tregues të një deficiti në Teorinë e Mendjes. Disa nga këto reagime janë: deficiti i vëmendjes së përbashkët (Baron-Cohen, 1989), mungesa ose vështirësia në komunikimin e qëllimshëm të tipit protodeklarativ (Camaioni, Perucchini, Muratori, Parrini dhe Cesari, 2003), mungesa ose varfëria reagimeve të lidhura me lojën simbolike (Hobson, Lee dhe Hobson, 2009). Deficiti tek këto aspekte komunikative janë tregues që fëmija me autizëm nuk arrin t'i atribuojë bashkëbiseduesit gjendje të caktuara mendore.

Duke iu referuar Baron-Cohen (1989), vëmendja e përbashkët konsiston në një reagim që zakonisht fëmija me zhvillim neurotipik fillon ta shfaqë rreth muajit të nëntë, kur tregon interes për gjërat e vëzhguara nga i rrituri, duke alternuar vëmendjen midis objektit dhe të rriturit të cilit ai dëshiron t'ia tregojë atë objekt. Për shembull, kur një fëmijë sheh një aeroplan në qiell, ia tregon me gisht nënës së tij sepse është i vetëdijshëm që nëna e tij ka një gjendje të ndryshme mendore nga ai dhe se ajo nuk e di që aeroplani është në qiell në atë moment. Sekuenca e komunikimit protodeklarativ paraqet një sjellje të të njëjtit lloj, të aktivizuar nga fëmija për qëllime komunikimi. Kur fëmija sheh një objekt, e bashkëndon këtë informacion përmes komunikimit verbal dhe joverbal, duke alternuar shikimin mes objektit dhe të fytyrës së personit të rritur, derisa ky i fundit të orientojë shikimin në të njëjtin drejtim me shikimin e fëmijës.

Një tjetër tregues i strukturimit të Teorisë së Mendjes përfaqësohet nga loja “Bëj sikur...”. Në moshën 4 vjeçare, një fëmijë në zhvillim neurotipik fillon të kuptojë që një person tjetër po bën sikur po kryen një veprim edhe kur realisht nuk është e vërtetë (Sodian dhe Frith, 1992). Për

shembull, të pretendosh se një banane përdoret si një telefon nuk e bën fëmijën të besojë se banania dhe telefoni janë e njëjta gjë, por përkundrazi se ai ose bashkëbiseduesi po e përdorin bananen si një telefon. Ai është i vetëdijshëm për ndryshimin dhe ka dy përfaqësime mendore të ndryshme për bananen dhe telefonin.

Episode të tilla shfaqen shpesh edhe gjatë mësimdhënies me fëmijët me Çrregullim të Spektrit Autik, në klasa me fëmijë me zhvillim neurotipik. Gjatë një ore mësimi në grupin parashkollor, po improvizohet një festë me një arush që kishte ditëlindjen dhe të gjithë fëmijët po bënin sikur po gatuanin një tortë me plastelinë. Fëmijët me zhvillim neurotipik ishin të vetëdijshëm që duhet të bënin sikur po hanin tortën, sepse ajo ishte plastelinë dhe nuk mund të hahej. Fëmija me Çrregullim të Spektrit Autik insistoi që të hante tortën prej plasteline, edhe pse ishte i vetëdijshëm që ishte prej plasteline dhe që plastelina nuk hahej, sepse për të koncepti “tortë” nënkuptonte diçka që ai mund ta hante.

Fëmija me autizëm ka mangësi thelbësore në proceset e vëmendjes së përbashkët, komunikimit proto-referencial dhe në lojën “Bëj sikur...”. Fëmija hamendëson se të tjerët gjithmonë thonë të vërtetën dhe se çdo gjë po ndodh si e sheh ai. Një këndvështrim i tillë, jo vetëm që e pengon të kuptojë situatat e paqarta, por edhe të reagojë në këto situata duke “bërë sikur.” (Baron-Cohen, 2008).

Perspektiva e mendjes inaktive

Termi "mendje inaktive" rrjedh nga studimet e Varelës (1992) dhe thekson procesin e të kuptuarit të situatave sociale në momentin që personi përqendrohet tek aspektet domethënëse të atij konteksti, duke përzgjedhur ata që nevojiten për të kuptuar ngjarjen e mënyrën si duhet vepruar me ata që nuk janë të rëndësishëm (Klin, Jones, Schulz dhe Volkmar, 2004). Fëmijët me zhvillim neurotipik, në një situatë sociale, përqendrohen lehtësisht në aspekte relacionale që janë të rëndësishme për të kuptuar atë që po ndodh në atë kontekst, ndërsa siç argumentojnë Klin dhe kolegët (2004), vështrimi i fëmijëve me autizëm shpesh tenton të përqendrohet në aspekte të parëndësishme, duke shkaktuar si pasojë vështirësi për të bërë përvoja të përshtatshme sociale dhe për të përvetësuar njohuri për marrëdhëniet. Kuptimi i botës shoqërore dhe orientimi në të nënkupton nevojën për një fleksibilitet të caktuar në arsyetim në situata të ndryshme, hap pas hapi, duke marrë parasysh si elementet e rëndësishme ashtu edhe përparësitë e secilit element bazuar në kërkesat e situatës. Këto procese janë të vështira për fëmijët me autizëm.

Duke iu referuar përqendrimit në aspektet e rëndësishme, të trajtuar më sipër, Klin et al. (2004) realizuan një seri eksperimentesh me metodologjinë e ndjekjes së syve, të cilat lejuan të vëzhgonin dhe matnin sesi subjektet me autizëm me funksionim të lartë kërkojnë kuptimin e asaj që shohin (bazuar në drejtimin e vështrimit) kur ekspozohet ndaj skenave të situatave të ndërveprimit natyror. Në eksperiment, u prezantuan disa skena të filmave me një përmbajtje të lartë emocionale, duke kërkuar që fëmijët me zhvillim neurotipik dhe ata me autizëm të interpretonin ndryshimin në gjendjet emocionale të aktorëve. U zbulua se fëmijët në zhvillim neurotipik ishin në gjendje, përmes vëzhgimit të syve dhe gojës, të identifikonin emocionet e personazheve, ndërsa fëmijët me autizëm, të së njëjtës moshë dhe me të njëjtin koeficient inteligjence (IQ) si ata me zhvillim neurotipik, drejtonin vështrimin në pikat minimale informuese të tilla si pjesa periferike e fytyrës, duke mos arritur të kuptojnë shprehjet emocionale të aktorëve.

Në përvojën e mësimdhënies me fëmijët me autizëm, kuptojmë se një qasje e tillë reflektohet shpeshherë në punën me ta. Gjatë një ore mësimi, një nxënëse e klasës fillon të qajë. Nxënësit me zhvillim neurotipik afrohen dhe e pyesin se përse është duke qarë. Nxënësjë me autizëm afrohet dhe nuk shikon fytyrën e nxënëses që po qan, por lidhësen e flokëve që ajo ka në kokë dhe në atë moment thotë: “Sa e bukur lidhësja e flokëve”. Ky shembull tregon që vështrimi i nxënëses me autizëm ishte drejtuar tek një aspekt që nuk ndihmon në kuptimin e situatës sociale e për rrjedhojë, reagimi i nxënëses me autizëm nuk është në përputhje me reagimet që kërkon kontesti.

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

Sipas Teorisë së Mendjes (Baron-Cohen 1989), personat me autizëm kanë vështirësi të orientohen në botën ndërpersonale. Këto vështirësi lidhen me atribuimin e gjendjeve mendore, aftësinë për të kuptuar këndvështrimin e bashkëbiseduesit dhe qëllimet e tij. Personat me autizëm mendojnë që të gjithë personat që takojnë, janë duke parë dhe menduar njëllor si ata.

Sipas Perspektivës së Mendjes Inaktive (Klin, Jones, Schulz e Volkmar, 2004), rrënjët e vështirësive sociale të fëmijëve me autizëm, kërkojnë tek drejtimi i shikimit të tyre. Sipas këtij modeli, fëmijët me autizëm e drejtojnë shikimin te disa aspekte të parëndësishme të situatave sociale, duke lënë jashtë fokusit elemente që ndihmojnë në kuptimin e asaj që po ndodh mes dy personave që ndërveprojnë

Duke iu referuar Teorisë së Mendjes dhe Perspektivës së Mendjes Inaktive, mund të themi se fëmijët me Çrregullim të Spektrit Autik kanë

vështirësi në përqendrimin tek aspektet e rëndësishme të situatave sociale, në kuptimin e tyre dhe në gjetjen e reagimit të përshtatshëm me kontekstin.

Përmes kontributit të qasjeve dhe teorive të ndryshme kuptojmë se sa e komplikuar është për personat me autizëm të menaxhojnë marrëdhëniet, në kontekste që ata përpiqen të kuptojnë dhe se sa e nevojshme është që të angazhohemi secili për t'ua thjeshtuar këto kontekste, për t'i dhënë fëmijës me autizëm kohë dhe hapësirë për të kuptuar.

BIBLIOGRAFI

- Baron-Cohen, S. (1989). Perceptual role-taking and protodeclarative pointing in autism. *British Journal of Developmental Psychology*, 7, 113-127.
- Baron-Cohen, S. (2008). Autism, hypersystemizing, and truth. *The Quarterly Journal of Experimental Psychology (Colchester)*, 61(1), 64-75.
- Baron-Cohen, S., Leslie, A. M. e Frith, U. (1985). Does the autistic child have a “theory of mind”? *Cognition*, 21(1), 37-46.
- Camaioni, L. (2001). Il contributo della Teoria della Mente alla comprensione dello sviluppo umano. *Giornale Italiano di Psicologia*, 28 (3), 455-475.
- Camaioni, L., Perucchini, P., Muratori, F., Parrini, B. e Cesari, A. (2003). The communicative use of pointing in autism: developmental profile and factors related to change. *European Psychiatry*, 18(1), 6-12.
- Dennett, D. (1980). The Milk of Human Intentionality. *Behavioral and Brain Sciences*, 3(3), 428-430.
- Hobson, R. P., Lee, A. e Hobson, J. A. (2009). Qualities of symbolic play among children with autism: a social-developmental perspective. *Journal of Autism and Developmental Disorders*, 39 (1), 12-22.
- Howlin, P., Davies, M. e Udwin, O. (1998). Cognitive functioning in adults with Williams Syndrome. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 39 (2), 183-9.
- Itard, J. G. M. (1962). *The Wild Boy of Aveyron*. New York: Appleton-Century-Crofts.
- Klin A., Jones W., Schulz R., Volkmar F. (2004). La mente enattiva o dalle azioni alla cognizione: lezioni sull'autismo. *Autismo e Disturbi dello Sviluppo*, 2 (1), 7-44.
- Klin A., Jones W., Schulz R., Volkmar F. (2004). La mente enattiva o dalle azioni alla cognizione: lezioni sull'autismo. *Autismo e Disturbi dello Sviluppo*, 2 (1), 7-44.
- Premack, D. e Woodruff, G. (1978). Does the chimpanzé have a theory of mind? *Behavioral and Brain Sciences*, 1, 515-526.
- Varela, F. (1992). *La via di mezzo della conoscenza. Le scienze cognitive alla prova dell'esperienza*. Milano: Feltrinelli.
- Wimmer, H. e Perner, J. (1983). Beliefs about beliefs: representation and constraining function of wrong beliefs in young children's understanding of deception. *Cognition*, 13, 103-128.

RËNDËSIA E PSIKOLOGUT SHKOLLOR NË SHMANGIEN E BRAKTISJES SË SHKOLLËS

Arlinda Ymeri

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", departamenti i Mësuesisë

ABSTRACT

Shoqëria jonë, edhe pse për disa vite, vazhdon të përjetojë periudha tranzicioni, përfshirë fushat shoqërore dhe intelektuale duke hasur herë pas here ngecje dhe pengesa për zhvillimin e saj të mëtejshëm. Shpesh ndodh që në institucionet tona shkollore të ndodhin ngjarje negative dhe probleme të njëpasnjëshme, duke implikuar kështu proceset mësimore-edukative.

Ekzistenca e psikologut të shkollës mund të shihet si një sukses në parandalimin e sjelljeve negative dhe shmangien e tyre tek nxënësit. Integrimi i tij në shkollat shqipe fillon në një periudhë relativisht të gjatë, prej gati më shumë se një dekade. Aktiviteti i tij zhvillohet në lidhje dhe bashkëpunim të ngushtë me stafin pedagogjik dhe drejtimin e shkollës, me prindërit dhe komunitetin, aty ku ndodhet shkolla. Në përgjithësi ekziston një tendencë pozitive për të trajtuar rolin e saj dhe marrëdhënien student-psikolog, duke pranuar komunikimin dhe ndikimin e vazhdueshëm.

The importance of the school psychologist in avoiding school abandonment

ABSTRACT

Our society, although for several years, continues to experience periods of transition, including the social and intellectual fields, occasionally encountering stagnation and obstacles to its further development. It often happens that in our school institutions negative events and successive problems occur, thus implicating the learning-educational processes.

The existence of the school psychologist can be seen as a success in preventing negative behaviors and avoiding them in students. Its integration in Albanian schools begins in a relatively long period, of almost more than a decade. Its activity takes place in close connection and cooperation with the pedagogical staff and management of the school, with the parents and

the community, where the school is located. There is generally a positive tendency to treat its role and the student-psychologist relationship, acknowledging ongoing communication and influence.

Qëllimi primar i këtij studimi është evidentimi i rolit të psikologut të shkollës në shkollat shqiptare, duke u fokusuar në efektivitetin e pozicionit të tij në mosbraktisjen e shkollës nga të rinjtë shqiptarë.

Dy janë çështjet e rëndësishme lidhur me njohjen dhe funksionimin e psikologut të shkollës në Shqipëri. Së pari, do të njihemi me përkufizimin e përgjithshëm të njohjes së psikologut shkollor dhe detyrat e tij. Së dyti, do të ndalemi te detyrimi ligjor i institucioneve të edukimit në Shqipëri për çasjen e psikologut të shkollës në strukturat e tyre dhe detyrat e përcaktuara të tij.

1.1 Psikologu i shkollës dhe detyrat e tij

Që në fillimet e zhvillimit të konceptit të psikologut shkollor dhe në faza të ndryshme të zhvillimit të funksionit të tij në botë, janë hartuar dhe formuluar përkufizime të ndryshme për të. Një psikolog shkollor, sipas studiuesve Fagan dhe Wise (1994) është një specialist i psikologjisë së përgjithshme, qëllimi i të cilit është të sjellë një perspektivë psikologjike gjithëpërfshirëse që lidhet me shërbimet edukuese ndaj klientit.

Nga ana tjetër Shoqëria Kombëtare e Psikologjisë Shkollore (NASP) e përkufizon psikologun shkollor si ndihmesë të fëmijëve dhe të rinjve për të patur sukses në shkollë, në shoqëri, në zgjidhjen e problemeve emocionale dhe atyre me sjelljen. Në këtë linjë, rëndësia qëndron në bashkëpunimin me mësuesit, prindërit dhe profesionistë të tjerë për të krijuar mjedise të sigurta në mbështetje të procesit të të mësuarit, duke ndikuar gjithashtu dhe në forcimin e lidhjes: shtëpi- shkollë-komunitet për të gjithë nxënësit."

Divizioni i 16-të i Shoqërisë Amerikane të Psikologjisë, APA (SHAP), duke u ndalur në objektivat dhe qëllimet, jep përkufizimin si më poshtë: "Psikologjia shkollore është shkenca që ofron një praktikë të përgjithshme dhe shërbim shëndetësor në atë disiplinë të psikologjisë së përgjithshme që merret me fëmijët, të rinjtë, familjet, nxënësit e të gjitha moshave dhe procesin e mësimdhënies. Arsimi bazë dhe trajnimi i psikologëve të shkollave i përgatit ata për të siguruar një gamë të gjerë të vlerësimit psikologjik, ndërhyrjeve, parandalimit, promovimit të shëndetit, si dhe të zhvillimit dhe vlerësimit të programit të shërbimeve me një fokus të veçantë në proceset e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve brenda kontekstit të shkollës.

Në përmbledhje të këtyre përkufizimeve, mund të konkludojmë se, psikologjia shkollore është pjesë e fushës së psikologjisë së përgjithshme dhe është e lidhur gjithashtu me fushën e edukimit dhe me fusha të tjera profesionale. Gjithashtu, psikologu shkollor, është një profesion që merret me zhvillimin, shëndetin mendor, edukimin e fëmijëve dhe të rinjve dhe pajis me shërbime fëmijë, të rinj dhe familjet e tyre brenda një konteksti edukativ që nuk limitohet vetëm brenda kornizave të vjetra të edukimit.

Specifikisht detyrat e psikologut të shkollës mund të rënditen si më poshtë:

- Ndihmon familjet, shkollën dhe komunitetin për të përmbushur nevojat akademike të nxënësve;
- Konsultohet me prindërit, mësuesin dhe profesionistë të tjerë për të promovuar mirëqenien mendore, sikurse arritjet apo sukseset e nxënësve;
- Vlerëson nevojat akademike dhe socio-emocionale të nxënësve;
- Observon nxënësit në klasat e tyre dhe në bazë të të dhënave të mbledhura zhvillon programe të ndryshme parandalimi dhe intervenimi për nxënësit;
- I mëson nxënësit të bashkëpunojnë dhe të zhvillojnë aftësi për zgjidhjen e problematikave. Përkrah edukimin gjithpërfshirës;
- Në rast nevoje, rekomandon program edukimi të veçantë për nevoja të veçanta të nxënësve;
- Mundëson zhvillimin e komunikimit në mes të shkollës dhe prindërve, për t'i bërë prindërit pjesëmarrës dhe ndikues në edukimin efektiv të fëmijëve të tyre;
- Ndihmon prindërit për të njohur nevojat e veçanta të fëmijëve të tyre dhe i ndihmon nxënësit në përmbushjen e suksesshme të tyre;
- Ndihmon prindërit për të kuptuar mënyrën e interaksionit me fëmijët e tyre në çdo fazë zhvillimi;
- Bashkëpunon me organe dhe profesionistë të tjerë (të cilët e rrethojnë fëmijën) për implementimin e rekomandimeve të tij në procesin edukativo-arsimor.

Rëndësia e psikologut shkollor në shmangien e braktisjes së shkollës.

1.2 Shërbimi psikologjik shkollor në Shqipëri

Tashmë shërbimi psikologjik shkollor në Shqipëri funksionon në baza ligjore, të huazuara në parimet kryesore në të cilat mbështetet dhe shërbimi psikologjik i vendeve të zhvilluara. Fillesat konsistojnë në vendimin nr. 321, të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit, përkatësisht eksperimentimi i shërbimit psikologjik në sistemin arsimor parauniversitar në vitet shkollore 2004-2005-2006 (MASH, 2004). Në të paraqiten dhe analizohen cilësitë e punonjësit të shërbimit psikologjik, arsimit i tij specifik, qëllimi kryesor si

specialist i shërbimit psikologjik që bashkëpunon me tre aktorët kryesorë: nxënës, mësues, prindër, duke realizuar vlerësimin e rezultateve të nxënësit, orientimin shkollor e profesional, zhvillimin psiko-social, emocional të personalitetit etj. Në vitin 2006 ky vendim ndërroi formë, duke u kthyer nga eksperimental në përfundimtar dhe në 2008-ën merr shtrirje. Ky vendim, duke patur qëllimin e shtrirjes së këtij shërbimi si në zonat urbane, por dhe në zonat rurale, për të gjithë fëmijët e moshës nga 0 deri 18 vjeç bazohet edhe në Ligjin e Arsimit Parauniversitar 69/2012, që parashikon ngritjen e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore. Në të udhëzohen qartë aktivitetet vlerësuese, parandaluese dhe edukuese. Bazuar po në këtë ligj njësitë arsimore vendore u sigurojnë shërbim psiko-social nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore dhe gjithashtu shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve sociale për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor. (Ligji i Arsimit Parauniversitar 69/2012: Neni 46). Urdhri nr.344, Nr. 19.08.2013 i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës parashikon ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social pranë Drejtorive Arsimore dhe Zyrave Arsimore. Numri i psikologëve shkollorë llogaritet mbi bazën e numrit të nxënësve dhe nivelin e shkollimit të tyre. Ligji i Arsimit Parauniversitar 69/2012 dhe Dispozitat Normative të Arsimit parauniversitar, përshkruajnë detyrat dhe përgjegjësitë e psikologut shkollor si më poshtë:

- a) Në bashkëpunim me mësuesit dhe prindërit, identifikon e vlerëson, sa më herët, nxënësit me probleme të sjelljes ose me vështirësi në të nxënë, dhe harton e zbaton për këta nxënës plane individuale parandaluese ose rehabilituese.
- b) Ndihmon punonjësit arsimorë, prindërit dhe nxënësit në parandalimin ose eliminimin e abuzimeve të punonjësve arsimorë ndaj nxënësve, të nxënësve ndaj nxënësve dhe abuzimeve të vetë nxënësve nga duhani, alkooli, droga etj.
- c) Informon, nëpërmjet bisedave e leksioneve, punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimet moshore tipike të nxënësve dhe problemet tipike që nxënësit hasin gjatë të mësuarit dhe të nxënit.
- ç) Ndihmon mësuesit kujdestarë dhe mësuesit lëndorë për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasat e institucioneve arsimore të zakonshme.
- d) Këshillon nxënësit për karrierën e tyre.
- dh) Administron dhe interpreton teste psikologjike (nga psikologu).
- e) Plotëson dosjet individuale për rastet e nxënësve që kanë përfutur nga

shërbimi psiko-social.

e) Raporton me shkrim tek drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social çdo fakt për abuzim të nxënësve nga punonjës arsimor dhe prindër të nxënësit.

f) Merr pjesë në kërkime të parashikuara në planin vjetor të njësisë.

Të gjitha këto veprimtari, me qëllim mirëqenien psikologjike dhe fizike të nxënësve, plotësojnë njëra-tjetrën dhe funksionojnë si të integruara e të koordinuara mirë.

Në funksion të ligjit dhe vendimeve zyrtare, inspektoriat Shtetëror i Arsimit Parauniversitar botoi në 2013-ën manualin "Inspektimi dhe vetëvlerësimi i shërbimit psikologjik në shkollë", ku detajohen 5 fushat themelore të inspektimit dhe vetëvlerësimit. Këto fusha konsistojnë në: 1.Vlerësimi, 2.Planifikimi, 3.Konsultimi dhe bashkëpunimi, 4.Këshillimi dhe 5.Zhvillimi profesional i psikologut shkollor. (ISHA 2013; 20)

Efetshmëria e psikologut të shkollës në shmangien e braktisjes së saj.

Në vazhdimësi të logjikës, ku njihemi me funksionin, detyrimet dhe detyrat e psikologut të shkollës, do të ndalemi në ndikimin që ka psikologu i shkollës në nxitjen e nxënësve për të ndjekur arsimin. Qëllimi kryesor do të jetë evidentimi i rëndësisë së tij në rënien e nivelit të braktisjes së shkollimit të rregullt nga nxënësit në Shqipëri.

2.1 Fenomeni i braktisjes së shkollës në Shqipëri

Në këtë periudhë ku dixhitalizimi është fenomeni kryesor i shoqërisë, sfidat e prindërve, mësuesve dhe të gjithë elementeve me funksion edukues të shoqërisë janë të shumta dhe të larmishme. Sfidat e fëmijës dhe të riut shqiptar, përkojnë me sfidat e të rinjve në mbarë botën. Studimet tregojnë se disa nga problemet që të rinjtë përjetojnë, që lidhen me diferencat ekonomike, kulturore dhe gjuhësore, në vende të ndryshme ku janë bërë anketime dhe shqyrtime nga shërbimet psikologjike, janë si më poshtë (Oakland & Cunningham, 1992):

1. Problemet e hasura nga rezultatet në mësimet (në të nxënë), dështim në shkollë.
2. Problemet me adaptimin e ciklit të ri shkollor, frikë rreth fillimit të shkollës.
3. Menaxhimi i keq i kohës nga fëmijët dhe mungesa e vetëdisiplinës.
4. Stresi i shkaktuar nga mbingarkesa e kurrikulës, alterteksi dhe presioni i notes a kursit nga mësuesi.
5. Stres i shkaktuar nga ngjarjet në familje si divorci i prindërve apo vdekjet, konfliktet madhore të prindërve, dhuna nga njëri apo të dy prindërit.
6. Të ndjerit i depresuar i fëmijës nga arsye të ndryshme, pa përjashtuar dhe vetë adoleshencën.

7. Varësia e theksuar nga substancat: alkooli, duhani, droga.
8. Varësia e theksuar nga lojërat e fatit, bixhozi, interneti, rrjetet sociale.
9. Neglizhimi që i bëjnë prindërit e familjarët duke mos i ndihmuar në problemet e adoleshencës.
10. Mendim rreth vetëvrasjes.
11. Shqetësim dhe stres nga mungesa e aftësisë për të studiuar me metodat më të mira të një nxënie efektive.
12. Shqetësime rreth seksualitetit
13. Tendenca për braktisje të shkollës (braktisja de juro dhe braktisja e fshehtë).
14. Përballje me probleme rreth vendimmarrjes.
15. Mungesë përvoja në zgjedhjen e shkollës, profesionit, karrierës.
16. Stres nga kriza e identitetit, vetëvlerësimi i ulët/ i lartë, marrëdhëniet jo normale në grupin social etj.

Ndryshimet politike e sociale në Shqipëri dhe po ashtu tranzicioni i tejzgjatur, krahas shumë anëve pozitive (duke iu referuar deri në 11.10.2004 kur u implementua shërbimi psikologjik), solli lindjen e shumë fenomeneve negative, si: emigracioni, droga, prostitucioni, trafikimi i fëmijëve, puna e zezë e tyre, braktisja e shkollës, divorci, migracioni dhe polarizimi i shoqërisë në një pakicë shumë të pasur dhe një shumicë shumë të varfër. Të gjitha këto fenomene social-ekonomike ndikuan shumë tek mësuesi, nxënësi dhe adoleshenti i brishtë, duke shtuar çrregullimet psiko-emocionale e sociale (Manual në ndihmë të psikologut në shkollë 2006).

Në Raportin e vitit 2002 "Shqipëria dhe objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit", theksohet se gjatë dekadës së parë të tranzicionit ka patur rënie të madhe në numrin e të regjistruarve në shkolla, braktisje shkollore dhe rritje të analfabetizmit. Raporti evidenton se në vitin shkollor 2000-2001, ndoqën mësimet 19% më pak nxënës në krahasim me vitin shkollor 1989-1990. Ai përmend gjithashtu edhe braktisjen e fshehtë të shkollës si një problem tjetër të rëndësishëm për arsimin e përgjithshëm fillor në Shqipëri. Në këtë raport citohet se "Sipas një studimi të kohëve të fundit numri i nxënësve që e braktisin shkollën është shumë më i vogël nga numri i atyre që e nisin dhe ndjekin shkollën pa asnjë progres. Është vlerësuar që në disa zona ky numër arrin edhe 1/3 e numrit të përgjithshëm të nxënësve që ndjekin shkollën. Në të njëjtin raport citohen shifra të Ministrisë së Arsimit e Shkencës mbi braktisjen shkollore. Sipas tyre braktisja e shkollës nga fëmijët arriti pikun e vet në vitet 1991-1992 në 6.31%, shifër kjo që u ul në 2.3% në vitin 2001. Në një raport të mëvonshëm studimor, të vitit 2007, përgatitur nga Qendra e Zhvillimeve Humane evidentohet se në Shqipëri braktisja shkollore dhe mosregjistrimi në shkollë, është më e

theksuar në komunitetin Rom se sa në popullsinë jorome, e kushtëzuar kjo nga një sërë faktorësh. Referuar të njëjtës periudhë, publikimi "Të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, 2009", të UNICEF & specialistët e Observatorit Kombëtar dhe ekspertëve të tjerë të jashtëm, thekson se mosvijueshmëria e shkollës lidhet ngusht me nivelin ekonomik të banorëve të një komuniteti të caktuar. Në një tjetër publikim, të vitit 2009, të SHIS, në bashkëpunim me AECID, titulluar "Një vlerësim multi faktorial në shkollat 9-vjeçare shqiptare, i cilësisë së arsimit - Një qasje alternative ndaj braktisjes shkollore në disa qytete", pasi bëhet një analizë e detajuar e situatës në shkollat 9-vjeçare në këto qytet, (mbi cilësinë e shkollave, infrastrukturën, pajisjen, materialet dhe kualifikimin e stafit të tyre), analizohen arsyet kryesore të braktisjes shkollore dhe vihet theksi në aspektin ekonomik të familjeve. Në këtë publikim përmendet se sipas Raportit për OMZH, për vitin 2009 është arritur një progres i rëndësishëm për sa i përket arritjes së një arsimit 9-vjeçar universal, por theksohet gjithashtu se më shumë se 10% e fëmijëve në moshë shkollore, nuk e frekuentojnë shkollën. Një gjë e tillë është shqetësuese, për shkak të ndikimit që ka tek OMZH-të e tjera. Për shembull rritja e përqindjes së nënave me arsim 9-vjeçar ose të mesëm nënkupton reduktim të nivelit të vdekshmërisë foshnjore dhe përmirësim në të ushqyer. Për më tepër shkollimi i prindërve është i lidhur me shkallën e lartë të frekuentimit të fëmijëve në shkollë.

Informacioni i raporteve më sipër na tregon kështu që braktisja shkollore e ka shoqëruar tranzicionin shqiptar gjatë gjithë ecurisë së tij. Të gjitha ndryshimet e ndodhura në etapa kohore të ndryshme të tranzicionit shqiptar, kanë ndikuar drejtpërdrejt tek ecuria e fenomenit të braktisjes së shkollës, pasi kanë sjellë ndryshime në shkaqet përcaktuese të tij. Vlerat më të larta të braktisjes i përkasin dekadës së parë të tranzicionit për vetë problematikat komplekse që mbarte ajo etapë. Nga viti 2000 e në vazhdim, marrja e disa masave ekonomiko-sociale dhe futja në rrugën e përmirësimit të gjendjes së përgjithshme të jetës në Shqipëri reflektoi me rënie të përqindjes së problematikës së braktisjes. Megjithatë nuk duhet të harrojmë se fenomeni i braktisjes së arsimit të detyruar vazhdon të ekzistojë edhe aktualisht.

Studiuesi Stavri Llambiri (Tiranë, 2006), na sugjeron që për shmangien e këtij fenomeni na vjen në ndihmë shërbimi psikologjik. Sipas tij për masën e nxënësve me çrregullime në të nxënë është i nevojshëm dhe e domosdoshme jo vetëm shtrirja e shërbimit psikologjik, por edhe forcimi i detyrave, rolit dhe funksionit të tij, si në shkollat që është shtrirë ose jo.

Në të njëjtën linjë qëndrojnë, në anketën dhe studimin e ndërmarrë nga dr. Majlinda Ziu (2014), përgjigjet e grupeve të synuara, që janë

prindërit dhe nxënësit. Aty theksohet kërkesa për bashkërendim të punës dhe për krijimin e një raporti më funksional midis psikologut të shkollës e nxënësve si dhe psikologut dhe mësuesve kujdestarë. Prindërit theksojnë idenë se psikologu i shkollës duhet të luajë rol më të madh në njohjen dhe ndihmën ndaj nxënësve me probleme të ndryshme ekonomike, sociale, psikologjike etj., por edhe në parandalimin e zgjidhjen e konflikteve nxënës-nxënës. Sipas po këtij studimi, në shkollat që kanë nxënës që braktisin shkollën ose të cilët kanë prirje për të lënë shkollën, prania e psikologut ndihmon në tërheqjen tyre në shkollë, duke pasur parasysh faktin që ata janë edhe kontigjenti i cili ka nevojë më tepër për mbështetje alternative edukuese dhe shërbime këshillimore sistematike.

2.2 Trajtimi i braktisjes së shkollës nga psikologu shkollor

Më lart u trajtuan hollësisht detyrat e një psikologu shkolle. Është pikërisht bashkërendimi i tyre që ndihmon në mirëqenien e nxënësit në tërësi dhe në veçanti në nxitjen e tij për të ndjekur arsimin.

Psikologu i shkollës konkretisht ka rol të kuptojë dhe të ndihmojë nxënësit për tejkalimin e problemeve të ndryshme, si:

Vështirësitë në të mësuar;

Ankthi i përgjithshëm;

Rënia e suksesit;

Dhuna në shkollë,

Mendimet për vetëvrasje:

Testimi dhe vlerësimi:

Problemet familjare;

Vështirësi në socializim;

Probleme me vëmendjen:

Vetëbesimi i dobët;

Rënia e motivacionit;

Shtatzënësia tek adoleshentët;

Problemet në lidhje me seksualitetin;

Presioni i grupit;

Abuzimi me substanca narkotike;

Trauma etj., elemente që ndikojnë në vëmendjen dhe dëshirën e nxënësve për të studiuar ose jo.

Për realizimin dhe eficiencën në këto pika, çështjet në të cilat punon psikologu janë:

A. Vendimmarrja e bazuar në të dhënat e mbledhura dhe mirëllogaritura, për të parashikuar kështu ndonjë intervenim të mundshëm psikologjik apo edukativ, duke bërë të mundur orientimin e formave të aktiviteteve shkollore dhe arritjen e synimeve të sistemit shkollor.

- B. Komunikimi interpersonal, Bashkëpunimi dhe Konsultimi-Këshillimi mes personelit shkollor, familjeve, nxënësve dhe komunitetit.
- C. Dhënia e instruksioneve efektive, ndihmëse për zhvillimin kognitiv dhe akademik, nëpërmjet kujdestarëve të klasave dhe personelit.
- D. Socializimi dhe zhvillimi i të qenurit kompetent në jetë duke i mësuar nxënësit që të bashkëpunojnë mirë me të tjerët në një klimë respekti të ndërsjellë.
- E. Diversiteti në zhvillim dhe mësim përmes analizimit të "diferencave individuale", që mundëson për nxënësit të zhvillojnë dhe implementojnë intervenime bazuar në karakteristikat e personit, familjes, sistemit social etj.
- F. Preventimi dhe intervenimi në kriza, promovimi i shëndetit dhe mirëqenies duke u kujdesur që të krijojnë programe për informimin e nxënësve rreth rrezikshmërisë nga sëmundje të ndryshme, mënyrën e mbrojtjes nga ato etj.

PËRFUNDIME

Literatura, anketimet dhe statistikat në vite për arsimin në Shqipëri na tregojnë që për një kohë të gjatë vendi ynë ka patur dhe ka probleme. Braktisja e shkollës në një hark kohor prej më shumë se 20 vitesh ka patur luhate të dukshme dhe të ndjeshme. Gjithashtu koncepti dhe njohja me psikologun e shkollës, si në aspektin teorik edhe në atë praktik ka ndryshuar hap pas hapi dhe vit pas viti. Edhe pse jo e matur në shifra të sakta, shihet tendenca e përmirësimit të arsimit edhe nga prezenca dhe implementimi i psikologut të shkollës në strukturat arsimore. Statistikat tregojnë që niveli i braktisjes së shkollës ka pësuar rënie që nga viti 2004, kur u diskutua dhe u përfshi psikologu i shkollës.

Pavarësisht këtyre statistikave, njohja me funksionin e psikologut dhe detyrat e tij, na nxit t'i kushtojmë më shumë vëmendje pozicionit të tij. Prandaj arsimi në Shqipëri duhet të vazhdojë të rishqyrtojë rëndësinë e tij dhe t'i japë më shumë hapësirë. Kjo duhet të funksionojë nëpërmjet ndërgjegjësimit të mëtejshëm dhe informimit të të gjitha hallkave të shoqërisë tonë.

Referenca:

- Botimii UNICEF: "Të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, 2009" (Aleanca për fëmijët, Shqipëri- Observatori për të drejtat e fëmijeve).
- Fagan, T. K., & Wise, P.S. (1994) School Psychology: Pas, Present and Future. New York: Longman.
- Ligi Nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".
- Llambiri, S. (2006): "Braktisja e fshehtë Tiranë" (UNICEF).
- MASH (2006): Manual në ndihmë të psikologut në shkollë. Tiranë.
- Ministria e Arsimit, (2002): 'Dispozitat normative për arsimin parauniversitar Tiranë (MASH).
- Ministria e Arsimit (2004): Strategjia e arsimit parauniversitar, Tiranë.
- Ministria e Arsimit (2004): Udhëzim bazë i Ministrisë së Arsimit për futjen e shërbimit psiko-pedagogjik në shkollë, Tiranë, www.mash.gov.al Oakland, T.D., dhe Cunningham, J. (1992). A survey of school psychology in developed and developing countries. School Psychology International, vol.13
- Publikim i Shoqatës Internacionale për Solidaritetin (SH.I.S.) në bashkëpunim me Agjencinë Spanjolle për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Zhvillim (AECID): "Një vlerësim multifaktorial në shkollat 9-vjeçare shqiptare, i cilësisë së arsimit - Një qasje alternative ndaj braktisjes shkollore në qytetet e Tiranës dhe Shkodrës". Tiranë, qershor 2009.
- Raporti "Shqipëria dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit", përgatitur për Sistemin e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri nga Qendra për nxitjen e zhvillimit njerëzor (HDPC), Tiranë, maj 2002.
- Ziu, M. (2014) "Gjeografia e fenomenit të braktisjes së shkollës". Tiranë.

www.apa.org

mash.gov.al

ww.nasponline.org

KUPTIMI DHE IMPLIKIME PRAKTIKE TË PUNËS SOCIALE LIGJORE

Brilanda Lumanaj

Universiteti "Luigj Gurakuqi", departamenti Psikologji-Punë Sociale

ABSTRAKT

Ndërsa interesi i publikut për ligjin është rritur, fokusi i punonjësve socialë, gjithashtu, është zhvendosur në adresimin e një vargu më të gjerë të çështjeve ligjore që kërkojnë zbatimin e njohurive profesionale të punës sociale për të arritur qëllime në një larmi kontekstesh të çështjeve civile dhe penale. Artikulli është një trajtim teorik i realizuar përmes analizës së studimeve dhe kontributeve të autorëve të ndryshëm si dhe artikujve shkencorë lidhur me fushën e punës sociale ligjore. Artikulli ka si qëllim kryesor të paraqesë fillimisht një vështrim të përgjithshëm të konceptit të punës sociale ligjore. Punimi, gjithashtu, ka si objektiv të eksplorojë rëndësinë e kësaj fushe, disa nga rolet dhe implikimet e punonjësit social në sistemin gjyqësor me fokus kryesor aspektet praktike dhe profesionale të punonjësit social ligjor. Artikulli duke trajtuar fillimisht konceptin e më pas rëndësinë dhe implikimet praktike evidenton aspekte shumëdimensionale. Artikulli thekson faktin se puna sociale ligjore shpesh portretizohet si një fushë e specializuar brenda disiplinës së punës sociale. Grupi i synuar i punës sociale ligjore përballet me një larmi problemesh në fusha të ndryshme brenda sistemit gjyqësor e më gjerë. Në këtë kontekst punonjësi social ligjor jep kontributin e tij profesional.

Fjalët kyç: punë sociale ligjore, implikime praktike, sistemi gjyqësor, drejtësi.

Understanding and practical implications of forensic social work

ABSTRACT

As public interest in law has increased, the focus of social workers has also shifted to addressing a wider range of legal issues requiring the application of professional social work knowledge to achieve goals in a

variety of civil and criminal contexts. The article is a theoretical treatment realized through the analysis of studies and contributions of various authors as well as scientific articles related to the field of forensic social work. The main purpose of the article is to present an overview of the concept of forensic social work. The paper also aims to explore the importance of this area, some of the roles and implications of the social worker in the judicial system with the main focus on the practical and professional aspects of the forensic social worker. The article addresses first the concept and then the importance and practical implications highlights multidimensional aspects. The article highlights the fact that forensic social work is often portrayed as a specialized field within the social work discipline. The target group of forensic social work faces a variety of problems in various areas within the judicial system and beyond. In this context the forensic social worker gives his professional contribution.

Keywords: forensic social work, practical implications, judicial system, justice.

Hyrje

Sot, punonjësit socialë ftohen gjithnjë e më tepër në sistemin ligjor për të bashkëpunuar brenda sistemit gjyqësor dhe për të krijuar një ndryshim të qëndrueshëm shoqëror.

Sipas Van Wormer (2008), roli i punës sociale në sistemin ligjor po ndryshon ndjeshëm. Rehabilitimi i shkelësve të moshës madhore dhe të mitur është kthyer në një fokus kryesor. Qasjet inovative nën rubrikën e drejtësisë restauruese po ndryshojnë peizazhin e praktikës së punës sociale, veçanërisht në sistemin e drejtësisë penale (f. 366).

Springer dhe Roberts (2007) argumentojnë se praktikantët ligjorë kanë një rol të jashtëzakonshëm në sigurimin e vlerësimeve të rrezikut, dëshmimeve të ekspertëve, kujdesit të shëndetit mendor, trajtimit të abuzimit me substanca dhe praktikave të tjera më të mira në kohë si për viktimat ashtu edhe për shkelësit e ligjit. Gjatë dekadës së kaluar, fokusi më në fund është zhvendosur nga neglizhimi i viktimave të krimit në sigurimin e fondeve të plota shtetërore dhe lokale për shërbime shoqërore gjithëpërfshirëse, reagime të policisë, ndërhyrje në gjykatë, njoftim i kompjuterizuar i çështjeve gjyqësore, strehim urgjence, kujdes mjekësor urgjent, shërbime të shëndetit mendor, kompensimi i viktimave, avokim dhe ndërhyrja në krizë për viktimat e krimit dhe të mbijetuarit e dhunës në familje (f. 3).

Puna sociale ligjore ndihmon punonjësit socialë në përgatitjen e dëshmitarëve ekspertë. Ajo, gjithashtu, kërkon të edukojë profesionistët e ligjit për çështje të mirëqenies sociale dhe punonjësit socialë për ligjin (Maschi, Leibowitz dhe Killian, 2017, f. 12).

Sipas këndvështrimit të Merriam-Webster (2007) termi punë sociale ligjore mund të kuptohet si shuma e pjesëve të saj. Shumica e përkufizimeve të punës sociale theksojnë përdorimin e perspektivës “personi në mjedis”. Shtimi i termit ligjor në punë sociale e bën të qartë kryqëzimin e sistemeve sociale dhe ligjore. Në fakt, termi “ligjor” i referohet “përkatësisë, e përdorur ose e përshtatshme për gjykatat dhe gjyqësorin ose diskutimin dhe debatin publik” dhe “në lidhje me ose që kanë të bëjnë me zbatimin e njohurive shkencore në problemet ligjore”. Theksi që i vihet aspekteve ligjore ose praktikës së drejtësisë është një faktor dallues që e veçon punën sociale ligjore nga praktika e zakonshme e punës sociale (cituar nga Maschi dhe Killian, 2011, f. 11).

Veçanërisht për kontekstin shqiptar ky artikull vjen si një kontribut teorik për literaturën e lidhur me punën sociale ligjore. Artikulli, gjithashtu, ndihmon punonjësit socialë që punojnë në sistemin e drejtësisë me qëllim krijimin e një panorame më të qartë të kuptimit, rolit dhe aspekteve praktike të punës sociale ligjore. Qëllimi i këtij artikulli është që të qartësojë fillimisht konceptin e punës sociale ligjore dhe më tej të paraqesë në një mënyrë të përmbledhur disa prej roleve të punonjësit social në këtë fushë si dhe të evidentojë rëndësinë e kësaj disipline. Në përputhje me qëllimin kryesor, njëkohësisht, do të prezantohen edhe disa implikime praktike të punonjësit social ligjor.

1. Kuptimi i punës sociale ligjore

Praktika ligjore e punës sociale ka ekzistuar që nga fillimi i profesionit të punës sociale, por historikisht ka qenë një segment i vogël i këtij profesioni (Chatfield, 2008; Neighbors, Chambers, Levin, Nordman, & Tutrone, 2000) (cituar nga Munson, 2011, f. 37).

Sipas Maschi, Bradley dhe Ward (2009), puna sociale ligjore ka evoluar gjatë shekullit të kaluar, por ajo është njohur zyrtarisht vetëm në 30 vitet e fundit si specialitet brenda profesionit të punës sociale (cituar nga Butters dhe Vaughan-Eden, 2011, f. 62).

Që nga organizimi i Konferencës Kombëtare të Bamirësisë dhe Korrektimit në 1879, praktika me shkelësit e ligjit është identifikuar si e rëndësishme për punonjësit socialë. Roberts dhe Brownell (1999) kanë gjurmuar marrëdhëniet midis korrektimit dhe punës sociale që nga vitet

1800 dhe demonstrojnë prova të marrëdhënies së punës sociale me mjediset ligjore si në shërbimin e drejtpërdrejtë ashtu edhe në politikë. Ka disa shembuj historikë të punonjësve socialë të angazhuar në shërbim të drejtpërdrejtë me shkelësit e ligjit. Punonjësit socialë u përfshinë në zbatimin e ligjit dhe sistemin e drejtësisë në fillimin e viteve 1900. Roberts dhe Brownell (1999) shpjeguan se punonjësit socialë u tërhoqën në punën sociale mjeko-ligjore, veçanërisht me të rinjtë shkelës, gjatë viteve 1930 dhe 1940. Punonjësit socialë shërbyen si ndërlihdës gjykatash në vitet 1950 për klinikat e mbështetjes së fëmijëve në të gjithë vendin (cituar nga Lowe, 2003, f. 6).

Sipas Wilson (2010), në SHBA praktika e punës sociale ka qenë e përfshirë në sistemin e drejtësisë penale si një komponent thelbësor duke filluar nga fillimi i praktikës në vitin 1904. Kjo është realizuar duke përfshirë praktikën e kryer në sisteme të ndryshme të drejtësisë për të mitur, në drejtësinë penale si dhe punonjës socialë korrektues ose punë sociale forensike. U theksua se roli i punonjësve socialë në gjykata si punonjës socialë të drejtësisë penale është që të balancojnë konfliktin midis nevojës publike për siguri dhe nevojave të shkelësve për të adresuar nevojat e tyre biopsikosociale. Këtu sfida etike për punonjësit socialë është të peshojnë nevojën e shoqërisë dhe sistemit të drejtësisë kundër atyre të shkelësve (cituar nga Ayalew, 2016, f.18).

Green, Thorpe, dhe Traupmann (2005) argumentojnë se qasja Australiane është në përputhje me pikëpamjen e Organizatës Kombëtare të Punës Sociale Ligjore të SHBA-së. Puna sociale ligjore ka qenë e përqendruar fuqishëm në shëndetin mendor dhe sistemet e korrektiveve, megjithëse mund të kuptohet si zbatim i punës sociale në çdo sistem jo vullnetar, përfshirë shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve. Sigurisht, praktika bashkëkohore e punës sociale në shëndetin mendor dhe mbrojtjen e fëmijëve është një praktikë aq e ligjshme sa ajo në sistemin e drejtësisë penale dhe atë të korrektimit, duke pasur parasysh gamën e legjislacionit që rregullon ndërhyrjet profesionale me klientët dhe familjet e tyre (cituar nga Sheehan, 2016, f. 2).

Sipas Maschi dhe Killian (2011), termi ligjor (forensik) nënvizon, gjithashtu, natyrën e përbashkët të punës sociale efektive ligjore, e cila përfshin bashkëpunim me klientë, profesionistë dhe aktorë të tjerë brenda dhe jashtë sistemeve zyrtare dhe joformale për të punuar së bashku në mënyrë që të arrijnë informimin rreth klientëve (cituar nga Mangezi, 2014, f. 16).

Ekzistojnë një numër përkufizimesh për punën sociale ligjore. Ato variojnë nga të përgjithshme tek më specifiket. Në literaturën shkencore,

Barker (2003) mbase ofron përkufizimin më të gjerë duke e përcaktuar si:

“Specialiteti i praktikës në punën sociale që përqendrohet në ligj, çështjet ligjore dhe çështjet gjyqësore, penale dhe civile, duke përfshirë çështjet në mirëqenien e fëmijëve, kujdestarinë e fëmijëve, divorcin, delikuentën e të miturve, përgjegjësinë e të afërmeve, të drejtat e mirëqenies, trajtimin e mandatuar dhe kompetenca juridike” (cituar nga Maschi, Leibowitz, dhe Killian, 2017, f. 12).

Organizata Kombëtare e Punonjësve socialë ligjorë (NOFSW), gjithashtu, na prezanton me një përkufizim të gjerë që përfshin:

“Praktikën e punës sociale, e cila në çdo mënyrë ka të bëjë me çështje ligjore dhe çështje gjyqësore, si penale ashtu edhe civile. Çështjet e kujdestarisë së fëmijëve, që përfshijnë ndarjen, divorcin, neglizhencën, përfundimin e të drejtave prindërore, implikimet e abuzimit të fëmijëve dhe bashkëshortëve, shërbimet e drejtësisë për të mitur dhe të rritur, korrigjimet dhe trajtimi i mandatuar të gjitha bien nën këtë përkufizim”.

Aspekti "ligjor" i punës i vendos punonjësit socialë në një pozicion për të respektuar angazhimin e tyre profesional për drejtësinë sociale përmes përdorimit të njohurive dhe aftësive ligjore, përfshirë avokimin dhe praktikën e politikave (Maschi dhe Killian, 2009, f.4).

Barker dhe Branson (2014), gjithashtu, përpiqen të japin një interpretim më të gjerë të punës sociale ligjore duke e përshkruar atë si *“një specialitet profesional që përqendrohet në ndërveprimin midis sistemeve ligjore dhe sistemit të shërbimit human”*. Këta autorë deklarojnë se një numër në rritje i konflikteve dhe problemeve në shoqërinë e sotme po zgjidhen në gjykatë. Si pasojë, kërkesa për punonjës socialë, të cilët dinë se si funksionon sistemi gjyqësor është në rritje (cituar nga Naessens dhe Raeymaeckers, 2020, f. 4).

2. Rëndësia dhe roli i punonjësit social ligjor

Maschi, Leibowitz dhe Killian (2017) argumentojnë se të gjithë punonjësit socialë në të gjitha fushat e praktikës, jo vetëm ata në mjediset e drejtësisë penale dhe për të mitur, shpesh ndihmojnë klientët e prekur nga ligjet dhe politikat ose problemet në qasjen e burimeve (f. 10).

Në këtë kontekst, autorë të shumtë japin këndvështrimet e tyre lidhur me kontributin e punonjësve socialë ligjorë në aspekte të ndryshme. Kështu, Gibelman (1995) shpjegon se puna sociale ligjore kërkon të edukojë profesionistët e ligjit për nevojat njerëzore dhe të shërbimeve sociale të njerëzve si dhe edukon kolegët e punës sociale për aspektet ligjore të punës së tyre (cituar nga Barker dhe Douglas, 2013, f. 3).

Punonjësi social ligjor i cili përpiqet të krijojë një aleancë konfidenciale terapeutike me një klient, vazhdimisht duhet të peshojë nevojën për të mbrojtur klientin dhe komunitetin nga dhuna ndaj klientit kundrejt të drejtës së klientit për konfidencialitet dhe rëndësisë së rritjes së besimit të klientit. Duke pasur parasysh çështjet komplekse të konfidencialitetit dhe dëmit të pashmangshëm, punonjësit socialë ligjorë duhet të kërkojnë konsulencë kur përballen me këto vendime. Roli i konsulentit në këto aspekte është të ndihmojë punonjësit socialë ligjorë të jenë mjaft të lirë nga ankthi për të përcaktuar realisht potencialin e klientit për dhunë (Brennan et.al., 1986, f. 345).

Specializimi i punës sociale ligjore është një mjet ideal për të lundruar në mjedisin socio-ligjor që shkon zakonisht përtej praktikës së punës sociale. Është një model i praktikës integruese që përfshin etikën e punës sociale, praktikën e përgjithshme dhe të specializuar, njohuritë dhe aftësitë e kërkimit, si dhe natyrën e provave, ligjit, praktikës së politikave dhe bashkëpunimit ndërdisiplinor ose ndërprofesional si dhe ndërsektorial. Në fakt, një angazhim praktikë që përfshin ndërhyrje psikosociale dhe ligjore është në përputhje me qasjen e integruar historike dyplanëshe të praktikës së punës sociale (Maschi, Leibowitz dhe Killian, 2017, f. 5).

Si përfundim themi se punonjësit socialë mund të bashkëveprojnë me sistemin ligjor përmes përpjekjeve për të zgjidhur mosmarrëveshjet tek çështjet gjyqësore, duke shërbyer si një dëshmitar ekspert në emër të një klienti, si një këshilltar i një avokati ose si një ekspert për gjykatën dhe duke siguruar të dhëna apo duke u angazhuar me ligjvënësit, rregullatorët dhe / ose politikëbërësit në hartimin e ligjeve, rregulloreve ose politikave të reja, në vlerësimin e programeve që lidhen në një farë mënyre me sistemin e drejtësisë, në punën me komunitetet dhe përfaqësuesit e tyre për të avokuar për një pozicion të veçantë (Butters & Vaughan-Eden, 2011; Galowitz, 1998–1999; Green et al., 2005; Munson, 2011; National Organisation of Forensic Social Worker) (cituar nga Loue, 2018, f. 103).

3. Implikime praktike të përfshirjes së punonjësit social ligjor në sistemin e drejtësisë

Punonjësit socialë në kontekstin ndërkombëtar operojnë bazuar në manual praktike që udhëheqin punën e tyre. Munson (2011, f. 41) shpjegon se tri organizata profesionale kanë prodhuar udhëzime praktike ligjore që përmbajnë elemente të ngjashme me rolet e kryera nga punonjësit socialë ligjorë. Ato janë Shoqata Amerikane e Psikologjisë, Shoqata Amerikane e Psikiatrisë dhe Shoqata e Gjykatave të Familjes dhe Pajtimimit (AFCC).

Punonjësit socialë në sistemin e drejtësisë përfshihen përmes disa implikimeve praktike. Autorë të ndryshëm, kontribues në literaturën e punës sociale ligjore, kanë identifikuar disa aspekte praktike të përfshirjes së punonjësve socialë në këtë fushë. Disa prej tyre prezantohen në analizën e mëposhtme.

Barker & Branson (2014) sugjerojnë që puna sociale ligjore mund të luajë një rol të rëndësishëm në informimin e sistemit gjyqësor për nevojat e këtij grupi të synuar. Në të njëjtën kohë, punonjësit socialë ligjorë duhet të informojnë punonjësit e tjerë socialë për kornizat përkatëse ligjore, duke i bërë ata të vetëdijshëm për ndikimin e tyre në jetën e klientëve (cituar nga Naessens & Raeymaeckers, 2020, f. 4).

Sipas Barker dhe Douglas (2013), punonjësi social ligjor përmbush të paktën dhjetë funksione kryesore. Ai dëshmon në gjykata si ekspert, vlerëson në mënyrë sistematike individët në mënyrë që informacioni që rezulton të mund të paraqitet në gjykatë ose tek autoritetet ligjore, paraqet rekomandime tek gjykata dhe autoritete të tjera ligjore si mënyra për të zgjidhur konflikte të mundshme, ndihmon në rehabilitimin e atyre që shpallen fajtorë për krime ose që paraqesin neglizhencë në veprimet civile, mund të kontribuojë në lehtësimin e dënimit të dhënë nga gjykata për personin e dënuar, etj. (f. 14).

Maschi, Leibowitz dhe Killian (2017) kanë kontribuar në fushën e punës sociale ligjore përmes një perspektive teorike të integruar si një qasje e të drejtave të njeriut dhe sistemeve të drejtësisë sociale. Kjo perspektivë është e dobishme për vizualizimin e praktikës me klientë të ndikuar nga një kombinim i çështjeve sociale dhe ligjore. Sipas kësaj qasjeje punonjësit socialë që punojnë me individë dhe familje të përfshira në sistemet e shërbimit preken nga çështjet sociale, ligjet, çështjet ligjore dhe politikave (f. 4).

Ndërkohë Maschi dhe Killian (2009), kanë kontribuar në paraqitjen e një qasjeje të dyfishtë për të ndihmuar klientët. Kjo qasje përfshin ndërhyrjen me klientët si në nivelin individual për të adresuar mirëqenien sociale të një klienti dhe/ose në nivelet ligjore ose të politikave. Ata propozojnë emërtimin e kësaj qasjeje si një "qasje të integruar". Në një këndvështrim të tillë, më të gjerë, puna sociale ligjore integron njohuritë dhe aftësitë e saj me punën sociale gjeneraliste dhe të specializuar. Ato i referohen kësaj fushe specialiteti si "punë sociale ligjore bashkëpunuese" (f. 3).

Punonjësit socialë ligjorë, gjithashtu, kanë implikime praktike edhe në fushën e shëndetit mendor. Kështu, punonjësit socialë ligjorë në shumë raste punojnë me klientë që janë diagnostikuar si "antisocial" ose të etiketuar

"rezistent dhe të patrajtueshëm" nga kontaktet me agjencitë e shëndetit mendor (Brennan et. al., 1986, f. 348).

Aspektet praktike të punës sociale ligjore janë të shumta. Gibelman (1995) thekson faktin se punonjësit socialë ligjorë i përdorin aftësitë e tyre për të ndihmuar autoritetet e ligjit në mënyra të ndryshme. Ata intervistojnë viktimat e krimit apo dëshmitarët dhe u japin informacion hetuesve dhe gjykatave, ata këshillohen me avokatët për llojet e jurive që mund të ishin optimale për çështjet e tyre, punojnë me ekspertë të tjerë të shëndetit mendor për të përcaktuar nëse klientët kanë aftësi të mjaftueshme mendore për të gjykuar, si dhe ata shpesh janë dëshmitarë të fakteve ose dëshmitarë ekspertë në procesin e gjykimit (cituar nga Barker dhe Douglas, 2013, f. 3).

Sipas Këshillit të Edukimit të Punës Sociale (2008, f. 5), për më tepër, punonjësit socialë angazhohen për realizimin e "të drejtës së njeriut dhe drejtësisë sociale dhe ekonomike". Duke punuar me sistemin e drejtësisë arrihet që punonjësit socialë të trajtojnë dhe adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjet e drejtësisë dhe padrejtësisë. Brenda kësaj fushe praktike, punonjësit socialë mund të ndikojnë në mirëqenien e individëve, familjeve dhe komuniteteve, të avokojnë për drejtësinë sociale, adresojnë diskriminimin dhe të ndikojnë në ndryshime politike (cituar nga Butters dhe Vaughan-Eden, 2011, f. 62).

KONKLUZIONE

Bazuar në analizën e mësipërme vlen të theksohet se puna sociale ligjore është një praktikë e rëndësishme në disiplinën e punës sociale në mbështetje të sistemit të drejtësisë. Siç u evidentua edhe më lart, praktika profesionale e punës sociale ligjore brenda, ose në konsultim me, sistemet juridike civile dhe penale, përcaktohet në mënyra të ndryshme.

Artikulli tregoi se puna sociale ligjore është përcaktuar ngusht si praktikë profesionale ku punonjësit socialë angazhohen rregullisht si ekspertë në ofrimin e shërbimeve të vlerësimit dhe trajtimit në sistemin gjyqësor për të arritur qëllime ligjore. Në marrëdhëniet me klientët në një sistem gjyqësor, punonjësit socialë duhet të dinë se si të mbajnë marrëdhënie që plotësojnë nevojat e klientit duke minimizuar rreziqet e keqkuptimeve ose konflikteve.

Punonjësit socialë, gjithashtu, duhet të kenë dijeni se çfarë kërkon ligji prej tyre në punën e tyre me klientët. U evidentua fakti që arrihen përfitime reciproke nga përfshirja e punonjësve socialë ligjorë në sistemin e drejtësisë. Nga njëra anë, kemi përfitimin e sistemit të drejtësisë për një kuptim më të plotë të aspekteve të lidhura me mirëqenien sociale, dhe nga

ana tjetër, përfitimin e punonjësve socialë për një njohje më të thellë të implikimeve praktike që mund të lidhen me procesin e drejtësisë sociale.

Në këtë kontekst punonjësi social ligjor jep kontributin profesional në mbështetje të realizimit të një prej parimeve bazë profesionale, atë të drejtësisë sociale. Nevoja për një ndërveprim të sistemit social me sistemin ligjor justifikon në mënyrë eksplicite domosdoshmërinë e punonjësit social ligjor.

Në mënyrë të përmbledhur mund të evidentojnë se studime të ndryshme dhe autorë të shumtë shpjegojnë rëndësinë e përfshirjes së punonjësit social ligjor në sistemin e drejtësisë si në çështje civile ashtu edhe në ato penale. Ata angazhohen për këshillim, shërbime mbështetëse, dëshmitarë, ndikojnë në dhënien e vendimeve gjyqësore më të drejta, implikohen në vlerësimin e programeve që lidhen me sistemin e drejtësisë, aspekte të shëndetit mendor si ndikues në aspekte të ndryshme të procesit gjyqësor etj.

Si përfundim, vlen të theksohet, se përfshirja e punonjësve socialë ligjorë në sistemin e drejtësisë duhet parë si një proces bashkëpunimi, me synim realizimin e gjykimeve objektive përmes respektimit të të drejtave themelore të njeriut si dhe kontributit në përmirësimin e drejtësisë sociale.

REFERENCA:

- Ashford, J. (2015). *The changing face of forensic social work: An overview*. Oxford University Press. Aksesuar nga: https://www.researchgate.net/publication/278244224_The_changing_face_of_forensic_social_work_An_overview
- Ayalew, S. (2016). *Role and Contribution of Social Work Practice in Court Setting and Its Support System: The Case of Lideta Federal First Instance Court Addis Ababa*. Aksesuar nga: <http://213.55.95.56/bitstream/handle/123456789/2426/Seble%20Ayalew.pdf?sequence=1&isAllowed=y>
- Barker, R. L., Douglas M. B. (2013). *Forensic Social Work. Legal Aspects of Professional Practice Second Edition*. Routledge. ISBN: 978-1-315-82157-3 (eISBN). New York, USA.
- Brennan, Th.P., Amy E. Gedrich, Susan E. Jacoby, Michael J. Tardy, Katherine Tyson McCrea. (1986). *Forensic Social Work: Practice and Vision*. " *Social Casework*, vol. 67, no. 6): 340-350. Aksesuar nga: https://ecommons.luc.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1013&context=socialwork_fac_pubs
- Butters, R. P., & Vaughan-Eden, V. (2011). *The Ethics of Practicing Forensic Social Work*. *Journal of Forensic Social Work*, 1(1), 61–72. doi:10.1080/1936928x.2011.541202

- Mangezi, M. (2014). An investigation into the specialized skills and knowledge required for forensic social work practice in South Africa. University of Cape Town. Aksesuar nga: https://open.uct.ac.za/bitstream/handle/11427/28182/thesis_hum_2014_mangezi_mart_in_simbarashe.pdf?isAllowed=y&sequence=1
- Maschi, T., Killian, M. L. (2011). The Evolution of Forensic Social Work in the United States: Implications for 21st Century Practice. *Journal of Forensic Social Work 1(1):8-36*. DOI: 10.1080/1936928X.2011.541198. Fordham. Aksesuar nga: file:///C:/Users/User/Downloads/TheEvolutionofForensicSocialWorkintheUnitedStates_Implicationsfor21stCenturyPractice.pdf
- Maschi, T., S. Leibowitz, G., Lou Killian, M. (2017). Conceptual and Historical Overview of Forensic Social Work. Springer Publishing Company. Forensic Social Work (Second Edition). DOI: 10.1891/9780826120670.0001. Aksesuar nga: https://connect.springerpub.com/binary/sgrworks/3e7dd1c695505e83/da7f6bee76fb72edc75a3a065f4fada8c01ce960f63f04c2d8b9378d5adf771a/9780826120670_0001.pdf
- Maschi, T., Bradley, C., Ward, K. (2009). Forensic social work: psychosocial and legal issues in diverse practice settings. New York, NY: Springer Publishing Company. Ebook ISBN: 978-0-8261-1858-5.
- Maschi, T., Leibowitz, G.S. (2018). Psychosocial and Legal Issues Across Diverse Populations and Settings. Second Edition. Chapter 25. Restorative Justice: What Social Workers Need To Do—Part 2 (Katherine van Wormer). Springer Publishing Company. Aksesuar nga: https://www.researchgate.net/publication/230216937_Forensic_Social_Work_Current_and_Emerging_Developments
- Munson, C. (2011). Forensic Social Work Practice Standards: Definition and Specification. *Journal of Forensic Social Work, 1(1), 37–60*. doi:10.1080/1936928x.2011.541200
- National Organization of Forensic Social Work (NOFSW). Aksesuar nga: <https://www.nofsw.org/what-is-forensic-social-work-1>
- Naessens, L., & Raeymaeckers, P. (2020). A generalist approach to forensic social work: A qualitative analysis. *Journal of Social Work, 146801731982674*. Doi: 10.1177/1468017319826740. Aksesuar nga: <https://journals.sagepub.com/doi/pdf/10.1177/1468017319826740>
- Lowe, L. (2003). Social work and forensic practice: an assessment of attitudes and experiences. The University of Georgia. Aksesuar nga: https://getd.libs.uga.edu/pdfs/lowe_laura_a_200405_phd.pdf
- Loue, S. (2018). The Social Worker and Forensic Social Work. *Legal Issues in Social Work Practice and Research, 103–131*. doi:10.1007/978-3-319-77414-5_6
- Sheehan, R. (2016). Forensic Social Work: Implementing Specialist Social Work Education. *Journal of Social Work, 16(6), 726–741*. doi:10.1177/1468017316635491
- Springer, D., Roberts, R. A. (2007). Handbook of Forensic Mental Health with Victims and Offenders: Assessment, Treatment, and Research. Springer Publishing Company. New York. USA. ISBN 0-8261-1514-4.

PUNA SOCIALE NË ZONAT RURALE (RASTI I BASHKISË SHKODËR)

Ledina Preza, Bujanë Topalli

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, departamenti Psikologji-Punë Sociale

ABSTRACT

Puna sociale në zonat rurale është një fushë e re e profesionit të Punës Sociale e cila në vendet perëndimore njihet si zhvillim i hershëm. Vitet e fundit në Shqipëri ka patur një rritje të vëmendjes së qeverive lokale në ofrimin e shërbimeve sociale në zonat rurale. Ky ndryshim lidhet me zhvillime të rëndësishme të politikave sociale në vendin tonë; një prej të cilëve është dhe procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale. Studimi ka për qëllim të na njohë me zhvillimet e punës sociale në zonat rurale dhe me sfidat me të cilat përballen punonjësit socialë. Bazuar në metodologjinë cilësore dhe nëpërmjet intervistave të realizuara me punonjës socialë profesionistë që punojnë në zonat rurale të Bashkisë Shkodër, do të përpiqemi të njihemi me gjerësisht me këtë kontekst profesional.

Fjalët kyçe: punë sociale rurale, përvojë, sfida, e ardhme.

Rural Social Work (The case of the municipality of Shkodra)

ABSTRACT

Social work in rural areas is a new field of social work profession in our context, while in western countries it is more developed. In recent years, in Albania there has been a focus of local government attention towards the provision of social services for rural areas. These developments are related to important changes in the field of social policies, among which is the process of decentralization of social services.

The study aims to analyze the situation of social work in rural areas and to show the challenges of social workers. Based in qualitative methodology, through interviews with these professionals will try to understand the reality of rural Social Work in the Municipality of Shkodra.

Key words: rural social work, experience, challenge, future.

Hyrje

Puna sociale, në vendin tonë ende konsiderohet një profesion i ri, duke qenë se fillimet e ushtrimit të saj datojnë pas viteve 90-të. Zhvillime të rëndësishme në fushën e politikave sociale përgjatë këtyre viteve kanë sjellë mjaft progres në njohjen e rolit të punonjësit social.

Zbatimi i reformës administrative territoriale, konsiderohet si një moment mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e profesionit të Punës sociale në vendin tonë. Kjo, pasi reforma, përveçse solli zgjerimin e sipërfaqeve të bashkive, i delegoi njëkohësisht më shumë kompetenca në sektorin social qeverive lokale (decentralizimin).

Pikërisht si rrjedhojë e kësaj situatë të re, një ndër sfidat e qeverisjeve lokale, mbetet mbulimi me shërbim social i zonave rurale, pasi deri tani shërbimet sociale të bashkive kanë qenë të përqendruara në zonat urbane.

Në qoftë se më përpara Bashkia Shkodër ka mbuluar me shërbime sociale 5 rajonet e qytetit Shkodër, tashmë sfida është më e madhe, pasi pushteti lokal duhet të ofrojë shërbime sociale edhe për njësitë administrative (ish-komunat), territore këto që nuk janë mbuluar më përpara nga shërbimet sociale në bashki. Konteksti ku do të ofrohen shërbimet sociale në njësitë administrative përfaqëson edhe një kontekst të ri të Punës sociale, pikërisht punën sociale në zonat rurale.

Puna sociale rurale: karakteristikat, sfidat dhe parimet

Në literaturën e huaj ka mjaft përpjekje për të dhënë një përkufizim në lidhje me Punën sociale në zonat rurale. Shpesh një përpjekje e tillë është përqendruar te dallimi ndërmjet punës sociale urbane dhe asaj rurale. Ndërkohë me evolimin e njohjes në këtë fushë, autorë të ndryshëm kanë dhënë përcaktimin e tyre në lidhje me punën sociale rurale dhe gjithashtu kanë evidentuar karakteristikat tipike të punës sociale në këto zona.

Zona rurale, sipas autorëve Heyman dhe Vandebos (1989), konsiderohet ajo zonë gjeografike me popullsi të shpërndarë me dendësi të ulët dhe me pak shërbime sociale *cituar te* (Brownlee, K., Graham, J. R., Doucette, E., Hotson, N., & Halverson, G., 2010).

Referuar autorit Schmid (2000), zonat e thella malore dhe të izoluara, konsiderohen ndryshe zona rurale, pasi këto zona janë konsideruar si të veçanta, duke qenë se shpesh banorët vendas ndihen të harruar dhe të marginalizuar nga pjesa tjetër e popullatës. Sigurimi i shërbimeve, të tilla si: arsimit, kujdesi shëndetësor, shërbimi social etj., janë një sfidë për këto

territore si rrjedhojë e kushteve të vështira klimatike.

Pikërisht referuar kushteve të lartpërmendura ofrimi i shërbimeve sociale në zonat rurale nuk është një nisëm e lehtë, shto këtu dhe faktin se puna sociale rurale paraqet karakteristikat e veta të veçanta. Kjo ka sjellë që shpeshherë strukturat publike që ofrojnë shërbime sociale, të ndejnë nevojën e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile për të arritur ofrimin e shërbimeve të përshtatshme në këto territore. Ndërkohë, duhet theksuar, se interesi dhe angazhimi i organizatave të shoqërisë civile për të vepruar në këto zona është i vogël, duke i privuar kështu banorët nga aksesin në shërbimet sociale dhe duke limituar mundësitë për zhvillimin e këtyre komuniteteve (Pugh, R., & Cheers, B., 2010, f. 115).

Kufizimi i ofrimit të shërbimeve sociale në zonat rurale lidhet ngusht edhe me disa karakteristika të këtyre komuniteteve, të cilat influencojnë fushën e punës sociale rurale. Fakti që këto komunitete kanë të zhvilluar shumë mbështetjen e tyre sociale nëpërmjet marrëdhënieve familjare dhe rrethit të ngushtë të njohurve, bën që ata të dinë çdo gjë rreth njëri - tjetrit, duke diktuar që punonjësi social të veprojë në mungesë të anonimatit me klientët e tij. Gjithashtu, marrëdhëniet e forta ndërmjet anëtarëve të komunitetit rural, mund të shikohen si mjaft pozitive në drejtim të sigurisë publike, pasi këto komunitete duke qenë se vetëmonitorohen janë shumë të sigurta, por ama kjo ka një çmim; pranueshmëria e individëve të cilët devijojnë nga normat e bashkësisë është shumë e ulët. Për këtë arsye, shpeshherë, punonjësi social në zonat rurale, mund të përballlet me sfidat sesi t'i përqaset komunitetit, të kuptojë kulturën e tyre dhe të pranohet prej anëtarëve të komunitetit rural (Scales, T. L., Streeter, C. L., & Cooper, H. S., 2014, f. 321).


Referuar autorëve Delaney dhe Brownlee (1995) puna sociale në zonat rurale paraqet kufizimet e veta specifike, si: akseset të limituara në supervizion dhe sidomos problematika në lidhje me çështjet etike, sidomos në lidhje me konfidencialitetin. "Intergrimi i rolit", pra pranimi i rolit të punonjësit social në zonat rurale, konsiderohet nga Zapf (1984), si një ndër vështirësitë më të mëdha me të cilat përballen punonjësit socialë në zonat rurale, krahasuar me zonat urbane *ciuar te* (Schmidt G. G., 2002).

Ndërkohë që autorë të tjerë kanë evidentuar karakteristika të punës sociale rurale siç janë: krijimi i marrëdhënieve shoqërore me klientët dhe përdorimi i qasjes gjithëpërfshirëse. Duke qenë se puna sociale rurale zhvillohet në komunitete me numër të vogël banorësh, mundësia që një klient ta kesh koleg në të ardhmen është një ndër situatat tipike me të cilat përballlet një punonjës në zonat rurale. Gjithashtu, njohja dhe zbatimi i të gjitha metodave të punës sociale, është domosdoshmëri për një punonjës

social në zonat rurale, i cili e gjen veten në role të ndryshme profesionale dhe kjo nuk është aspak diçka e lehtë (Croxtton, T. A., Jayaratne, S., Mattison, D., 2002).

Pikërisht qasja gjithëpërfshirëse përfaqëson edhe një ndër 3 parimet bazë që udhëheqin punën sociale në zonat rurale, bazuar në modelet e punës sociale rurale të propozuar nga autorët Scales, T. L., et al. (2014). Ndërkohë, që dy parimet e tjera të cilat përbëjnë këtë model pune janë: analizimi i shkëmbimeve sociale midis sistemeve dhe përdorimi i perspektivës së bazuar në pikat e forta (f.10).

Figurë 1. Modeli i Punës Sociale në zonat rurale.



Pra, referuar këtij modeli, kuptohet që puna sociale në zonat rurale, merr parasysh karakteristikat e marrëdhënieve të ngushta që kanë anëtarët e komunitetit rural, të cilat janë mjaft të ndryshme me ato të banorëve në zonat urbane që tregohen më individualistë dhe gjithashtu nxit njohjen e pikave të forta të komunitetit, duke stimuluar identifikimin e një praktike ndërhyrjeje më efektive.

Siç edhe literatura paraqet, puna sociale rurale, tashmë konsiderohet si një fushë e veçantë e profesionit të punës sociale, e cila udhëhiqet nga parimet e veta dhe gjithashtu shquhet për karakteristikat dalluese si dhe sfidat e shumta.

Zhvillimi i Punës sociale rurale në vendin tonë (Rasti i Bashkisë Shkodër)

Referuar punës sociale në zonat rurale në vendin tonë, eksperiencat në këtë fushë janë të pakta apo sporadike.


Në përgjithësi pas viteve 90-të popullsia rurale nuk ka pasur akses në shërbime sociale, pasi vëmendja e qeverive ka qenë më shumë e fokusuar në rimëkëmbjen e ekonomisë së këtyre zonave, si një ndër çështjet më emergjente. Ndërkohë, problematikat sociale që përjetojnë komunitetet rurale në vendin tonë janë të larmishme. Vështirësitë në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale në këto zona (komunitete rurale) ndikohen më së shumti nga kultura e popullatës së zonës. Pikërisht kjo vështirësi ka nxitur që shumë ndërhyrje sociale të realizohen nëpërmjet personave referent (anëtarë të komunitetit), të cilët njohin më mirë mentalitetin e zonës, sesa nga punonjës socialë (E. Myftari., & I. Tahsini., 2003, f. 71-74).

Ndërkohë, që referuar studimeve në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale private nga OShC-të, evidentohet se shumica e OShC¹-ve shqiptare janë vendosur në qytetet kryesore dhe panorama e mbulimit të territoreve rurale (fshatra apo zona të largëta) nga shoqëria civile duket të jetë shumë e ulët. Sipas të dhënave të një sondazhi të kryer në vitin 2009, vetëm 11% e OShC-ve mbulonin me shërbimet e tyre qytetet e vogla dhe fshatrat. Disa ndër problematikat që këto OShC paraqitnin, lidheshin me mungesën e aftësive të tyre për të shkruar projekte, për të ndërtuar koalicione, advokuar si dhe paqartësi e vështirësi në stabilitetin financiar. Por, pavarësisht vështirësive, prezenca e tyre mbetet mjaft pozitive për zhvillimin e komuniteteve ku ata veprojnë (Dhëmbo, E., Gjokutaj, E., Kuci, B., 2012, f. 16).

Ndërkohë, që vetëm pas vitit 2015, situata në lidhje me shërbimin social në zonat rurale filloi të ndryshonte. Pikërisht procesi i decentralizimit mund të konsiderohet si kryefjala e këtyre zhvillimeve.

Zbatimi i Reformës Administrativo-Territoriale (2015) ndikoi në rritjen e numrit të popullsisë dhe në zgjerimin deri në 52 herë të sipërfaqes së Bashkisë Shkodër. Tashmë nën administrimin e Bashkisë Shkodër janë 1 qytet dhe 93 fshatra, të grupuara në 11 njësi administrative (Plani Social i Zonës, 2018-2021, f. 2-3).


¹ Organizata të shoqërisë civile.

Figurë 2 Ndarja administrative e Bashkisë Shkodër.

Shoqërimi i kësaj reforme me miratimin dhe zbatimin e Ligjit për “Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” (2015), i cili përcaktoi mënyrat e funksionimit, kompetencat dhe detyrimet e qeverisjes lokale, solli dhe konkretizimin e procesit të decentralizimit.

Gjithashtu në rritjen e vëmendjes drejt punës sociale në zonat rurale kontriboi edhe Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, në Nenet 36 dhe 37 ku përcaktohet qartë jo vetëm roli i bashkisë në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, por edhe strukturat që duhet të ngrihen e të funksionojnë si pjesë e saj, me qëllim që të bëhet funksional një sistem lokal komunitar i këtyre shërbimeve. Në këndvështrimin e ligjit, bashkia duhet të ketë struktura të ngritura në dy nivele: 1. Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në bashki; 2. Njësi vlerësimi të nevojave dhe referimit, e krijuar në nivelin e njësisë administrative. Pra, ligji i cakton Qeverive Vendore, detyra planifikuese dhe zbatuese në lidhje me shërbimet sociale (Bisha, E. Kulluri, E. Tahsini, I., 2019, f. 9).

Aktualisht, Bashkia Shkodër ofron shërbime sociale në komunitet në 5 qendra komunitare në qytetin e Shkodrës të ndarë sipas rajoneve.

Figurë 3 Organizimi i shërbimit social në Bashkinë Shkodër.

Këto shërbime sociale ofrohen në partneritet me OSHC të ndryshme që veprojnë në vendin tonë. Target grupet të cilat mbulohen me shërbime sociale komunitare janë: komuniteti rom, familjet dhe sidomos ato të kthyer nga emigrimi. Përveçse në qytet, qendra komunitare janë krijuar dhe po ofrojnë shërbime edhe te njësitë administrative (ish - komnat) si: Rrethina, Shala, Velipoja, Dajçi, Gur i Zi. Ndër shërbimet e komunitetit të ofruara nga këto qendra duhet të përmenden dhe theksohen ato për fëmijë dhe familje, kryesisht me funksion: informim, këshillimi, orientim, shërbim psiko - social etj., (Report - University of Tirana, Elbasan, Shkodër, 2020, f. 53).

Kohët e fundit, hapja e këtyre qendrave komunitare në njësitë administrative të Bashkisë Shkodër paraqet një përpjekje për të mbuluar me shërbime sociale zonat rurale, pasi shumica e shërbimeve sociale kanë qenë të përqendruara në qendrën urbane të bashkisë. Ndërkohë që cilësia e këtyre shërbimeve mbetet ende një sfidë (Dizdari, V., Troshani, A., Drishti, E., 2019).

Krijimi i partneriteteve ndërmjet shërbimeve sociale publike dhe atyre private, konsiderohet një risi në fushën e shërbimeve sociale në Bashkinë Shkodër, një përpjekje dinjitoze për të mbuluar me shërbim social

efektiv dhe eficient zonat më të largëta të saj.

Metodologjia e studimit

Studimi “*Puna Sociale në zonat rurale (Rasti Bashkisë Shkodër)*” ka për qëllim njohjen e situatës së shërbimeve sociale në zonat rurale, më konkretisht punës sociale rurale. Ndërsa, objektivat e punimit, fokusohen në dy çështje kryesore, si: 1. Të informohemi në lidhje me punën sociale në zonat rurale të Bashkisë Shkodër dhe 2. Të evidentojmë karakteristikat dhe sfidat e punonjësit social në zonat rurale që punojnë në Bashkinë Shkodër.

Studimi është realizuar bazuar në metodën cilësore, pasi nuk rezulton të ketë studime të tilla të realizuara në kontekstin tonë. Për këtë arsye synohet që nëpërmjet *instrumentit të intervistës së strukturuar* të mund të sigurohet sa më shumë informacion në lidhje me njohjen e kësaj fushe, sidomos në kontekstin e Bashkisë Shkodër. Pyetjet kërkimore të studimit janë: 1. *Cila është panorama e punës sociale në zonat rurale të Bashkisë Shkodër?* dhe 2. *Cilat janë disa nga sfidat e punonjësve socialë me komunitetet rurale?*

Kampioni i këtij studimi është i qëllimshëm dhe përzgjedhja e të intervistuarve është bazuar në kriteret e të qenit punonjës social në sektorin publik apo privat, por që është i angazhuar në ofrimin e shërbimeve sociale në zonat rurale të Bashkisë Shkodër.

Konkretisht pjesëmarrës në studim janë 10 punonjës socialë që punojnë në zonat rurale. Instrumenti i intervistës së strukturuar është aplikuar në realizimin e këtij studimi. Intervista është konceptuar që mos të kalonte 25 minuta kohëzgjatje në plotësim. Realizimi i tyre është bëri i mundur gjatë periudhës prill-maj 2020, ku referuar edhe situatës së pandemisë, është përzgjedhur formati elektronik (mail) për administrimin e tyre.

Pikërisht, referuar literaturës, intervistat në distancë njihen dhe si *asinkronike* dhe vlerësohen në lidhje me avantazhet që krijojnë si për studiuesin ashtu dhe për të intervistuarin. Në lidhje me të intervistuarit avantazhi qëndron në faktin që ato kanë më shumë kohë në favor për ta plotësuar intervistën dhe gjithashtu mundësi në plotësimin e saj në një moment të përshtatshëm për ta, çka garanton edhe cilësi më të mirë të përgjigjedhënieve. Ndërkohë, që për studiuesin, avantazhi që ofron intervistimi nëpërmjet mail-it, paraqitet gjatë fazës së analizës së të dhënave, pasi duke qenë se të dhënat merren në formë teksti nga të intervistuarit, nuk kanë nevojë që ato të zbardhen, kështu që ato janë të gatshme për analizë (Matthews.B dhe Ross.L, 2010, f. 303-304).

Gjetje dhe diskutime

Referuar analizës së të dhënave cilësore, rezultate mjaft interesante janë përfshirë në lidhje me tematikën e studimit dhe pasqyrimi i tyre do të shoqërohet edhe nëpërmjet pjesëve të shkëputura nga intervistat me punonjësit socialë pjesëmarrës në këtë studim.

Tematikat e përfshira në këtë studim janë si më poshtë:

- 1- *Roli i punonjësit social në zonat rurale të Bashkisë Shkodër.*
- 2- *Roli i punonjësit social në perceptimin e komuniteteve rurale të Bashkisë Shkodër.*
- 3- *Aftësitë dhe sfidat e punonjësit social rural.*
- 4- *E tashmja dhe e ardhmja e punës sociale rurale.*

Disa nga **rolet** e shumta që punonjësit socialë zhvillojnë në komunitetet rurale evidentohen të jenë: ndërgjegjësues, organizues aktivitetesh të ndryshme, vlerësues, menaxher rastesh, koordinatorë, animatorë, agjentë ndryshimi, informues, ndërmjetësues, lobues, bashkëpunues.

“Lobim për familje të disvantazuara pranë organeve shtetërore. Përfshirje e fëmijëve në aktivitete argëtuese dhe kreative, gjithashtu në kampe verore. Ndërmjetësim për dhënie të ndihmës direkte për familje në vështirësi ekonomike, nga donatorë të huaj. Ndërmjetësim për përfitim të ndihmës ligjore falas etj”. Intervistuari 5

“Roli im është i përcaktuar sipas projekteve. Përgjegjëse në punën me gratë, koordinim të aktiviteteve socio - ekonomike, animatore, lehtësuese e procesit të punës me gratë etj.”. Intervistuari 6

Ndërkohë, lidhur me faktin sesa njihet nga anëtarët e komuniteteve rurale roli i punonjësit social, sipas të intervistuarve, konstatohet se vazhdon të kenë vështirësi në njohjen e vlerave të tyre si profesionistë nga banorët e zonave rurale. Ende ka një konfuzion në radhët e komuniteteve rurale në lidhje me rolin e punonjësit social, i cili ngjan i padallueshëm nga ai i psikologut dhe gjithashtu në shumë raste duke qenë se punonjësit socialë në zonat rurale përfshihen në zbatimin e projekteve sociale, i ka bërë ata të identifikueshëm në sytë e komuniteteve rurale më shumë si “ekspertë projektesh sociale”, sesa për rolet e tjera.

“Anëtarët e komunitetit ku unë punoj nuk kanë shumë informacion për rolin e punonjësit social, më shumë njihet roli i psikologut. Po mendoj që me kalimin e kohës anëtarët e komunitetit kanë vazhduar të ndërgjegjësohen”.

Intervistuari 2

“Me aq sa kam arritur t’i njoh dhe të flas me ta, nuk kanë shumë informacion për figurën e punonjësit social. Më shumë e perceptojnë si një person që bën projekte sociale, sesa krejt rolet e tjera!”. Intervistuari 7

Referuar edhe literaturave të ndryshme botërore, puna sociale rurale ka aspektet e veta të veçanta. Ndërkohë, referuar kontesktit tonë social, bazuar në të dhënat e këtij studimi, konstatohet se puna sociale rurale evidenton profilin e saj, influencuar nga kultura dhe historia e zhvillimit të shërbimeve sociale si dhe profesionit të punës sociale.

Të shumta janë problematikat apo **sfidat** që një punonjësi social të zonave rurale i duhet për t’u përballur, të cilat doemos kërkojnë dhe aftësitë të reja që duhen zhvilluar. Disa prej tyre janë paraqitur përmbledhtazi më poshtë:

- Ndër sfidat e evidentura nga të intervistuarit vërehet të jenë:
 - mënyra e jetesës së banorëve,
 - mungesa e informacionit mbi punonjësia social,
 - mungesa transportit e shërbimeve,
 - probleme të mëdha sociale,
 - infrastruktura,
 - mungesë aksesi,
 - siguria e ulët,
 - mentaliteti,
 - pabarazitë gjinore.

Gjithashtu, punonjësia sociale të intervistuar, pohojnë se puna sociale rurale paraqitet mjaft ndryshe në raport me punën sociale në komunitetet urbane. Mungesa e një jetë sociale, pamundësia e argëtimit e socializimit si dhe mbizotërimi i mentalitetit patriarkal në zonat rurale ka nxitur edhe më shumë zhvillimin e pabarazive gjinore. Për këtë arsye **aftësitë** e punonjësia social në këtë fushë priten të jenë të tjera në raport me punën sociale në zonat urbane.

“Aksesi i zonave është i vështirë për një punonjës social, nuk ka lehtësi transporti. Siguria për jetën gjatë transportit është e ulët. Komuniteti nuk ka pritshmëri të qarta për rolin e punonjësia social”.

Intervistuari 1

“Duke qenë se unë punoj edhe në zonë rurale edhe urbane vë re që tek zona rurale ka mungesë informacioni edhe mentaliteti i njerëzve ka ndryshime. Për shembull denoncimi i dhunës, mungesa e informacionit për

ofertat e punës, hartën e shërbimeve etj.”. Intervistuari 3

“Fshati ka pak mentalitet! Për të zhvilluar një aktivitet social-kulturor me të rinj nuk është e lehtë! Janë skeptikë ndaj organizimeve të tilla. Por, në qoftë se i fton në këtë aktivitet një person me influencë nga fshati, gjërat ecin shumë më mirë! Ne zakonisht bashkëpunojmë në të tilla aktivitete me mësues të zonës, jo me ato që vijnë nga qyteti!” Intervistuari 8

“Aftësia që duhet pasur parasysh nga punonjësi social është të ndërtojë marrëdhënie sa më mira me target grupin që punon. Gjithashtu, komunikimi ka një rol kryesor në zhvillimin sa më të mirë të punës. Kultura, tradita, zakonet duhen patur shumë në konsideratë, pasi mund të kenë disa vlera që ato i kanë shumë të rrënjosura dhe t’i duhet të jesh shumë i kujdesshëm në respektimin e tyre”. Intervistuari 2

Me kalimin e viteve situata e punës sociale rurale ka njohur zhvillim dhe përmirësim. **Tashmë**, banorët e zonave rurale, kanë filluar të njihen me llojet e shërbimeve sociale dhe kanë mësuar sesi të arrijnë të përfitojnë prej tyre. Gjithashtu, janë shtuar shërbimet sociale, aktivitetet e ndryshme dhe është rritur informimi për shërbimet sociale, ku gjithnjë e më shumë rëndësi po i kushtohet punës sociale në këto zona.

“Situata sociale në zonat rurale besoj që ka ndryshuar, sepse më përpara njihej vetëm ndihma ekonomike si shërbim social, ndërsa tani shikohen aktivitetet dhe shërbimet ditore”. Intervistuari 9

“Ka një ndërgjegjësim më të lartë të insititucioneve mbi rëndësinë e suportit social”. Intervistuari 2

“Them që nuk është bërë mjaftueshëm kohë sa për të faktuar ndryshime, pasi në 6 vjet kemi si OJF që punojmë në këtë zonë, por ama them se komuniteti tashmë është i njohur me shërbimet tona, me prezencën tonë dhe do e kemi më kollaj bashkëpunimin”. Intervistuari 10

“Mendoj që planifikimi i sa më shumë politikave sociale do të ndihmonte shumë që të zhvillohet roli i punonjësit social në zonat rurale”. Intervistuari 3

“Bashkimi Evropian ka strategji në lidhje me zhvillimin e zonave rurale. Smart Village është modeli që ata synojnë dhe që edhe ne po mundohemi t’i shkojmë pas! Ne jemi në nivel më “primitiv”, pasi jemi në hapat e krijimit të fermave sociale, por ato shkojnë edhe me larg në dixhitalizimin e këtyre zonave të cilat pretendohen se do të ndikojnë në një tjetër perspektivë zhvillimi të këtyre zonave. Përfitimet do të jenë mjaft të mëdha si në aspektin ekonomik, por edhe atë socialhuman!”.

Intervistuari 8

E ardhmja e punës sociale në zonat rurale pritet të jetë më dinamike. Referuar të intervistuarve tendencat do të jenë në përqendrimin e

zbatimit të më shumë projekteve sociale në dobi të zhvillimit të zonave rurale, rritja e numrit të punonjësve socialë, shtimi i qendrave komunitare në këto zona, krijimi i fermave sociale – bizneseve sociale.

Rëndësi e studimit dhe kufizimet e kërkimit

Me ndarjen e re administrative, me zgjerimin e territoreve të administrimit të bashkive dhe referuar edhe procesit të decentralizimit, ku çdo bashki duhet të sigurojë vetë mbulimin me shërbime sociale të territorit të saj, paraqitet me mjaft interes shqyrtimi i kësaj teme. Zgjerimi i kompetencave të Bashkisë Shkodër edhe në zonat rurale, konkretizuar kjo me hapjen e 5 qendrave komunitare në zonat Rrethina, Shala, Velipojë, Dajç, Gur i Zi, vërteton tendencën e zhvillimit të punës sociale në zonat rurale dhe gjithashtu nevojën për njohjen e karakteristikave profesionale për këtë sektor.

Gjithashtu, ky punim, duke qenë se përfaqëson një përpjekje të parë për të kuptuar situatën e punës sociale në zonat rurale në Bashkinë e Shkodrës, si i tillë mbart kufizime. Së pari, pasi njohja e situatës është bazuar vetëm në eksperiencën e ofruesve të shërbimeve, punonjësve socialë dhe fakti që punimi është bazuar në metodologjinë cilësore nuk krijon mundësi për përgjithësim të gjetjeve.

KONKLUZIONE

- Puna sociale rurale është një fushë specifike e profesionit të punës sociale që është zhvilluar më vonë se puna sociale në zonat rurale, kjo për shkak historike të zhvillimit të profesionit të punës sociale.
- Reformat dhe ligjet e ndryshme në fushën sociale të zbatuara në vendin tonë këto vitet e fundit, kanë filluar të japin efektin e tyre edhe në fuqizimin e punës sociale në zonat rurale.
- Ndarja e re administrative dhe procesi i decentralizimit i kanë diktuar Bashkisë Shkodër më shumë vëmendje për mbulim me shërbime sociale të njësive administrative dhe si rrjedhojë dhe fillimin e zhvillimit të punës sociale rurale.
- Sfidat e ofrimit të shërbimeve sociale në zonat rurale të Bashkisë Shkodër paraqiten të shumta, duke filluar që nga vështirësitë infrastrukturore për të arritur në këto zona të largëta, mentaliteti që komuniteti i këtyre zonave ka dhe mosnjohja apo konfuzioni në lidhje me rolin e punonjësit social.
- Aftësitë e bashkëpunimit me anëtarët e komunitetit, komunikimi i thjeshtë, njohja dhe respektimi i traditave dhe zakoneve të zonave rurale,

konsiderohen si shprehitë kryesore në ofrimin e shërbimeve sociale nga punonjësit socialë në këto zona.

- E ardhmja e punës sociale rurale në Bashkinë Shkodër pritet të jetë shumë më pozitive sesa paraqitet tani, duke qenë se ndërgjegjësimi në lidhje me nevojën e shërbimeve sociale, rolin e punonjësit social dhe implementimi i projekteve sociale (me parteneritet publik-privat) është rritur këto vitet e fundit.

BIBLIOGRAFIA:

1. Bisha, E. Kulluri, E. Tahsini, I. (2019). *Udhërrëfyes për bashkitë për planifikimin dhe administrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror*. Tiranë, Albania: ESA Consulting, f. 9.
2. Brownlee, K., Graham, J. R., Doucette, E., Hotson, N., & Halverson, G. (2010). Have communication technologies influenced rural social Work practice? *British Journal of Social Work*, 40(2), f. 622-637.
3. Croxton, T. A., Jayaratne, S., Mattison, D. (2002). *Social Work Practice Behaviors and Beliefs: Rural-Urban Differences?* (Vol. 3), f.117-132.
4. Dhëmbo, E., Gjokutaj, E., Kuci, B. (2012). *Civil society in rural and areas in albania*. Tiranë: IDM & UNDP, f.16.
5. Dizdari, V., Troshani, A., Drishti, E. (2019). The Bumpy Road of the Externally Transferred Austerity Agenda in Albania and Its Fragmentary Effects on Local Public Services,. (T. N. in A. Lippi, Ed.) *Austerity across Mediterranean. Local Public Services in Times of Austerity* f.193-216.
6. E. Myftari., & I. Tahsini. (2003). *Punonjësit socialë*. Tiranë: Dituria, f. 71-74.
7. Matthews, B., Ross, L. (2010). *Metodat e hulumtimit; Udhëzues praktik për shkencat sociale*. Tiranë: Centre for democratic education CDE. f. 303-304.
8. *Plani Social i Zonës (2018-2021)*. Bashkia Shkoder, Shkoder/Albania: 2018.
http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/plani_social_i_zones_draft_1813.pdf, fq 2-3.
9. Pugh, R., & Cheers, B. (2010). *Rural Social Work: An International Perspective*, f. 115.
10. Scales, T. L., Streeter, C. L., & Cooper, H. S. (Eds.). (2014). *Rural social work: Building and sustaining community capacity*. John Wiley & Sons. f.10 dhe 321.

11. Schmidt, G. G. (2002). Remote, northern communities: Implications for social work practice. *International Social Work*, 43(3), f.337-349.
doi:doi.org/10.1177/002087280004300306.
12. Report - University of Tirana, Elbasan, Shkoder. (2020). *Social services in Albania: background and state of the art*. Itali: Caccuci, f.53.

SFIDAT QË NDESHIN PUNONJËSIT SOCIALË NË USHTRIMIN E PROFESIONIT TË TYRE NË QENDRAT KOMUNITARE TË QYTETIT TË SHKODRËS

Gjulia Bebani

Punonjëse Sociale

ABSTRAKT

Koncepti i një modeli për Shërbimin me Bazë Komunitare është një risi dhe kontribuon në krijimin e një perspektive të re të sistemit welfare për t'iu përgjigjur kërkesave të komunitetit. Fokusi i Qendrave dhe Shërbimeve Komunitare është integrimi i komuniteteve të marxhinalizuara në jetën socio-ekonomike, të qenurit zë dhe mediator i komunitetit, mbi të drejtat dhe nevojat e tij.

Evidentimi i sfidave që hasin punonjësit socialë në Qendrat Komunitare në qytetin e Shkodrës është objekt i këtij studimi.

Metoda kërkimore e këtij studimi është metoda cilësore, e cila përputhet me qëllimin e këtij studimi. Janë intervistuar tetë punonjës socialë të cilët punojnë në dymbëdhjetë Qendrat Komunitare të qytetit të Shkodrës. Nga studimi rezulton se në Qendra Komunitare ofrohet larmishmëri shërbimesh për komunitetin e megjithatë ato nuk mund të plotësojnë kërkesat e komunitetit. Kjo sepse kërkesat janë të shumta, ndërsa shërbimet janë të kufizuara si në sasi ashtu edhe në buxhet.

Pengesat që ndeshen në ofrimin e shërbimeve sociale në mënyrë efektive janë:

- Shpërndarja gjeografike e përfituesve.
- “Presioni” i projekteve për sasinë e ofrimit të shërbimeve në një afat të limituar kohor.
- Mbivendosja e roleve.
- Mungesa e fondeve çon në mungesë të burimeve njerëzore të nevojshme.
- Në disa raste mungon bashkëpunimi mes institucioneve.

Respektimi i standardeve është një instrument i rëndësishëm i matjes së cilësisë së shërbimit. Standardet ndihmojnë në identifikimin e pengesave gjatë zbatimit të tyre, si dhe identifikimin e nevojave për burime shtesë.

Fjalët kyçe: Puna sociale, Standardet e Shërbime Sociale, kapacitete institucionale, sfida.

The challenges that social workers face in exercising their profession at the communities centers at the Shkodra

ABSTRACT

The concept of a Community-Based Service Model is innovation and contributes to creating a new Welfare system perspective to respond to community requirements. The focus of Community Centres and Services is the integration of marginalized communities into the socio-economic being the voice and mediator of the community, on rights and needs of the community.

Identifying the challenges faced by social workers in the Community Centers in the city of Shkodra that provide services through an integrated approach is the object of this study.

The research method of this study is the qualitative method, which is consistent with the purpose of this study. Eight social workers have been interviewed at twelve Community Centers of the city of Shkodra. From the study turns out that the Community Center offers a variety of services for the community, however, they cannot meet the requirements of the community. That's because the demands are numerous, while the services are limited as in quantities and budget. The obstacles encountered in providing social services effectively are:

- Geographical distribution of beneficiary groups.
- "Pressure" of projects for the number of services on a very limited time.
- Overlapping roles.
- Lack of funds leads to the absence of the necessary human resources.
- In some cases there is a lack of cooperation between.

Respecting standards are an important instrument of measuring service quality. The standards help identify the barriers during their implementation, as well as identifying additional resources needs.

Keywords: Social Work, Social Service Standards, institutional capacities, challenges.

Qendrat Komunitare kanë në fokus zhvillimin e komunitetin dhe nuk kanë qëllim që komuniteti të jetë i varur ndaj tyre, pasi të gjithë punojnë që të fuqizojnë individët dhe komunitetin, në mënyrë që të aftësohen për të vazhduar më pas “me këmbët e tyre”, kjo sepse projektet nuk janë të përjetshme, por me kohëzgjatje të caktuara. Gjithashtu sepse punonjësit socialë duan që të fuqizojnë individët në mënyrë që ato të mos kenë më nevojë për shërbimet e tyre, por pranë tyre të drejtohen për të marrë në shërbim individë të tjerë që duan të përmirësojnë situatën e tyre, por nuk dinë se si ta bëjnë këtë gjë.

Reforma e shërbimeve sociale, e prezantuar në fillim të vitit 2013, së bashku me hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale dhe të Dokumentit të Politikave për Përfshirjen Sociale, si dhe ligjin e ri “Për shërbimet sociale” (i cili hyri në fuqi më 24 nëntor 2016) dhe projektligjin e propozuar “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” krijojnë themelet ligjore dhe politike për zhvillimin e shërbimeve sociale me bazë në komunitet, të cilat për nga natyra duhet të jenë më të aksesueshme se dispozitat e menaxhuara në mënyrë tradicionale në nivel qendror (Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia e Shkodrës, 2016).

Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë sfidat që hasin punonjësit socialë të Qendrave Komunitare në qytetin e Shkodrës bazuar në përvojat, përjetimet e tyre si ofrues të shërbimit social të këtyre qendrave.

Duke kuptuar sfidat në profesionin e punës sociale në komunitet, mund të kuptohet se sa kompleks është ky profesion dhe se sa i nevojshëm është për komunitetin (Jance M, “*Puna Sociale me Grupe dhe Komunitete*”). Kjo pasi sfidat e këtij profesioni lindin nga nevojat dhe problemet e komunitetit. Gjithashtu, mungesa e burimeve, bën që punonjësi social të ndeshet në vështirësi për realizimin e rolit të tij në përputhje me nevojat e klientit. Me rritjen e numrit të problemeve sociale, ka lindur dhe nevoja e hapjes së Qendrave Komunitare si në zonat urbane dhe në zonat rurale, rrjedhimisht është rritur nevoja për këtë profesion. Por, sfidat nuk

janë të njëjta në të gjitha Qendrat Komunitare, diferenca të dukshme ka ndërmjet Qendrave komunitare në zonat urbane dhe rurale.

Synimi i këtij studimi është evidentimi i sfidave që ndeshin punonjësit socialë në Qendrat Komunitare në qytetin e Shkodrës.

Për këtë arsye u ngritën disa objektiva:

1. Identifikimi, eksplorimi dhe analizimi i shërbimeve që ofrohen për përfituesit e shërbimeve në Qendrat Komunitare të qytetit të Shkodrës duke u bazuar në përvojat, përjetimet e punonjësve socialë si ofrues shërbimesh në këto qendra.
2. Identifikimi dhe eksplorimi i pengesave që hasin punonjësit socialë në ofrimin e shërbimeve sociale në mënyrë efektive në Qendrat Komunitare të qytetit të Shkodrës.
3. Identifikimi i bashkëpunimit të të gjithë aktorëve në plotësimin e nevojave të përfituesit të shërbimeve në Qendrat Komunitare të qytetit të Shkodrës.
4. Identifikimi i nevojave të vazhdueshme për trajnime profesionale të stafit të Qendrave Komunitare në qytetin e Shkodrës me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor.

Pyetjet kërkimore të studimit janë:

1. Çfarë shërbimesh ofrohen për përfituesit e shërbimeve në Qendrat Komunitare të qytetit të Shkodrës? Cilat janë nevojat e tyre?
2. A hasin pengesa punonjësit socialë në ofrimin e shërbimeve sociale në mënyrë efektive në Qendrat Komunitare të qytetit të Shkodrës?
3. A ka bashkëpunim të të gjithë aktorëve në plotësimin e nevojave të përfituesit të shërbimeve në Qendrat Komunitare të qytetit të Shkodrës?
4. A ekziston një nevojë e vazhdueshme për trajnime profesionale të stafit të Qendrave Komunitare të qytetit të Shkodrës me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor?

Rëndësia e punimit qëndron tek fakti se studimi i sfidave që ndeshin punonjësit socialë në ofrimin e shërbimeve sociale në Qendrat Komunitare të qytetit të Shkodrës, do të na informojë mbi situatën aktuale të këtyre shërbimeve. Gjithashtu do të mundësojë evidentimin e sfidave dhe risive të cilat ndikojnë në ofrimin e shërbimeve sociale cilësore. Vlera e

studimit qëndron në evidentimin e sfidave në Qendrat Komunitare në zonat rurale dhe urbane.

Intervista u realizua në dymbëdhjetë Qendrat Komunitare të qytetit të Shkodrës. Intervista iu adresua vetëm punonjesve socialë që ofrojnë shërbime në këto qendra komunitare. Në këtë studim u përfshinë tetë punonjës socialë që ofrojnë shërbime në këto qendra. Numri i punonjësve socialë që janë intervistuar është tetë, sepse nga kufizimet e masave të marra si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, ishte e pamundur t'i takoja të gjithë. Kampioni fillestar i synuar ishte dhjetë punonjës socialë, sepse edhe duke qenë dymbëdhjetë qendra dy qendra nuk kanë punonjës socialë të mirëfilltë, pra punonjësit socialë janë në lëvizje të herëpashershme. Personat e intervistuar janë shtatë punonjës socialë dhe një punonjës social. Kampionimi është i qëllimshëm, pasi janë intervistuar vetëm punonjësit socialë që ofrojnë shërbim pranë këtyre qendrave.

Instrumenti i përdorur është intervista ballë për ballë. Intervista është gjysmë e strukturuar, sepse ajo gjendet diku midis intervistës së strukturuar dhe asaj të pastrukturuar (Dhëmba E., *“Metoda të Kërkimit Cilësor dhe Analiza e të Dhënave”*). Intervista ndahet në dy pjesë: ku pjesa e parë përbëhet nga të dhënat demografike dhe pjesa e dytë nga pyetje të hapura, të cilat lejojnë që të merret sa më shumë informacion. Kjo intervistë u ndërtua nga vetë autorja dhe nuk është bazuar në intervista të mëpërparshme, pasi nuk ka studime në këtë fushë. Gjithashtu pyetjet janë krijuar në përputhje me qëllimin e studimit. Intervista përmban trembëdhjetë pyetje, të cilat janë në përputhje me pyetjet kërkimore të studimit dhe në të njëjtën linjë me to. Intervistat u realizuan me punonjës socialë që punojnë në Qendrat Komunitare në zonat urbane dhe rurale. Intervista është mjeti kryesor për mbledhjen e të dhënave. Ato zgjatën 30-35 minuta secila dhe gjatë procesit u mbajtën shënime njëkohësisht me regjistrimin audio.

Metodologjia e përdorur për këtë studim është cilësore. Karakteristikat e këtij studimi janë: natyrë realiteti subjektive, jo lidhje shkak-pasojë, hulumtim i lidhur ngusht me vlerat, induktiv, interpretative, vë pak theks tek statistikën, sepse i jep rëndësi analizës verbale dhe cilësore, intervistuesi dhe i intervistuari janë interaktivë dhe të pandashëm, gjithashtu përgjithësimet janë analitike, specifike sipas kohës dhe kontekstit (Tahiri F., Rama R., Sota M., *“Metodat Kërkimore në Shkencat Sociale”*).

Qëllimi kryesor i analizës së të dhënave ishte shqyrtimi dhe organizimi i sasisë së informacionit të marrë nga realizimi i intervistave në mënyrë që temat dhe interpretimet që do të dilnin nga ky proces të adresojnë pyetjet e ngritura në fillim të studimit. Në fillim u bë dëgjimi i regjistrimit audio, më pas të dhënat u transkriptuan, i gjithë teksti u shkrua në programin word, ku krahas regjistrimit u përfshinë edhe shënimet e mbajtura gjatë procesit të regjistrimit. Duke qenë se shpesh përgjigjet ishin të ngjashme, u bë e mundur përfshirja e tyre në një përgjigje të vetme gjatë analizimit apo gjatë listimit të shërbimeve dhe nevojave. U shënuan në një fletë temat dhe konceptet e rëndësishme që dolën nga dëgjimi i intervistave. Gjatë përgatitjes së transkripteve janë përfshirë edhe ngjarjet joverbale të intervistimit, që reflektojnë ndërveprime joverbale, si pauzat. Gjithashtu iu dha rëndësi tonit dhe intensitetit të komenteve që u bënë gjatë intervistimit, gjë që nuk është e mundur të kuptohet në tekstin e shkruar. Në përgjithësi nuk kishte ndryshim në qëndrimet e të intervistuarve përveç rasteve kur flisnin për dashurinë që kanë për këtë profesion dhe për zhgënjimin që kanë ndaj pagave apo shpërblimeve. Pasi autorja është familjarizuar me të gjitha të dhënat e mbledhura, i ka klasifikuar ato në njësi me kuptim. Në këtë mënyrë, është vazhduar me identifikimin e atyre pjesëve të informacionit të cilat përshtaten njëra me tjetrën në një mënyrë të kuptimshme dhe më pas është vazhduar me kodimin e tyre. Pasi janë transkriptuar të gjitha të dhënat dhe pasi ato janë përmbledhur në mënyrë paraprake është vazhduar me kodimin e nivelit të parë, duke kombinuar njësitë që janë identifikuar si njësi kuptimi, duke i përshtatur ato në kategori dhe duke shënuar kode për kategoritë. Teksti i përfituar nga analiza e intervistave ishte i gjatë mjaftueshëm për të nxjerrë të dhëna të bollshme në funksion të çështjeve të ngritura në studim.

Gjetjet e studimit marrin në konsideratë shumë faktorë. Ndërveprimi i këtyre faktorëve ndihmon për të kuptuar sa më mirë sfidat e punës sociale në Qendrat Komunitare. E rëndësishme është që të kuptojmë që këto sfida lidhen me faktorë si:

- Nevojat e komunitetit janë më të mëdha se sa mundësia për t'u mbuluar me shërbime nga Qendrat Komunitare.
- Gjendja e vështirë ekonomike.
- Shpërndarja gjeografike e përfituesve.
- Mbivendosje e roleve.
- Mungesa e fondeve çon në mungesë të burimeve njerëzore të nevojshme.

- Lufta me paragjykimin.
- Në shumicën e Qendrave Komunitare në njësitë administrative jashtë qytetit stafi është i reduktuar në vetëm një person.
- Në Qendrat Komunitare në fshatra po ndërtohet roli i punonjësit social duke u bazuar tek eksperiencia e qytetit, por që nevojat janë të ndryshme, pasi kultura dhe mentaliteti ndryshon.
- Shpeshherë rastet janë aq komplekse saqe nevojitet bashkëpunim me OJF.

Duke qenë se komuniteti përbëhet nga një tërësi individësh, të cilët janë të ndryshëm, që kanë nevoja komplekse, puna me to paraqet sfida dhe pengesa me të cilat punonjësit që punojnë në këtë profesion ndeshen në përditshmërinë e tyre (Mergo K, *“Parimet dhe Metodat e Punës në Komunitet”*).

Duke pasur një numër të lartë përfituesish pranë këtyre qendrave, klientët e punonjësve socialë janë të larmishëm, pasi komuniteti është kompleks. Ndonjëherë nuk janë vetëm nevojat e përfituesve që ndeshin pengesa për t’u plotësuar, por ndodh që karakteristikat e individëve bëjnë që të ketë pengesa dhe sfida në ofrimin e shërbimit sa më cilësor për përfituesit. *“Jo rrallë herë edhe komuniteti ku punojmë tregohet jo bashkëpunues, pasi kanë nevojë për të marrë shërbimet që ofrojmë, por ka frikë se mos paragjykohet nga personat e tjerë të komunitetit ku jetojnë.”*, u shpreh një punonjëse sociale.

Sfidë tjetër është nxitja e komunitetit për të marrë vetë situatën në kontroll, por kjo ndonjëherë është e vështirë, sepse pavarësisht nga përbërja e komunitetit ka edhe anëtarë apo grupe që janë pasivë, që nuk përfshihen, por për të mirën e përbashkët të komunitetit duhet të përfshihen. Gjithëpërfshirja synohet jo vetëm si standard, por më së shumti sepse me anë të përfshirjes të anëtarëve u jepet mundësia që të paraqesin nevojat e tyre, atëherë kur është e mundur komuniteti të punojë në tërësi për t’i zgjidhur dhe të marrin vendime bashkarisht. Punonjësi duhet të hartojë një plan rezervë, pasi gjërat mund të mos shkojnë ashtu siç është planifikuar, ku nuk përfshihen të gjithë dhe komuniteti nuk bie në konsensus. Gjithashtu duhet të gjendet një formë bashkëpunimi e strukturave lokale apo qendrore, gjë që ndonjëherë është sfidë më vete dhe mund të duhet shumë punë për të arritur bashkëpunim të frytshëm.

Shërbimet që ofrohen nga Qendrat Komunitare nuk janë në përputhje me numrin e lartë të nevojave që paraqet komuniteti, kjo ndodh, pasi shërbimet janë të kufizuara në kohë dhe në buxhet. Gjithashtu komuniteti ka vështirësi të theksuara ekonomike, sepse anëtarët e tij nuk

janë në punë, nuk kanë mundësi të punojnë apo nuk janë të aftë për punë. Janë të shumë faktorët që ndikojnë në aspektin e punësimit të individëve. Disa prej tyre lidhen me arsimimin dhe aftësinë për punë, por jo rrallë herë janë ndeshur individë të cilët janë dembelë dhe nuk kanë dëshirë të punojnë. Në këto raste ato kanë kërkuar mbështetje financiare nga qendrat apo projektet, por qendrat nuk kanë në fokusin e tyre ofrimin e ndihmës financiare në para. Për këtë arsye me këto individë është punuar në mënyrë të veçantë me familjen e tyre, sepse në shumicën e rasteve ndihma që i është dhënë familjes në tërësi ka ndikuar dhe tek individë që është synuar në veçanti. Një model veprimtarie që ndiqet nga Qendrat Komunitare që është IGA. Kjo veprimtari synon fuqizimin ekonomik të individëve apo grupeve të caktuara. Në mënyrë që ky fuqizim të arrihet kërkon mbështetjen e komunitetit, sepse me anë të IGA-s individët ndihmohen që të hapin një minibiznes dhe të gjenerojnë të ardhura, por kjo bëhet duke parë aftësitë e individëve për drejtimin e një minibiznesi, duke i trajnuar ato më parë dhe duke hapur atë biznes që komuniteti ka nevojë.

Gjithashtu në punën me komunitetin janë hasur vështirësi në shpërndarjen gjeografike të përfituesve. Kjo është më e theksuar në zonat rurale, por edhe në punën me komunitetin Rom, pasi një pjesë e tyre lëviz në mënyrë të vazhdueshme. Për këtë duhet të krijohet një staf i mirëfilltë në Qendrat Komunitare në zonat rurale, sepse ato punojnë me staf të reduktuar dhe me kohë të pjesshme. Duke qenë se në territorin ku ofrojnë shërbim këto qendra kanë mbi tre mijë banorë të cilët një pjesë e tyre kanë nevojë për shërbimet e qendrës, stafi prej vetëm një personi është i papranueshëm, kjo sepse ka shumë sfida dhe vështirësi. Gjithashtu një staf kaq i reduktuar është e pamundur që të ofrojë shërbimin e nevojshëm në komunitet, por edhe që të luftojë paragjykimin që i bëhet profesionit apo qendrës. Paragjykimi nuk ka të bëjë vetëm me faktin e njohjes së qendrës, por edhe anëtarët e komunitetit paragjykojnë ata persona që marrin shërbim pranë qendrave. *“Në një nga Qendrat Komunitare në fshat është paraqitur një rast dhune në familje, ku bashkëshortja shprehej se e dinte që mund të merrte shërbim pranë kësaj qendre, por që vetëm tani kishte vendosur të kërkonte ndihmë, pasi bashkëshorti në momente grindjeje dhe abuzimi me alkoolin e kishte dhunuar aq shumë sa i kishte shkaktuar fraktura në brinjë. Kjo situatë ishte e përsëritur, madje ajo shprehej që kishte tentuar që të kërkonte ndihmë më përpara, por ishte stepur nga frika e mentalitetit dhe paragjykimin, pasi ajo ishte në dijeni edhe të rasteve të tjera ku gratë pranonin dhunën për të mos u përballur me mentalitetin. Ajo kishte vendosur që të kërkonte ndihmë, pasi kishte frikë për jetën e saj dhe të vajzave të saj. Tashmë ajo dhe fëmijët e saj gjenden të strehuar në një prej*

organizatave që mërren me dhunën ndaj grave dhe çështja ndiqet me gjykatë”, u shpreh njëra prej punonjëseve sociale.

Sipas punonjësve socialë të intervistuar, dëshira që ato kanë për të punuar në profesion bën që të përballohen sfida të ndryshme që lindin gjatë ushtrimit të tij. Gjithashtu, ato shprehen se ajo që i motivon për të ofruar më të mirën e tyre është dashuria që kanë për këtë profesion, kjo pasi shpërblimi shpeshherë nuk është motivues. Në lidhje me motivimin dhe kënaqësinë në punë ekzistojnë një shumëllojshmëri teorish nga të cilat mund të përmendim: Teorinë e Marrëdhënieve Njerëzore, Ambientaliste dhe e Motivim-Higjienës të cilat i japin rëndësi marrëdhënieve njerëzore dhe përgjegjësive në punë për të qenë sa më të motivuar. (Topalli B., *“Administrim në Punë Sociale”*). Këto teori nuk e mohojnë rëndësinë e shpërblimit monetar si faktor motivimi, por aspekte të tjera janë të një ndikimi më të madh në motivim.

Sfidë tjetër që ndeshin punonjësit socialë, është mbivendosja e roleve tek profesionisti. Kjo ndodh, pasi Qendrat Komunitare, kanë vetëm një punonjës social dhe kanë një numër të madh përfituesish shërbimi pranë këtij profesionisti. Për këtë arsye koleget në raste të ndryshme ndajnë detyrat apo në situata të tjera është e pamundur që të ofrohet shërbim i caktuar në cilësinë e duhur. Nga mbingarkesa në punë punonjësit e këtyre qendrave janë më të predispozuar për të përjetuar Konsumin Profesional. Nga përgjigjet e të intervistuarve është evidentuar se disa punonjës socialë kanë përjetuar disa elemente të konsumimit profesional gjatë punës së tyre edhe pse eksperiencia e tyre është vetëm disavjeçare. Me evidentimin e këtyre elementeve janë ndërmarrë veprime të ndryshme nga ana e stafit në mënyrë që të evidentohet Konsumimi Profesional. Kjo është arritur nëpërmjet ndarjes së detyrave, trajnimeve të ndryshme apo edhe pushimeve disa ditore nga puna, në mënyrë që të reduktohet ngarkesa dhe stresi në vendin e punës.

Punonjësit socialë të cilët operojnë në zonat rurale kanë në fokus advokacinë si në nivelin lokal për të ndihmuar komunitetet që të ndihmojnë veten ashtu edhe në nivelin kombëtar për të bërë të mundur hartimin e legjislacionit që autorizon shërbime sociale në bazë të nevojave të komuniteteve. Gjithashtu synohet të zgjerohet profesioni në këto zona. Për shkak të mungesës së strukturave sociale, punonjësit socialë të zonave rurale shpesh gjenden përballë një numri shumë të madh problemesh sociale. Në kushte të tilla, përfshirja e familjeve dhe e komunitetit është e domosdoshme. Duke qenë në situata të tilla, punonjësit socialë bashkëpunojnë ngushtësisht me anëtarët e familjes dhe komunitetin. Duke qenë se në zonat rurale numri i stafeve në Qendrat Komunitare është i

reduktuar, për t'i ardhur në ndihmë punonjësit social dhe komunitetit, punonjësit socialë mund të edukojnë dhe trajnojnë anëtarë të tij për të ndërhyrë tek fqinjët apo të afërmit, për t'i ndihmuar me probleme të ndryshme që mund të shfaqin. Nga kjo kuptojmë që puna në terren dhe edukimi janë pjesë e pandarë e punonjësit social, nga ana tjetër është e rëndësishme njohja e teknikave dhe strategjive të punës me grupet dhe komunitetet. Punonjësi social mund të krijojë grupe mbështetjeje të cilat mund të sigurojnë ndihmë për shumë çështje në komunitet. Këto grupe mund të krijohen duke trajnuar vullnetarë, anëtarë të komunitetit. Shpesh familjet apo grupe të tjera e kanë më të lehtë të mbështeten nga pjesëtarët e komunitetit sesa nga punonjësi social që është i panjohur për to.

Duke qenë se Puna sociale është profesion që konsiston në punën me klientë të ndryshëm, punonjësi social merr pjesë në trajnime që nxisin kuptimin e kulturës dhe funksionin e saj në sjelljen njerëzore dhe në shoqëri. Kjo arrihet duke njohur pikat e forta të kulturës së klientëve, me anë të cilës ato tregojnë kompetencë në sigurimin e shërbimeve që janë të ndjeshme ndaj kulturës dhe ndaj diferencave mes njerëzve dhe grupeve. Gjithashtu punonjësit socialë marrin trajnime të cilat kanë në fokus kuptimin e natyrës të diversitetit social dhe shtypjes në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, moshës, besimit ose aftësisë së kufizuar mendore apo fizike.

Gjatë përgjigjeve të pyetjes “*Cilat janë shërbimet specifike që ofroni në përmbushje të rolit të punonjësit social?*”, sipas mendimit të autores një rëndësi të veçantë duhet t'i jepet punës për integrimin e moshës së tretë, pasi ajo vëren që gjithmonë në shoqërinë ku jetojmë kjo kategori është më pak e përfshirë, janë më të veçuar dhe rrijnë nën shoqërinë e personave të të njëjtës grupmoshë me to. Teoria e Modernizimit, Teoria e Mosangazhimit, Teoria e Aktivitetit dhe Teoria e Shkëmbimit (Dragoti, 2009, fq 268), sipas mendimit të autores, tregojnë rëndësinë e integritit të moshës së tretë në aktivitete të ndryshme në shoqëri. Sepse jo rrallë herë, ndodh që të dëgjojmë nëpër ambiente të ndryshme për projekte për fëmijët, të rinjtë, por pothuajse asnjëherë për të moshuarit. Prandaj duhet që në të ardhmen të ketë një vazhdimësi projektesh për kategori. Kjo minianalizë u iniciua nga fakti që një prej Qendrave Komunitare ka në fokus kategorinë e personave të moshuar.

Pavarësisht se në audiore studiohet në lidhje me Sistemet e Shpërndarjes së Burimeve në Komunitet, në punën e punonjësit social në Qendrat Komunitare kjo gjë është themelore. Pasi puna e tyre konsiston në përdorimin e sistemit natyral të burimeve ku bëjnë pjesë: familja, grupi shoqëror, grupet e mbështetjes reciproke dhe burimet e komunitetit, ndërsa

një sistem tjetër është ai formal i burimeve që përfshin agjencitë e shërbimeve sociale dhe organizata të ndryshme të interesuara për të zbatuar projekte brenda komunitetit.

Gjithashtu bashkëpunimi me organizata të ndryshme është themelor në punën e punonjësve socialë në Qendrat Komunitare, jo vetëm për rastet e referimit, por gjithashtu nga përgjigjet e marra evidentohet fakti që punonjësit socialë kanë marrëdhënie intershipi ndërmjet tyre. Kjo arrihet nëpërmjet bashkëpunimit dhe trajnimeve të ndryshme. Duke qenë se Qendrat Komunitare punojnë me projekte jo gjithmonë kanë në fokus të tyre trajnimin e stafit, por këtë ‘boshllëk’ e plotësojnë Organizatat Joqeveritare partnere të këtyre qendrave.

Ndodh që punonjësi social duhet të referojë rastin, pasi nuk ka kompetencat e duhura ose për shkak të mbingarkesës në punë. Në mënyrë që referimi të bëhet në mënyrën e duhur, në fillim punonjësi bën një vlerësim paraprak, pasi siç vihet re dhe nga emërtimet e punonjësve socialë të intervistuar, ndodh që rastet të kenë nevojë për shërbime specifike ku disa punonjës socialë janë të specializuar apo tek një organizatë e caktuar. *“Një rast që u paraqit në zyrë është referuar tek Qendra e Zhvillimit dhe është pritur shumë mirë, ku ato janë treguar shumë të gatshëm për të bashkëpunuar. Gjatë eksperiencës sime prej dy vitesh pranë kësaj qendre asnjë rast i referuar nuk është refuzuar, por ka marrë shërbimin e duhur tek qendra ku është referuar”*, u shpreh punonjësi social. Gjithashtu ky vlerësim realizohet edhe kur rasteve u ofrohet shërbim nga punonjësi social i qendrës, kjo ndodh, pasi me anën e saj arrihet të nxirret informacion paraprak mbi problemin, kohëzgjatjen e tij, intensitetin dhe frekuencën, kontekstin apo dëshirën e klientit për ta zgjidhur. Ndodh që ndonjëherë klientët nuk kanë dëshirë të kërkojnë shërbim, por janë nxitur nga të tjerët pa dëshirën e tyre. Edhe për këto raste, punonjësit socialë kanë marrë trajnime të ndryshme se si duhet të punohet me to apo me klientët e vështirë. Në të tilla situata, në fillim punohet me individin, pastaj me situatën problematike, pasi nëse klienti nuk bashkëpunon, puna për të ndryshuar problemin është kohë e humbur për të dyja palët.

Punonjësit socialë ofrojnë shërbime në bazë të nevojave që paraqesin individët, formohen grupe të cilat janë: Grupe të bashkëbisedimit shoqëror, të edukimit, të zgjidhjes së problemeve dhe vendimmarrjes, të vetëdihmës, të socializimit, sensitive dhe të ballafaqimit (Jance Marilda, *“Puna Sociale me Grupe dhe Komunitete”*, Cikël leksionesh). Puna me grupet ndesh problematika të ndryshme ku një ndër to është krijimi i nëngrupeve, të cilët mund ta prishin kohezionin e grupit. Për të përballur këtë problematikë apo problematika të tjera që mund të ndeshen gjatë punës

me grupet, punonjësit socialë marrin trajnime në lidhje me këtë kategori. Kjo ndodh, pasi një pjesë e shërbimeve ofrohen në grupe, sidomos për fëmijët dhe të rinjtë, të cilët është venë re që jo rrallë herë krijojnë lidhje të ngushta me disa anëtarë të grupit dhe rrjedhimisht krijojnë nëngrupe.

Kufizimet e studimit

Si çdo studim shkencor edhe ky studim paraqet kufizimet e veta. Faktorët kryesorë që e kufizojnë këtë studim janë:

Së pari, mungesa e studimeve të mëparshme në Shkodër mbi sfidat e punonjësve socialë në Qendrat Komunitare që ofrojnë shërbime në këtë qytet.

Së dyti, mungesa e studimeve nuk jep mundësinë që të krahasohen të dhënat ndër vite, për të parë nëse sfidat janë të njëjta apo kanë ndryshuar.

Bibliografia

- Dragoti Edmond, 2009, “*Hyrje në Punë Sociale*”, Shtypshkronja “Dajti 2000”, Tiranë, f. 268 – 269 – 270.
- Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, Bashkia e Shkodrës, 2016.
- Dhëmbo Elona, “*Metoda të kërkimit cilësor dhe analiza e të dhënave*”, Cikël leksionesh.
- Jance Marilda, “*Metoda dhe shprehi në praktikën e Punës Sociale*”, Cikël leksionesh.
- Jance Marilda, “*Puna Sociale me grupe dhe komunitete*”, Cikël leksionesh.
- Mergo Klara, “*Parimet dhe metodat e punës në komunitet*”, Cikël leksionesh.
- Satka Ermelinda, “*Menaxhimi dhe administrimi i institucioneve të shërbimeve sociale*”, Cikli i leksioneve.
- Tahiri Fatlinda, Rama Rudina, Sota Marinela, “*Metodat kërkimore në shkencat sociale*”, Cikël leksionesh.
- Topalli Bujane, “*Administrim në Punë Sociale*”, leksioni ‘Motivimi dhe kënaqësia në punë’.
- Topalli Bujane, “*Probleme sociale*”, Cikël leksionesh.

Shtojca

Intervista me punonjësit socialë

Institucioni ku ju punoni _____

Pozicioni _____

Mosha _____

Gjinia _____

Vitet e eksperiencës së punës _____

1. Cilat janë shërbimet sociale që ofrohen nga qendra komunitare ku ju punoni?
2. Cilat janë nevojat prioritare që referojnë më së shumti përfituesit e shërbimeve në qendrën komunitare ku ju punoni?
3. A mendoni se shërbimi që ofron qendra është i mjaftueshëm dhe në përputhje me nevojat e komunitetit?
4. Cilat janë shërbimet specifike ofroni në përmbushje të rolit të punonjësit social?
5. Çfarë pengesash ndeshni në ofrimin e shërbimeve sociale në mënyrë efektive?
6. Çfarë sfidash paraqet përmbushja e rolit të punonjësit social në qendrat e reja komunitare në zonat rurale, në raport me ato në zonat urbane?
7. Cilat janë strategjitë që ju kanë ndihmuar në kapërcimin e sfidave profesionale gjatë shërbimit të ofruar në qendrën komunitare?
8. A e ndjeni të nevojshme në punën tuaj bashkëpunimin me aktorë të tjerë për të plotësuar nevojat e përfituesve të shërbimit në qendrën komunitare, si p.sh., në marrjen e financimit nga partnerët?
9. Në nivelin praktik a mund të më thoni specifikisht me kë bashkëpunoni më shumë: me administratën publike, me OJF-të, me donatorët etj?
10. A ju ka ndodhur të referoni raste? Nëse po, si janë pritur këto raste në institucionin ku janë referuar?
11. Sipas opinionit tuaj a ka vend për të përmirësuar cilësinë e shërbimit në qendrën ku ju punoni? Nëse po, ku konkretisht?

12. A ekziston një nevojë e vazhdueshme për trajnime profesionale të stafit të qendrave komunitare në qytetin e Shkodrës me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor?
13. A besoni se trajnimet ju ndihmojnë në menaxhimin efektiv të sfidave që hasni në ushtrimin e rolit tuaj si punonjës social?

PËRMBLEDHJE PËRSHKRUESE E ELEMENTEVE TË PUNËS SOCIALE

Arena Llapaj

Punonjëse sociale

ABSTRAKT

“Kur dashuria merr trajtën e dukshme, quhet punë sociale.”

Puna sociale është një ndër profesionet më humane dhe pranë shoqërisë. Ajo prej shumë vitesh është përpjekur të ndihmojë individët dhe grupet vulnerabël të fuqizohen dhe të bëhen të pavarur. Në këtë punim shpaloset dhe bëhen përpjekje për të kuptuar natyrën dhe dinamikën e këtij profesioni. Studimi ka për qëllim të hulumtojë mbi elementet e këtij profesioni dhe të arrijë në një panoramë përshkruese të tij. Ky punim përpiqet t’u japë përgjigje pyetjeve si: “Çfarë është puna sociale, si ka evoluar ajo ndër vite?”. “Çfarë bën punonjësi social?”. “Ku punon punonjësi social?”. “Cila është baza teorike në të cilën punonjësi social mbështetet gjatë urshtrimit të këtij profesioni?” etj. Metodologjia e këtij punimi është bazuar në rishikimin e literaturës dhe studimeve ekzistuese mbi profesionin e punës sociale.

Ndër gjetjet më kryesore të këtij studimi mund të veçojmë që puna sociale lindi nga një rrymë vullnetarizmi në ndihmë të shtresave në nevojë të shoqërisë rreth fundit të viteve 80-të, e udhëhequr kryesisht nga Jane Adams e njohur dhe si pionerja e punës sociale. Një tjetër gjetje lidhet me faktin që tashmë puna sociale gëzon statusin e një profesioni të mirëfilltë i cili studiohet në universitetet më në zë botërore. Ajo është një profesion i cili ka si mision fuqizimin e grupeve vulnerabël dhe arritjen e mirëqenies sociale.

Fjalët kyçe: punë sociale, punonjës social, histori, profesion, mirëqenie sociale, drejtsi sociale, vlera, parime etike, role.

Descriptive summary of elements of social work.

ABSTRACT

"When love takes on a visible form, it is called social work." Social work is one of the most humane professions and close to society. It

has for many years tried to help vulnerable individuals and groups empower themselves and become independent. In this paper, it reveals and attempts to understand the nature and dynamics of this profession. The study aims to research the elements of this profession and arrive at a descriptive overview of it. This paper tries to answer questions such as: What is social work? How has it evolved over the years? What does the social worker do? Where does the social worker work? What is the theoretical basis on which the social worker relies when practicing this profession? etc. The methodology of this paper is based on a review of the existing literature and studies on the social work profession.

Among the main findings of this study we can single out that: social work was born from a stream of volunteerism to help the needy strata of society around the late 1980s, led mainly by Jane Adams, the pioneer of social work. Another finding is related to the fact that social work already enjoys the status of a real profession which is studied in the most prestigious universities in the world. It is a profession whose mission is to empower vulnerable groups and achieve social welfare.

Keywords: social work, social worker, history, profession, social welfare, social justice, values, ethical principles, roles.

Hyrje

" Puna sociale është art, shkencë dhe profesion.³⁵"

Është art sepse të punosh me shtresat më në nevojë të shoqërisë vërtet nevojitet të njohësh artin e komunikimit, të arrish të kuptosh tjetrin, të thuash me fjalë të thjeshta gjërat më të ndërlikuara, ta kuptosh dhimbjen e tjetrit ashtu siç ai e ndjen, pa ta treguar ai, dhe prap të jesh në gjendje të mos përfshihesh emocionalisht. Të jesh një punonjës social i mirë duhet të jesh dhe një "piktor i mirë", duhet të arrish të vizatosh ylberë plot ngjyra në mendjet e njerëzve që mendojnë vetëm bardh e zi. Gjithashtu duhet të jesh një animator i mirë, duhet të arrish të fusësh gëzim dhe shpresë në zemrat e njerëzve përmes fjalëve, gjesteve apo qëndrimeve.

Puna sociale është profesion, pasi ajo së pari është një disiplinë shkencore. Që të bëhesh një punonjës social, duhet të studiosh në degën përkatëse. Është profesion për faktin se zotëron çdo element për të qenë i tillë, ai si çdo profesion tjetër ka vlerat, standardet, parimet, si dhe kodin e etikës në bazë të të cilit ushtrohet. Në brendësi të këtij punimi do të paraqitet një përshkrim më i detajuar i asaj se çfarë është puna sociale.

³⁵ <https://www.quora.com/How-is-social-work-as-an-arts-and-science>

Qëllimi i përgjithshëm

Eksplorimi dhe njohja me elementet bazë të punës sociale.

Objektivat

- Të paraqesim disa nga përkufizimet më të njohura të profesionit të punës sociale.
- Të përshkruajmë evolucionin e punës sociale ndër vite.
- Të njihemi me bazën teorike mbi në cilin mbështetet puna sociale.
- Të njihemi me terrenin në të cilin punonjësit socialë ofrojnë shërbimin e tyre.

Pyetjet kërkimore

1. Çfarë është puna sociale?
2. Cila është historia e punës sociale?
3. Mbi cilat teori mbështetet puna sociale?
4. Ku punojnë punonjësit socialë?

Metodologjia

Për realizim e këtij studimi është përdorur metoda kërkimore cilësore. Subjekte të këtij studimi janë libra dhe artikuj shkencorë të punuar nga autorë të shquar të punës sociale të aksesueshëm dorazi dhe online. Studimi ka kaluar në këto etapa kërkimore:

- Faza e kërkimit të literaturës relevante me pyetjejet që **ngren** studimi.
- Faza e leximit dhe meditimit.
- Faza e identifikimit të përgjigjeve dhe kristalizimit të koncepteve
- Faza e nxjerrjes së përfundimeve

Detaj tjetër që vlen të theksohet është fakti që është përdorur literaturë e viteve të fundit për të dhënë një pasqyrim sa më aktual të situatës.

Gjetjet

Puna sociale si përkufizim.

Ekzistojnë shumë përkufizime mbi punën sociale, autorë të ndryshëm e shohin në këndvështrime të ndryshme.

Sipas (NASË 1970-1980 Shoqata kombëtare e Punonjësve socialë në Amerikë) "Puna sociale është një aktivitet profesional, që ndihmon individët, grupet ose komunitetet, të përmirësojnë ose shtojnë kapacitetet e tyre për funksionimin social si dhe krijon kushte të favorshme sociale për të realizuar këtë qëllim".

Ndërsa sipas CASË (shoqata kanadeze e punës sociale), puna sociale është "një profesion i interesuar të ndihmojë individët, familjet, grupet dhe komunitetet që ta rrisin mirëqenien e tyre individuale dhe kolektive".

Në një tjetër konceptim, "puna sociale synon ta rrisë funksionimin shoqëror të individëve - të vetëm apo në grupe - me veprimtari që përqendrohen në marrëdhëniet e tyre shoqërore, që përfshihen në ndërveprimin e njeriut me mjedisin. Këto veprimtari mund të grupohen në tre funksione, që janë: riaftësimi i kapacitetit të dobët; përgatitja dhe vitalizimi i burimeve individuale dhe shoqërore; parandalimi i disfeksioneve shoqërore³⁶.

E thënë në mënyrë më të thjeshtë "puna sociale është profesioni më gjithëpërfshirës i shërbimeve humane dhe me kalimin e kohës është njohur si profesioni që fokusohet në ndihmën e njerëzve për të përmirësuar funksionimin social (Gjermani E, Metoda dhe Shprehi në Praktikën e Punës Sociale fq. 15). Pra një punonjës social ndihmon njerëzit të konsolidojnë ndërveprimet e tyre me personat që i rrethojnë (fëmijet, prindërit, partnerët, kolegët, komunitetin) dhe burimet e mjedisit (institucionet publike dhe private).

Historia e punës sociale

Puna sociale është e lashtë sa vetë jeta...

Ajo ekzistonte si një praktikë jetike edhe para se të ishte një profesion i mirëfilltë.

Për të qenë më të qartë puna sociale dikur quhej "ndihmë reciproke" ku individët grupet dhe komunitetet ndihmonin njëri - tjetrin në raste, si: varfëri, sëmundje, kujdesi ndaj fëmijëve në rast vdekjeje të prindërve etj. Përherë ka pasur përpjekje vullnetare për të ndihmuar individët, komunitetet apo shoqëritë me probleme sociale. Në fundin e shekullit të 18-të, ajo që njihet si pionerja e punës sociale Jane Adams themeloi "Settlement House Movement" në SHBA e cila kishte si mision ofrimin e shërbimeve ligjore, arsimore dhe shëndetësore për të varfërit. Punonjësit socialë të asaj kohe organizoheshin në shtëpi/kampe në zonat ku kishte probleme të theksuara sociale.

Deri në vitin 1913, ishin shpërndarë 413 vendbanime në 32 shtete në vend për të përmirësuar jetën e të varfërve.

³⁶ Werner W. Boehm, Objectives of the Social Work Curriculum of the Future, Curriculum Study I, 1959, fq. 54.

Në shekullin e 19-të me revolucionin industrial jeta filloi të bëhet më dinamike, njerëzit filluan të migrojnë nga periferia në qendrat urbane dhe kështu filluan të humbasin njohjet dhe lidhjet që dikur kishin mes vete. Gjithashtu, në këtë periudhë, u shfaqën shumë sëmundje mendore dhe fizike. Probleme sociale, si: varfëria e skajshme, përjashtimi social, trafikimi i qenieve njerëzore apo mungesa e strehimit, tashmë kishin nevojë për një trajtim profesional.

Në kushte të tilla lindi dhe profesioni i punës sociale i cili deri në këtë kohë ishte përpjekje vullnetare për të zbutur problemet sociale. Grupe dhe organizata të ndryshme punonjësish socialë filluan të angazhohen në rivendosjen e mirëqenies sociale.

Në vitin 1903 profesioni i punës sociale filloi të mësohet përmes trajnimeve në departamentin e Sociologjisë në Universitetin e Londrës. Individë të trajnuar në njohjen dhe trajtimin e problemeve sociale i gjeje kudo, në shkolla, spitale, agjencitë e mirëqenies familjare dhe të fëmijës etj. Në vitin 1930 puna sociale merr statusin profesional.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, u bënë përpjekje për të përmirësuar statusin profesional të punës sociale. Në vitin 1952 u formua Këshilli për Arsimin e Punës Sociale.

Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë është themeluar në vitin 1955. NASE është një nga organizatat më të mëdha të anëtarësimit të punëtorëve profesionistë socialë në botë, me më shumë se 120,000 anëtarë. Ajo punon konform me rritjen profesionale dhe zhvillimin e anëtarëve të saj, për të krijuar dhe ruajtur standarde profesionale dhe për të hartuar politika të shëndosha sociale.

Në vitin 1970 në SHBA u themelua nga kolegjet dhe universitetet, BSË (bachelor në punën sociale) si një program hyrës në profesionin e punës sociale.

Nga fillimi i viteve 2000 punonjësit socialë pëbëjnë përqindjen më të madhe të profesionistëve që punojnë në fushën e shëndetit mendor dhe shërbimeve të familjes në mbarë botën e sidomos në Angli dhe SHBA.

Sot formimi akademik i punonjësit social fillon nga niveli bachelor e deri tek profesor i asocuar. Ata i gjen në çdo nivel të ofrimit të shërbimeve sociale, duke filluar nga puna me individin deri tek hartimi i politikave sociale.

Puna sociale në Shqipëri

"Përherë në kohën dhe vendin e duhur!"

Puna sociale është një ndër profesionet më të reja në vendin tonë. Për herë të parë ky profesion u bë i njohur në vitin 1992. Deri në atë

periudhë nuk ekzistonte si term e as si praktikë. Si një profesion i ri duket se erdhi në kohën më të përshtatshme. Në një kohë kur me të vërtetë nevojitej ndihma profesionale e punonjësit social.

Rënia e regjimit komunist dhe vendosja e demokracisë e cila erdhi përmes revoltës, solli me vete shumë probleme sociale. Njerëzit filluan t'i thyejnë kufijtë imagjinarë të vendosur gjatë komunizmit. Ata filluan të dynden drejt qendrave urbane. Gjatë këtij migrimi ata lanë pas shtëpitë, punën, rrethin e ngushtë dhe çdo gjë që kishin për të t'ia filluar nga e para. Sfidat ishin të mëdha duke filluar me gjetjen e strehimit, punës, shkollës së fëmijëve, përshtatja me mjedisin e ri etj.

Në këtë situatë u shfaqën probleme, si: varfëria, mungesa e strehimit, droga, alkooli, trafikimi i qenieve njerëzore, delinkuencat rinore etj. Gjithashtu tranzicioni u shoqërua me përplasje kulturash e cila solli paragjykime, diskriminime e deri në përjashtime sociale drejtuar personave që erdhën nga periferia.

Në gjithë këtë situatë të krijuar punonjësit socialë dhanë një kontribut shumë të madh në rivendosjen e stabilitetit social.

Një tjetër sfidë me të cilën u përball vendi ynë në fundin e viteve 90-të ishte menaxhimi i situatës dhe mikpritja e popullit të Kosovës të cilët emigruan drejt vendit tonë gjatë kohës së luftës. Edhe në këtë rast punonjësit socialë ishin prezent dhe madje shumë aktivë në ndihmë të personave që po përjetonin trauma, si: humbje e njerëzve të dashur, humbje e pasurisë, dhunë e të gjitha llojeve etj.

Vlen të theksohet se puna sociale në Shqipëri që në fillimet e saj është menduar si një disiplinë shkencore. Shkolla e punës sociale për të parën herë në vendin tonë është hapur në vjeshtën e vitit 1992 bazuar në VKM nr. 348 dt. 10.08.1992.

Në vitin 1996 u diplomua brezi i parë i Punës Sociale në Shqipëri. Tregues për profesionalizmin dhe formimin akademik është edhe fakti që sot shumica prej tyre janë personalitete të shquara të këtij profesioni, në ofrimin e shërbimeve, përgatitjen akademike të punonjësve socialë të rinj si dhe në vendimmarrje e politikëbërjeje.

Gjatë viteve, punonjësit socialë shqiptarë, kanë punuar pareshtur në ngritjen dhe përhapjen e këtij profesioni shumë të nevojshëm për shoqërinë.

Sot puna sociale në Shqipëri studiohet në disa nga Universitetet shtetërore me në zë si p.sh.: Universiteti i Tiranës, Universiteti i Shkodrës "Luigi Gurakuqi", Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" etj.

Kurrikulat shqiptare i ofrojnë punonjësit social formim akademik i cili fillon nga niveli bachelor e deri tek doktoratura.

Profesionistët e punës sociale sot i gjen kudo në institucionet tona si private ashtu edhe shtetërore, duke ofruar kontributin e tyre në funksion të mirëqenies sociale.

Rolet e punonjësit social.

Çfarë bën punonjësi social?

Kjo është pyetja me e shpeshtë që dëgjon punonjësi social sa herë që pyetet rreth profesionit të tij. Kjo nuk është një pyetje e lehtë për t'iu përgjigjur. Jo sepse një punonjës social nuk e ka të qartë rolin dhe detyrat e tij në shoqëri, por sepse këto të fundit janë të shumta dhe gjithëpërfshirëse. Ndoshta është më mirë të them "nuk di nga t'ia fillojë" për të shpjeguar punën që bën.

Për të kuptuar më mirë punën e një punonjyesi social po e filloj nga misioni i tij. Misioni i punës sociale fokusohet në ofrimin e ndihmës ndaj shtresave në nevojë të shoqërisë, fuqizimin e tyre dhe rritjen e kapaciteteve me qëllim arritjen e drejtësisë dhe mirëqenies sociale. Për të plotësuar këtë mision ai ndërmerr role të ndryshme.

Ai është aktivist, në mbrojtje të të drejtave të klientit të tij, është lobues i të drejtave të munguara. Një punonjës social është ndërlidhës mes klientëve dhe burimeve që ofron komuniteti, është negociator në funksion të sigurimit të nevojave të tyre. Ai është iniciator i nismave të ndryshme në funksion të drejtësisë dhe mirëqenies sociale. Punonjësi social është lehtësues grupi, folës i grupit që përfaqëson. Roli i avokatit të grupeve apo individëve të marzhinalizuar është gjithashtu një ndër rolet që më së shumti ai ndërmerr. Punonjësi social është kërkues shkencor, ai angazhohet shpesh në hulumtime mbi ngjarjet apo problemet sociale që trajton. Gjithashtu ai është një hartues dhe zbatues i mirë politikash, programesh e projektesh sociale.

Nivelet e punës sociale.

Në pikën 2 të nenit 4 të ligjit të punës sociale theksohet: "Punonjës social është një profesion i rregulluar që ushtrohet në fushën e punës sociale në nivel makro, mezo dhe mikro, në shërbim të individëve, familjeve, grupeve, komuniteteve, institucioneve të nivelit qendror e vendor në sistemin publik dhe privat".

Nga sa u citua më sipër kuptohet që punonjësit socialë janë kudo. Në nivelin mikro të ndërhyrjes/ofrimit të ndihmës, punonjësini social e gjen të fokusuar tek puna me individin. Në nivelin mezo ai punon me familjen dhe grupet e vogla. Ndërsa në nivelin makro punonjësi social punon me agjencitë, organizatat, komunitetet dhe shoqërinë në përgjithësi. Shpesh

termin "Nivele" në literaturën e punës sociale e gjejmë të emërtuar si "Metoda", por të dyja i referohen fushës së veprimit të punës sociale.

Edhe pse teorikisht ekzistonte një ndarje e tillë, punonjësi social nuk mund t'i "presë gjërat me thikë". Shpesh një punonjës social që ofron shërbimin e tij në nivelin mikro e gjen të përfshirë njëkohësisht dhe në dy nivelet e tjera, mezo dhe makro. Për ta bërë më të kuptueshme këtë ndërlidhje që ekziston mes niveleve të punës sociale po e ilustruam me një shembull.

Një punonjës social që punon në shkollë identifikon një nxënës që kohët e fundit ka filluar të ketë sjellje shmangëse dhe vetizoluese. Ai gjithashtu ka filluar të ketë rënie të theksuar në mësim. I shqetësuar nga gjendja e nxënësit ky punonjës social fillon ta studiojë rastin e tij. Gjatë punës zbulon që atmosfera familjare e fëmijës ka ndryshuar. Zënkat mes prindërve të cilat reflektojnë në gjendjen emocionale të fëmijës janë pothuajse të përditshme. Kjo duket se ka ardhur si pasojë e humbjes së punës që babai kishte dhe pamundësisë për të përballuar shpenzimet familjare me ardhjen në jetë dhe të motrës së vogël. Pasi njihet me gjendjen e familjes punonjësi social fillon punën për lidhjen e familjes me burimet që komuniteti ofron si dhe gjetjen e një pune për babain e nxënësit.

Ndërkohë analizojmë ndërhyrjet.

Puna me nxënësin (ndërhyrje në nivelin mikro).

Puna me familjen (ndërhyrje në nivelin mezo).

Puna me agjencitë, ndërlidhja e familjes me burimet e komunitetit (ndërhyrje në nivelin makro).

Siç kuptohet dhe nga shembulli punonjësi social njëkohësisht ofron shërbimin e tij në nivele të ndryshme. Ai është si një elektron që lëviz nëpër "orbitat e punës sociale" për të ofruar më të mirën për klientin e tij.

Vlerat dhe parimet etike të punës sociale

Si çdo profesion tjetër puna sociale mbështetet në disa vlera profesionale dhe parime etike gjatë ofrimit të shërbimeve.

Në vijim do të njihemi me parimet etike të punës sociale të cilat bazohen në vlerat e saj.

Vlera: *Shërbimet.*

Parimi etik: *Qëllimi parësor i punonjësit social është të ndihmojnë njerëzit në nevojë dhe të adresojë problemet sociale.*

Kjo do të thotë se punonjësit socialë nuk e ngrejne punën e tyre profesionale mbi interesin vetiak. Ata investojnë vlerat dhe njohuritë e tyre për t'u ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë. Vlen të theksohet që

punonjësit socialë inkurajohen të vullnetarizojnë një pjesë të aftësive të tyre profesionale pa pritur ndonjë shpërblim të konsiderueshëm financiar.

Vlera: *Drejtësia sociale*

Parimi etik: *Punonjësit socialë sfidojnë padrejtësinë sociale.*

Punonjësit socialë që në fillimet e këtij profesioni atëherë kur ekzistonte si një përpjekje vulltare për të zbutur problemet sociale kanë promovuar drejtësinë sociale.

Kjo është edhe arsyeja pse ata i gjen përherë të angazhuar me probleme si varfëria, papunësia, diskriminimi etj.

Drejtësia sociale ngrihet mbi ofrimin e mundësive dhe aksesit në burimet e komunitetit në përputhje me nevojat, karakteristikat dhe prioritetet e grupeve apo individëve.

Vlera: *Dinjteti dhe vlera e personit*

Parimi etik: *Punonjësit socialë respektojnë dinjtetin dhe vlerën e qenësishme të personit.*

Një punonjës social e trajton çdo njeri me kujdes dhe respekt duke patur parasysh dallimet individuale, përkatësinë etnike apo diversitetin kulturor. Ai përpiqet të rrisë kapacitetet e klientëve dhe të adresojë problemet e tyre në mënyrën sa më humane si dhe në përputhje përherë me vlerat, parimet dhe standardet profesionale.

Vlera: *Rëndësia e marrëdhënieve njerëzore*

Parimi etik: *Punëtorët socialë njohin rëndësinë qendrore të marrëdhënieve njerëzore.*

Njerëzit janë qenie sociale dhe si të tilla nuk mund të jetojnë larg lidhjeve të tyre. Studimet e ndryshme psikologjike tregojnë që njeriu në një përqindje të lartë e kupton vetveten (krijimi i vetëkonceptit) falë shoqërizimit me të tjerët dhe ndërveprimit me mjedisin rrethues.

Duke njohur rëndësinë e marrëdhënieve njerëzore punonjësit socialë i përdorin ato shpesh si mjete ndihmëse në punën me klientët. Ata vazhdimisht përpiqen që t'i kurojnë, rivendosin, ruajnë e forcojnë këto lidhje duke rritur kështu mirëqenien e individëve, familjeve, grupeve sociale, organizatave dhe komuniteteve.

Vlera: *Integriteti*

Parimi etik: *Punonjësit socialë sillen në një mënyrë të besueshme.*

Punonjësit socialë janë vazhdimisht të vetëdijshëm për misionin e profesionit të tyre, vlerat, parimet dhe standardet etike si dhe praktikën duke ruajtur qëndrueshmërinë mes tyre. Punonjësit socialë veprojnë me ndershmëri dhe me përgjegjësi dhe promovojnë praktika etike nga ana e organizatave në të cilat bëjnë pjesë.

Vlera: *Kompetenca*

Parimi etik: *Punonjësit socialë ofrojnë shërbime në fushat e tyre të kompetencave si dhe zhvillojnë dhe forcojnë ekspertizën e tyre profesionale.* Punonjësit socialë vazhdimisht përpiqen të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale dhe t'i zbatojnë ato në praktikë. Një punonjës social nuk ndalon asnjëherë së mësuari. Ai është përherë në përpjekje për të zbuluar dhe përsosur metodat e tij të punës. Në njëfarë mënyre punonjësi social duhet të përparojë në praktikat e tij të punës konform dinamikave të problemeve sociale.

Punonjësi social përballë psikologut dhe sociologut

Një fakt i pamohueshëm është konfuzioni që ekziston në shoqërinë shqiptare dhe jo vetëm në bërjen e dallimit mes punës sociale, psikologjisë dhe sociologjisë.

Si fillim duhet sqaruar që të tre janë profesione të mirëfilltë, të ndarë nga njëri - tjetri. Që të zotërohet cilido prej tyre duhet të ndiqen studimet në degën përkatëse.

Po nga buron gjithë kjo ngatërresë në shoqëri? Pse përherë puna sociale i atashohet ose sociologjisë ose psikologjisë?

Fakti që janë profesione me qasje sociale iu jep atyre shumë ngjashmëri dhe kjo e bën konfuze masën e gjerë.

Një element tjetër që duhet sqaruar është se një punonjës social veç të tjerash, pjesë shumë të rëndësishme të formimit të tij akademik ka marrjen e dijes sociologjike dhe psikologjike.

Për sa i përket sociologjisë ajo është shkenca e cila merret me studimin e shoqërisë. Këtë e kuptojmë edhe nga ndërtimi morfologjik i emrit, Sociologji = Socio (shoqëri)+Logos (shencë). Për ta bërë më të kuptueshme një sociolog interesohet t'u përgjigjet pyetjeve, si: si, pse, kur, ndodhin ngjarje të ndryshme në shoqëri. Punonjësit socialë përveç këtyre të fundit janë më shumë të fokusuar në ndërhyrjen konkrete në zgjidhjen e problemeve sociale, pra në rast se një sociolog merret me anën teorike të problemit, punonjësi social, punon në funksion të zgjidhjes së tij.

Përsa i përket psikologjisë ajo ndryshe njihet si shkenca që studion shpirtin, psyche (shpirt) + logos (shkencë). Psikologu e studion të brendshmen e njeriut përmes sinjaleve që ai pasqyron së jashtmi pra, përmes sjelljes së tij. Po ta krahasojmë tani punën e psikologut me atë të punonjësit social shohim, që psikologu fokusohet me tepër tek sjellja e njeriut dhe synon ekuilibrin e tij të brendshëm, ndërsa punonjësi social më së shumti angazhohet në funksionimin shoqëror dhe synon mirëqenien sociale.

Duhet theksuar që këta tre profesionistë (punonjësi social, psikologu, sociologu) shpesh në përditshmëri i gjen të punojnë së bashku në të ashtëquajturat grupe multidisiplinore. Në këtë mënyrë ata i bëjnë një trajtim më të plotë problemit duke e analizuar në tërësi. Për ta përmbyllur, po marr një shembull: Gjatë punës në grup për zbutjen e varfërisë, sociologu merret me studimin e fenomenit varfëri, pra përpiqet të identifikojë shkaqet, pasojat, shtrirjen etj. Psikologu merret me rekuperimin e dëmeve psikologjike të shkaktuara nga kjo situatë siç mund të jenë, stresi, depresioni, ndjenja e inferioritetit etj. Ndërsa punonjësi social angazhohet në gjetjen e alternativave për zbutjen e varfërisë duke lidhur individët me burimet e komunitetit të llojit shërbime apo punësim.

Teoritë e punës sociale

Në praktikën e punës së tyre punonjësit socialë bazohen në disa teori ndër të cilat janë *teoria e sistemeve*, *teoria psikodinamike*, *teoria e të mësuarit social* dhe *teoria e konfliktit*.

1. Teoria e sistemeve e vë theksin tek interveprimi i vazhdueshëm i njeriut me mjedisin. Ajo përpiqet të shpjegojë se si sistemi familjar ndikon atë individual. Në bazë të kësaj teorie çdo ndryshim në një pjesë të këtij sistemi e ndikon atë në tërësi.

2. Teoria e të mësuarit social e vë theksin tek mënyra se si njerëzit zhvillojnë aftësitë e veta njohëse dhe mësojnë përmes shembujve që ofron mjedisi rrethues. Në bazë të kësaj teorie imitimi dhe reagimi ndaj stimujve janë ata që formësojnë sjelljen e mësuar.

3. Teoria psikodinamike thotë që energjitë e brendshme të njeriut dhe forcat e jashtme ndërvprojnë me njëra-tjetrën duke dhënë impakt në zhvillimin emocional të tij. Në bazë të kësaj aktiviteti i pavetëdijshëm dhe i vetëdijshëm i mendjes është ai që motivon sjelljen njerëzore.

4. Teoria e konfliktit e vë theksin tek mënyra se si fuqia e strukturave dhe e pabarazive në shoqëri ndikon në jetën e njeriut. Në bazë të saj të gjitha shoqëritë përjetojnë disa forma të shtypjes dhe padrejtësisë dhe pabarazisë strukturore. Fuqia dhe pushteti janë të ndara në mënyrë të pabarabartë dhe për rrjedhojë disa grupe dominojnë mbi të tjerë. Në këtë mënyrë jeta është e dominuar nga konflikti jo nga koncensusi.

Ku punojnë punonjësit socialë?

Punonjësit socialë janë kudo ku ka probleme sociale për të trajtuar.

Ata ofrojnë shërbimin e tyre në sektorë të ndryshëm.

Ata i gjejnë në sektorin publik duke punuar nëpër, shkolla, spitale, bashki, polici, gjykata, në institucionet e shërbimit të provës, burgje, shtëpitë e të

moshuarve, qendrat komunitare, shtëpitë e fëmijës, zyrat e punës, në sektorin e shëndetit publik, si dhe si akademik politikëbërës.

Në sektorin privat punonjësit socialë i gjen të ofrojnë shërbimin e tyre në subjekte, si: organizatat jofitimprurëse, qendra të ndryshme multidisiplinare, zyra këshillimi apo ndërmjetësimi etj.

Si freeleancer, duke ofruar shërbime të ndryshme, si: këshillim, mentorim, hartim projektesh sociale apo realizimin e kërkimeve shkencore.

Në vitet e fundit, u bë i njohur dhe koncepti i ndërmarrjeve sociale apo biznesit social, ku në këtë sektor u atashuan shumë punonjës socialë duke e parë si një mënyrë të mirë për zbutjen e problemeve sociale.

PËRFUNDIME:

Si përgjigje ndaj pyetjeve tona kërkimore arritëm në përfundimet që:

- Puna sociale fillimisht lindi si një nismë vullnetare në ndihmë të grupeve vulnerabël të shoqërisë rreth fundit të viteve 80.
- Sot puna sociale është një profesion i mirëfilltë dhe në rritje i cili punon për fuqizimin e individit, vendosjen e drejtësisë sociale në funksion të përmbushjes së misionit të saj që është mirëqenia sociale.
- Profesionit i punës sociale bazohet në disa teori, si: *teoria e sistemeve*, *teoria psikodinamike*, *teoria e të mësuarit social* dhe *teoria e konfliktit*.
- Punonjësit socialë ofrojnë shërbimin e tyre në tre nivele: mikro (puna me individin) mezzo (me familjen dhe grupet e vogla) dhe makro (me komunitetin dhe shoqërinë mbarë). Ata ofrojnë shërbimin e tyre si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat.

REFERENCAT

1. Dragoti, E. *Hyrje në punë sociale*, Tiranë, 2009.
2. Gjermeni, E. *Metoda dhe shprehja në praktikën e punës sociale*.
3. Lumani, B. *Hyrje në punë sociale*, Cikël leksionesh, Shkodër, 2013.
4. Seanca webinar të realizuara mes profesionistësh të punës sociale, përfaqësues të universiteteve dhe studentëve të punës sociale në kuadër të projektit TASK.
5. <https://www.socialworkdegreeguide.com/faq/what-is-the-history-of-the-social-work-profession/>
6. <https://oxfordre.com/socialwork/view/10.1093/acrefore/9780199975839.001.0001/acrefore-9780199975839-e-623>
7. <https://socialwork.simmons.edu/evolution-social-work-historical-milestones/>
8. <https://www.naswfoundation.org/Our-Work/The-NASW-Legacy-Project/NASW-History>
9. <http://fshs-ut.edu.al/departamenti-i-politikave-dhe-punes-sociale/>
10. <https://www.vendime.al/ligj-nr-1632014-per-urdhrin-e-punonjesve-sociale-ne-republiken-e-shqiperise-2/>
11. <https://youtu.be/jJXRB1V5eVw>
12. <https://www.socialworkers.org/About/Ethics/Code-of-Ethics/Code-of-Ethics-English>
13. www.socialworkscapbook.wordpress.com
14. <https://www.quora.com/How-is-social-work-as-an-arts-and-science>

VEÇORI TË KOMUNIKIMIT NË ZYRËN E PRITJES SË QYTETARËVE NË RRETHANAT E PANDEMISË COVID-19

Sherif Dervishi

Në fushë të sociologjisë

ABSTRAKT

Përballja me situatën e panjohur më parë, krijuar nga përhapja e pandemisë Covid-19, ka qenë dhe mbetet e vështirë për pothuajse të gjithë njerëzit. E veshur me shumë pasiguri dhe informacione të dyshimta, të cilat të përcjellin mendësinë se në çdo hap që hedhin mund të shkelin në një zonë të minuar, nga çasti në çast, pas çdo kontakti me njerëzit vihet në pikëpyetje e ardhmja dhe shëndeti i njerëzve, i njerëzimit.

Ndër vitet e fundit, bota ka përjetuar rritje të numrit të pandemive lokale dhe globale si për shembull SARS (2003), H1N1 Flu (2009), MERS (2012), Ebola (2014), Zika virus (2016), dhe së fundmi COVID-19, duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2019 (David, K., and Gary, K., 2020:2).

Sjelljet dhe qëndrimet tradicionale në komunikimet e përditshme të shumicës së shqiptarëve kanë hyrë në një proces të pashmangshëm të rimodelimit, si pothuajse në shumicën e vendeve të botës, i zhvilluar si mekanizëm mbrojtës për t'iu përshtatur situatës pandemike për përkujdesjen e shëndetit vetjak dhe të afërmëve nga Covid-19.

Kësisoj, në mjediset e punës dhe veçanërisht në zyrat e mbyllura me disa kolegë dhe prani të shtuar të qytetarëve që vijnë nga jashtë për të marrë shërbime të ndryshme, rritet rreziku i përhapjes së infektimit me Covid-19. Kështu, në sektorin e informacionit për shërbime ndaj qytetarëve në Bashkinë Tiranë, janë zbatuar në mënyrë rigoroze të gjitha udhëzimet e përditësuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe institucioni vendor, lidhur me marrjen e masave parandaluese për të mos përhapur Covid-19, duke rimodeluar sjelljen dhe komunikimin me qytetarët në praktikën e përditshme të shërbimeve që ofrohen.

Në këtë artikull synohet të nxirren në pah veçori të komunikimit në sektorin e informacionit në Bashkinë e Tiranës, për shërbime ndaj qytetarëve, gjatë muajve të karantinimit dhe pas rihapjes, ku ende paraqitet rrezikshmëri e lartë për infektim. Duke qenë se në territorin e Bashkisë së Tiranës banojnë njerëz të ardhur nga të gjithë qytetet dhe krahinat e

Shqipërisë, mjaft prej përfundimeve të këtij artikulli mund të kenë vlerë për komunikimin e punonjësve me qytetarët edhe në bashki të tjera të Republikës së Shqipërisë

Koncepte kyçe: Komunikim, pandemi, covid-19, masa parandaluese, shërbime, informacion, infodemi, sjellje të rimodeluara.

Peculiarities of communication in the office of citizen services under the circumstances of covid – 19 pandemic

ABSTRACT

Dealing with a previously unknown situation, developed by the spread of the Covid-19 Pandemic, has been and still is tough for almost anyone. Coated with doubt, skepticism and uncertainty, which leaves traces of feeling like one is walking through a mine field, after every single contact with people, humankind's health and future are increasingly being questioned.

In the last years, the number of local and global pandemics in the world appears to be increasing with time, for instance, SARS (2003), H1N1 Flu (2009) MERS (2012), Ebola (2014), Zika virus (2016) and recently COVID-19, starting from the second half of 2019 (David, K., and Gary, K., 2020:2).

An unavoidable refashioning process has already seized everyday language, behavioural patterns and social manners of the vast majority of the Albanian people, just as it happened in most countries worldwide due to the need for an effective defence-mechanism that would adapt to the time of pandemic and would serve as precaution for our own health and our relatives as well.

Therefore, the risk of contracting Covid-19 increases in the workplace, especially in enclosed spaces offering considerably many services, with a multiplied presence of people coming from crowded outdoors. Hereupon, all updated directions on Covid-19 preventive measures issued by the Ministry of Health and local authority, were strictly followed in the division of citizen information service in the Municipality of Tirana, leading to altered patterns of communication and conduct interactions between the service-provider and the citizen.

This paper aims at spotlighting peculiarities of communication in the information division in the Municipality of Tirana, regarding services

provided for citizens during quarantine months and post-reopening period defined as yet by a high risk of contamination. Given the fact that people migrating from all regions and counties of Albania come and settle within the territory of the Municipality of Tirana, many conclusions on communication and service-providing patterns between municipality officials and citizens stemming from this article might apply to other municipalities of the Republic of Albania.

Metoda kërkimore

Informacioni i nevojshëm për realizimin e këtij artikulli është mbledhur nëpërmjet metodës kërkimore cilësore. Përmes kësaj metode është synuar të vihen në pah përvojat e njerëzve në dinamikën e jetës së përditshme, së cilës, si problem i shtuar, i janë bashkangjitur dhe masat parandaluese që synojnë të shmangin infektimin me Covid-19.

Me anë të kësaj metode është synuar të bëhet radiografia e komunikimeve të qytetarëve të Bashkisë Tiranë në mjedisin e tyre social, ashtu siç shfaqen me të gjitha ngjyrat e përvojave të tyre. Janë realizuar mbi 200 biseda në formë interviste në muajt qershor-korrik 2020, në të cilat është përthithur informacioni drejtpërdrejt nga komunikimi me qytetarët që vijnë të marrin informacion për shërbime në zyrën e pritjes së Bashkisë Tiranë. Ndërkohë për muajt mars-prill-maj 2020, që përkuan me periudhën e izolimit pothuajse total nga Covid-19, janë intervistuar vetëm 15 qytetarë jashtë institucionit dhe kam pritur 64 telefonata të ardhura tek numri i gjelbër 0800 0888, pasi zyra e pritjes ka qenë e mbyllur për shkak të situatës së jashtëzakonshme. Kujtojmë që me 1 qershor 2020 është rihapur për shërbime zyra e pritjes së qytetarëve e Bashkisë Tiranë. *Në këtë punim do t'i japem përgjigje pyetjeve; Si ndikon situata pandemike në komunikimin e qytetarëve me nëpunësit në zyrat e njësisë vendore? Në cilat kushte zhvillohet komunikimi? Cilat janë risitë kryesore në komunikimin qytetar-nëpunës të përcaktuara nga trysnia e shumëfishtë psikologjike e pandemike?*

Hyrje

Në zyrën e informacionit dhe shërbimeve të qytetarëve të Bashkisë Tiranë në periudhën para përhapjes së pandemisë Covid-19, paraqiteshin për të marrë informacion dhe shërbime të ndryshme mesatarisht 300 qytetarë në ditë. Nëpërmjet kësaj zyre ofron informacione për 97 shërbime të ndryshme për qytetarët.

Kontakti dhe komunikimi me njerëzit në këtë zyrë është dinamik dhe i vazhdueshëm, përgjatë gjithë 10 orarëshit të punës, pothuajse pa

ndalesa. Imagjioni për një moment shumësinë e personazheve dhe karaktereve që ulen në karrigen përballë së njëjtës tavolinë, të cilët vijnë pareshtur gjer në mbylljen e institucionit në orët e vona të pasdites, duke shprehur kërkesa për shërbime dhe problematika për zgjidhje nga më të ndryshmet... Asnjë qytetar nuk përngjet me një tjetër, çdo karakter është i ndryshëm nga pararendësi. Problemet me karakter të njëjtë të disa prej qytetarëve që paraqiten për zgjidhje, shfaqen prej tyre në forma aq të larmishme nga mënyra si parashtrajnë kërkesën dhe fjalët që zgjedhin për t'u shpjeguar, aq sa të jep përshtypjen se ke të bësh me probleme krejt të ndryshme. Për shembull, për të kërkuar një certifikatë familjare (të trungut familjar) nga arkiva e gjendjes civile për vitet 1950-1974, një qytetar shprehet me fjalët “dua një trung”; një tjetër me frazën “*Më bëj një letër që të më vërtetohet mbiemri i vajzërisë, kur kam qenë tek babai se kështu ma kërkon noteri*”; një tjetër kërkesë pothuajse e përditshme nis me këto fjalë “*Më ka vdekur babai. Kemi ca prona për të ndarë me vëllezërit, po shikojë një herë këtë letrën çfarë më ka shkruar noteri të marr në bashki se nuk e kam idenë fare*”. Pra, i njëjti lloj shërbimi kërkohet nga pikëvështrime dhe me fjalë të ndryshme nga qytetarë të ndryshëm. Shpeshherë specialistët që presin qytetarin u duhet të gjykojnë nga këndvështrimi i rolit të psikologut për të konkretizuar me fjalë atë që qytetari ka në mendje, por që nuk arrin ta shprehë mjaftueshmërisht qartë se çfarë kërkon.

Komunikimi me qytetarët e Bashkisë Tiranë karakterizohet nga sfonde të larmishme nënkulturore, duke qenë se shumica prej tyre janë të ardhur nga e gjithë hapësira shqiptare pas vitit 1990 me lejimin e lëvizjes së lirë të popullsisë edhe në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Masat parandaluese për mospërhapjen e infektimit nga Covid-19 e veshin bashkëbisedimin e nëpunësve të bashkisë me qytetarët me një lloj filtri, që duke pretenduar se po mbrojnë shëndetin, vështirëson akoma më shumë komunikimin e drejtpërdrejtë. Kështu edhe në komunikimin joverbal, pengimi i shikimit qartë të fytyrës nga maskat mbrojtëse (pothuajse gjysma e fytyrës mbuluar), bën që të përcillet më pak informacion dhe emocione nga tiparet e fytyrës rreth asaj çka bashkëbiseduesi kërkon të shprehë.

1. Komunikimi ndërpersonal ngjall më shumë besim te qytetarët

Shumica e qytetarëve që vijnë në zyrën e pritjes në Bashkinë Tiranë, çmojnë shumë komunikimin sy më sy me specialistin/specialisten që i pret për dhënie informacioni ose ndonjë shërbim tjetër.

Komunikimi ndërpersonal ka të bëjë me ndërveprimin e drejtpërdrejtë siç ka analizuar Ervin Goffman (Shih: Marshall, G., 2009:

186). Pothuajse 90 për qind e qytetarëve edhe pasi janë informuar për një shërbim të caktuar nga disa kanale informimi, si për shembull: gazetatat, televizionet, faqja zyrtare e Bashkisë Tiranë Tirana.al, rrjetet sociale dhe nga telefonatat që bëhen nga qytetarët për informacion tek numri i gjelbër 0800 0888, përsëri i drejtohen zyrës së pritjes së qytetarëve për të konfirmuar vërtetësinë e informacionit. Shpesh herë qytetarët i drejtohen specialistit me shprehjen “Meqë më ra rruga këtej, desha të pyes për të qenë i sigurt nëse është i vërtetë lajmi i përhapur në media se Bashkia Tiranë së shpejti do të ndërmarri nismën për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve për ...”

Pasi sigurohen për vërtetësinë e lajmit, zakonisht qytetarët kërkojnë të njohin në mënyrë të detajuar ecurinë e realizimit të projektit, kohëzgjatjen, dokumentacionin që duhet plotësuar, nesë dokumentet mund t’i sjellë dikush tjetër në emër të tyre dhe kur do të dalin përgjigjet përfundimtare në mbarim të procesit. Theksojmë se, pavarësisht se çdo informacion lidhur me aplikimet e ndryshme në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve publikohet në stendat e jashtme dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, përsëri qytetarët i drejtohen zyrës së pritjes për t’u sqaruar më tej sy më sy me specialistët e zyrës.

Në kulturën shqiptare vështrimi drejtpërdrejt në sy ose me “sy përdhe” interpretohet në mënyra të ndryshme në varësi të rrethanave dhe të statuseve shoqërore, ekonomike, politike e profesionale të personave që komunikojnë. Për shembull, një nëpunës i niveleve të larta, mund të bisedojë në zyrë me nëpunës të niveleve më të ulëta ose me qytetarë që kanë shkuar për të zgjidhur ndonjë problem shoqëror dhe sidomos vetjak, duke i vështruar ata drejtpërdrejt në sy. Një model i tillë vështrimi karakterizohet si shprehje e çiltërsisë, e transparencës, e përkushtimit të nëpunësit të lartë për t’i trajtuar me dashamirësi problemet e nëpunësve të niveleve më të ulëta ose të qytetarëve hallexhinj. Në të kundërt, nëpunësi i niveleve të larta mund të flasë pa i parë në sy nëpunësit vartës ose qytetarët nevojtarë, por siç thuhet “i mban sytë përdhe”. Kjo mënyrë të vështruarit e paraqet nëpunësin e niveleve të larta si hileqar, të predispozuar për të mos ua zgjidhur problemet me dashamirësi nëpunësve ose qytetarëve hallexhinj, madje edhe të prirur për të dhunuar të drejtat e tyre në mënyrë të maskuar (Dervishi, Z., 2016:371).

Pas datës 11 mars 2020, kur u mbyll shërbimi në sportele në zyrën e pritjes së Bashkisë Tiranë, për shkak të masave më kufizuese që mori qeveria shqiptare për izolimin e popullsisë në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19, komunikimi i drejtpërdrejtë nuk ishte më në plan të parë, si mënyra më e shëndetshme për të komunikuar me institucionin. Kështu, 2 javët e para pas mbylljes së shërbimeve, në sportele

u ndërpre komunikimi mes qytetarëve dhe institucionit, pasi qytetarët refuzonin të komunikonin me institucionin nëpërmjet rrugëve të tjera të shërbimit dhe informimit si p.sh.: dërgimit të dokumentacionit nëpërmjet Postës Shqiptare, marrjen në telefon tek numri i gjelbër 0800 0888, i cili ka qëndruar i hapur 24 orë në shërbim të qytetarëve dhe e-mailit zyrtar të Bashkisë Tiranë Tirana@info.al.

Gjatë pandemisë, njerëzit zakonisht përjetojnë stres të shumëfishuar edhe nga përhapja e informacioneve kontradiktore deri në skaje, të mbingarkuar nga të gjitha anët, që vjen nga shumë kanale informative, si për shembull, media sociale, televizioni, radio dhe shkëmbim të njohurive me komunikim ndërpersonal (Bawden & Robinson, 2009:2).

Qytetarët vijonin të paraqiteshin te dera e zyrës së pritjes në Bashkinë Tiranë për t'u sqaruar dhe marrë shërbime nga specialistët, pavarësisht njoftimit zyrtar të afishuar në mur dhe në stendat e bashkisë se shërbimet do të vijojnë të kryhen nëpërmjet rrugëve alternative. Njoftimi zyrtar i afishuar në stenda nuk mjaftonte si orientim për qytetarët që kërkonin shërbime ndaj ne punonjësit kemi qëndruar jashtë institucionit për 2 javë, së bashku me policët e bashkisë, për t'i orientuar ata që të marrin në telefon dhe të përdorin shërbimin postar për të siguruar shërbimin e kërkuar.

Të informosh do të thotë të japësh lajme, përfshi këtu edhe lajme mbi nocionet. Mund të informohemi mbi ngjarjet, por edhe mbi njohuri të ndryshme... Mund të jesh i informuar mbi shumë gjëra, por të mos kuptosh asnjërin prej tyre... Të mbledhësh njohuri nuk do të thotë ende se i kupton ato (Sartori, G., 2013:61).

Shumica prej tyre shprehnin mosbesim dhe pakënaqësi për mbylljen e sporteve, pasi vetëm duke folur ballë për ballë me specialistët kanë besimin se shërbimi i kërkuar do të kryhet si duhet. Numri i qytetarëve që vinin te dera e bashkisë për sqarim sa vinte e shtohet duke e shpërfillur situatën e jashtëzakonshme, e cila edhe zyrtarisht u kërkonte qytetarëve të ruanin veten dhe të mos dilnin nga shtëpia për çështje jo shumë të rëndësishme.

Edhe kjo sjellje e qytetarëve përforcon "funksionimin" e prirjes konservative të shqiptarëve, të artikuluar me disa shembuj dhe fakte në librin "Nëpër degëzime të kulturës shqiptare", se si shqiptarët ende pas 55 vitesh, referuar vitit 1965, vit në të cilin u bë ndryshimi i vlerës nominale të parasë në shtetin shqiptar, vazhdojnë të shprehen me vlerën e parasë së vjetër, para vitit 1965. Ndër të tjera autori përmend: "...është e kuptueshme që për disa javë, muaj, madje disa vite, sa të mësoheshin me vlerën nominale të parave, shqiptarët të shpreheshin për çmimet e mallrave dhe të

shërbimeve të ndryshme, duke përdorur njëherazi vlerën nominale të vjetër dhe atë të re të parave. Një përdorim i tillë i dyzuar justifikohet në harkun kohor të pak viteve, veçanërisht për njerëzit në moshë të mesme dhe të tretë, por jo për më shumë se 48 vite. Shqiptarët kanë folur dhe ende flasin me termat e lekëve të vjetër jo vetëm në bisedat e përditshme, por edhe në diskutimet zyrtare, në mjediset e strukturave të pushtetit vendor e qendror” (Dervishi, Z., 2014:203-204).

Jam informuar se një situatë e tillë e ndryshimit të vlerës nominale të lirës është tejkaluar në Republikën e Turqisë në harkun kohor të pak viteve.

2.Komunikimi në rrugë alternative shmang bisedat e panevojshme.

Gjatë periudhës së karantinimit (11 mars-31 maj 2020), lëvizja e qytetarëve të Bashkisë Tiranë ishte e kufizuar sipas orareve të përcaktuara. Zyra e pritjes së qytetarëve nuk ishte e hapur, por specialistët punonin çdo ditë me dyer të mbyllura, duke iu përgjigjur letrave me postë dhe telefonatave që vinin nga qytetarët. Kështu, ra në mënyrë drastike numri i shërbimeve që kërkoheshin nga qytetarët. Para përhapjes së pandemisë zyra e pritjes në bashki kishte rreth 120 shërbime në ditë, ndërsa në ditët e pandemisë rreth 25 ose afro 5 herë më pak. Kjo për dy arsye kryesore: më shumë se gjysma e qytetarëve që adresohen çdo ditë pranë zyrës së shërbimit të qytetarëve janë në moshën mbi 60 vjeç, pra jo të përditësuar me përdorimin e komunikimit elektronik dhe nga mungesa e besimit tek dërgimi i dokumentacionit përkatës, drejtuar bashkisë nëpërmjet shërbimit postar.

Ndërsa sfida e komunikimit me përgjegjësi gjatë periudhës pandemike po rritet, inkurajimi i punonjësve për të qenë të hapur, të bëjnë pyetje, të mbash komunikim të lirë e të hapur me ta dhe të përdorësh komunikimin në formën më të mirë, ndihmon grupin të komunikojë më efektivisht dhe më me shumë përgjegjësi, jo vetëm gjatë pandemisë, por edhe në kohë normale (Whittlesey, A.A., 2020:1)

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe letrave të qytetarëve të mbërritura me postë, në adresën postare të Bashkisë Tiranë, vihej re mosartikulim i saktë i problematikave të shprehura me shkrim prej tyre, deri në kufijtë e të pakuptueshmes, madje shpeshherë specialistët u drejttoheshin njëri-tjetrit për ndihmë për të kuptuar se çfarë është shkruar, me një sens humori, duke u shprehur me formën përkeqësuese të fjalës: “S’kuptohet çfarë ka dashur të thotë autori”.

Shpesh në zarfe gjendeshin një serë dokumentesh të pashoqëruara me letër sqaruese se çfarë kërkohet nga qytetari dhe se ku duhet dërguar dokumentacioni për trajtimin e problemit. Më vonë, me kohën mësova se dokumente të ardhura në formë të tillë janë nga qytetarë që kanë kontakt me punonjës të brendshëm në Bashkinë e Tiranës, të cilët i porosisin qytetarët (në këtë rast të afërmit e tyre), se duhet të nisin me postë dokumentacionin që të figurojë i ardhur me shërbim postar, në mënyrë që kërkesa të marrë një numër protokollit për t'u deleguar më tej për zgjidhje. Pra, qytetarët, nga besimi që u jep komunikimi me një punonjës të Bashkisë Tiranë, i cili u premton se do ta ndjekë dosjen e tyre, pasi të ketë mbërritur me shërbim postar në institucion, nuk shqetësohen për përshkrimin saktë me një kërkesë me shkrim, të hartuar nga ana tyre, motivin e nisjes me postë të dokumentacionit drejt Bashkisë Tiranë. Në këtë rast komunikimi mes qytetarit dhe nëpunësit që është në rolin e lexuesit dhe protokolluesit të dokumentacionit të mbërritur me shërbim postar, krijohet një ngërç, i cili shpeshherë zgjidhet nga një palë e tretë që është në dijeni dhe në pritje të ardhjes së këtij dokumentacioni, pra i një specialisti nga një drejtori tjetër që interesohet për dokumentacionin e mbërritur dhe orienton specialistin e Drejtorisë së Komunikimit me Qytetarët për delegimin dhe protokollimin e saktë të dokumentacionit të mbërritur.

Kjo mënyrë komunikimi dhe e trajtimit të problemeve me mbështetje dhe konsultim paraprak me punonjës të Bashkisë Tiranë, i bën qytetarët të mos jenë të aftë të krijojnë një urë komunikimi me besueshmëri tek institucioni si organ ligjzbatues dhe në mbrojtje të interesave të qytetarëve, por të mbesin peng i besimit tek individit ose specialisti mik që punon në Bashkinë Tiranë. Pra, besueshmëria tek nëpunësi ndihmues, nëpunësi - mik është mbi besueshmërinë tek institucioni. Mjaft qytetarë dëndur shprehen se zgjidhja dhe pengesa për zgjidhje të problemeve të caktuara të tyre lidhet me emra të përveçëm të punonjësve të Bashkisë Tiranë.

Një pjesë e konsiderueshme e letrave të mbërritura me postë vinin nga qytetarë, të cilët kërkonin përkrahje dhe ndihma ushqimore, duke qenë se izolimi prej Covid-19 nuk u mundësonte të fitonin të ardhura të mjaftueshme për të siguruar ushqimin më të nevojshëm. Shumica e qytetarëve që dërgonin letra për ndihma në pako ushqimore, shpreheshin me shkrim se ishin të papunë dhe se nuk kishin pothuajse asnjë të ardhur. Duhet theksuar fakti se kjo kategori e qytetarëve bën punë të shërbimeve të ndryshme të paspecializuara dhe të pasiguruara në Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Kryesisht bëjnë punë që paguhet në dorë për shërbimin që bëjnë si p.sh.: hamall, pastruese shtëpiash, mbledhës hekurishtesh, e punë të

tjera që u kërkohen kundrejt një pagese të ulët. Kësaj kategorie qytetarësh i duhet të dalë çdo ditë nga shtëpia për të siguruar ushqimin e ditës, pasi ata nuk mundën të sigurojnë rezerva ushqimore dhe, aq më pak, financiare për të përballuar jetën për të paktën një javë pa punuar.

3. Komunikimi nëpërmjet rrjetit telefonik

Në sallën operative të Drejtorisë së Komunikimit me Qytetarët gjatë periudhës së izolimit vinin rregullisht mbi 200 telefonata çdo ditë nga qytetarë, të cilët shqetësim kryesor kishin furnizimin e tyre me ndihma dhe pako ushqimore.

Gjendja ekonomike e qytetarëve që telefononin për ndihmë në numrin e gjelbër të Bashkisë Tiranë, ishte e rëndë. Ata nuk kishin mundësi t'i rezistonin izolimit për një kohë të gjatë. Rreth gjysma e këtyre telefonuesve ishin çift pensionistësh ose pensionistë të vetmuar, të cilët shpreheshin se kishin frikë të dilnin jashtë për të blerë ushqime dhe ilaçe. Përveç këtij fakti, të ardhurat e tyre mujore ishin të pamjaftueshme për të përballuar izolimin, pasi nga qëndrimi për një kohë të gjatë në shtëpi, jo vetëm që konsumonin më shumë, por gjithashtu i pengonte të përfitonin nga ndihma në të mira materiale nga të afërmit e tyre si më parë.

Pjesa tjetër e telefonuesve ishin kryesisht nëna të vetme, me një ose më shumë fëmijë, dhe familje të tjera me të dy bashkëshortët të papunë, pa asnjë të ardhur ekonomike.

Komunikimi nëpërmjet telefonit me të tria kategoritë e lartpërmenduar ka qenë shpeshherë tepër i ngarkuar emocionalisht dhe, në disa raste me acarime dhe të bërtitura nga ana e qytetarëve. Pjesa më e madhe e qytetarëve, të gjendur në nevojë, telefononin të shqetësuar dhe të frikësuar për gjendjen e tyre gjatë periudhës së izolimit. Në jo pak raste, duke mos e marrë shërbimin e kërkuar brenda ditës për ndihma në pako ushqimore, qytetarët telefonin të irrituar dhe duke bërtitur se përse ndihmat nuk po mbërrinin në banesën e tyre, pavarësisht sqarimit nga specialistët se detyrë e institucionit ishte t'u përgjigjeshin të nesërmen, pa kaluar 24 orë nga kërkesa e bërë. Telefonatat bëheshin akoma më të vështira kur qytetarët qanin dhe tregonin vuajtjet e tyre, përvojën e tyre gjatë ditëve të izolimit, gjë që humbte fokusin për t'u marrë të dhënat personale dhe adresën për t'u dërguar ndihma. Disa prej tyre telefononin në gjendje të rënduar psikologjike dhe pasi shprehnin shqetësimin e tyre, largoheshin pa thënë adresën. Në këto raste specialistët përpiqeshin të rilidheshin me ta në telefon dhe të siguronin të dhënat e tyre për t'u dërguar ndihma në pako ushqimore.

Në tërësinë e këtyre rasteve shqetësuese nuk mungonin edhe telefonata me ankesa qesharake të tipit: *“Jemi në ballkon me bashkëshorten dhe po pijmë kafe për qejfin tonë, por jam i shqetësuar nga pamja që ofron ballkoni i fqinjës një kat më lart, nga rrobat dhe veshjet intime që ka varur në tel, të cilat janë të papërshtatshme dhe shumë provokuese. U zura me gruan për këtë fakt, pasi më akuzoi se po i vrojtoja me vëmendje. Të lutem sillni një patrullë që t’i bëjë vërejtje fqinjës së katit më lart dhe t’i largojë rrobat që aty. Ne jemi familjarë të rregullt dhe nuk duam skandale”*.

Qytetarë të tjerë shpreheshin: *“Na sillni një dekoder për të parë kanalet televizive se u çmendëm tërë ditën në shtëpi pa parë televizor, nuk marrim vesh asgjë çfarë bëhet jashtë...”*; *“Kam marrë 2 herë ndihma në pako ushqimore, u jam falënderues, por u lutem na sillni dhe një pako tjetër se po na mbarojnë furnizimet dhe, nëse keni mundësi, na sillni diçka tjetër për të ngrënë, se vetëm me oriz, vaj e makarona jemi mërzitur!”*.

Kërkesa të tilla që e trajtojnë institucionin si një organizatë bamirësie ose me përgjegjësi të plotë për t’iu përgjigjur për gjithçka qytetarëve edhe për gjëra të cilat nuk parashikohen në kompetencat e institucionit, tregojnë për mungesën e njohjes së funksionimit të shtetit ligjor nga ana e qytetarëve. Janë të shumtë qytetarët të cilët në komunikim e sipër, pasi nuk arrijnë të marrin shërbimin e kërkuar, sepse ajo që kërkohet nga ata nuk është kompetencë e Bashkisë Tiranë, përmendin me nervozizëm se kanë votuar për kryetarin në detyrë të bashkisë dhe si rrjedhojë, për këtë fakt, institucioni duhet që t’u përgjigjet për çdo kërkesë të mundshme.

4.Rikthimi i komunikimit ballë për ballë

Hapja e zyrës së pritjes së qytetarëve pas periudhës së izolimit u bë në kushte të shtrënguara sigurie, duke iu përmbajtur protokollit të përcaktuar nga Organizata e Botërore e Shëndetësisë dhe Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë.

Sipas këtij protokolli, nuk lejoheshin më qytetarët të qëndronin të grumbulluar në radhë në mjedise të mbyllura. Në sallën e pritjes së qytetarëve nuk lejoheshin veçse 3 sportele të diferencuar në distancë nga njëri-tjetri, duke pritur për shërbime 3 qytetarë të pajisur me maska mbrojtëse.

Sipas statistikave të institucionit, rreth 20% për qind e qytetarëve që paraqiten për të marrë shërbime, janë qytetarë dhe subjekte që vijnë rregullisht çdo muaj në Bashkinë Tiranë.

Impaktin e parë për ndryshimet e bëra në formën e pritjes dhe në dhënien e shërbimeve për qytetarët, e morëm pikërisht nga qytetarët që janë

të vazhdueshëm me kontaktet që kanë me zyrën e pritjes së qytetarëve.

Përveç maskave në fytyrë të mbajtura gjatë gjithë kohës së komunikimit nga qytetarët me specialistët e zyrës, në rrethanat e pandemisë, si barrierë në komunikim ishte dhe xhami transparent mbrojtës. Shumica e qytetarëve shprehen se kanë vështirësi në të folur dhe në të kuptuar gjatë komunikimit me specialistët. Vështirësinë në komunikim e pranojnë edhe specialistët e zyrës së pritjes së qytetarëve të cilët po ashtu si qytetarët, detyrohen herë pas here ta ngrej në zërin ose të heqin maskën për disa çaste për t'u kuptuar më mirë me qytetarin që kanë përballë. Vështirësitë më të mëdha në komunikim i hasin të moshuarit, të cilët dëgjojnë me vështirësi dhe ndonjëherë është i pamundur komunikimi me ta nëse nuk janë të shoqëruar nga një person i tretë, qofte ky dhe i afërm i tyre.

Gjatë marrjes së shërbimit qytetarët nuk ndihen më komod si më parë, ku shpeshherë në vijim të procedurës, shkëmbejnë dhe batuta me specialistin pritës. Vihet re, veçanërisht në moshat e mesme dhe të treta, frikë për të qëndruar më gjatë se zakonisht në zyrë. Madje disa prej tyre nuk pranojnë as të ulen në karrige gjatë kohës që duhet të presin për të marrë shërbimin, pasi duan të kenë sa më pak kontakte me pajisjet e zyrës që vizitohet nga dhjetëra qytetarë në ditë.

Vështirësitë në komunikimin me qytetarët kanë zhvilluar te specialistët syrin vigjilent dhe aftësinë për të kuptuar qysh në shikim të parë, sapo qytetari paraqitet në derë, se çfarë shërbimi ka ardhur të kërkojë. Kështu janë të shpeshta rastet në të cilat, qytetarin që në pamje të parë nuk ka asnjë dokument ose dosje shoqëruese, specialisti ta pyesë menjëherë pa hezituar me fjalët: “Zotëri, për certifikatë jeni?” dhe në të shumtën e rasteve qytetari pohon pyetjen e specialistit, paksa i habitur se nga e dinte specialisti se çfarë kërkon ai.

Studiuesit e “*administrimit të intuitës*” mendojnë se në komunikim duhet të dëgjojmë parandjenjat tona. Kur gjykojmë të tjerët, thonë ata, duhet të kapemi pas rruzujve jologjike të “*trurit të djathtë*”... Kur u jepet ekspertizë e mjaftueshme, njerëzit mund ta njohin në mënyrë intuitive përgjigjen e një problemi. Situata tërheq informacionin e depozituar në kujtesën e tyre (Myers, G.David., 2003:96,97).

Në raste të tilla kur qytetarët paraqiten pa dokumente shoqëruese me vete, vijnë thjesht për të marrë informacion ose për të kërkuar takim me Kryetarin e Bashkisë. Në Bashkinë Tiranë nuk ka procedurë të takimit me Kryetarin e Bashkisë, sepse, sipas legjislacionit në fuqi, çdo procedurë dhe problematikë ndiqet dhe trajtohet nga drejtoritë përkatëse, pa qenë nevoja që Kryetari i Bashkisë të jetë në dijeni për to. Megjithatë, mjaft qytetarë

kërkojnë doemos të takohen me të dhe t'ia shprehin atij problematikën, duke refuzuar ta konsumojnë me specialistin që i pret. Qytetarët orientohen nga specialisti për zgjidhjen e problemit, duke bërë një kërkesë për drejtorinë përkatëse, e cila më pas është e detyruar të kthejë një përgjigje zyrtare me shkrim. Kjo nuk mjafton për disa nga qytetarët, të cilët nuk kanë besim te zgjidhja që i ofron institucioni, por këmbëngulin për t'u takuar me kryetarin. Në raste të tilla, kur nuk mundësohet takimi me Kryetarin e Bashkisë, për më tepër për takime të panevojshme në kohë pandemie, për probleme të cilat zgjidhen me një kërkesë të protokolluar nga specialistët, qytetarët shpërthejnë me të shara e të bërtitura.

Shqiptarëve përgjithësisht u mungon ndjenja e respektimit të hierarkisë. Kjo është argumentuar në studimet sociologjike: *“Fshatarë më pak të shkolluar, madje edhe analfabetë, që banojnë në fshatrat më të skajshme të hapësirës shqiptare, në biseda të përditshme, në ceremoni gëzimesh ose hidhërimesh, pasi artikulojnë shumë vërejtje për presidentin, për qeverinë (përgjithësisht bashkia anashkalohet si diçka e parëndësishme), për Organizatën e Kombeve të Bashkuara, për NATO-n ose ndonjë organizëm tjetër ndërkombëtar, e përfundojnë bisedën me frazën e tipizuar “po të jem unë president e zgjidh këtë problem kështu ose ashtu...”, “po të isha unë në krye të qeverisë nuk do të lejoja asnjë abuzim...”, “po të jem unë në krye të Organizatës së Kombeve të Bashkuara nuk do ta bëj kurrë këtë ose atë gabim...”, “po të isha unë komandant i ushtrive të NATO-s nuk do të kisha ndërhyrë në këtë ose atë vend...”” etj.*

Çdo shqiptar që artikulon një frazë të tillë, gati instiktivisht e mendon veten në krye të këtyre institucioneve shumë të rëndësishme për funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë shqiptare, ose pothuajse të të gjithë vendeve të botës. Asnjëri prej tyre nuk e mendon veten zëvendëspresident, zëvendëskryeministër, zëvendësekreterar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose zëvendëskomandant i ushtrisë së NATO-s. Pothuajse të gjithë shqiptarët e mendojnë veten në rolin e figurës së parë, por kurrsesi në rolin e figurës së dytë, të tretë, të katërt, të pestë e me radhë (Dervishi, Z., 2014:233).

Në një rast u paraqit një qytetar që ishte banor i Fushë-Krujës, i cili kërkonte takim medoemos me kryetarin e Bashkisë Tiranë. Fillimisht specialisti që e priti u siguroi të mernte informacion nga qytetari lidhur me problematikën e tij. Qytetari u shpreh se kërkonte leje për të ndërtuar katin e tretë të shtëpisë private, pasi së shpejti i martohej djali i dytë. Në komunikim e sipër, pasi specialisti zbuloi se qytetari nuk ishte banor i Bashkisë Tiranë, e sqaron se për t'u pajisur me leje për ndërtimin e katit

shtesë në banesën e tij private, duhet t'i drejtohet Bashkisë së Krujës, pasi nuk është banor i qytetit të Tiranës. Këto fjalë nuk i pëlqyen qytetarit nga Fushë-Kruja, i cili, ndër të tjera, u shpreh: *“Si more nuk më pret mua në takim kryetari juaj. Pse, çfarë i duket vetja atij që nuk më takoka mua? Unë jam takuar me presidentin amerikan Xhorxh Bush në mes të Fushë-Krujës, e nuk takohem me kryetarin tuaj... Sa për faktin që jam banor i Fushë-Krujës, unë erdha te ju për zgjidhje, sepse ju jeni më të medhenj se ata. Bashkia e Krujës nuk më ka dhënë ende lejen për ndërtim, andaj unë erdha që të ankojem te ju, se ju jeni bashki më e madhe dhe meqë ata nuk ma japin lejen për ndërtim, atëherë të ma jepni ju. Gjithashtu në takim me kryetarin tuaj do t'i kërkoj t'i tërheqë veshin atyre të Bashkisë Krujë, se nuk po i bëjnë punët si duhet”.*

Siç mund të kuptohet, situatat konfliktuale artificiale, krejt të tepërta, janë pjesë e përditshme në zyrën e pritjes së qytetarëve, edhe sepse pritshmëritë për Bashkinë e Tiranës janë përtej banorëve të qytetit. Qytetarët e bashkive të qyteteve të tjera shohin dhe presin një model me pritshmëri të larta tek funksionimi i punëve organike të përditshme dhe zgjidhja e problematikave nga Bashkia Tiranë.

Është i pakundërshtueshëm fakti që Tirana ka pësuar ndryshime për mirë. Zgjerimi i akseve rrugore, përmirësimi i disa rrugëve dhe trotuareve, një përkujdesje më e madhe për paraqitjen më estetike të fasadave të jashtme të ndërtesave, çlirimi i hapësirave urbane nga lloj- lloj kioscash, që nuk e kanë patur vendin aty, rikthimi i parkut Rinia në funksionin e vet, një kërkesë më e fortë për zbatimin e ligjit kur është fjala për ndërtimet, tregtinë etj., përmirësimi i ndriçimit, kontaktet më të shpeshta të përfaqësuesve lokalë me publikun, një përpjekje për ta mbajtur më pastër qytetin, punimet për rregullimin e hyrjes në qytet etj., mund të numërohen si arritje të lavdërueshme. Padyshim, këtu kanë meritë të konsiderueshme drejtuesit e Bashkisë së Tiranës. Këtu është fjala për këshilltarët, për nëpunësit dhe për përfaqësuesit më të lartë të pushtetit lokal. Ata kanë treguar kulturë më të lartë administrimi se pararendësit, çka vjen veçse në të mirë të mbarë bashkësisë qytetare të Tiranës. Është e qartë, ata kanë një farë “shansi” që ka të bëjë me një konjunkturë ekonomike, politike, shoqërore, financiare shumë herë më të favorshme se ajo, në të cilën vepruan paraardhësit e tyre. Pa këtë rrethanë të fundit, pavarësisht nga faktori subjektiv, do të kishte qenë e pamundur që Tirana t'i njihte këto ndryshime. Sidoqoftë do të kishte qenë e padrejtë të mohohet kjo punë e bërë deri më tani. Ajo vetëm duhet përkrahur duke uruar vullnet e këmbëngulje edhe më të madhe. Veçse jo duke shkruar gjithmonë frazat se *“Kisha kaq kohë pa ardhur në Tiranë, dhe kur e pashë nuk u besova*

syve...”, të cilat janë bërë të shpeshta nëpër faqet e gazetave, por me arsye të fortë dhe në mënyrë kritike. (Fuga, A., 2008: 11).

Sipas të dhënave të INSTAT-it popullsia e Tiranës u rrit me 11 mijë e 6 banorë në vitin 2020, teksa një vit më parë u rrit me 11 mijë e 164 banorë, ndërsa në vitin 2018 qarku i Tiranës ishte shtuar edhe me 21 mijë e 635 banorë të rinj (<https://www.monitor.al/pergjysmohet-shtesa-e-popullsise-se-tiranes-me-2020-vetem-11-mije-banore-me-shume/>).

Në 3 vitet e fundit të llogaritur së bashku rritja e popullsisë në Bashkinë Tiranë është rreth 43.805 banorë të rinj (përlllogaritje e autorit). Këto të dhëna tregojnë se Tirana vazhdon të mirëpresë dhe t’i bëjë ballë jo vetëm popullsisë në rritje nga qytetarë që vijnë nga rrethet, por dhe problematikave që ata sjellin me vete.

Në një rast tjetër. Vjen me shumë vrull dhe e mllëfosur një beqare tek të 40-tat, e cila, pasi hyri me furi në zyrë duke prishur rendin e mbajtjes së radhës të disa qytetarëve të tjerë që prisnin jashtë institucionit, e nis fjalën në këtë formë: *“Thuaji Erjon Velisë të vijë të më takojë tani, urgjentisht!!!... Tani të ulet këtu poshtë dhe të flasi me mua se nuk kam kohë... Kush mendon se është ai, të më traumatizojë nënën dhe babain tim duke qëndruar për një orë të mbyllur në ashensor, sepse ikën dritat? Ai duhet të më përgjigjet mua për këtë dhe unë nuk largohem pa e takuar!”*

Kërkesa llogarie nga qytetarët në drejtim të Bashkisë Tiranë të këtij karakteri, ku institucioni nuk ka asnjë lidhje me atë çfarë kërkohet, janë të përditshme dhe tregojnë për besueshmërinë e lartë të qytetarëve të Bashkia Tiranë, por gjithashtu dhe mosnjohjen e kompetencave të saj.

5.Komunikimi joverbal më i sigurtë në situatë pandemike

Të lodhur nga komunikimi me maska mbrojtëse nga njëra zyrë në tjetrën, vihet re se një pjesë e qytetarëve, të cilët janë më të shkolluar dhe më të kujdesshëm paraqiten në sportele për të marrë shërbimin, duke paraqitur një letër në të cilën shkruajnë llojin e shërbimit që kërkojnë pa u shprehur në asnjë moment me fjalë, por duke pohuar me gjestikulacione dhe shenja, si p.sh.: lëvizjen e lehtë të kokës, shkeljen e syrit etj.

Ky lloj komunikimi realizohet shumë mirë kur qytetarët dhe nëpunësit kanë vullnetin e mirë për t’u kuptuar me njëri-tjetrin. Ndonjëherë ajo çka kërkon të shprehë qytetari me gjeste, nuk mjafton për t’u kuptuar, por me një pyetje orientuese nga specialisti, shërbimi vijon sërish të kryhet në qetësi, pa fjalë dhe më i sigurt nga përhapja e spërklave në ajër, të cilat mund të rrezikojnë shëndetin e bashkëkomunikuesve në këto mjedise të mbyllura të Bashkisë së Tiranës.

Kodet joverbale luajnë rol të rëndësishëm në procesin e komunikimit ndërmjet njerëzve. *“Mekanizmat e komunikimit joverbal, vihen në lëvizje nga bashkëveprimi i një kompleksi faktorësh. Impresionet e krijuara nga elementë të ndryshëm të komunikimit joverbal mund të jenë të sakta, të paplota ose të diskutueshme, por gjithsesi ato luajnë rol të pazëvendësueshëm, shumë të rëndësishëm në ndërveprimet e njerëzve pothuajse në çdo rrethanë. Përgjithësisht pothuajse në çdo shoqëri, njerëzit e përvetësojnë spontanisht shumicën e elementeve, të rregullave të komunikimit simbolik, joverbal, në procesin e shoqërizimit”* (Dervishi, Z., 2016: 20).

Komunikimi simbolik me gjeste si komunikim universal, funksionon shumë mirë dhe me jo shqiptarët që paraqiten për të marrë shërbime të caktuara. Kështu p.sh.: një qytetar me origjinë nga Ekuadori, me fyellin që kishte me vete, po përpiqej t’i shpjegonte specialistes që e priti se kërkonte të pajisej me leje për t’i rënë instrumentit muzikor në sheshin “Skënderbej”. Ai mundohej të improvizonte sikur po luante një pjesë të saj dhe shenjonte me gisht në drejtim të sheshit.

Komunikimi simbolik është gjithnjë zanafilla e identitetit të një populli, është shprehje e një dallimi; të kuptuarit e këtij komunikimi bën të mundur njohjen e veçorive të popullit që e përdor. Por komunikimi simbolik mbërthen në vetvete edhe një tjetër veçori specifike: pushteti i tij ndikon më shumë tek ata që nuk e zotërojnë sa duhet gjuhën e shkruar (Zecchi, S., 2006:9).

Situata pandemike mund të themi se ka nxitur komunikimin joverbal si komunikim alternativ i cili herë-herë është më i sigurt se komunikimi verbal. Gjithashtu dhe probleme të karakterit dialektik që hasim shpeshherë me qytetarë të ndryshëm, kryesisht të moshave të mëdha, të cilët e kanë më të vështirë të flasin me gjuhën standarde të letrave, janë minimizuar falë shprehjes për marrjen e një shërbimi me pak fjalë ose me letra të përgatitura nga vetë ata ose me shenja. Kështu për shembull, kam qenë i pranishëm në një situatë në të cilën një zonjë mbi të 50-tat, nga Veriu i Shqipërisë, iu drejtua specialistes me fjalët: *“Dua një certifikatë linjet...”*, ndërkohë specialistja ishte e paqartë se për çfarë lloji certifikate linje transporti e kishte fjalën zonja. Nëpunësja i thotë: *“Më falni zonjë, për çfarë lloj linje transporti e doni certifikatën, sepse ka shumë të tilla? Sa kaq zonja ia pret me sa kishte në kokë:- “...çfarë certifikatë transportit thu mojt... un du certifikatë linjet për djalin tem kur ka le... Kur ka del prej mejet mas non mujsh filli...”* Pas këtij sqarimi të detajuar gjithashtu në dialekt, specialistja e kuptoi çfarë kërkohet saktësisht nga zonja me origjinë nga Shkodra.

Komunikimi në një formë të pëlqyeshme me njerëzit është cilësuar që në lashtësi nga mendimtarë dhe filozofë të ndryshëm si art dhe mjeshtëri e veçantë. Ashtu siç në terminologjinë e feve monoteiste lidhur me gjenezën dhe zanafillën e jetës në tokë thuhet “*E para ishte fjala*”, komunikimi mbetet në qendër të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të njerëzve si urë lidhëse e mendimeve të qenieve njerëzore, pavarësisht sfidave natyrore dhe problemeve sociale që mund të ndeshim. Kështu komunikimi përshtatet dhe evolon sipas çdo situatë, sado e vështirë qoftë ajo, për t’i shërbyer më mirë njerëzve, përmirësimit të jetës së tyre në çdo aspekt.

Një nga faktorët më të rëndësishëm në parandalimin e përhapjes së Covid-19, është të furnizosh njerëzit me informacionin e duhur. Sot në periudhën e Covid-19, ka një superngarkim me informacion nga të gjitha anët çka çon në “Infodemi”. Gjatë pandemisë qarkullojnë shumë informacione false, prandaj është e këshillueshme funksionimi i një kanali të dedikuar për informacion zyrtar (Venkatashiva, R. and Gupta, A., 2020:3). Një komunikim i tillë informimi sa profesional e serioz është i nevojshëm edhe në shoqërinë shqiptare. Ai do të ndihmojë për të informuar qytetarët dhe nëpunësit, për të përmirësuar komunikimin ndërmjet tyre.

Literatura kryesore

- Fuga, Artan: *Brirët e Dhisë*, Botime “Ora”, Tiranë, 2008.
- Dervishi, Zyhd: *Lente të ndërveprimit simbolik*, Botime “Emal”, Tiranë, 2016.
- Dervishi, Zyhd: *Nëpër degëzime të kulturës shqiptare*, Botime “Emal”, Tiranë, 2014.
- Bawden, David, and Robinson Lyn. “*The Dark Side of Information: Overload, Anxiety and Other Paradoxes and Pathologies.*” US National Library of Medicine, National Institute of Health 2020.
- Do Kyun David Kim and Gary L. Kreps: *An Analysis of Government Communication in the United States During the COVID-19 Pandemic*, US National Library of Medicine, National Institute of Health 2020 August 2020.
- Marshall, Gordon: *Fjalor Sociologjik*, Botime “IDK”, Tiranë, 2010.
- Myers, G.David: *Socialpsikologjia*, “Eugen”, Tiranë, 2003.
- Sartori, Giovanni: *Homo Videns*, “Ditura”, Tiranë, 2013.
- Venkatashiva Reddy and Arti Gupta: *Importance of effective communication during Covid-19 infodemic*, US National Library of Medicine, National Institute of Health 2020 August 2020.
- Whittlesey, Alicia.: *Communication During a Pandemic*, Regulatory Focus, April 2020.
- Zecchi, Stefano: *Njeriu është çka sheh*, Botime “Max”, Tiranë, 2006.

Web

<https://www.monitor.al/pergjysmohet-shtesa-e-popullsise-se-tiranes-me-2020-vetem-11-mije-banore-me-shume/>

FEJESA SI INSTITUCION PARAMARTESOR, RËNDËSIA DHE ROLI I TIJ DJE DHE SOT

Arjan Rexhepi

*Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, departamenti
i Filozofi-Sociologjisë*

ABSTRAKT

Në këtë studim i cili është një rishikim i literaturës jam mbështetur te materialet e shumta dhe literatura e hershme e arkivuar në ndihmë të studiuesve, pas një pune të bërë në terrenin shqiptar, si dhe atë ndërkombëtar, që sociologë dhe personalitete të politikës dhe shkencës kanë punuar për të na vënë në dispozicion brezave të ardhshëm. Qëllimi i gjithë këtij studimi ka qenë tërheqja nga zakoni dhe tradita e shkëlqyer shqiptare, që ende në shumë zona të Shqipërisë, po ruhet e kultivohet akoma, si një shenjë serioziteti, qëndrueshmërie dhe motivimi. Vetë fejesa është gurr i themelit për ndërtimin e familjes së ardhshme mbi baza të shëndosha, të cilat kanë si qëllim, bashkimin e dy të rinjve në altar, një jetë të gëzuar, pasardhës të shëndetshëm dhe të denjë të fortë për familjen dhe shoqërinë. Fejesa nuk humbet kurrë në një popull që ruan fort traditat, zakonet dhe rritet fetare. Kjo vërehet si në zonat periferike rurale, ashtu dhe në ato urbane, ku shkalla e emancipimit, statusi shoqëror dhe elemente të qytetërimit janë dukshëm më të lartë. Duke dashur të evidentoj trashëgiminë tonë, të drejtën zakonore shumë të larmishme dhe personalitetin e çiftit të ardhshëm, përmes fejesës, tregoj rolin parësor të saj, në kufijtë e dy fiseve. Kjo e bën institutin e fejesës, shumë elastik, me gjithë ndryshimet në varësi të krahinave. Duke u tërhequr thellë në kohë kam dashur të hulumtoj institutin e jetës, e cila është një shkollë më vete, që i jep garanci çiftit të ardhshëm, si dhe familjeve respektive. Përmes fejesës, dalin në shesh si material studimi, besa, mikpritja, bujaria, trimëria, karakteri dhe personaliteti i dhëndrit, i familjes së tij, si dhe inteligjenca. Qëllimi i këtij studimi në kushte dhe rrethana krejt të ndryshme na shërben për të njohur kulturën kombëtare, pjesën e etnologjisë, rritet dhe zakonet e shumta që kanë ekzistuar në familje dhe krahina të ndryshme. Doja shumë që ky elasticitet të ishte i dukshëm edhe

në martesat e të rinjve me fe dhe kombësi të ndryshme, gjithnjë duke e parë nga pozita vërtet pozitive. Në studim dalin në pah elemente shqetësues që janë kultivuar për shkak të religjionit.

Fjalët kyç: kumbari, pelqim, dhënie fjale, moshë, fejese, meher, familje.

Engagement as a premarital institution, its importance, and role yesterday and today

ABSTRACT

In this study, which is a review of the literature, I have relied on the numerous materials and early literature archived to help researchers, after a work done in the Albanian field, as well as the international one, which sociologists and personalities of politics and science have worked to make it available to future generations. The purpose of all this has been to withdraw from the excellent Albanian custom and tradition, which is still in many areas of Albania, is still shaved and cultivated, as a sign of seriousness, stability, and motivation. Engagement itself is the cornerstone of building a future family on sound foundations, which aim to unite two young people at the altar, a happy life, healthy and dignified descendants, strong for family, and society. Engagement is never lost in a people that strongly preserves traditions, customs and grows religiously. This is observed in both rural and urban suburban areas, where the degree of emancipation, social status, and elements of civilization are significantly higher. Wanting to highlight our heritage, very diverse customary law, and the personality of the future couple, through engagement, I show its primary role, at the borders of the two tribes. This makes the engagement institute very resilient, with all the variations depending on the provinces. Through engagement, they emerge as study material, faith, hospitality, generosity, bravery, character and personality of the groom, his family, as well as intelligence. The purpose of this study in completely different conditions and circumstances serves us to know the national culture, the part of ethnology, grows and the many customs that have existed in different families and regions. I really wanted this resilience to be evident even in the marriages of young people of different religions and nationalities, always looking at it from a really positive position. The study highlights disturbing elements that have been cultivated because of religion.

Hyrje

Fejesa zë një vend të veçantë në të gjithë trashëgiminë tonë kulturore, si një institut i domosdoshëm për të realizuar një martesë të mirë, të fortë, të qëndrueshme dhe funksionale. Rëndësia që i është dhënë asaj qëndron në faktin e mbijetesës tonë kombëtare, te ruajtja e familjes, te trashëgimia e saj e vyer. Ajo zë fill që nga mënyra si përzgjidhet personi i cili do të ngarkohet me bashkimin e dy familjeve, me statusin që gëzon ky njeri në shoqëri, që duhet të jetë i qartë, besnik dhe inteligjent. Për shkak të natyrës shumë të theksuar kombëtare, për t'i mbijetuar asimilimit të të huajve, gjithnjë është synuar të realizohen fejesa brenda truallit arbëror. Objektivi ka qenë që të bëjë të mundur nëse fejesa është një domosdoshmëri, për të ardhmen e familjes, apo është një mbeturinë arkaike. Duke parë se fusha e studimit të institutit të fejesës, martesës, divorcit, familjes është shumë e gjerë dhe dokumentet referuar këtij procesi janë të shumta, vendosa të përzgjedh një metodë shumë eficiente, ku cilësia dhe ngarkesa e burimeve të shumta e bën më të lehtë përdorimin e metodës së rishikimit të literaurës, e cila gjendet lehtë si në vepra të politikës së hartuar për zhvillimin e vendit, përgjatë historisë së tij, ashtu dhe në autorë të ndryshëm, vendas dhe të huaj që jetën e tyre ia kushtuan problemeve dhe fenomeneve të sjelljes njerëzore ndaj proceseve të shumta mbi familjen.

Formulimi i problemit dhe qëllimit të punimit: Qëllimi është të shoh nëse është i domosdoshëm instituti i fejesës në periudhën që kam marrë për ta studiuar. Nëse po, këtë duhet t'ia bëj të ditur lexuesit, nëse jo, duhet të theksoj arsyet se përse është zhvlerësuar ai. Si është gjendja reale e familjes shqiptare? Kush janë shkaqet që e frenojnë këtë institut? Ku gjenden këto shkaqe? Në mendjen e kujt? Si zhvillohet familja përtej fejesës? Çfarë përfitohet përmes saj? Po nëse nuk e pranojmë si pjesë e një procesi të tërë? Si mund të rregullohet kjo punë? Kush janë pasojat e mungesës së këtij instituti? A ka dobi shoqëria, nëse del nga qarkullimi?

Rezultatet dhe diskutimet

Si rezultat i studimit është bërë e mundur të dalin shkaqet dhe arsyet e një martese të qëndrueshme, me bazë lumturinë e përbashkët, të çiftit, të fëmijëve dhe fisit. Janë zbardhur shumë dilema të cilat e frenonin mbajtjen gjallë të saj, janë nxjerrë dobësitë e kësaj pune dhe detyrat për të ardhmen. **Instituti i kumbarisë**, ky person planifikohej të ishte mik i të dy familjeve. Me pëlqimin e tyre, ka kaluar faza e parë e njohjes, e cila duhej bërë për shkak se sillte pasoja. Zakonisht te katolikët, kjo fazë nuk merrej parasysh,

pasi një rol të rëndësishëm luanin prindërit, të cilët donin më shumë ta shisnin vajzën se sa ta fejonin. Ndërsa ndër zakone dhe tradita të krahinave të tjera, gjithnjë merrej pëlqimi i vajzës. Gjithçka zë fill te qëllimi përse realizohet fejesa. Pas saj rëndësi ka përzgjedhja e shkuesisë për të ardhmen e familjes. E kam nisur nga historia, ku materialet nuk mungojnë dhe kam shtjelluar fejesën me të gjithë elementet e saj, të cilat e vënë atë në krye të përmbushjes së një detyre. Nga çfarë rezulton përmes kodit të familjes, ndoshta është hequr ai element i traditës sonë për të ndërhyrë në familje me qëllim që të kemi jo një individ, por një shoqëri të deformuar. Luhatjet që ka pësuar fejesa dhe bashkë me të edhe martesë, zënë fill mbas miratimit të kodit civil të Mbretërisë Shqiptare, e më vonë me futjen e shtëpive publike, ngritjen e manastireve, dhe institutit e burrneshave, ku roli i fejesës sa vjen edhe zbehet. Kjo duket më së miri te kodi i familjes së RPSH-së, i vitit 1962, ku fejesa as nuk përmendet fare. Këtu hyn në lojë partia, e cila të rrit, të edukon, të zhvillon, të marton, të dërgon në aksione dhe në fund të flijon për interesa të saj. E njëjta situatë ka ndodhur edhe gjatë studimit dhe kërkimit shkencor ku këto elemente janë zhdukur me pretendimin se i përkasin historisë dhe një epokë tjetër ka ardhur dhe ka hedhur rrënjë. Kjo është epoka e propagandës komuniste, e cila ka si parim të saj zhdukjen e familjes, të fejesës, të kontrollit përmes levave të saj që partia ka në përdorim për të fituar një familje pa familje, individ pa identitet kombëtar, pa të kaluar dhe si rrjedhojë e pa të ardhme, më saktë proletar, të cilët në rendin kapitalist kanë ndryshuar vetëm emrin dhe quhen emigrantë, apo ekstrakomunitarë mbi bazën e parimeve marksiste - leniniste. Mund të themi se ia arritën ta zhvishnin njësinë bazë të shtetit, familjen.

Çfarë është fejesa?

Ndër kohëra familjet i kanë kushtuar kujdes të posaçëm shqyrtimit të rrethanave para lidhjes martesore dhe i kanë dhënë asaj ceremonialitet tejet të madh, për të shprehur gëzimin, lumturinë e vlerësimin për këtë hap në jetë. Kanuni i Lekë Dukagjinit, Krye i Tretë. Shkuesia-Fejesa&.37. Përcaktimi i shkuesit. Shkues thirret njaj, i cili rreket m'u ba fjalë-mirë a te prindja e djalit a te prindja e vajzës, qi të marrin a të napin vajzën për at djalë.

Sipas **Legjislacionit të Traditës Profetike, Sejid Sabik** fejesa nënkupton kërkesën për t'u martuar sipas mënyrës së njohur nga njerëzit. Fejesa i paraprin martesës, fq 105, fejesa është vetëm premtim për martesë dhe jo detyrim i **legjislacionit të traditës profetike sejid sabik** fq. 98 të njihen bashkëshortët e ardhshëm dhe të hedhin hapin të vetëdijshëm drejt martesës.

Çifti i dashuruar me autor sociologun Leo Bucshalia, f.20. Martesa e tyre u bë me ndërhyrjen e familjarëve... Kur të dyja familjet e prenë fjalën, babanë filluan ta ftonin në shtëpinë e nënës.

Brenda të njëjtit shtet dhe përtej kufijve të tij, elementet bazë të formimit të familjes janë të njëjtë. Me kalimin e kohës këto elemente diku shumë e diku pak, tejkalojnë veten e tyre dhe ndërthuren me elementë jorealë për qëllimin e së cilës janë formuar.

Kur mund të bëhet fejesa?

Anthony Giddens Sociologji, f. 164. Përse ndodh që moshja mesatare e ardhjes së menstruacioneve nga 14.5 vjeç të zbresë në 12 vjeç, ai e lidh me kohën e ardhjes së ciklit menstrual.

Gruaja në Shqipëri (1912 - 1939) Fatmira Musaj, f. 28. Duke u mbështetur në të dhënat dokumentare pas formimit të shtetit kombëtar, zakoni i fejesës së vajzës në mituri kryhej edhe duke u nisur nga interesa përfitimi, ç'ka preku karakterin e të zgjedhurit të miqësisë.

Ceremoniali i dasmës fejesa në Shkodër, zakone, tradita, f.56. Vasha e premtuar për martesë është në bash të moshës. f.59. Vasha merret në mbrojtje pikërisht pse është e pafajshme, e vogël.

Kodi Penal i RPSSH, botim i Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri" më 15.6.1977

Krime kundër moralit shoqëror Neni 189. Fejesa e personve nën moshën e caktuar nga ligji për martesë...

Nga ajo çfarë bie në sy, është moshja e duhur për fejesë, e cila duhet thënë se nuk është e përcaktuar në të gjitha shoqëritë dhe popujt. Ajo çka vlerësoj ka lidhje me ardhjen e menstruacioneve, që do të thotë se vajza ka hyrë në fazën e pjekurisë së saj seksuale dhe është e aftë para kontaktit fizik me partnerin, të mbajë një fetus brenda saj. Kjo është vërtetuar edhe biologjikisht, pasi femra ka arritur që këtë fetus ta rrisë dhe ta nxjerrë në jetë. Mirëpo ajo çfarë vërej, është abuzimi dhe loja e shëmtuar e njerëzve dashakeq të cilët përmes instrumenteve ligjzbatues, normave dhe legjislacioneve respektive, kanë ndërhyrë me forcë mbi moshën e vajzës dhe djalit, duke devijuar nga qëllimi final, riprodhimin e vetvetes. Kjo është dukshëm bindëse edhe në ato pak referenca, ku moshja për fejesë ishte atribut i interesit të kryefamiljarit, duke humbur rëndësinë e vet, dhe u keqpërdor për fitime të momentit. Kultura etnocentrike vazhdon të dominojë të gjithë jetën e vendit.

Fejesa institucion paramartesor, domosdoshmëria e tij.

Fejesa institucion paramartesor, traditë dhe zakon.

Kanuni i Lekë Dukagjinit Nye i Gjashtëmbëdhjetët, Fejesa &.39. Të ndaluemt e martesës në Kanun. Në fakt për hir të së vërtetës kanuni i Lekë

Dukagjinit e njëjtte zyrtarisht institutin e fejesës.

Kodi Civil i vitit 1929 i kohës së Zogut.

Fejesa Neni 114. Fejesa formohet me premtim martesë dhe bahet simbas zakonit të vendit. Fejesa nuk detyron të fejuemin të ndaluem ose të mitun, përveç kur ky ka pasë moshën e lypun për martesë dhe ka marrë pëlqimin e përfaqësuesit ligjor të tij.

Ceremoniali i dasmës fejesa në Shkodër, zakone, tradita, fe, f.51.

Cikli i këngëve të fejesës lidhet me zakonet që kanë të bëjnë me momentin e dhënies së fjalës për lidhjen e krushqisë, me shenjën e fejesës, që nënkupton ceremoninë përkatëse dhe dhuratat e bëra me këtë rast... .. prenja e fjalës për fejesë dhe shkëmbimi i nishaneve ishin një angazhim aq publik, sa njerëzit konsideronin ekuivalent me lidhjen ligjore të çiftit. Ndër kohëra familjet i kanë kushtuar kujdes të posaçëm shqyrtimit të rrethanave para lidhjes martesore dhe i kanë dhënë asaj ceremonialitet tejet të madh, për të shprehur gëzimin, lumturinë e vlerësimin për këtë hap në jetë.

Deri në kufijtë e shekullit XX, fejesa do të ishte instituti i vetëm, nga i cili do të varej shumë e ardhmja e familjes shqiptare. Për shkak të rolit shumë të rëndësishëm, ajo do të bënte vend në të drejtën zakonore dhe traditën e familjes shqiptare edhe gjatë gjithë shekullit XX. Do të ndikonin shumë mbi të drejtat kanonike dhe sherriati, për t'u trasmentuar në breza. Me futjen e kapitalizmit si rend botëror, në fillim të viteve 1900, ndikimi i kulturës perëndimore do të ishte përcaktues për të ardhmen e familjes dhe institutit paramartesor, fejesës. Pra në këtë rast, kemi lëshim nga terreni konservator etnocentrik, drejt një fillimi të ri, relativizmi kulturor.

Fejesa shndërrohet në ligj përmes kodit të familjes

Gruaja në Shqipëri (1912-1939) Fatmira Musaj.

faqe 175., Në sherriat ndalohej vënia e kurorës me një femër që ka pirë qumësht me një mashkull, duke i quajtur vëllezër qumështi, kurse Kodi Civil, përkundrazi, e lejonte. faqe 209 ... përcaktonte si moshë optimale për fejesën e vajzës moshën 14 vjeç, si dhe ndalonte fejesën pa dëshirën e saj, faqe 81. Anë tjetër e diskriminimit të femrës në institucionin e fejesës në këtë periudhë ishte martesë e vajzave me djem në moshë më të vogël.

Çifti i dashuruar me autor sociologun Leo Bucshalia f.20. Martesa e tyre u bë me ndërhyrjen e familjarëve... Kur të dyja familjet e prenë fjalën, babanë filluan ta ftonin në shtëpinë e nënës... Nëna ishte gjithmonë e pranishme, por kurrë nuk mund të ngelej vetëm me babanë. Në fakt gjurmët e saj i gjejmë te të gjithë popujt e tjerë. Ndryshon vetëm forma se përmbajtja është e njëjtë, qëllimi dihet përse bëhet dhe finalizimi është martesë. Nga një traditë dhe e drejtë zakonore, fejesa u institucionalizua në ligj dhe kodin e familjes 1928 mbreti zog.

Kodi Civil i vitit 1929 I kohës së Zogut. Fejesa Neni 114. Fejesa formohet me premtim martese dhe bahet simbas zakonit të vendit. Fejesa nuk detyron të fejuemin të ndaluem ose të mitun, përvec kur ky ka pasë moshën e lypun për martesë dhe ka marrë pëlqimin e përfaqësuesit ligjor të tij.

Ceremoniali i dasmës, fejesa në Shkodër, zakone, tradita, fe f.51.

Martetat bëheshin me krushqi të menduara edhe për të krijuar aleanca midis familjeve të të njëtit rang (familje të pasura, të mesme, të varfra).

Ajo çfarë vihet re, me shqetësim, është dalja nga natyrshmëria e saj origjinale dhe vënia përballë një fakti kokëfortë, me hyrjen e kodit të familjes e më pas me sanksionimin e një diktature, ku normat dhe ligjet e saj, bënin të mundur një revolucion të shtrënguar të detyruar, për njësinë bazë të shtetit siç është familja. E gjithë historia e njerëzimit, pjesë e së cilës jemi, hidhet poshtë ose mohohet me dashje, duke përcaktuar rregulla të reja loje, të cilat për mendimin tim, vënë në rrezik serioz të ardhmen e njerëzimit. Kush e bëri, dhe pse e bëri ngelet për t'u parë. Këto norma, ligje dhe sanksione ndëshkuese e fusin individin, fejesën dhe martesën në një *darrë shtrënguese*. Të huazuara, përmes procesit të difuzimit, dhe natyrës ksenocenteike, ato futen në jetën politike, ideologjike, ekonomike dhe socialkulturore të vendit dhe brenda një kohe të shkurtër arrijnë e bëhen, norma zakone e tradita të një kulturore entnocentrike. Dëmi është shumë i madh.

Me kë lejohet fejesa,

Anthony Giddens Sociologji, f. 375. Marrëdhëniet seksuale para dhe jashtë martese ishin normale në Evropën mesjetare. Madje në disa rajone mashkullit i lejohej të provonte aftësinë e gruas së ardhshme për mbajtjen e fëmijës, duke u përpjekur që ta linte shtatzënë.

Kanuni i Lekë Dukagjinit. Në fejesë varzash dotë shikjohet; me këdo përveç rasteve : a)Të mos jetë gjak egjini; b)Të. mos jetë tënjis fisi;c)Të mos jetë mesë fisi të djalit, që do me xanë ;d)Të mos jetë grueja e lshueme:e)Të mos ketë kumari:1-në. të peshuem. në derë tëkishës .2-në. Kunorë 3-në. të marrun të flokëve 4-të mos jetë vllaznue me gjak të pim. Kanuja s'e ban fejesen e martesën, kur të ndermjetsohen ndalimete naltpermenduna, edhe në katëriind breza me kenë.[1]

Legjislacionit të Traditës Profetike Sejid Sabik, f. 99, të mos ketë pengesë fetare, dhe të mos i ketë paraprirë dikush tjetër për t'i kërkuar dorën. Nëse dikush nuk e din nëse ajo është e kënaqur me të fejuarin e parë, dhe anon nga ai, atëherë atij i lejohej fejesa me të.

Ceremoniali i dasmës fejesa në Shkodër, zakone, tradita, fe, f.51.

Martestat bëheshin me krushqi të menduara edhe për të krijuar aleanca midis familjeve të të njëtit rang (familje të pasura, të mesme, të varfra). f.52-53. Për të njohur vajzën e për t' u bërë garant ...dërgohej një grua që mund të hynte në shtëpinë e saj për ta parë...rolin e shkuesit për të krijuar fjalën e fejesës e bënin kurdoherë burrat. Shkuesi ishte ndërmjetës për një fejesë.

Kodi Penal i RPSSH, botim i Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri" më 15.6.1977

Krime kundër moralit shoqëror Neni 189. Fejesa e të miturve. Fejesa e personave nën moshën e caktuar nga ligji për martesë ose shtytja për t'u fejuar nën këtë moshë, të bëra nga prindërit, kujdestari ose persona të tjerë, dënohen: me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

Ceremoniali i dasmës fejesa në Shkodër, zakone, tradita, f.55.

... në fillim të shekullit XX ndër katolikët zakonet kanë ndryshuar, duke u ndikuar nga sjellje evropiane, shumë më shpejt se sa ndër myslimanë. Fejesa, në të gjitha familjet qytare, bëhej fakt i kryer nga prindërit; të rinjve sidomos vajzës, i kërkohesh një mendim formal, ose vetëm sa i komunikohesh këputja e punës për fejesë. Lidhjet e krushqive të realizuara kështu, me nismën e vendimin e prindërve i bënë ata të mbanin një përgjegjësi shumë të madhe për mbarëvajtjen e jetës së mëtejshme të fëmijëve të tyre.

E drejta zakonore e orientonte fejesën drejt formimit të një familjeje të qëndrueshme. Dualiteti kudo zë vend dhe gërryen të drejtën kanonike. Fejesa gjatë sundimit të sistemit të diktaturës do të ishte përcaktuese e vetme e një vije të kuqe të PPSH dhe ideologjisë marksiste e cila do të ndikonte drejtpërsëdrejti mbi përcaktimin dhe më pas pëlqimin e fejesës sipas standardeve dhe nevojave që ishin përcaktuar nga ideologjia komuniste. Në raport me të drejtën zakonore, me traditën e ruajtur në bazë të krahinave, me kodet dhe kanonet respektive në bazë të religjionit, fejesa dhe më pas martesa do të shihej si një e keqe e madhe për interesat e mëdha të popullit dhe atdheut. Ajo do të ekzekutohej përmes kodit të familjes, dhe jo vetëm kaq, por mbi bazën e familjes pa familje, pa individ, pa të kaluar dhe njëkohësisht edhe pa të ardhme, do të miratoheshin kode familjeje dhe ligje në mbështetje të tyre, kodi penal, për të përfituar një familje shportë e kashtës. Kjo familje do të ishte një hybrid i importuar nga jashtë, nën pretendimin e ruajtjes së shtetit dhe forcimit të diktaturës që ne po zhvillonim në luftë të papajtueshme me elementët arkaikë reaksionarë dhe manipulues të fesë, traditës dhe së drejtës zakonore. Pra elementët e njëpasnjëshëm të ndërtimit të familjes, zhbëhen dhe vendin e tyre e zë e drejta familjare mbi bazën e kulturës ksenocentrike. Revolucioni më i poshtër dhe i

shëmtuar do të vazhdojë deri në deformimin e familjes shqiptare.

Çfarë ndodh kur refuzohet fejesa.

Legjislacionit të Traditës Profetike Sejid Sabik, faqe 99. Ndalohet fejesa e gruas gjatë periudhës së pritjes. Faqe 101. Ndalohet fejesa e një burri me të fejuarën e dikujt tjetër, sepse kjo konsiderohet shkelje e të drejtave të të fejuarit dhe ofendimi ndaj tij.

Gruaja në Shqipëri (1912-1939) Fatmira Musaj, faqe 175. Në sheriat ndalohej vënia e kurorës me një femër që ka pirë qumësht me një mashkull, duke i quajtur vëllezër qumështi, kurse Kodi Civil, përkundrazi, e lejonte. Faqe 209, përcaktonte si moshë optimale për fejesën e vajzës moshën 14 vjeç, si dhe ndalonte fejesën pa dëshirën e saj.

Kodi Civil i vitit 1929 i kohës së Zogut. Fejesa. Neni 115. I fejuemi që refuzon martesën nuk mund të shtrengohet me u martue. Damshpërblimet e paktueme si gjobë për rastin e refuzimit të martesës nuk mund të kërkohen.

Kodi Civil i vitit 1929 i kohës së Zogut.

Fejesa, Neni 114... Fejesa nuk detyron të fejuemin të ndaluem ose të mitun, përveç kur ky ka pasë moshën e lypun për martesë dhe ka marrë pëlqimin e përfaqësuesit ligjor të tij.

Elementët e diktaturës së proletariatit, si lufta e të kundërtave shihen mjaft qartë në të gjithë punimin. Sipas tyre e vjetra luftohet në gjirin e familjes, zhvillohet dhe pasurohet në gjirin e klasës punëtore dhe orientohet nga PPSH-ja dhe farkëtohet përmes mësimëve dhe ideologjisë marksiste –leniniste në luftën e të kundërtave. Të huaja për sistemin komunist janë dogmat me natyrë fetare, tradita në bazë të krahinave dhe e drejta kanonike dhe ajo sherriatike. Përgjatë shekullit XX, në rast se refuzohej fejesa e pagëzuar nga PPSH, mbahej qëndrim radikal. Fejesa në djep që ndodhte jo rrallë në krahina të ndryshme veriore, kodi i familjes dhe ai civil i zogut që kishte nene përjashtimore nga mosha për martesë në raste të ndryshme, si ngelja shtatzënë, e kundërshtonin indirekt moshën e përcaktuar në ligj e cila bëhej për një arsye të vetme, uljen e lindshmërisë natyrale, dhe përcjelljen e moshës në kufijtë e ngeljes beqar.

Prishja e fejesës, kur ndodh ajo dhe pasojat e saj.

Legjislacionit të Traditës Profetike Sejid Sabik

Kodi Civil i vitit 1929 i kohës së Zogut. Fejesa

Neni 116. Kur një nga të dy palët do me cartë fejesën, detyrohet me ia ba të ditun anës tjetër me ndërmjetësinë e një përsonei të besueshëm ... dhe në rast që ana e lejueme nuk u bindet aryeseve per të cilat kërkohet cartja ose e quen veten të damtueme, cashtja i referohet një konisioni arbitror të formuem prej katër ose gjashtë vetash, të cilët do të jenë nga gjinia ose miqtë e të dy palëve dhe do të zgjidhen në numër baras nga të dy anët. Ky komision mund të marrë edhe një sipërarbitër. Neni 117. Kur njeni prej të dy të fejuemve cart fejesën pa shkaqe të arsyeshme, ose kur ajo cartet prej njenit ose prej tjetrit nga shkaku i një fakti që i ngarkohet njenit prej të dyve, ana fajtoe detyrohet me i pague anës tjetër, ose prindërve ose personave të tretë që kanë veprue në vend të këtyne, një shpërblim të arsyeshëm përshpenzime t që kanq ba me mirëbesim, duke pasë

parasysh martesën.

Legjislacionit të Traditës Profetike Sejid Sabik, f.105, nuk lejohet kthim mbrapa i dhuratave ndërsa mehri që është pagesa e martesës kthehet.

Gruaja në Shqipëri (1912-1939) Fatmira Musaj, faqe 204. Për të shmangur hakmarrjen ndaj familjes dhe çdo formë presioni për ta kthyer në shtëpi ... vajzat, edhe pse nën mbrojtjen e kishës, u detyruan të betoheshin se nuk do të martoheshin asnjëherë. Një pjesë e kërtyrë vajzave, me ndihmën e kishës, morën rrugën e kuvendit të murgeshave, f. 209. Në tri nenet e para ligji merr në mbrojtje vajzën në tri momente të rëndësishme në institucionin e fejesës. U hiqte prindërve ose kujdestarëve të drejtën për të fejuar vajzën në moshë të mitur, faqe 33. Në gjysmën e dytë të shek.XIX dhe në fillim të shek.XX e drejta e virgjërisë filloi të shfrytëzohej edhe nga vajzat e fejuara që, për arsye të ndryshme, vendosnin të prishnin fejesën ... pas prishjes së fejesës, filluan t'u drejtoheshin institucioneve fetare, dioqezave, kishave, ku kërkonin mbështetjen e klerikëve për të kapërcyer vështirësitë që krijoheshin...ato kërkonin të bëheshin murgesha ose të mbylleshin në manastire.

Kodi Civil i vitit 1929 i kohës së Zogut. Fejesa. Neni 118. Kërkimi për shpërbllim moral është i pacënueshëm, por u shkon trashëgimtarëve në qoftë se ka qenë i njohur prej anës tjetër ose padia kundra debitorit ishte ngritur në kohën e çeljes së trashëgimit.

Legjislacionit të Traditës Profetike sejid sabik, f. 105, profeti muhamed ka thënë :shenjate hipokritit janë : kur flet, gënjen, kur premton nuk e mban fjalën, dhe kur i besohet diçka, tradhëton.

Gruaja në Shqipëri (1912 - 1939) Fatmira Musaj, f.55...në fillim të shekullit XX ndër katolikët zakonet kanë ndryshuar, duke u ndikuar nga sjellje evropiane, shumë më shpejt se sa ndër myslimanë.

Fejesa, në të gjitha familjet qytetare, bëhej fakt i kryer nga prindërit; të rinjve sidomos vajzës, i kërkohej një mendim formal ose vetëm sa i komunikoheshin këputja e punës për fejesë. Lidhjet e krushqive të realizuara kështu, me nismën e vendimin e prindërve i bënin ata të mbanin një përgjegjësi shumë të madhe për mbarëvajtjen e jetës së mëtejshme të fëmijëve të tyre. Neni 119.Të fejuemit në rast që cartet fejesa, mund të kërkojnë kthimin e peshqeshesheve që i kanë dhanë njëni- tjetrit. Në qoftë se këto nuk gjenden ma në natyrë, kthimi bahet simbas parimeve të caktueme për rastet e begatimit pa shkak. Kthimi i peshqesheve nuk mund të kërkohet kur fejesa çartet me vdekje. Paditë që rrjedhin nga fejesa parashkruhen mbas një viti që prej çartjes së fejesës.

M, **Tirta, Etnologjia e Shqiptarëve**, f. 276, prishja e fejesës pa shkaqe të arsyeshme, shkaktonte pasoja juridike...

Ndonëse ishte e lejueshme prishja e fejesës, në të drejtën kanonike, shariat dhe atë zakonore, përgjegjësia nuk lihej jetime.

Ndërsa sot ndodh një fenomen i ri, bashkëjetesa mes dy të rinjve, shihet si **gurr** prove për një martesë të suksesshme, vetëm se nuk dihet jetëgjatësia e saj.

Qëllimi i fejesës.

Legjislacionit të Traditës Profetike Sejid Sabik f. 98, përzgjedhja e bashkëshortit.

Kodi civil i vitit 1929 i kohës së Zogut. Fejesa të përfitohej një martesë e fortë e qëndrueshme dhe e lumtur. Neni 114. Fejesa formohet me premtim martesë.

Çifti i dashuruar me autor sociologun Leo Bucshalia Neni 114. Fejesa formohet me premtim martesë

Kanuni i Lekë Dukagjinit &.29. Mëndyrët e martesës[1]: a)Martesa me kunorë, e pëlqyeme kah Feja e kanuja e Lekës;b)

M. Tirta, Etnologjia e shqiptarëve, f. 272 të realizonte një martesë ku prioritet ishin interesat e familjes.

Ceremoniali i dasmës, fejesa në Shkodër, zakone, tradita, fe, f.52.

Krijimi i familjeve të reja ishte në qendër të vëmendjes së prindërve ... Martesat bëheshin me krushqi të menduara edhe për të krijuar aleanca midis familjeve të të njëjtit rang (familje të pasura, të mesme, të varfra). Lidhej çifti, por lidheshin edhe familjet, gjaku bashkohej ndër nipër e mbesa. Ndaj bëhej kujdes të zgjidhej si vajza apo djali, aq edhe familjet, të cilave u shikohej burrëria, besa, bujaria, fisnikëria...

A ka ngjashmëri dhe dallime mes dhënies së fjalës, fejesës dhe bashkëjetesës.

Te e para kemi marrëveshje në mes prindërve të dy të rinjve pa marrë parasysh pëlqimin e të rinjve për shijet dhe ndjenjat e tyre. E pasqyruar të Kanuni i Lekë Dukagjinit më së shumti.

Te e dyta kemi marrëveshje mes të rinjve dhe prindërve të tyre duke e ligjësuar para opinionit publik. Kjo vërehet më shumë në shoqërinë tonë para epokës së shtetit shqiptar, aty ku gjen një përhapje të gjerë sheriati dhe e drejta kanonike ortodokse pjesërisht kryesisht te e drejta zakonore, dhe elemente të saj i gjejmë deri në kufijtë e ndërrimit të sistemit, në fund të viteve 80, por gjithnjë duke u zhdukur instituti i fejesës.

Te e treta kemi marrëveshje të pashkruar mes dy të rinjve të cilët vendosin që për një kohë të jetojnë bashkë pa pëlqimin dhe aprovimin e prindërve. Te e treta, kemi elemente moderne, bashkëkohore evropiano - perëndimore kryesisht, të cilat datojnë fillimet e saj që nga kodi civil i Zogut, në mbretërinë e vitit 1928, e vijnë duke u formësuar në kodet civile të sistemit socialist proletar, duke u bërë faktorë vendimtarë të trendit të zhvillimit të kodit të familjes pas hyrjes së vendit në epokën e lirisë së pakufizuar në dukje.

Frika që vihej re në periudhën pas viteve 1945 e këtej nga prindërit për fëmijët e tyre dhe kryesisht për femrat apo vajzat, është e njëjtë me frikën dhe terrin që vihet re sot te prindërit e rinj pas viteve 90-të me lejimin e *pluralizmit (për këtë shiko z.Dervishi demonët e konflikteve dhe gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik), faqe 79 kreu i parë. Gjendja e klasës punëtore f. 8, 177, 216.*

Sot, dhënia e fjalës ndërmjet dy familjeve, e ndodhur më së shumti në kodet dhe kanunet e ndryshme, është zhdukur thajse fare.

Pyetjet problemore:

Nëse nuk pyetet prindi mbi martesën çfarë mund të ndodhë?

Nëse nuk do të ekzistonte fejesa çfarë pasojash mund të kishim?

Nëse humbet qëllimi i fejesës çfarë mund të përftohet?

Nëse elementët e së drejtës zakonore dhe asaj kanonike, mbi institutin e fejesës, dalin nga qarkullimi, si mundet të funksionojë shoqëria?

A është i mjaftushëm kodi i familjes për të administruar shoqërinë?

Me kë nuk është e pëlqyeshme të realizohet fejesa?

Kur mund të kemi deformim të shoqërisë?

Materiali është marrë në arkivat e bibliotekës kombëtare, ndër të vetmet burime serioze të vërteta për të realizuar studimin mbi fejesën. Janë shfrytëzuar për këtë qëllim literaturë vendase dhe e gjithë puna është bazuar mbi metodën e rishikimit të literaturës, përmes studimit të fakteve, jam përpjekur të ndërtoj punën time.

Konkluzionet: si rezultat i punës studimore mbi bazën e kërkimit shkencor mbi vepra të ndryshme dhe kodin e familjes, dal në përfundimin se fejesa është një domosdoshmëri jetike për të ardhmen e njerëzimit, përkundër saj do të kemi një shoqëri në anarki të plotë ku nuk do të njohim njëri - tjetrin, dhe jo më pasardhësit tanë. Fejesa ka qenë, është e do të jetë paradhoma e familjes së shëndetshme.

Bibliografia

- Leo Bucskaglia, Çifti i dashuruar, Shtëpia botuese *Plejad*, 2001, Tiranë.
- Ceremoniali i dasmës, fejesa në Shkodër, zakone, tradita, fe, 2012.
- Kodi Penal i RPSSH, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri" 1977, Tiranë.
- Shtjefën Gjegovi 1933, Kanuni i Lekë Dukagjinit ribotim i vitit 2001, Tiranë.
- Anthony Giddens, Sociologjia, Shtëpia botuese *Çabej* (1999).
- Kodi civil i vitit 1929 i Zogut. Tiranë.
- Sejid Sabik, Legjislacioni i traditës profetike, Shtëpia botuese "Milenium i Ri" Tiranë, Vëllimi dytë 2008.
- Fatmira Musaj, Gruaja në Shqipëri (1912 - 1939) botim i Akademisë së Shkencave 2002.
- Mark Tirta, Etnologjia Shqiptare, Tiranë, GEER, 2003 vëllim i dytë.
- Z. Dervishi, Demonët e konflikteve, Shtëpia botuese *Jerusalem*, Tiranë, 2001.
- F.Engels, Gjendja e klasës punëtore në Angli, Shtëpia botuese *Naim Frashëri*, Tiranë, 1970.

ISSN 2221 – 6863

*Doli nga shtypi korrik, 2021 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x 250 mm.
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës
“Luigj Gurakuqi”*